

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS  
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

Ali Podrimja

# VEPRA

VËLLIMI I NËNTË



PRISHTINË, 2013

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS  
SECTION OF LITERATURE AND LINGUISTICS

Ali Podrimja

# WORKS

IX

Editorial board:

Ali Aliu, editor  
Rexhep Ismajli  
Eqrem Basha  
Sabri Hamiti  
Mehmet Kraja



PRISHTINË, 2013

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS  
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

Ali Podrimja

# VEPRA

VËLLIMI I NËNTË


Redaksia:

Ali Aliu, redaktor përgjegjës  
Rexhep Ismajli  
Eqrem Basha  
Sabri Hamiti  
Mehmet Kraja



PRISHTINË, 2013







**DIELLI I ZI**  
(ESE DHE SHËNIME NGA ESNAFI KRIJUES)

“Rilindja”, Prishtinë, 2000





## SHQETËSIMET E IMAZHIT TË RI

Ka ndodhur thyerje e papritur para teje. Krijuesi nuk është më ai me qetësinë e artikulimin e të cilit je mësuar. Para ke një imazh të ri, përmasash e formash të ndryshme. Përmes xhamit të thyer vëren shfaqjen e diçkajes, që në tekst mund të hyjë si ide rrëqethëse e momentit. Patjetër do të ndikojë edhe në interpretimin tënd ku, ndoshta, mungojnë fjalët çelës: pse ndodhi kjo derisa pija unë çaj apo shkruante ai një libër mbi të kaluarën njerëzore?

Nuk ekziston më as rendi dhe nuk di në cilën karrige ishe ulur. E kupton dikur se një fuqi e padukshme të vë në lëvizje për të gjetur shkak-pasojën e thyerjes së xhamit. Se krijuesi nuk është më ai i mëparshmi, që përcillte fluturimin e fluturës në kopsht, ato rrotullime farfuritëse, magjike. Tani ai është tjetër, vështrues kurioz, pakëz i humbur. Nuk ka probleme vetëm me fjalë, me përmbajtje, me ide, me mesazhe. Kontrollimi i gjërave është më i vështirë, seleksionimi. Edhe ai jeton në një imazh shqetësues, që mund të ndikojë në perceptim dhe në të menduar. *Toka e djegur* (term i Eliotit) apo ai xham i thyer në dritare ka shkaktuar çrregullime e në ty rrëtime të brendshme.

Para teje shfaqet njeriu me një kostum tjetërfare, që e ke parë në ndonjë film apo muze historik. Më vonë ato tesha i hedh. Refuzon t'i veshësh mbasi frikëson se nuk të rrinë bukur, ose nuk dëshiron t'u përngajë atyre të përrallave. Me një ndërrim të papritshëm nuk je mësuar. Duhet kohë të bëhet i lexueshëm dhe ta mundesh zjarminë.

Morbiditeti vë në sprovë të madhe krijuesin: nga të niset, çka të zgjedhë, çfarë mesazhesh; të kundërshtojë marrinë njerëzore apo të pranojë çfarëdo vlere nga ajo thyerje e qetësisë. Bindet, megjithatë, se teksti i mungon diç. Është më i vetëdijshëm për atë që ndodhi, se kur e takove para se të thyhet xhami, kur fjalët i shpalosje me kujdes në një qetësi olimpike, të themi.

Mirëpo, me shfaqjen e asaj hije të rëndë në dritare bindesh se ndërrohet edhe ti: nuk je mësuar njeriun ta shohësh jashtë vetvetes; ke besuar se është i vetes dhe është i kohshëm. Pranon se thyerjet kanë dorë në interpretimin e gjërave: botën dhe fatumin njerëzor e sheh krejt ndryshe, vizion i ri. Nga kaosi me përmasa biblike, detyrë e parë të shpëtosh credon krijuese, ndërgjegjen. Duhet bërë këtë për hir të njeriut, lexuesit, artit. Me pasoja merren projektuesit e të ardhmes kur ujku mbyllet prapë në ndonjë përrallë. Komunikimi me të ardhmen nuk është shkëputje nga e kaluara. Përkundrazi, grith kujtesën, se krijuesi fillon punën e filigranit; nga të bëmat ka pak fjalë, që mund të hyjnë në mjeshtërinë e tekstit.

Fatkeqësisht, kaosi ka ndodhur. Gjërat nuk janë aty ku i ke lënë as nuk mund t'i gjesh lehtë nga drita e kuqe, që pushton hapësirën në mënyrë të habitshme. Nuk ekziston më as biblioteka. Prapë të del punë me kujtesën: nga fillim duhesh t'ia fillosh ndoshta se i ngjan cungut të hedhur ndanë udhe.

Rindërtimi nuk shkon aq lehtë. Nuk të kujtohet se ç'ndodhi më parë me xhamin në dritare, çfarë fuqie demoni e theu atë derisa pije çaj apo flitje me perëndinë. Thyerja krijoi imazhin e ri. Aty gjendesh. Si të dilet? Vë në veprim fuqinë mendore: së paku të vësh rregull edhe në tekstin mbi të papriturën, që ndodhi kur besoje se nuk do të përballësh me shpirtra, me atë hijen e rëndë në dritare. Të mundshmen kërkon ta shpëtosh nga e pamundshmja, e cila mund të humbasë edhe kontrollin mbi fjalët gjithnjë më nevrrike.

Dikur pranon se edhe në ty ndodhin tërmete: nuk mund ta shohësh xhamin e thyer, të kujton çaste trishtuese. Marramendthi njerëzor tek ka filluar, i cili bën trysni në ty pa dëshirën tënde. E sheh se nuk bën të shkëputesh nga ajo që ndodhi pak më parë; të vjen turp të pranosh se *toka e djegur* nuk ka ndodhur; se njeriu nuk ka pasur një kostum tjetërfare apo pija çaj në një ballkon hyjnor, i lumtur se më në fund në krahun tim kishte rënë flutura. Nuk e vraja mendjen fare se nën dritaren tonë ndodhte irracionalja...

(25-26 qershor '99, Mynben)

# MBI FATIN DHE MJESHTËRIT E ÇELËSAVE

## PASQYRA E NJË FATUMI

*(Fjalë e mbajtur në PEN-in gjerman)*

Problemi juaj më besoni apo jo, vetëm më vjen turp të flas para këtij tubimi se ç'ndodh në vendin tim. Së pari, atje është lënduar rëndë personaliteti i njeriut; së dyti, nuk dalluaka njeriu shumë nga kafsha dhe mund të bëka edhe më të keqen. Vërtet, më dhemb ajo që ndodh atje. Tragjedinë e popullit tim e shoh edhe në kuadër të tragjedive të ish-bashkësisë jugosllave. Për këtë fatkeqësi, që u shkallëzua në fillim të viteve '90, nuk janë fajtorë kroatët, boshnjakët, sllovenët, shqiptarët; nuk mund të jenë fajtorë malazetët e maqedonët, e më së pakti NATO-ja, por regjimi kriminal serb dhe një mentalitet, që e satanizoi edhe popullin e vet, emrin e të cilit nuk mund t'ia them për shkak të kodit etik. Nuk pajtohem me atë se ka popull të mirë e të keq, nuk pajtohem as me tregtinë e popujve, që mund të ndodhë. E keqja gjendet gjithmonë në krye dhe fjalë. E, fjalët shpesh janë vrastare...

Në fjalën time mund të jem ironik, ekuivok, patetik, emotiv; ndoshta për dikë edhe nacionalist, por unë nuk urrej. Nuk mund ta fyej njeriun dhe të luaj me letrenë e nacionalizmit serb. Përpiqem të gjej shkakun e irracionales.

## Pakëz histori

Më me dëshirë do të korrespondoja me të tashmen, por për të painformuarit apo të “bombarduarve” nga gënjeshttra sllave më duhet të dëshmoj se populli im nuk është fis as i trilluar. Është një popull me lashtësi të thellë e kulturë të veçantë. Ptolomeu e vënte bri helenëve të lashtë. Me këtë rast nuk dua të zbres në kohën ilire, dua t’iu kursej edhe juve, por do të ndalem të momentet e para kur sllavët na u bënë fqinj tanë e të cilët ne i njohim më mirë se të tjerët. Ne dimë kush janë, dimë edhe për dinjitetin e tyre. Kërkoj falje, megjithatë duhet të kthehem aty, ku filluan përleshjet tona e që nuk kanë të ndalur.

Para dy vjetësh (Bled, 1997) ca poetë nga Sarajeva derisa më flitnin për spastrimet etnike, më kishte ardhur të qesh dhe nga ky gjest imi ishin prekur ata. Më vonë kisha pasur vështirë t’i bind se për atë që më flitnin, ne shqiptarët e kishim përjetuar në shek. XIX. Mendonin se vetëm ata kishin kaluar nëpër atë filter çnjerëzor. E shihja se shkaktar për këtë ishte gënjeshttra sllave, ato “bombardime” të pseudoshkencës serbe. Dikur ishte sqaruar çdo gjë, edhe pabesia dhe e “vërteta” shkencore serbe, që ishte në fazën kritike të paranojës.

Zotërinj, gjendem në mes jush. Unë i takoj një populli, një historie, një gjuhë e qytetërimi, që u ka interesuar shumë edhe baballarëve tuaj, për kontributin e të cilëve shkencat albanologjike dhe populli im ka një respekt të veçantë. Dua të theksoj këtu se shumëçka në shpinën tonë serbët realizuan dhe me tokat tona bënë kusuritje me të tjerët. T’u mundësojmë këtyre përbindëshave mesjetarë edhe tani të kalojnë mbi trupa e ëndrra tona? Pra, ky tekst mund të fillojë edhe kështu: Dhuna serbe ndaj shqiptarëve autoktonë reprimohet me intensitet të shtuar. Vitet fatale për vendin tim mbetën 1878 (Kongresi i Berlinit), 1913,1919 (Konferenca e Londrës Kosovën ia dhuron Serbisë), 1989 (përçarjet dhe nisja e shpërbërjes së ish-bashkësisë jugosllave, rrënimi i autonomisë dhe i të gjitha institucioneve të tjera) dhe vitet 1998 e 1999 (përgjakjet, shkatërrimet dhe spastrimi i madh etnik i paparë ndonjëherë në historinë njerëzore). Drama në vendin tim ka ndodhur me përmasa biblike. E, Evropa vështirë e ka ta pranojë këtë

se është turpi i saj; se kjo katastrofë ndodh mu në hapësirën europiane. Dhe ajo që ndodh në Kosovë, kam përshtypjen, se pakëz shihet e dëgjohet këtu. Shpesh kam mbetur pa tekst: bëhet ndeshje me njeri apo me kope? Krimi është i organizuar dhe i paramenduar. Varet se në ç'mënyrë dhe nga cili aspekt peshohet. Po ku shpie ky irracionalitet?

Mjaft domethënës është rasti, që e dëgjova këto ditë në vendin tuaj. Berlinezja 15-vjeçare, e quajtur Yvonne (*Bild*, 3 maj) në ekranin TV, duke parë skena biblike nga Kosova, bën vetëvrasje, e frikësuar edhe për gjeneratën e vet. Tmerri apokaliptik bartet në metropolet europiane, bëhet shqetësues edhe në mjedisin tuaj. Në fund të shek. XX mendonim se në mes shteteve, popujve e sistemeve nuk do të ekzistojnë fare mure qikloprike, anktesh. Diku pranë nesh, ose brenda nesh, ndodhin gjëra irracionale: barbaria serbe vështirë frenohet. Çarjet mes shqiptarëve e serbëve marrin dimensione të katastrofave të mëdha. Dhe, gjithë kjo ndodh për shkak të së drejtës për të ekzistuar një popull e kulturë në hapësirën e vet historike e në mënyrë të vet. Dhuna serbe duhet elaboruar edhe përmes përplasjeve të dy qytetërimeve: perëndimor dhe atij lindor, që përcaktojnë deri diku edhe opcionet: demokracinë dhe totalitaren.

Me vjet mulliri propagandues i hegjemonisë serbe shpif e lanson gjithfarë rrenash mbi shqiptarët, alarmon botën me botime gjysmake se shqiptarët na qenkan antieuropianë, fundamentalistë, popull amorf, fisnor, pa kulturë e histori; se nuk dinë ç'është historia, bile këtë e konfirmoi tash së voni edhe Fyteri i tyre. Mirëpo ajo që ndodh pikërisht në vendin tim dëshmon më së miri se kush çka është. Mostoleranca e regjimit kriminal serb shpuri te përgjakja e tmerrshme në mes shqiptarëve autoktonë dhe serbëve ardhacakë. E vërteta, për fat, vazhdon të dalë sheshit. Shqiptarët dinë kur e nga erdhën serbët në Ballkan, këta mjegullojnë gjërat, nuk mund të pajtohen me epitetin ardhacak, as nuk mund të pranojnë autoktoninë e shqiptarëve. Po të pranohej kjo, atëherë ndodh shpërbërja e ëndrrës së hegjemonisë dhe gjithçka që kanë thënë e shkruar për shqiptarët, përfundon me debaklin serb. Në një ditë tjetër do të shikohej *Miti i Kosovës*, nuk do të peshoheshin gjërat nga rrafshi i irracionalës, ku kontribuan dukshëm

pjesa dërmuese e intelektualëve dhe krijuesve serbë. Mesazhet fashistoide u shndërruan në opinionum gjithëkombëtar serb: shqiptarët duhet zhdukur, mendojnë ata; se shqiptarët janë fatkeqësia serbe që penguan shtrirjen e pansllavizmit; se shqiptarët shpërbënë edhe ish-Jugosllavinë. Ndëshkimi ndaj tyre prandaj të jetë i përgjakshëm. Kompleksi i ardhacakut u bë obsesion, paranojë e rëndë. Sipas tyre mënyra më e mirë, të lirohen nga ky epitete, shqiptarët duhet përzënë nga Kosova e më vonë edhe nga Shqipëria. Kujtoni për pak kohë elaboratet e shkrimit pamfletiste të Garashaninit, Vasa Çubrilloviqit, nobelistit Ivo Andriq (gafin e tij e shikoj në rrafshin politik jo në atë letrar), shkrimet kontraverze të Dobrica Qosiqit e deri te krrokatjet memorandike të Akademisë së Shkencave të Serbisë, pastaj pamfletet e llojllojshme të Francuska 7 (Lidhja e Shkrimtarëve Serbë) dhe të atyre individuale. Gjatë kësaj, fushate gjenocidale pakkush ngriti zërin kundër asaj që ndodhi në Kosovë, nuk e panë të arsyeshme as atëherë kur u helmuan mbi 7000 nxënës, pra kur vriteshin edhe lexuesit e veprave të tyre ndoshta. Serbët mendojnë se ku është një varr serb është dhe tokë serbe. Dhe nuk është çudi nëse nesër ndonjë lahtar serb të bëjë ndonjë kallëzim biblik edhe për NATO-n kur u ndesh me azganllëkun serb. Mund të pritët edhe shumëçka nga një popull hyjnor, i cili e shpalli serb edhe Zotin. Po të ishte kështu, si të besoja atëherë në vrasës, në pjellën e së keqes, sidomos tani kur ai Zot shpërbën vendin tim?

Serbët vazhdojnë të besojnë se djepi i serbizmit është Kosova. Duke lexuar gjëra të tilla nuk mund të mos zhgënjehesh se këta nuk e ditkan as historinë e vet; se atë duhet t'ua mësojnë e tregojnë të tjerët, bile ku e kanë edhe djepin. Me këtë rast po përmend vetëm historianin bashkëkohës anglez, Noel Malcolm, dhe veprën e tij: *Një histori e shkurtër për Kosovën*.

Sidoqoftë, djepi nuk është i vetmi problem serb. Kontestohet edhe hapësira Kosovë, historikisht shqiptare. Kur erdhën sllavët në Ballkan, *Kosova* kishte një emër fisnik. Quhej Dardani. Dhe, kjo hapësirë nuk ishte vakuum. Dikush aty jetonte. E, ata ishin shqiptarët, pjesëmarrës edhe në Betejën e Kosovës (1389); gjithmonë mbetën

shumicë edhe në momentin e tanishëm kur bëjnë çmos të na shkulin me rrënjë.

Kohëve të fundit serbët filluan të bëhen edhe argëtues. E trilluan sintagmën *Shqipëri e Madhe*. Ju lutëm, Etnia Shqiptare, sipas logjikës serbe, na shpallet për Shqipëri të Madhe, pra shtrirja gjuhësore, që nuk u krijua në dëm të popujve të tjerë, siç ndodh me Serbinë e Madhe!...

## Realiteti dhe paqja e përgjakur

Dikur kam lexuar me ëndje veprat fantastike. Më ndihmonin në imagjinatën time krijuese. Tani fantastika shpërngulet nga literatura në realitetin e përditshëm kosovar. Dhe pajtohem me atë që e thoshte Borhes: nuk ka gjë më fantastike se realiteti. Po ky realiteti i sotëm kosovar, më bëhet se është diç më fantastik: has trupa pa kokë; koka pa trup fluturon në kozmos, bie diku në ndonjë pus apo gardh, shpirti shndërrohet në diç magjike, me të mund të komunikosh edhe vizuelisht. Rreth teje gjallëron një materie tjetër, që e krijuan mjeshtërit e thikës, se në vendin tim sheh dhe trupa të masakruar të të gjitha gjinive e moshave; ata kanë forma të çuditshme, një postmoderne e rrallë. Dikur bindesh se njerëz të nxjerrë sysh nga thika serbe, që bredhin maleve e fushave, rastësisht ta kujtojnë Homerin. Bindesh se gjërat u përsëritkan dhe të përkujtojnë diç të largët. Fatkeqësisht, këta Homerët e mi dëshmojnë për krimin e organizuar serb. Me çfarë ta krahasoni gruan shtatzënë, që i është nxjerrë me thikë fëmija nga barku? Ky është ai trëndafil i zi, që nuk dëshiron ta shohësh as në ëndërr. Por ky është realitet diku në Evropë. A nuk turpërohem për këtë? Diç më morbide nuk ka ndodhur as në ankitiket. Qindra fshatra nuk ekzistojnë më. Mbi një milion njerëz janë përzënë nga shtëpitë dhe vendi i tyre. Janë plaçkitur edhe të vdekurit. Nuk ekzistojnë shumë objekte historike me vlera muzeale. Nuk ekziston as arkitektura shqiptare. Ndodh të mos ekzistojë nesër as toponomia. Shpopullëzohet nga shqiptarët Kosova!

## Zënkat intelektuale në Evropë

Përgjakja e Kosovës nxori në dritë edhe figurën e intelektualit, e atyre *për ose kundër lirisë*, siç i quajti një mik imi. Përderisa intelektualët e krijuesit serbë u prijnë forcave vrastare të regjimit kriminal dhe mesazhet e tyre aplikohen në spastrimin etnik, në shfarosjen e një populli, intelektualët e krijuesit europianë mbrojnë të drejtën për të jetuar, pra vlerat njerëzore dhe mbështesin intervenimin e NATO-s. Çdo njeri që ka ideal lirinë, e trimërojnë qëndrimet dinjitoze të Gynter Grasis, bie fjala, apo të Herta Myllerit, Habermasit e shumë të tjerëve. Ndërkaq, habit qëndrimi i romancierit subtil austriak Peter Handkës dhe i pacifistëve, që miku im i quajti produkt të neoproletariatit. Unë do t'i quaja nostalgjikë të paqes së përgjakur, të mos them mazohistë. Dhe tek dëgjon fjalimet çjerrëse se duhet të ndërpriten bombardimet e NATO-s, atëherë nuk mund të mos pyesësh, ç'të bukur shohin këta zotërinj në krimin serb, në varret masive, në masakrat shtazarake ndaj shqiptarëve? Çfarë kënaqësie përjetojnë dhe ç'art fsheh thika serbe? Arti i therjes, i krimit mos bëhet dhe art i së ardhmes, i barbarisë njerëzore?

Megjithëse i vonë, intervenimi i NATO-s është dashur të ndodhë. Besoj se u sjell paqen si serbëve, ashtu dhe shqiptarëve. Serbët do t'i lirojë nga diktatura, krimi e turpi mesjetar-njerëzor e shqiptarëve do t'u sjellë të rrëmbyrën e të shkelurën, besimin në njeri e në të ardhmen. Ata që mendojnë ndryshe pavetëdijshëm zhytin popullin serb në krim dhe pranojnë gjenocidin ndaj shqiptarëve. Mirëpo ne duhet të shpëtojmë ndërgjegjen njerëzore, të dallojmë *luftën* nga *krimi*: të bëjmë diç për njeriun se krimi nuk është veti civilizuese e më se paku art që të magjepsë. Në këtë moment nuk mendoj vetëm për popullin tim. Pavarësia ime është pavarësi edhe e fqinjve të mi, që duhet të kuptojnë një herë se kanë të drejtë të jetojnë edhe të tjerët...

## Çelësi dhe Itaka ime

Rastësisht u gjeta në këtë tubim, ku debatohet edhe për fatin e vendit tim. Për këtë u shpreh respektin. Vendi im nuk kërkon më



shumë se i takon. Pra, nuk kërkoj mëshirë, kërkoj nga ju të mbroni vlerat njerëzore, të drejtën për të jetuar. Edhe shqiptarët janë njerëz. Mendoni kështu edhe ju besoj. Foli për ta Ptolomeu i famshëm kur nuk kishin zbritur sllavët ende në Ballkan. Me këtë nuk dua t'i fyej fqinjët e mi shekullorë...

Sipas të gjitha gjasave berlinezja 15-vjeçare, e quajtur Yvonne, bëri vetëvrasje nga frika edhe për gjeneratat e ardhme. Në mesin tuaj shfaqet terri apokaliptik. Siç vëreni vështirë të shkëputemi nga atmosfera e rëndë e poezive të Traklit dhe imazhi i zymtë i Paul Celanit: *Pi qumësht të zji...*

T'i kthehemi laboratorit orvellian, do të ishte fundi i moralit, i humanizmit, i mirëkuptimit, i vëllezërisë njerëzore. Librat tanë do t'i mbyllnim me mesazhin: *ende kaqshët nuk kanë mësuar të lexojnë...*

Nga kjo tragjedi njerëzore arrita të shpëtoj vetëm çelësin e shtëpisë, të ma kujtojë se kam pasur kulm dhe Itakën time.

*(Bremen, 6 maj 1999)*

## KOSOVA FORMË E VRAZHDË E LIRISË

(Fjalë e mbajtur në tryezën “Lufta në Europë”)

Nga kjo godinë e postmodernes nuk ka as një km, një ndërtesë e vjetër dhe e zyrtë, ku filloi tragjedia e popullit tim. Vazhdimisht ky qytet ma kujton tkurrjen e vendit tim. Mirëpo fatin e popullit shqiptar e përjetoi edhe populli gjerman pas Luftës së Dytë Botërore.

Isha në Frankfurt kur ra *Muri i tmerrshëm i Berlinit*. Kisha shkruar ca vargje. Më vonë i pagëzova “*Fatet*”. Rrënimin e tij, e kisha përjetuar: së pari, si fitore të guximit njerëzor e intelektual gjerman dhe, së dyti, të arsyes së rendit të ri botëror që trokiste. Tek e kisha përcjellë si humbte ai në ekranin TV, përfytyroja rënien e një muri më të zyrtë diku në Ballkan. Të dytë i kishin ngritur padrejtësitë. Ky në mes shqiptarëve kishte një datë më të hershme dhe ishte ngritur në rrethana krejt të tjera. Fqinjët e mi kishin grabitur secili nga ca qytete, lokalitete, lumenj...

Në ballafaqime me të keqen shpesh kam përkujtuar këtë qytet. Njëra nga arsyet është se akti i parë i tragjedisë së vendit tim njihet në histori me *Kongresi i Berlinit* (1878), e në kujtesën shqiptare si ditë kur hapësira na ishte copëtuar dhe kishte filluar t’i ngajjë lëkurës së leopardit. Arsyeja tjetër, të dy muret ishin ngritur për shkak të frikës së të tjerëve: si gjermanët, ashtu dhe shqiptarët donin t’i vënin nën kontroll të rreptë.

Bizmarku kishte deklaruar se nuk i njihnte shqiptarët. Mund të copëtohen trojet e tyre. Elita intelektuale gjermane, që merreshin edhe me çështje ballkanike, pakëz ndryshe mendonin. Interesimin e Lajbnicit të famshëm dhe autorëve të tjerë të hapësirës gjermanofone për shqiptarët, nuk mund të mos e pranonin. Të dy muret simbolizonin tragjedinë gjermane, gjegjësisht shqiptare...

Në një kohë e ambient krejt tjetër kur flasim tani për dramën shqiptare në Kosovë, i shohim gjërat në një dritë roze. Jemi më të

moderuar, më njerëzor. Pranojmë lirinë e të drejtën e secilit popull e kulturë për të ekzistuar. Mozaiku i vlerave bëhet më interesant. Fillojmë të lirohemi nga paragjykimet dhe verbëria e së kaluarës. Propaganda mashtruese në stilin serb vështirë gëlltitet. Nga pika e vdekjes lëvizin gjërat. Zgjidhimi i sotëm i Evropës le të kuptosh si përpjekje për të korrigjuar marrëzirat e të kaluarës dhe për të ndërtuar një Evropë të të gjithëve: pra atë të fuqisë së lirisë. Muri i Berlinit nuk ekziston më, me murin tim ç'ndodh?

Poetin grek, Kavafis, ngritja e mureve e tmerronte. I dukeshin diç absurde. Ndajnë qytetërimi e popuj. I kuptonte dhe i trajtonte si kufizim të lirisë dhe normalitetit njerëzor; varfëri shpirtërore e mendore. Muret janë shkaktarë të fatkeqësive të mëdha. Njerëzit e frustuar kënaqen me to. Brenda tyre ngrisin kultet, mbretëritë. Paranoja serbe është variant i kësaj vetëkënaqësie, i vetizolimit, territ mesjetar; bën çmos t'i shtyjë ato edhe më larg. Logjika fisnore murin e konsideron si triumf. Kavafisi dhe rebeluesit e ardhshëm nuk e pranojnë këtë marrëzi të dikatorëve...

Figurativisht koka ime ra atje në Ballkan. Në mes shqiptarëve vazhdon të hijojë muri. Për këtë është fajtor edhe Evropa. Çmendurinë fisnore serbe lejoj të vrasë e rrënojë popuj e kultura të lashta në hapësirën e tyre historike. Ende na pëlqejnë kallëzimet biblike në prag të mileniumit të tretë, ende vuajmë nga egoizmi nacional: të dominimit mbi të pambrojturit, mbi të varfërit. Apo teatri ynë nuk bën pa xhelatë e viktime mbasi do të mungojë prania e publikut. Konkretisht liria ime i ngjan këmishës së përgjakur, që nuk thahet. Shkak është se ca frikësohen nga antikiteti e ca nuk mund të shkëputen nga lashtësia e tyre.

## 2.

Me rastin e helmimit të nxënësve shqiptarë dhe vrasjes së mbi 100 demonstruesve paqësorë në Kosovë (1989) një poet i njohur serb kishte shkruar poezinë *Fëmijët shqiptarë* dhe ma kishte dërguar me lutje: "Ti mund ta botosh. Do të jem mirënjohës tërë jetën se më ndihmon të pështyj në fytyrë nacionalizmin e popullit tim".

Me gjasë poezia u botua vetëm në gjuhën shqipe. Megjithatë, kisha pasur fat më shumë se poeti e miku im nga Sarajeva, Izet Sarajliq. Gjatë luftës në Bosnjë atë e kishte vizituar vetëm një poet serb. Edhe ky kishte qenë i vdekur.

Poeti shqiptar Migjeni thotë: *Liri - Po liri dhe gafornja gëzon por gaforre asht...*

### 3.

Dobrica Qosiq, babai i kombit serb, siç e quan Çarshia serbe, mendohej se e kuptoi më në fund se nacionalizmi ekstrem është fatkeqësi. Përmes intervistës dhënë agjencisë Beta, të dhënë pastaj edhe nga mjetet e informimit gjerman (*Dojçe Wele*), ai u deklarua për ndarjen e Kosovës: të jetë ky kompromis në mes serbëve dhe shqiptarëve. Kjo do të thotë të ketë gjakderdhje edhe më tutje. Zotëria moti përpiqet hapësirën shqiptare ta copëtojë. Nuk i pranon as kornizat e sotme, që ia vunë komunistët në krye të të cilëve ishte edhe ky. Qosiq dëshiron ta sheh Kosovën gjë të vdekur. Çështja e saj, pa shqiptarë, mund të thuhet vetëm atëherë se është mbyllur. Nëse aprovohet ç'ëndërron pseudoshkenca dhe Çarshia serbe, copëtimi i mëtutjeshëm i Kosovës mbetet njollë e zezë në ndërgjegjen njerëzore. Për fatin e Kosovës vendosin, para së gjithash, autoktonët. Kompleks i ardhacakut nuk shërohet me thellimin e tragjedisë shqiptare, me zhdukjen e tyre. Duke parë se paranoja serbe shkallëzohet, një shkrimtar serb tha: kjo luftë mund të jetë e fundit, që e bëjnë serbët me këtë emër. Në të vërtetë, shkrimtari i nderuar ua tërhoq vërejtjen të vetëve për barbarinë ndaj të tjerëve; mbron lirinë e popullit të vet, që varet edhe nga faktorë të jashtëm.

### 4.

Më 25 maj 1999 në Romë, në konferencën me gazetarë, një dezertor ushtarak serb, në mes të tjerash, deklaroi: kishim urdher të vrasim çdo gjë që lëviz. Edhe kafshët. Asgjë të mos mbetet pa u shkatërruar... Nga lektyra e mjerimit njerëzor gjëra të tilla kisha dëgjuar edhe më parë. Letrat e zëna të paramilitarëve të vrarë serbë e të

publikuara, dëshmojnë për një paranojë në shkallën nacionale. Apo, planet sekrete të regjimit kriminal serb për deportimin e serbëve nga Bosnja dhe Kraina në Kosovën e zbrazët (9 qershor, *Dojçe Welle*) mund të krahasohen me elaboratet më fashistoide. Gjërat të tilla rrënojnë besimin në njeri dhe mjegullojnë të ardhmen...

5.

Në Kroaci e Bosnjë ishte dëgjuar refreni: *katundi i bukur, digjet bukur* (1992). Me këtë emër u xhirua një film. Ky refren u dëgjua pastaj edhe në marshimet vrastare serbe në Kosovë. Nuk kemi të bëjmë me luftën pra, por me etnocid të paparë: të vritet e shkatërrohet gjithçka...

Ne shqiptarët e dimë pse ndodh kjo; dallojmë po ashtu, luftën nga krimi-shfarosja, që të tjerët pakëz e ndjenjë ose i kanë harruar luftërat e tyre. Po pse ndodh ky konflikt i përgjakur? Mbetet e paqartë për një pjesë të Evropës, ose për ata që ende flertojnë me regjimin kriminal serb si Rusia, Greqia, Franca, Italia... Mashtrimi serb, megjithatë, ka zënë të zhveshet. Ndaj shqiptarëve nuk ndodh gjenocidi shkaku i të ashtuquajturit *djepit serb*, i cili lëviz sa herë të duan kokat nacionaliste, apo për shkak të hapësirës “kontestuese”, sipas propagandës serbe. Gjenocidi ndodh thjesht për shkak të pasurive, resurseve të mëdha që ka Kosova, të eksploatimit të tyre. Edhe në mileniumin e tretë Serbia ëndërron të ketë koloni.

Në librin *Një histori e shkurtër për Kosovën*, Noel Malkolm elaboron edhe të vërtetën mbi *djepin serb*, pse ky përdoret, pastaj të shkruarit e historisë në mënyrën serbe, sipas diktatit të hegjemonisë, dhe keqpërdorimin e nocioneve “popull” dhe “komb”, etj, etj.

Pas *Konferencës së Dejtonit* telallxhinjtë serbë filluan nominimin e Millosheviqit për çmimin “Nobël”. Vetëm ky mund të shpëtojë Ballkanin nga kasaphanja, thoshin. Me këtë bari, nëse nuk flretohet edhe më, me siguri çmimi do t’i jepet në Hagë. E, shkaktar i marrëzrave të tilla është keqpërdorimi i lirisë, monopoli mbi të. Në të vërtetë, ajo lexohet si farsë.

Një korrespondent nga Beogradi perëndimor lajmëronte se shkrimtarë e intelektualë serbë nuk mund t'ua dërgojnë mesazhet botës, shkak i ndërprerjes së shpeshtë të rrymës nga bombardimet e NATO-s. Ky ishte cinizëm. Fare nuk e shqetësonte zotrinë tragjedia e dy milionë shqiptarëve, që ndiqen e vriten në hapësirën e tyre historike. Shkatërrimet e vrasjet i shihte vetëm në Serbi. Po në Kosovë, ç'ndodh? Vdiset edhe për një pikë ujë në hijen e imazhit të ri. Gjëra të tilla njeriun e bëjnë të gërditshëm...

Marketing politik nuk bëra, se nuk jam anëtar i asnjë partie; dinjitetin krijues, po ashtu, frikësohem ta vë në zjarrin e nacionalizmit të egër. Përpiqem edhe populli serb të lirohet nga demoni shkatërrues, primitivizmi, që e poshtëron atë si komb e kulturë. Monologu me vetveten shpie në kibuc. Sipas Zotit liria u takon të gjithëve, sipas Njeriut nuk di. Kosova është njëra nga format e vrazhda të saj.

*(Shtëpia e Kulturës së Botës, Berlin 3.7.1999)*

*I. Kadare lexoi një fragment nga "Tri këngë zije për Kosovën". B. Shehu, B. Haxhiu, G. Pula dhe autori i këtij libri nuk i kishim barruar kumtesat. Gynter Grasi gjendej në veri të Gjermanisë.*

## INTELEKTUALËT E BODRUMEVE DHE VIÇAT

### Ku gjendet Kosova?

Kongresi i Berlinit i takon të kaluarës dhe nuk dëshiroj të reprizohet. Mua më intereson e ardhmja që, fatkeqësisht, nuk shihet ende. Por, kur ne flasim bukur e me ngazëllim për lirinë dhe besojmë se tmerri u mbyll në bisht të Evropës, postbllloqet serbe mbijnë në mes qyteteve e lokaliteteve shqiptare dhe deshmojnë diç tjetër: copëtimin e lirisë, hapësirës, përgjakjen e mëtutjeshme, morbiditetin.

Në anën tjetër të Urës së Mitrovicës, ku gjenden “Trepça” dhe Kullat e Boletinëve, rreshtohen paramilitarët serbë. Ballë tytave vrastare shqiptarët protestojnë dhe nuk mund i gjejnë ashtëpitë e tyre. Mund të ketë kjo diç me lirinë? Apo atë që e themi me fjalë të bukura, është koha e ardhme dhe këtë që e bëjmë, e bëjmë shkaku i ndërgjegjes sonë, se bëjmë diç edhe për ballkanasit. Tentimi i serbëve për të mbajtur “Trepçën” e resurse të tjera, dëshmon bindshëm se këta nuk e duan Kosovën shkaku i manastireve dhe varreve të shenjta.

Unë jam njëri nga një i milionti i të deportuarve nga Kosova, siç thotë një mik imi. Në mbarim të shek. XX vizuelisht e me lëkurë përjetova tmerret biblike - secili më i rëndë se tjetri. Ky është turp të ndodhte në kohë të gurit. Bandave kriminale serbe më shumë u pëlqen trëndafili i zi se i bardhi...

Ne flasim për lirinë, por ç'të bëjmë me elaboratet e memorandumet fashistoide të Akademisë, të intelektualve e krijuesve të frustuar serbë; ku t'i varim mesazhet mesjetare të shumë veprave historiko-letrare; ku të varrosim urrejtjen shekullore ndaj

joserbëve; ç'të bëhet me idenë e projektin e Serbisë së Madhe, që u ngrit gjithmonë në fatkeqësinë e popujve të tjerë?

Ai që di ç'është lufta, në Kosovë sheh diç më rëndë: përpjekje për shfarosje. Konkretisht u rrënuar kujtesa dhe identiteti shqiptar. Dorë pati dhe Kisha Serbe me mesazhe e marshime të mortshme. Hija e eshtrat e Car Llazarit bridhnin trojeve shqiptare, alarmonin fundin. Tani si t'i bindim serbët se gjithë kjo marri e tyre nacionale ndodhi në tokë të huaj? Ç'të bëjmë me fjalë të gjakosura, të tymosura, me gjysmë perëndi e të remë, që nuk shohin kë tjetër pos vetes dhe kryqit të ortodoksizmit të egërsuar në hapësirën ballkanike? Dhe ç'është më e keqja, pakkush ose askush nga serbët nuk ka guxim qytetari të distancohet nga paranoja e tyre nacionale. Përkundrazi, forcojnë radhët bri krimit. Sipas tyre është momenti të mbyllet çështja e Kosovës.

Ne bisedojmë këtu për një të ardhme në *Tokën e djegur*, të fyer dhe të shndërruar në varrezë masive dhe harrojmë ç'të bëjmë me fantastët, me ata që nuk mund e gjejnë udhën, shtëpinë e lindjes, lokalitetin; ç't'u themi atyre që i kërkojnë varret e të afërmëve; po fëmijëve bredhacakë që nuk dinë si quhen, të kujt janë, nga vijnë e ku shkojnë. Regjimi kriminal serb nuk u tmerrua vetëm nga *Abetarja e Gjuhës Shqipe*, por edhe nga arkivi shqiptar, identiteti. Ne shqiptarët u përpoqëm të shpëtojmë diç nga kujtesa, por në krematoriume e kasaphane na i shndërruan miniera e fabrika tona.

Pajtohemi se liria u takon të gjithëve. Diktatori i Beogradit mendon ndryshe. Prapë hipnotizon popullin e vet të varfër mbasi edhe opozita serbe flرتون me regjimin kriminal. Dhe, marshimet e protestat e tyre lënë të kuptohen si mllef serb: pse u humb Kosova, pse nuk u realizuan mesazhet e elaborateve dhe të memorandumëve të ndryshme, pse shqiptarët gjenden aty ende...? Liria është vërtet diç magjike. Ofron e pavarëson popuj, nga paragjykimet e të ligat, i liron njerëzit, por si të shikohen në sy viktima e xhelati, si të vazhdohet jeta e përbashkët më tutje? Kur përmendim lirinë, unë frikësohem mos e lëndoj edhe më shumë



viktimën, mos po i bëj ndonjë hile. Njëra nga arsytet: ku ishim para se të ndodheshin varret masive në Kroaci, Bosnjë dhe Kosovë? Dhe, kjo Kosova në cilin planet gjendet? Mos donim ta konservonim aparteidin afrikan në bisht të Evropës? Pritëm të ndodhë katastrofa njerëzore, toka e djegur, deportimet, varret masive e të pajtohemi se liria u takon të gjithëve! Por këtë e bëjmë më tepër nga frika, se mos kosovizohet edhe Evropa. Në këtë qëndrim ka pakëz hipokrizi.

### Intelektualët e bodrumeve

Intelektualët serbë dhe ca miq të tyre të bodrumeve të Evropës nuk besojnë në atë që ndodhi në Kosovë! Kjo, thonë ata me bashkëmendimtarët e tyre, është trillim, pjellë e masmediave amerikane e propërendimore. Shtrohet pyetja: varret masive, tokën e djegur, rrënimin e kujtesës dhe identitetit mos i shkaktuan vetë shqiptarët: mos deshën shqiptarët të braktisin kolektivisht këtë botë mbasi ata nuk i kuptuaka kush dhe lashtësia e tyre na qenka halë në syrin e ardhacakëve? Është e dhembshme kur dëgjon fjalën e Kryetarit të Akademisë së Arteve të Berlinit, zotit Gyorgy Konrad. Të bëhet se ai lexon një faks të diktatorit të Beogradit, që ia kishte lënë dikush aty para foltores. Pezmi i tij ndaj demokracisë evropiane dhe mbrojtja e krimin serb, ishte diç patologjike. Po sa ishte bindës ky filoserb hungarez, ndaj poltronizmit të tij dëshmon reagimi i shkrimtarit serb, Boro Çosiq. I kisha të qarta edhe reagimet e shumta të PEN-it shqiptar, që nuk patën efekt derisa i nderuari na ishte kryetar i PEN-it Ndërkombëtar. I një niveli, të mos them katastrofik, ishte një biçim krijuesi nga Bullgaria me emrin Alexander Kiossev. Fatkeqësisht, të tillë ka shumë në Evropë. Atyre më së pakti u intereson dinjiteti krijues, njerëzor. Intelektualët serbë si Aleksandër Tishma e Vuk Drashkoviç, me ca bredhacakë të tjerë e bashkëmendimtarë, nuk mund të pajtohen se policia serbe, se ushtria e paramilitarët serbë, se çmenduria serbe shkoi aq larg sa armikun e kërkoni

edhe në bark të grave shtatzëna; të çmontojnë atë farë “bombe” biologjike shqiptare, që nuk i la të bënin gjumë. Ky është primitivizmi i një fisi gjytyrym; diç neveritëse, raciste; e papranueshme për rendin e ri botëror. Logjika e tillë pamundëson çfarëdo bashkëjetese të mëtutjeshme të dy popujve. Për shkak të lirisë dhe paqes duhet të ndodhë divorci. E, kjo nuk thotë se këta dy popuj në të ardhmen nuk do të komunikojnë e bëjnë tregti; se nuk do të përkrahin multikulturën rajonale.

Unë vij nga Kosova, ku vazhdon të zbulohet fytyra e vërtetë e regjimit kriminal serb dhe frikësohem se ne shqiptarëve na luhet ndonjë lojë e nuk na mundësohet ajo për çka u flijua. Ndodh shpesh të reprizohet e keqja. Frika tjetër është se nacionalizmi serb mos e agresoi nacionalizmin shqiptar, i cili ishte në rolin vetëmbrojtës. Irracionalja serbe mos bëhet shembull se duhet vrarë edhe fëmijë; se duhet rrënuar çdo gjë që nuk është jotja. Kësaj të keqe, që e luftuan SHBA-të, dhe Aleatët perëndimorë, më mban shpresa se shqiptarët dinë t’i rrinë larg. E liga refuzohet edhe shkaku i kodit etik nëse mbështetemi ende në të: se nuk shtihet në fëmijë apo grua të asnjë nacionaliteti.

Ditë më parë një mik imi tha se lufta mori fund; të ruhemi tani nga paqja. Ishte këshillë me vend. Paqja mund të shkaktojë gjakderdhje të reja nëse nuk dimë të gjendemi, të rrestohemi. Ajo që ndodhi në Kosovë ishte një moskujdes, vonim i Evropës, por të sillemi ne si serbët, të keqpërdorim përkrahjen? Rindërtimin e kujtesës dhe mbrojtjes së identitetit kombëtar, po ashtu, Evropa duhet ta pranojë si nishan të mozaikut të vet. Katastrofa njerëzore nuk ndodhi në Mars.

Sidoqoftë, pas krahurës në vendin tim, të besohet se Evropa nuk do i mbyllë më sytë para krimit. Dhe pse të mos besojmë se edhe ne shkaputemi më në fund nga ana e errët e njerëzimit. E, të mendosh për njeriun, e ndihmon pavarësinë tënde. Vetëm atëherë mund të themi se mbrojmë edhe lirinë; se ajo u takon të gjithëve, pa marrë parasysh, se ca intelektualve të bodrumeve të Evropës u pëlqyeka më shumë mazohizmi...

Shpesh e lexoj një poezi të Brehtit për viçat, se viça ka kudo dhe gjithëfarësh. Me bollëkë janë aty ku tirania rrënon dhe shpirti mediokër “ndrit”. Ka edhe në sallahanën e Ballkanit. Dëgjova se ca shkarravisin dhe ulërijnë se ku mbet ky apo ai shkrimtar. Nuk i tmerrojnë as varret masive. Bëjnë, diç thonë. Ideali i tyre të ngulin diku shkaku i biografisë, shpëlarjeve e shkarjeve. Udhën e hapur duan ta kenë në triumfin e marrisë. Punë viçash më. Shkrimtarët e mëdhenj si Brehti janë aktualë në çdo kohë; me vizionaritetin e tyre, interpretues të çuditshëm të shenjave të së ardhmes, para se të ndodhë e papritura.

*(Berlin, 4.7.1999)*

## TË FYERIT VENDOSIN PËR TË ARDHMEN

(Fjala e mbajtur në tryezën *Kulti i luftës dhe i paqes në Tübingen*)

Kur të pushojë lufta, do të shihet sa ishte i arsyeshëm rebelimi në vendin tim. Unë nuk mund të dukem më i madh se ç'jam. Për të debatuar mbi një fjalë magjike, siç është paqja, nën këtë çati gjermane na tuboi paranoja serbe, që veten e sheh më të madh se ç'është. Ëndrra: Serbia është Jugosllavi, se fymon brenda kornizave të kësaj krijese të dhunshme mbeti iluzion serb. Jo vetëm nga ky synim marroç, zbulohet se serbët kanë probleme me historinë e vet, vazhdojnë ta shkruajnë siç dëshirojnë. Kuptohet, në dëm të popujve të tjerë. Një vetëkënaqësi e tillë nuk i shëron nga kompleksi i ardhacakut, por sjell fatkeqësi.

Megjithëse saktësisht nuk është ditur kurrë numri i shqiptarëve, ishim populli i tretë në ish-bashkësinë, ku të drejtat tona fare pak i realizuam. Frika ndaj nesh ishte permanente: nga shtimi ynë natyral deri te kthimi i normalitetit brenda kufijve të etnisë, Kosova u bë preteks në rrënimin e ish-bashkësisë. Kjo i konvenoi më së shumti nacionalizmit të egër serb, i cili u radikalizua sidomos pas ardhjes së Sllobodan Millosheviqit (1986). Për pak kohë u rrënua çdo gjë. Shkolla shqipe, mbrojtëse e denjë e dinjitetit kombëtar, u shpërngul në bodrume. Nisëm thuaja jetë ilegale, ndërkaq dhuna serbe shkallëzohej, bëhej më e egër. Afro tetë vjet u deklarua për paqe dhe ishim pacifistët më fanatikë në një kohë robërie. Pranuam edhe fyerjet, edhe ndjekjet, edhe vrasjet vetëm të mos ndodhë më e keqja, që synonte regjimi kriminal serb. Por xhelatin e frikësonte pacifizmi ynë. Shkrime të ndryshme të çarshisë serbe alarmonin: shqiptarët shtohen më shumë se serbët. Sipas logjikës së tyre “bomba” shqiptare të çmontohet, të bëhet i pamundshëm shtimi natyral. Në këtë kishin dorë ish-bashkësia si dhe pushteti serb. Nuk u mundësuan shqiptarëve jetë të rregullt e njerëzore, i marginalizuan në çdo fushë. Bënin çmos t'i dënonin edhe me ligje drakonike. Përmes kanaleve të ndryshme

mafioze, që ndikuan edhe profiterët shqiptarë ta zbrazin Kosovën dhe “bombën” biologjike ta çmontojnë. Brenda një kohe të shkurtër nxorën jashtë mbi një gjysmë milioni (1998). Dëbimi u bë me zjarr e me djegie sistematike të fshatrave e lokaliteve derisa Kosova filloi të humbasë drejtpeshimin. Xhelati ëndërronte me çdo kusht të zbrazet kjo hapësirë neuralgjike, ta shihte veten shpëtues të serbizmit, të mbyllte çështjen shqiptare. Kokat nacionaliste mendonin se ndaj një fushate të egër do t’i mbyllë sytë bota.

## 2.

Fqinjët tanë ishin edukuar mbrapsht nga elaboratet, memorandumet, librat e kisha. Në të vërtetë, me këtë legjitimimin gjuetinë më të egër në njerëz, që ishte parë ndonjëherë në kohë të modernitetit. Është më se tragjike se kjo ndodh mu në Evropë. Vritet një popull i deklaruar për zgjidhje paqësore e mirëkuptim.

Absurde më duken tani protestat e pacifistëve këtu në mjedisin tuaj dhe në metropole europiane. I dalin krah regjimit kriminal dhe shkatërrime e të vrarë shohin vetëm në Serbi. Pavetëdijsëm rreshtohen në anën e krimit të organizuar kundër shqiptarëve, këta satanizojnë edhe popullin e varfër serb. Ku është ai guximi intelektual e njerëzor? Pacifistët të ngriheshin në mbrojtjen e pacifistëve shqiptarë, të mbronin vlerat njerëzore, atëherë do e kuptoja revoltën e tyre si mençuri. Ndryshe, reagimet e tyre lënë përshtypjen se aprovojnë etnocidin ndaj shqiptarëve. Për mua ky është mjerimi njerëzor e intelektual. Mund të pagëzohet edhe si racizëm i heshtur: se veprohet edhe në bazë të përkatësisë fetare, që shqiptarët më së pakti mund t’i akuzosh për mostolerancë. Dhuna serbe duhet ndalur edhe për arsye të tjera. Pyes: kush i bën vrasjet në Kosovë, kush zbraz qytete e fshatra, kush hap varre masive dhe kush zhduk një popull e kulturë të lashtë? Ndërhyrja e NATO-s më së pakti është shkaktare.

Regjimin kriminal serb nuk e kundërshtuan vetëm shqiptarët, por edhe popujt e ish-bashkësisë. Në mbrojtjen e së drejtës për të jetuar dhe intervenimin e NATO-s qëndrojnë po ashtu shumë krijues e intelektualë eminentë botërorë, kurse ushtarakët bëhen më të

vetëdijshëm për atë që ndodh në Kosovë, nuk i duartrokasim krimin, siç bëjnë pacifistët e ca krijues minorë. Është turp të dyshohet në të vërtetën mbi masakrat ndaj shqiptarëve. Sharlatanizmi bie ndesh me rendin e ri botëror. Nuk pranojnë liri për të gjithë ose i përziejnë konceptet mbi lirinë. Po parafrazoj një mendim të hershëm të Presidentit Slloven, zotit Milan Kučan. Me rastin e rebelimit të minatorëve të “Trepçës”, kishte thënë se në Kosovë mbrohej ish-Jugosllavia (1989), mund të thuhet diç e tillë edhe për momentin e pikërishtëm: rendi i ri botëror aplikohet mu në Kosovë.

Propozimet nacionaliste të Dobrica Çosiqit me kopenë e tij - se duhet ndarë Kosovën, nuk janë kompromis. Kornizat e sotme të Kosovës janë kornizat e kohës së komunistëve. E kjo nuk mund të bëhet më xhuxhe. Është copëzuar tepër, kujtoni Sanxhakun, Toplicën, Rrethinën e Nishit, të Leskocit, të Vranjës. Hapësira shqiptare, sipas tyre, të copëtohet vazhdimisht shkaku apetiteve hegjemoniste pansllave?

Ne përjetuam disa pastrime etnike. Ky që ndodh në mbyllje të shek. XX., barbaria serbe mbetet lektyrë e dorës së parë: shqiptarët i shndërroi refugjatë në tokë të tyre.

### 3.

Është më njerëzore të debatojmë këtu për shkaqet e krimin, të pengojmë neofashizmin serb, që mund të jetë i dëmshëm edhe për drejtpeshimin e vet Evropës. Në punë të zotrave nuk bën të përzihemi. Është e dhembshme lufta. Por ne nuk ia nisëm. E shikoni, unë dëshmoj pacifizmin tim të moderuar? Xhelatit nuk i pëlqen paqja ime, se e tmerron. Prandaj unë dua të ekzistoj edhe pse ma kërkon kokën. Qartë shihet se serbët nuk dinë të bëjnë luftë. E kuptojnë këtë si hakmarrje, pastrim etnik, vrasje masive, shfarosje të një populli, që vështirë e lejon kush. Këtë “art”, ne ndryshe e kuptojmë. Në rrënimin apo në ndërtimin e një ideje duhet të ketë edhe pakëz dinjitet. Dhe, duke iu dëgjuar nën këtë çati, ma kujtuat çarshinë serbe. Fajtorë nuk jeni ju, është propaganda serbe, që iu gënjen edhe këtu.

Do t'iu pyetja: dini për ndonjë rast se UÇK-ja ka vrarë fëmijë, gra, pleq serbë; se ka djegur ndonjë fshat, se ka rrënuar tempuj e objekte me vlera muzeale të kulturës serbe? Nuk mund t'i pranoj çjerret e pakontrolluara të disave. Dihet se në Ballkan shembet ëndrra serbe e dominimit ndaj të tjerëve. Kodi etik shqiptar obligon edhe luftëtarin e lirisë: nuk shtihet në fëmijë, gra, pleqë! Ne nuk pranojmë vandalizmin as ndaj kulturës shpirtërore e materiale të secilit popull. I konsiderojmë edhe tonat se ca gjenden vërtet në tokën tonë. Edhe në këtë rrafsh ne shqiptarët jemi superiorë ndaj fqinjve serbë, të cilët prishin rendin dhe ekologjinë në vendin tim: me vrasje masive e zhdukjen e një kulture të lashtë. Ndaj të tjerëve humanizmi ynë nuk u vu në pyetje asnjëherë. Por në tokën e djegur çfarë paqe të ngrihet? - pyesin. Le të vendosin për këtë më mirë ata që përjetuan poshtërimin e masakrat, rrëfimet e të cilëve u ngjajnë kallëzimeve biblike. Unë apeloj në ringjalljen e jetës në gërmadha të kataklizmës para së cilës, kam përshtypjen, se turpërohet edhe Evropa.

Dua t'iu kujtoj poetin tuaj, Brehtin e famshëm. Përafërsisht ai thoshte: ndonjë e keqe kur ndodh në qytetin tuaj, duhet kundërshtuar të gjithë. Në vendin tim ndodhi kataklizma, në Serbi marshon çizmja e neofashizmit më të egër i kohëve moderne, e ne hamendemi: jemi apo nuk jemi për lirinë e njeriut? Akademiku, profesori e miku im Fehmi Agani, pjesëmarrës në Konferencën e Rambujesë e i vrarë pastaj nga regjimi kriminal serb, na këshillonte: të gjithë kanë të drejtë të jetojnë, për ata që i shkelin normat njerëzore, të merret ligji...

Shikojeni zotërinj, vendi im ndërron imazhin nga dhuna serbe. Nuk iu shqetëson kjo?

*(16 maj 1999)*

## MITI QË VAZHDON

### Miti mbi betejën e askujt

Kur i qasem mitit, më bëhet se kam një pasqyrë të mjegulluar përballë, nga e cila duhet shkundur shumëçka për të parë veten në një kohë, që ka formën e kallëzimit. Sa është i vërtetë, mbetet çështje tjetër. Mirëpo, vështirë të mbështetet se miti është njëfarë çelësi magjik në zgjidhjen e kontesteve.

Popujt e ngarkuar me nacionalizëm e kanë pikëmbështetje për ndonjë aventurë, e cila mund të mbyllet me fatkeqësi. Ne hyjmë në mileniumin e ri kur nuk mungojnë shtresimet e reja të mitit me përmbajtje edhe nga bashkëkohësia. Nëse ky trajtohet drejt, pa paragjykime, besoj se lirohen popujt nga iluzioni.

Domethënëse është dialogu i zhvilluar në mes dy ambasadorëve diku në Paris. Njëri ishte nobelisti Miguel Asturias e tjetri ballkanas. Pas një debati mbi problemin e mjegullës, shkrimtari i nderuar kishte pyetur se a ka mjegulla në Shqipëri. Bashkëbiseduesi iu kishte përgjigjur në shumës. Ishte e mjaftueshme për Asturiasin të kuptojë se popujt e Ballkanit gjenden ende nën pushtetin e mitit. Këtë fenomen Ismail Kadare e trajton nga një rrafsh tjetër (libri: *Legjenda e legjendave*).

Me konstatimin e heshtur të Asturiasit pajtohem. Ballkani është vend i miteve, i labirinteve shpirtërore. “Në kuptimin antik të fjalës”, siç do të thoshte Gerard Genette, pak hulumtohet, nuk lënë hasmëritë. Kokëçarje solli sidomos *Miti i Kosovës* mbi betejën e askujt, siç ka zënë të quhet. Serbët me aleatët e tyre e mbrojnë, e kultivojnë edhe pse beteja ndodhi në tokë të huaj e që, fatkeqësisht, aty qenka vrrarë një prijës serb.



Nga reth identitetit të vrasësit të Sulltan Muratit nuk dihet. Ekzistojnë supozime nga më të ndryshmet. Mbështeten edhe në rrafshin gjuhësor.

Nga kjo ndeshje popujsh, më e rëndësishme është se në *Betejën e Kosovës* (1389), nuk ndodhi siç thotë shkenca serbe. Krah forcave serbe kundër osmanlinjve qëndronin dhe shqiptarët, malazezët, bullgarët, kroatët, hungarezët, madje dhe polakët.

Kujdestarët e kombit nuk e pranojnë këtë, se shpërbëhet ëndrra e tyre hegjemoniste. Propagandojnë se i vetmi popull, që luftoi për çështjen e Kosovës janë serbët. Ky konstatim nuk është i qëndrueshëm. E, pse forcohet *Miti i Kosovës* dhe ku fillon djepi i serbizmit? Nuk ka lektyrë më të mirë për kokat e nxehta se libri *Kosova - një histori e shkurtër* i Noel Malkolmit.

Miti i Kosovës nuk na ka interesuar ne shqiptarëve. Së pari, nuk kemi nevojë të dëshmojmë për autoktoninë tonë dhe, së dyti, dimë se deri ku shtriheshim. Për këtë ekzistojnë fakte të shumta, madje dhe nga shkenca e mirëfilltë serbe. Të vjen keq vetëm se Betejën e Kosovës, me gjasë, aleanca e parë e ballkanasve kundër një armiku të fuqishëm të kohës, serbët qëllimisht e shikuan nga interesi i tyre nacional. Nuk është vështirë të lexohet shkaku. Nga irracionalja këta nuk mund të lirohen as sot. Shansin e parë ballkanasit e humbën. Do të kishim kokëçarje më pak në rajon.

Shtrohet pyetja: kujdestarët e kombit, ku do të mbështetnin hegjemoninë po të kishte rënë në Kosovë një prijës nga aleatët dhe dinë gjë për emrin e vërtetë të vendit tim, që është emrim i një fisi ilir? Miti i Kosovës mbetet ëndërr trishtuese për iluzionistët. Personalisht mua më intereson ballafaqimi me realitetin. Konstatimi i Borhesit për fantastiken ma forcon mendimin për një mit tjetër, atë të Kullës, që nuk është kështjellë as fortesë, por i kryen të njëjtat funksione.

Ç'është qeniesore, kulla është realitet dhe mit njëherësh. Nuk kërcënon kënd as i dihet moshë. Nuk e radhis në shumësin, që u dëgjua diku në Paris, në mes të Asturiasit të famshëm e ballkanasit.

## Kulla realitet dhe mit

Vërtet, ç'është kulla? Para së gjithash, kulm familjar; shpesh me fund tragjik, të vetëflijimit. U shfaq në zonat malore të viseve veriore të hapësirës shqiptare. Supozohet të ketë origjinën nga koha e kulturës komane (shek. VII). Lidhjet e saj kërkohen edhe në rrënojat ilire. Shkaku i ngulitjes përgjatë hapësirës veriore mund të jenë dyndjet sllave. Kulla mbet kulm me një arkitekturë të çuditshme e vetmi guri, e izoluar nga rreziqet, me një pavarësi më vete. Përfaqëson botën epike shqiptare. Është ndër simbolet e para në artet dhe ekzistencën shqiptare. U shndërrua në nocion nacional, interpretimi i të cilit nuk bën të shikohet si kundërmit.

Zakonisht, kulla ka dy kate. Në të lartin gjendet oda e burrave me oxhak dhe këndi ku varen armët. Dritaret e saj quhen *frangji*, dimensionesh të vogla. Nga aty përcillen lëvizjet e jashtme. Në rast se kush e cënon, mund të ketë pasoja. Në katin përdhes ekziston një infrastrukturë tjetër, më tepër për nevoja familjare, një labirinth i brendshëm. Materia e parë e saj është guri.

Disa kulla përbënin fisin me kodin që nuk guxon ta shkelë kush. Pra, kulla kultivon moral të fortë, të ashpër. Nga kulmi familjar u shndërrua në diç ekzistenitale, të domosdoshme për kolektivin: *nën kokë vë Çelësin dhe Shpatën*, thuhet në një poezi bashkëkohore. Se, në mes kullës e botës lëvizte e panjohura, frika. Disi këto lëvizje brenda-jashtë dëshmojnë edhe për funksionin e saj në kohë të pakohë dhe në relacionin individ-kolektiv.

Në fillim kjo ngritej në kodër të vetmuar, larg rrëmujave. E para, e hetonte të keqen. Nuk ka të bëjë me jetën baritore, siç mendohet. Figurativisht të themi: kulla është sy në kodër. Kur u pakësuan hasmëritë, nguli dhe në rrafsh.

Mirëpo kulla me kullën ndodh të hasmërohen. Nëse është shkelur *Kanuni* dhe nëse konflikti nuk është zgjidhur, kulla që ka shkaktuar deliktin, është izoluar. Me vite ka mbetur e ngjuar. Më vonë, ndërtimi i saj u bë mjeshtëri, art. Familjet e mëdha dhe në zë kishin kulla me një arkitekturë më të përsosur. Shquheshin për bukuri e madhështi.

Të njohura ishin Kullat e Junikut dhe ato të Rrafshit të Dukagjinit. Folja *ishin* tregon fundin e tyre tragjik. Një mik imi fliste edhe për peshën e gurit. Përafërsisht, dinte sa kg gurë ka në një kullë. Në luftën e fundit, ky art monumental përjetoi fatin e njeriut. Mbet ndonjë mur ose oxhak nga gjithë ajo bukuri.

Kohën e vet shpesh kulla e mbylli me fund tragjik. Poeti nacional, At Gjergj Fishta, kandidat për çmimin “Nobel” në vitin 1938, në epopenë *“Labuta e Malcis”*, na jep dhe aktin e fundit dramatik të kullës: kjo nuk bën të bjerë në dorë të armikut. Në njërën nga këngët, heronjtë e mbyllur sapo kishin parë ushtrinë e armikut nëpër mure, kishin ngritur në ajër gjithë ç’kishte pasur aty. Nuk bëhet fjalë vetëm për akt heroik. Vetëflijimi u bë traditë në kohë të liga. Ndodhi kjo dhe me vashat krutane, me ato të Sulit në Epir, me gjakovaret. Në asnjë rast nuk u pranua të shkilet nderi. Edhe në luftën e fundit (1999) u përsërit vetëflijimi. Tregojnë se familje të tëra fluturuan me kullën. Ngujimi në të është kulmi i dramës. Asnjëherë nuk dihet si mbyllet.

Në kohën e diktaturës kulla nuk pat fat më të mirë. Me frikë pakëz e shikonte shteti ideologjik. Petro Marko, luftëtar i Revolucionit Spanjoll (1936) dhe shkrimtar i shquar, kishte shkruar një dramë me subjekt nga koha e Skënderbeut (shek. XV). Pas botimit, drama ishte ndaluar.

Sipas censorëve, aty kishte ndodhur tradhti. Shkrimtarit ia kishin parë për të madhe se ushtarët kishin defiluar para frangjive dhe gjatë kishin shikuar tej horizontit. E, tutje gjendej një botë tjetër, që nuk përkonte me shtetin ideologjik. Kemi të bëjmë me paradoksin diktatorial: në asgjë të mos besohet. Kështu madhështia e kullës u shndërrua në tmerr për ata, që botën e shikonin përmes syzave. Nuk mund të shpëtojë as bukuria. Në luftën e fundit, barbaria serbe zgjodhi formën më të vrazhdë: rrënimin, lirimin nga hija e saj. Kallëzim i dhembshëm ky, nuk ka diç me antikën? Interpretimin tim për një nocion nacional, më së pakti të merret si kundërmit: të shikohet në vazhdën e ekzistencës së një populli. Kulla është mit, i cili vazhdon si realitet.

*(Bielefeld, 1999)*

## MBI FATIN DHE MJESHTËRIT E ÇELËSAVE

*(Fjalë e mbajtur me rastin e marrjes së çmimit “Nikolaus Lenau”)*

Takimi i parë me Nikolaus Lenau (1802-1950), ndodhi rastësisht. Ndërmjetës u bë një poet i papërsëritshëm shqiptar. Ai quhet Lasgush Poradeci (1899-1987) dhe në bibliotekën time zë vend meritor. Në mes dy luftërave botërore shkroi vetëm dy libra me poezi dhe disa tekste diskursive. Pas Luftës së Dytë veten e shpalli për të vdekur shkaku i lirisë krijuese në vendin e vet. Diktatura nuk kurseu as vlerat. Mbase ishte mjeshtër i fjalës dhe i tekstit, kulturën shqiptare e pasuroi me përkthime të shkrimtarëve, që i respektonte. Në vitin 1962, një libërth prej 514 vargësh ai e përktheu edhe nga vepra e Lenaut. Fati i tij është i dhembshëm. Libërthi nuk u botua as sot. Një bashkëkohanik i Lasgushit kishte deklaruar se vëllimi ishte vlerësuar i papërshtatshëm, pesimist: binte në kundërshtim me normat e moralit të atëhershëm. “Poezia e dhembjes”, siç u quajt vepra e Lenaut nga kritika gjermane, nuk ishte poezi muskuloze, e angazhimit. Logjika totalitare veproi, pra, në dëm të kulturës shqiptare. Pas vdekjes së Lasgushit, dorëshkrimi i poezive të Lenaut në shqip, u shumëzua. Një kopje e kisha edhe unë. Revista avangarde e Prishtinës *MM* në vitin 1996, në nr. 2, botoi një cikël nga vëllimi i pafat. Kështu nisi jetën ndër lexuesit shqiptarë Lenau.

Biblioteka ime kishte një gjysmë shekulli jetë. Mbaja aty gjallë kujtesën para të papriturave. Dhuna kur trokiti dhe në derën time, u desh të zgjedhja: të bëhesha numër apo të merrja vrapin e maratonit. Vendosa për të dytën. Njëra nga arsyet: të alarmoja të tjerët se ç’ndodhte në vendin tim. Si duket, isha vonuar. Të gjitha diheshin përkundër propagandës së rreme të shovinistëve serbë.

Në plotfuqinë e çelësit, që mbylla jo vetëm banesën time, mendoja se ishte çdo gjë. Ditë me parë mësove se çelësi nuk kishte mundur të frenonte irracionalen. Serbët janë mjeshtër të çelësave. Ishte derdhur edhe biblioteka ime. Sapo mësova për çmimin

“Nikolaus Lenaut”, kujtova atë dhe këndin e Lasgushit aty, ku gjendej edhe vëllimi fatkeq i Poetit.

Isha kureshtar se ç’ë shtyri poetin shqiptar të përkthente poezitë e Lenaut. Kërkoja ekuivalentët në kohën e romantizmit shqiptar, bile edhe në traditën e hershme, që kap afro pesë shekuj e që mendja e errët serbe bën çmos ta linçojë e të na paraqesë para botës në një dritë tjetër. Lojë e shovinistëve është e qartë. Unë hulumtoj shkakun e përkthimit të poezive të Lenaut. Mos kishin diçka të përbashkëta poezitë e tij me të Budit (1566-1922) ose me sibilat e famshme të Pjetër Bogdanit (1630-1689), që i çmonte shumë Lasgushi.

Krijuesi në historinë shqiptare është edhe lufëtar. Bogdani, bie fjala, njëhte dhe si prijës e mbrojtës i *Kishës Shqiptare*. Vepra e tij u përkujtua me botime, ribotime, studime e simpoziume të ndryshme. Në oborrin e kishës në Prishtinë aty ku mendohet se është vvarë, ka edhe një bust, të cilin e shihja çdo ditë nga ballkoni i banesës sime. Mirëpo barbaria nuk e kurseu as madhësinë e këtij kolosi, që ishte nderuar edhe nga Vatikani. Kështu, identiteti shqiptar u bë i tmerrshëm për ata që nuk dinë të nderojnë. Lufta në Kosovë ndodhi edhe shkaku i kompleksit serb.

Kureshtja ime kristalizohej sapo mësove se kush ishte Lenau dhe nga vinte. Njëra prej arsyeve pse poeti shqiptar kishte përkthyer një vëllim të Lenaut, ishte se poezia e tij ngërthen shqetësime të mëdha njerëzore, të thëna përmes një gjuhe të afërt me poetikën shqiptare. Ndarjen nga vendlindja Lenau e kishte përjetuar rëndë. Në hapësirën gjermanofone ky hyri me imazhin gri të vendlindjes me një ndjeshmëri të mahnitshme. Mbyllja e jetës së tij dëshmon se ishte një shpirt i trazuar. Një jetë të tillë kishte çuar edhe poeti shqiptar gjatë studimeve në Grac të Austrisë dhe në Bukuresht.

Lasgushi kishte veti gjeniu, ishte shpirt rebelues. Falë tij hyra në botën imagjinative të Lenaut dhe çmimi që mban emrin e tij, nderon edhe popullin tim.

E ç’kam të përbashkët me Lenaun?

Së pari, deportimin nga Ballkani nevrík. Dy shekuj bëhen që kur poeti braktisi Banatin në rrethana të panjohura, ndoshta. Po këtë fat

përjetova dhe unë në mbyllje të shek. XX kur lashë vendin dhe përpiqem të krijoj atë që humba: lirinë. Së dyti, të dytë bartim traumat, dhembjen njerëzore, ankthin, ëndrrën për vendin e shpërbërë. Së treti, nuk jemi të fundit nga familja e poetëve që zgjohemi në ekzil...

Në udhëtimin tonë, megjithatë, ka diçka që na dallon. Lenau nuk pat fatin të lexonte vizuelisht *Biblën*: të ishte numër në marrëmendthin njerëzor të kohëve moderne. Irracionalja serbe, që mund të interpretohet edhe si turp nacional serb, që bind se shumëçka nga historia njerëzore u përsëritka, në forma më të përsosura dhe më të egra ndoshta, e sidomos kur ballafaqohesh me mjeshtra të çelësave. Ne qenkemi variant i fatumit njerëzor.

Përpiqem të bëj portretin e popullit tim, pa i lënduar të tjerët. Shoh se i kam fjalët të përgjakura. Nga historia dihet se popullit tim i kushtoi shtrenjtë toleranca: me humbjen e vazhdueshme të hapësirës. Në këtë tragjizëm patën dorë në të kaluarën edhe padrejtësitë e Europës, që dihen. Antishqiptarizmi serbo-grek lansoi më të zezën. U përpoqën të zhvlerësonin edhe gjërat e shenjta: gjuhën, kulturën, historinë. Shurdhuese u bë propaganda e tyre kudo. Vendi im pësoi nga shkallëzimi i paranojës së tyre derisa ndodhi dhe katastrofa njerëzore në Bllacë (1999), dita kur çelësin e shtëpisë e futa në xhep dhe kalova vijën e kuqe.

Për morbiditetin serb, nuk mund të thuhet se bota nuk dinte, por mua kujtesa m'u derdh. Çmimi "Nikolaus Lenau" ma kujton të shkuarën. Se, nuk humb çdo gjë, e mësova edhe përmes figurës së shenjtëreshës shqiptare, Nënës Tereze. Ajo na këshilloi: dëshpërimi është shpresë. Shkoi më larg se ekzistencialistët.

Lenau vinte nga monarkia Austro-Hungareze, me një qytetërim më dinjitoz, ku kihej kujdes edhe për kujtesën. Në vendin tim ndodhi gjenocidi. Nocionet *luftë* dhe shfarosje përzihën shpesh nëpër metropolet europiane. Qesharake është të flitet për simetrinë ndërmjet *viktimës* e *xhelatit*. Apo konfliktin në mes tyre të shpallet luftë qytetare, siç kanë zënë ta lansojnë ca të marrë. Kjo të bën të dyshosh se e sotmja nuk u kënaq me Bllacën biblike. Fqinjët e mi treguan egërsi. Dëshmojnë qindra varre masive dhe lokalitete të zhdukura; numri i

madh i njerëzve që nuk dinë ende a ka përfunduar gjuetia serbe në shqiptarë, as që nuk dinë ku shkojnë, se e kanë humbur orientimin. Nëse kjo nuk dëshmon se në Kosovë ndodhi gjenocidi, atëherë ç'është morali?

Në Banatin e Lenaut në Rumani nuk kam qenë. Di për krahun tjetër të kësaj hapësire në ish-Jugosllavinë. Se ç'ndodhi me bashkëkombasit e poetit e pata të qartë, sapo lexova *Elaboratin* famëkeq të Vasa Çubrilloviqit, të shkruar në vitin 1937. Ky elaborat u plotësua nga disa të tjera dhe u zbatua në vendin tim me marshimin e egër serb. Me gjithë kamuflimet para botës, racizmi serb është i hershëm dhe i pranishëm.

Ky çmim ka domethënie të veçantë për mua se mban emrin e një poeti të deportuar nga e njëjta hapësirë, ku u tentua në mbarim të shek. XX të shkullnin me rrënjë edhe popullin e kulturën shqiptare. Por shtëpinë, a do ta çel me çelësin tim prapë, varet edhe nga kurajoja njerëzore: si do ta përdor lirinë? Në momentin e pikërishtëm frikësohem se ne shqiptarët mos u infektuam me të keqen, nacionalizmin e fqinjve. Vështirë të heshtin hasmëritë dhe të lirohen ballkanasit nga e keqja. Është koha të mos shikohemi përmes nishanit.

Në poezinë *Njëherë* dhe tash nga vëllimi *Lirika* (Berlin, 1920) Lenau thotë:

*tek vendi i vjetër*

*Është dritë e fatit tim.*

Poeti ishte i hershëm. Unë jam më i vjetër se ai. Me një rast tjetër për këtë. Nuk thuhet të gjitha menjëherë.

*(Stuttgart, 11.12.1999)*

## PËRBALLË REALITETT

### Përkimet dhe bukuria e mallkuar

Thjeshtësia është veti e krijuesve të mëdhenj. Me pak duan të thonë shumë. Aty qëndron madhështia e veprave të tyre. Mediokrit, besojnë se krijojnë vepra të të ardhmes po qe se tekstin e ngulfatin me gjithfarë “stolish”. Njëri nga keqkuptimi i interpretimit të arteve qëndron dhe nga kërkesa: ç’duam nga një vepër arti? Ernesto Sabato, i gjakut tonë, thotë: Nuk ka letërsi kombëtare dhe letërsi universale, ka letërsi të vërtetë dhe letërsi të cektë.

Shkak i këtij teksti u bë një pikturë e vonshme, fascinuese për mua, e piktorit Gjelo Gjokajt. Në pannonë me dimensione të zakonshme ballafaqohemi me dy fërkemë njeriu të dhënë përmes ngjyrës së zezë në dy tone. Fërkemi i parë ka ngjyrë të zezë të zbehtë, shenjë se dikush në hapësirën e padefinuar lëviz, lë ose ka lënë gjurmë; pra një jetë normale e individit-kolektivit. Fërkemi tjetër shtrihet mbi të parin, i cili lë përshtypjen se tërhiqet dhe mezi i duket hija. Fërkemi i dytë është dhënë me ngjyrë të rëndë, futë. Siç do të thoshte populli, mund të lexohet: ka zi e më zi kur prishet rendi. Piktori dhunën arrin të na japë me një invencion të çuditshëm. Mbasi dihet nga është ai, atëherë pikënisje e ka dhunën serbe ndaj shqiptarëve, secilës dëshiron t’i japë dimensione shqetësuese. E keqja u përplas vërtet për shqiptarët në formë të vrazhdë, por dhuna mbetet problem njerëzor. Pra, konfliktin, ndjekjen, pasojat piktori i thotë vetëm përmes dy fërkemëve. Mesazhi është i qartë.

Në të kthyer nga kurbeti në një *Album, njëri*, kishte lënë këto fjalë: *bukur këtu, bukur, por nuk ka me bukurinë e mallkuar të vendit tim*. Çfarë është bukuria e mallkuar, kuptohet nga nënteksti. Shënimi ishte i një refugjati të luftës nga Ballkani. Komenti është i tepërt.



Në rastin e parë Gjokaj na jep dhunën me nuanca trishtimi. Në rastin e dytë ndeshemi me ankthin e kthimit, dashurinë e llahtarshme për *bukurinë e mallkuar*, e cila për ballkanasin fatkeq është shumë më e lartë se bukuria e metropoleve, ndoshta mahnitëse. Do të thotë, atdhe nuk të bëhet asnjë vend. Njeriu i ngjan kafshës kur e humb identitetin e vet. Poezinë patriotike të Çajupit është mirë ta lexojmë më shpesh. Atdhedashuria kurrë më shumë nuk na është dashur se në momentin e pikërishtëm, por duhet të kemi kujdes ndaj euforisë. Mund të jetë një vrapim dëshpërues.

### Nuk qenka kryer lufta

Ne, shqiptarët nuk kemi nevojë të bëhemi nervozë, as të shndërrohemi në ndjekës. Të gjitha faktet ekzistojnë se në vendin tonë ka ndodhur gjenocid me përmasa të mëdha dhe vështirë ta mohojë kush; besoj po ashtu, se NATO-ja nuk luan me autoritetin e vet në ndjekjen dhe ndëshkimin e kriminelëve. Ne duhet të bëhemi nervozë për organizimin e mirëkuptimit e brendshëm kombëtar që bëhet dhe shkak i ngecjeve të shumë iniciativave. Ne vrapojmë më shumë për një gjysmë karrige e të pasurimit të paligjshëm se t'i ofrojmë njerëzit. Ne duhet të lirohemi edhe nga vetvetja mbasi e hoqëm qafe dhunën. Të poshtëruarve, të fyerve t'u kthejmë dinjitetin dhe t'u sqarojmë se liria nuk arrihet ndryshe, e përcjell edhe mortit.

Bashkësia Ndërkombëtare është kaptinë më vete, ka zënë të merret me ne shkaku i turpit të vet: si është e mundur në hapësirën e saj të ketë kaq barbari njerëzore, varre masive e rrënime deri në themel! E shqetëson kjo edhe për një arsye tjetër: në hapësirën europiane paska popuj, që krimin e kanë art. Shkaku i turpit shpesh mbyll syrin ndaj shkaktarëve të krimit. Dhe ndodh lojë e dyfishtë, ku pavetëdijshtëm kontribuojmë edhe ne. Është frikësuese se përkundër fakteve, regjimit kriminal serb t'i zgjatet jeta. Krah të fortë i ka rusët, grekët e ca të tjerë që po identifikohen me qëndrime të tyre. Ka edhe nga ne, që ende primitivizmin lindor e kujton me nostalgji. Çështja kombëtare mbrohet me guxim e mençuri.

Eksceset në Kosovë kryesisht i shkaktajnë formacionet sekrete serbe të infiltuara jo vetëm në njësitë ruse. Ndryshe nuk mund të kuptohet ngritja e tre gishtërinjve dhe këngët çetnike. Vetëm fundamentalistët serbë mund të bëjnë këtë. Për Bashkësinë Ndërkombëtare bëhen shqetësuese dhe enklavat, ku supozohet të ketë armë të shumta e paramilitarë. Është qesharake të pajtoheshim se erdhi koha të bëjmë gjumë të rehatshëm mbasi paqen e bëjnë të tjerët. Gabim fatal do të ishte ky. Duhet t'i ruhemi paqes së rreme. Rast ekletant i arrogancës diplomatike është vizita e paradokoshme në Kosovë e ambasadorit rus në Kombet e Bashkuara (1999). Pas gjitha atyre varreve masive e rrënimëve, nuk e pa të udhës të vizitojë një fshat shqiptar, por kërkoi kthimin e ligjeve të Serbisë (!), që na poshtëruan e dënuan dhe Kosovën e kthyen në aparteid; kërkoi të bëhet kantonizimi i Kosovës për të cilën kërkesë dëgjojmë me vite nga qarqet fashistoide e memorandumet e panumërta të Akademisë Serbe. Gati nuk tha se Kosova tani e tutje nuk bën të ekzistojë. Nga diplomacia e stepes nuk pritet ndonjë mençuri pos ultimatumëve e kërcënimeve. Shikojeni pakëz Çeçeninë! Habit Bashkësia Ndërkombëtare, si e përpiu këtë marrë të diplomacisë ruse! Askush nuk është kundër mirëkuptimit në mes popujve, por të trimërosh nacionalizmin serb dhe të përdhosësh shqiptarët, nuk di ç'ka me demokracinë! Ndonjë servil yni mund t'u bëjë temena fallangës ruso-gerke-serbe. Mos qofsha në lëkurën e tij...

Evropa ka harruar luftërat e veta dhe gëzon shkalla e lartë e zhvillimi të saj në çdo lami, por gjakftohtësia e saj lexohet nganjëherë si hipokrizi. Pa marrë parasysh, se krimi është krim, nuk është njëjtë si një i vrarë e si njëqind. Ekziston dallimi mes vrasjeve në afekt dhe krimin të organizuar nga shteti. Gjatë ish-in përgatitur elaboratet e regjimit kriminal, ish-in shndërruar në shkollë krimi për dëbimin e masakrimin e shqiptarëve. Por ne nuk mund të jemi serbë, duhet t'i dëgjojmë miqtë tanë jo të paktë dhe të kuptojmë se hasmëritë me të tjerët më së pakti na konvenojnë.

Është koha, po ashtu, diplomacia shqiptare të krijojë miq të qëndrueshëm. Ne përballemi me një realitet, ku të gjithë duhet të jemi telallxhi. Logjika shesheliane, tipike fashistoide, raciste: viktima të puth

vrasësin, ka zënë të pëshpëritet nën plaf. Lufta nuk ka përfunduar. Kam frikë se tek fillon. Paranoja shërohet vështirë.

## Fomat e gurit

Prapë të kthehem të një intervistë e Gjelosh Gjokajt, dhënë para pak kohe, Jonida Xhyrës (*Koba ditore*). Aty flet edhe për simbolikën e gurit, që na intereson shumicës. Kur ndalem te ky simbol, nuk mund të mos e kujtoj kullën, e cila u qëndroi të gjitha rrebesheve historike deri te paranoja serbe. Me te çmallëm tani në pikurat monumentale të Muslim Mulliqit, ku u përjetësua; ose e përcjell pikën e ujit si e shpon gurin, siç thotë në një poezi poeti Besim Bokshi e të mahnitem me trajta të reja të qëndresës sonë. Disi Gjokaj na përkujton: “Guri ka qenë gjithmonë simbol për mua. Jam marrë për një kohë të gjatë me përjetimet e gurit. Kam studiuar format e tij. Kur arrita të zotëroj teknikën e përjetimit të gurit, gjeta vetveten, fitova pavarësi dhe fillova të imponohem me artin tim. Të kuptohemi ky është një proces që vazhdon ende. Tek, guri, për mua, gëllijnë të konkretizuara format e jetës shqiptare”. Në botën tonë shpirtërore-materiale guri u shndërrua në simbol nacional, të pamposhtur e fisnik, i cili vazhdimisht riprodhoi vetveten në trajta të reja. Bie fjala, UÇK-ja, (e konsideroj ushtri të popullit, pra të asnjë partie), është njëra nga format e tij domethënëse në historinë tonë të re. Është nga format e qëndrueshme, që paralajmëroi se shqiptarët dinë dhe të vdesin kur u kërcënohet ekzistenca, është “një proces që vazhdon”. Pra, qëndresa jonë kurrë nuk prajti, u shtresua vazhdimisht me përmbajtje e mesazhe të reja, të shndërrohet në ortek gjithëkombëtar.

Mirëpo është e dhembshme kur këtë segment të fortë të ekzistencës sonë e zvetnojmë për arsye që dihen: ca duan ta copëzojnë, ca duan ta heqin nga skena; në të vërtetë, ne kemi fyer luftën e popullit tonë, që nuk kurseu asgjë për të ngadhënjyer mortin. E, rusët, grekët e të tjerët, zëshëm kërkojnë forcat serbe të kthehen në Kosovë, prapë muri të ngrihet në mes shqiptarëve. Zotërinjtë e

kancelarive europiane kur do të kuptojnë se Kosova nuk ka qenë as  
është tokë serbe?

Kjo është brengosëse. Lufta nuk qenka kryer...

## Kosova dhe një zotëri

Presidenti i SHBA-së, zoti Bill Clinton, në biseda e fjalime të tij  
shpesh e shqipton emrin e Kosovës, siç duhet të shqiptohet, pra  
*Kosova*, me *a*. Kancelaritë e Evropës e përdorin trajtën sllave për  
hapësirën shqiptare, pra nuk e respektojnë shumicën. Pavetëdijshtëm  
bëhen qesharakë bashkë me ATSH në gjuhë të huaja dhe vëhen në  
shërbim të shovenizmit serb, konkretisht të Millosheviqit, që ndiqet  
nga Tribunali i Hagës.

Mirëpo Amerika është Amerikë. Dhe nëse duam të bëjmë farë  
krahasimi në mes tyre dhe europianëve, ta kërkojmë në kodin etik.  
Borhesi qysh moti kishte thënë se amerikanët kanë një etikë të fortë.  
Do të thotë se nuk i hanë fjalët. Shkojnë deri në fund. E ne, të  
deklaruar si popull që nuk ka asgjë me sllavë, duhet të pranojmë  
rregullat e rendit të ri.

Poezinë e Kosovës e paska sharë një zotëri, i cili nuk di ta  
shkruajë, më tha një mik. Zënë në thue në ne jo vetëm të huajt; nuk e  
ka pasur përnjëmend ndoshta. Shkaku i piedestalit e ka. Ajme për ne!

## FOTOGRAFITË E ZEZA

### NË NJË KOHË ROBËRIE

Nën çati të huaj parandjej se nuk do të qëndroj gjatë. Përjetova fatin e Brehtit. Gjumin e parë e bëra si njeri pa atdhe. Nuk di ç'ndodh me Ulpianën, Dardaninë. Thonë se kullat e Junikut, të Dukagjinit, Çarshia e Madhe në Gjakovë, dhe ajo në Pejë me vlera muzeale, i kanë rrënuar - djegur. Janë shndërruar në varre masive. Nuk di ç'dorë artisti do t'i ngrisë dhe kur? Frikësohem se shumë miq nuk do t'i takoj kur të kthehem. Sërish nga fillimi, të ngris të humburën. Nuk di a do të kem kohë edhe për gjëra të tjera, që i shoh vetëm në ëndërr. Ekzistojnë kampet: Stankovc, Kukës, Çegran; tendat numër kaq e kaq. Një popull pa adresë...

Shëtinë e parë do e bëj deri te varret, t'u kërkoj falje të tejmëve, që i lashë për një kohë. Po qe se ka lule në Kosovë, t'i vë secilit nga një. Më kanë treguar se luhatet Ura e Shenjtë. Aty i kam lënë ditët e djalërisë. Nëpër gërmadha do kërkoj vetveten. Feniksi ynë patjetër do të nisë udhëtimin e ri. Nuk kemi dalë fare. Besoj në atë, që e kam thënë si gjimnazist i Gjakovës: *Miq, Kosova është gjaku im që nuk falet...* Nuk mund e paramendoj vdekjen diku tjetër. Nuk çohet koha kot. Turp është të shikosh si vdesin të tjerët...

## Vepra kombëtare pasuri e letërsisë së përbotëshme

Në një pyetje të Radios Gjermane, Redaksia në gjuhën shqipe, Këln (1.6.1999) isha përgjigjur:

Në një kohë robërie ishim pacifistë më fanatikë. Paqja jonë tmerroi regjimin kriminal serb. Parashikohej se diç e tmerrshme do të ndodhë. Pakkush besonte se edhe vizuelisht lexohet *Bibla*. Shoh se ca e humbasin shpresën. Në anën tonë është rendi i ri botëror. Nokdauni kriminal serb na bind se çështja kombëtare nuk zgjidhet në emër të fisit, të çatisë, por të Kombit. Është mësim ky që ndodh me ne e rreth nesh. Ditë të mira vijjnë për krijuesit e të gjitha profileve. Veprat tona do të jenë specifike. Mbi diktaturën e fundit në Evropë do të shënojnë edhe triumfin. Përballemi me përmbajtje, ide e mesazhe ekzistenciale, njerëzore. Çështja shqiptare nuk është vetëm çështje jonë. Lypset, një seleksionim rigoroz, më qeniesor të elaborohet shkaku-pasoja. Krijuesit e rinj shtohen edhe në këto ditë të rënda. Kjo dëshmon se truri ynë vepron përkundër dhunës së egër serbe. Fat më të mirë do të kenë me siguri. Koha nëpër të cilën përbirohemi është sprovë e madhe. Vizioni i të rinjve mbi këtë katrahurë njerëzore, mund të jetë tjetërfare. Sidoqoftë, vepra e mirë kombëtare bëhet pasuri e letërsisë së përbotshme. Gabimeve të brezeve të mëparshme, huqeve të themi, me mençuri do t'u shmangen me avancimin e mendimit të ri. Të rinjtë i shoh vazhdimësi, ndryshe e kotë do të ishte çdo përpjekje jona.

## Takimet e poetëve në Romë

Poetin e mikun Visar Zhiti, sapo e dëgjoj në telefon, di se më lajmëron diç të gëzueshme. Por shpesh e qes në hall. Visari nuk ngurron. Punë të shenjtë di se bëjmë. As kësaj here nuk udhëtova në takimin e poetëve në Romë, që mbaheshin më 2 qershor, në një shesh të këtij metropoli. Mesazhi im ishte ky:

Roma është qytet i veçantë. Poezitë e mia janë të përgjakura fatkeqësisht, u mungon buzëqeshja. Regjimi kriminal serb ua derdhi atdheun. Kanë tani një imazh të ri, ekzistencial...

Ende ka shtete, diplomatë e intelektualë, që kënaqen me “artin” e krimin. Ky është problem i tyre, më tepër ideologjikofetar e etik. Por Kosova nuk bën të harrohet, është Atdheu edhe i Nënës Tereze, i asaj krijese të mrekullueshme, që të dëshpëruarve ua kthen shpresën.

Çështja e Kosovës do të zgjidhet moti po qe se diplomacia botërore të mos i kishte mbyllur sytë para krimin të organizuar serb. Besoj në dinjitetin Tuaj krijues e njerëzor në mbrojtjen e popullit shqiptar, i cili i fali botës jo vetëm Nëna Tereze. Keni rast të deshmoi. Jeni racë e vetëdijshme dhe nuk bën të frikësohi në mbrojtjen e vlerave njerëzore...

*(Langenbroich, 28.5.1999)*

*Me nderime*

*Ali Podrimja*

Ndërkaq pyetjes së gazetës “*Famiglia Cristina* për Shqipërinë e Madhe isha përgjegjur: Ne shqiptarët ishim tepër tolerantë. Ptolomeu i famshëm, na vinte krah helenëve. Fqinjët tanë të vonshëm rrënuan çdo gjë që nuk e ka shenjën e tyre, në hapësirën ballkanike të duken vetëm ata dhe historinë e tyre ta shkruajnë siç dëshirojnë, qoftë ajo edhe një gënjeshtër. Ndryshe ne i shikonim gjërat, nuk mund të vepronim jashtë kodit tonë etik. Ne nuk kishim kompleksin se zbritëm nga Karpatet ose nga ndonjë planet.

Shikonim punën tonë, ku shpesh na përziheshin fqinjët. Ptolomeu na kishte pranuar kur fiset sllave mrizonin në stepe ende. Grindjet e mëvonshme në Ballkan dëshmuar se serbët çdo gjë filluan ta shikojnë mbrapsht. Etninë tonë gjuhësore e shpallin për Shqipëri të Madhe. Pas kësaj sintagme fshehin hegjemoninë serbe. Fatkeqësisht, kjo budallaki serbe gjen përkrahje edhe në disa qarqe të painformuara mirë, bile edhe në Itali ca e mbështesin. Nuk di pse pranojnë një të

pavërtetë. Tjetër është, bie fjala, me Serbinë e Madhe, e cila vazhdon të krijohet në dëm të popujve të tjerë, thjesht shkak i dominimit në rajon. Nuk bën të harrohet se ora serbe ecën sipas orës ruse, pra të pansllavizmit.

Mirëpo nuk besoj se ballkanasit të shikohen tërë jetën përmes grykës së pushkës. Po që se arrijnë të lirohen nga iluzionet do të kthehen në normalitet. Do të mbyllet një hasmëri shekullore. Gjërat do të shikoheshin në një dritë krejt tjetër...

Të reagosh ndaj të keqes, duhet gjetur mënyrën. Brenda mundësive, në këto kohë të liga, secili mund të kontribuojë diç për çështjen kombëtare. Mënyra ime është grithja e ndërgjegjës së fjetur. Dikujt kjo nuk i duket gjë. Varet nga truri e karriga.

*(Qershor, 1999)*



## ËNDRRA POLARE

Në vetminë rrëqethëse të stepes së akullit Pjetri i Madh i kishte tubuar krerët e fisit dhe u kishte lënë një amanet. Më vonë fjalën e rahmetlisë ca do e quajnë Testament e ca Ëndërr polare. Aty i kishte këshilluar detajisht si duhet dhe nga t'ia nisin për të dominuar në të ardhmen gjithë Europën. Nga ta shoshitësh fjala e tij nuk dallon asgjë nga paranoja e sotme serbe; bile testamenti u bë pikënisje e shumë elaborateve fashistoide, kryesisht serbe e greke, për triumfin e fundamentalizmit ortodoks, sepse fundamentalizëm tjetër nuk ka në Evropë, as mund të ketë.

Dallimi në mes Testamentit ose të Ëndërrës polare dhe shkrimeve të mëvonshme qëndron se këto të fundit shkojnë më larg; u vjen era gjak, vdekje, ku ndrit apartheidi, siç ndodh me elaboratin e Partisë Radikale Serbe të Sheshelit. Çdo gjë aty është në maksimum. Ëndrra e pansllavizmit ekziston pra qysh se ekzistojnë fiset sllave. Ajo kurrë nuk është fshehur. Para ca vjetësh në Athinë Jelcini kërkoi të ripërtrihet e të pasurohet kjo aventurë sllave, të krijohet një shtet i fortë ortodoks nga Athina në Moskë dhe të lidhet nyje aty diku në Shumadi. Shkrime të tilla, një kohë ishin të mbyllura në sirtarë dhe lexoheshin vetëm nga ca njerëz. Më kujtohet shkrimi i Dr. Bogdan Krizmarit, profesor në Universitetin e Zagrebit, mbi *Elaboratin* e Ivo Andriqit. Ashtu siç më kishte rënë në dorë, e kisha përcjellë. Për një kohë të gjatë kishte marshuar rebelimi i fshehtë në ish-Jugosllavinë, që ia nxori të zezat. Në një farë mënyre, për të zbuluar të vërtetën kërkohet çelësi. Për ne shqiptarët ky çelës ruhej në mënyrën më sekrete.

“Mbajeni kombin rus në gjendje lufte”, kishte theksuar Pjetri i Madh. Me këtë ai frikësonte rrotull vetes ata, që nuk i nënshtroheshin urdhrat të tij dhe t'u bënte me dije se ku ekziston qendra. Domethënë se është edhe këshilla: “bëni që paqja t'i shërbejë luftës dhe lufta

paqes”. Ndeshemi me dinakërinë e hegjemonizmit të kultivuar me vjet. Por si të triumfojë fundamentalizmi orotodoks ndaj Evropës?

Kërkoheshin mënyrat nga më banalet. Nga shkrimet e tilla gjithmonë lexohet nënteksti. Në këtë amanet, ndoshta të fundit, Pjetri i Madh i kishte dhënë vend dominant krushqisë, martesave të përbashkëta me të tjerët e sidomos me shtresa të larta. Ata fshihnin të kërkuarën. Ishte vënë në përdorim edhe intimiteti njerëzor. Femra konsiderohej fuqi, që mund të bëjë mrekullira. Përmes saj hulumtohej edhe caku. Përzierja e gjakut dhe e këmbëve zbulonte dhe dobësinë e armikut. Sa patën sukses dy gishta vend në ekspansionin e pansllavizmit ia lëmë kohës dhe shkretëtirës ndjenjore, por as ne shqiptarët nuk i shpëtuam një testimi policesk, terribël.

Këshilla tjetër ishte krijimi i aleancave me popuj të afërt për nga besimi, forcimi i tyre që të shkaktoheshin përçarje të mëvonshme në mes europianëve. Shembulli i Greqisë së sotme lexohet si fara e kuqe. Edhe pse anëtare e NATO-s nuk mori pjesë në mbrojtjen e vlerave njerëzore në Kosovë. Përkundrazi, aktualizoi “fshisën e hekurt” ndaj emigrantëve shqiptarë. Siç shihet, e keqja rreth nesh nuk është e sotme, ka historikun e vet dhe shkakun. Ajo vepron kur ne më së pakti e presim. Pengesë të pakapërcyeshme pansllavizmi i sheh shqiptarët në Ballkan.

## 2.

Këshillat e rahmetlisë përsosen e zbatohen edhe tani. Në kohën e komunizmit lexohej vetëm ajo që shihej. Për të paditurit dhe kolltukofagët ishte karem përrallor. Për një kunj ose grua linin kokë e atdhe, do thoshte një mik imi. Fat se dinakëria u kuptua shpejt dhe pakkush u përmut në kurthin e pansllavizmit, të lidhë fatin me fatkeqësinë. Zotëria nga stepa e akullt u ofronte të tjerëve yrnekun rus me çdo kusht, duke vënë në përdorim edhe dy gishta vend. Në kohën e “vëllazërisë së popujve” dhëlpëria arriti shkallën më të rrezikshme. Nga Mesdheu në Pacifik tentohej vetëm një gjuhë, një gazetë e një ligji.

Nuk shihej askush tjetër nga mençuria e vëllait të madh. Pas titoizmit këtë lojë e luajti nacionalizmi i egër serb. Të tjerët nuk kanë

nevojë të komunikojnë as të dinë historinë e shkollën e tyre. Serbi është ku ra edhe ndonjë vjedhës kuajsh apo ku shfaqej ndonjë kukavajkë serbe. Amaneti i rahmetlisë mbështetje të fortë kishte sidomos internacionalizmin, vëllazëria e popujve në bazë të ideologjisë dhe të servilitetit do të shtoja. Në këtë tragjedi - komedi bastardhësh kryesori ishte baçushka, që dashke të pyesësh edhe kur duhet rënë me gruan. Në sjelljet e “vëllait të madh” më shumë pësonin ata që nuk kishin asgjë të përbashkët me besimin, kulturën e lashtësinë sllave. Në mënyrë më të poshtër tentohej në fshirjen e trurit dhe të identitetit kombëtar. Edhe në planprogramet nacionale vezullinte syri i “vëllait të madh”. Për hir të edukimit të “njeriut të ri” nxirreshin vlerat kombëtare nga librat e bibliotekat. Mithatin, Fishtën, Skiroin, Faikun, Koliqin e të tjerë i kisha lexuar tinëz. E, pse kishin lejuar tanët diç të tillë, nuk dua t’i fyej për së vdekuri...

As në vëllazërinë e popujve, ta quajmë kështu, nuk ishte lënë anash krushqia. Me ca përjashtime femra nuk ishte vetëm eposh i kënaqësisë. Ishte shpesh një Mata Hari apo Ilona Stalleri, që me trupin e vet mposhte të pamposhturit, depërtonte në sekretin e trurit, të intimitisë; në emër të vëllazërisë shndërrohej në mjet asimilues, që duhej ta shpinte në vend urdhrin e të madhit. Nga një fushatë e tillë gjysma e Shqipërisë ishte torturuar e gjysma tjetër ishte treguar më dinjitoze edhe pse ishte e okupuar. Ta zëmë, emrat autoktonë ilirë nuk ishin zëvendësuar me ata të karpateve, as nuk ishte përzirë gjaku. Hegjemonia pansllave me gjithë egërsinë e vet nuk kishte qenë aq e suksesshme në Kosovë e troje të tjera shqiptare. Nga frika se asimiloheshin më shpejt, i bënin ballë kërcënimit, se Ëndrrën polare e kishin lexuar ashtu si lypset.

### 3.

Në të ardhmen a do të mund të strofullojë dinakëria e stepës kund, varet nga shumë faktorë që nuk i kishin rënë në mend Pjetrit të Madh. E, sidomos viktimizimi i mëtutjeshëm i nderit ku do të arrijë apo i humbjes së ndjenjës për atdhe... Fatkeqësisht, këshilla e moçme sa vjen e nuk harrohet. Në fillim të shek. XX, Ministri i Punëve të

Jashtme të Ruisë Cariste, kishte thënë një profeci: në shek. XXI shqiptarët do t'i hedhim në det. Gjatë barbarisë serbe vëllezërit rusë kishin dalë haptazi kundër ekzistencës sonë.

Paradoksi: Na vranë e thonë tani se na mbrojnë (!) Unë nuk jam aq i mençur të kuptoj lojën rreth nesh. Kam filluar t'i shoh gjërat ndryshe qysh se në hapësirën tonë nguliten edhe forcat ruse. Tjerrja e dredhisë bizantine vazhdon. Tani për tani kulmi gjenocidal është elaborati i Partisë Radikale Serbe të Sheshelit. Me përpikmëri është shkruar si duhet gjakun të na e pijnë me pambuk. Përplasjet e popujve në të ardhmen mund të jenë edhe më të përgjakura.

Shikojeni vetëm rastin e vrasjes së 14 serbëve të ndjerë diku në Kosovë. Nuk dihet kush ka shtirë në ta, mbasi në rroba të ushtrisë sonë u kapën shpesh edhe kriminelë oridinerë serbë: alarmohet opinionimi botëror jo vetëm nga propaganda serbe. Kjo bëhet vetëm të qiten në harresë masakrat dhe varret masive shqiptare gjithandej Kosovës. Gjunjëzimi ynë para ulërimës serbe, do të mbyllte çdo përpjekje tonë me një tragjedi të re. Ne askujt nuk i ramë në qafë. Koha e bajraktarëve është e zezuar. Në mundjen e të keqes, lypset veprimi i trurit kombëtar. Rilindësit ngulnin këmbë se dielli ynë lind në Perëndim. Mesazhi i tyre të çohet në vend. Lindjen e ngopëm me gjak: Të mbyllet fundi i tregimit habitor për ne...

I vaftë shpirti Pjetrit të Madh aty ku duhet. Më shtyri të merrem edhe me sorrën time pse m'u zbardh në kupë të qiellit. Megjithatë, orën e kishte kurdisur keq rahmetlia. E venerova këtë, sapo dola në breg...

## FOTOGRAFITË E ZEZA

Në dekadën e dytë të shekullit që po e lëmë, Trockin e famshëm e kishte qitur udha në trojet shqiptare nga kishte informuar lexuesin rus për të bëmat më të reja në Kosovë, pasi Fuqitë e Mëdha ia kishin dhuruar Serbisë. Në mes të tjerash, kishte deklaruar se Kosova, megjithatë është gur i rëndë për Serbinë. Me gjasë dinte për veprën *“Golgota shqiptare”* (1913) të Leon Frojdlhut mbi holokaustin shqiptar të viteve 20 dhe shkrimet e Ami Bues, kishte veneruar se shqiptarët janë farë e çuditshme. Serbët mendonin ndryshe: shqiptarët janë popull fisnor, janë kafshatë e vogël për ta.

Ishin shfaqur pastaj vojvodë pas vojvode, secili më kriminel se shoqi, duke menduar se çështja e Kosovës do të zgjidhet me thikë e gjak. Dhe krimi ishte përsëritur dhe pëshpëritur gojë pas goje e diku ishte kapur edhe me objektiv. Njëfarë Miliq Kërsta, i anës së Epërme të Dukagjinit, tregojnë se e kishte pasur për zakon sa herë të vriste shqiptarë ose t’i lidhte, të fotografohej në mes tyre mbasi ata i konsideronte si farë trofeu. E bënte këta se 1) dëshironte t’u tregojë gjeneratave të ardhshme si luftohet për Serbinë e Madhe e si veprohet me shqiptarë dhe 2) në histori nuk hyhet pa thikë e trofe...

Ky farë Kërstiqi kishte edhe shumë shërbëtorë nga tanët. Dëgjon njëri nga ta se ç’fliste vojvoda nëpër ndeja e muhabetete dhe e shpie aty ku e kishte merituar. Me vite nuk kishte pushuar çiftelia si Selman Kadria na paska vrarë atë përbindëshin serb, i cili nuk kishte lënë një të keqe pa e bërë. Fatkeqësisht, Selmani nuk e kishte dëgjuar deri në fund këngën për të. Në besë e kishte prerë një dajë i vet. Krimi ishte mbështjellë me të gjitha të zezat e dredhitë. Ballkan më!

Gjërat makabre nga Vilajeti i Errët, megjithatë, nuk mundi askush t’i fshehë. Ca ishin mbyllur nëpër këngë e ca ende presin kohën e vet. Tek bridhja Evopës një çkëndues kishte nxjerr nga një kuti ca fotografi, ku për herë të parë ia shihja çehren Miliq Kërstës. Ca

nga ato kishte filluar t'i hajë koha, por fytyrat e viktimave bëheshin më lemeritese aty te këmbët e vojvodës. Ca kopje m'i kishte bërë miku, se origjinalin ia kishte paguar shtrenjtë oficerit të lartë rus, Nikolla Kizem (92), këshilltar në xhandarmërinë e ushtrisë serbe gjatë mposhtjes së Kryengritjes shqiptare (1914-20). Në vitet e nëntëdhjeta kishte braktisur stepën e shiste hajmeve gjermane gjëra të çmuara. Me kujdes i kisha paluar ato dhe mezi kisha dëgjuar pëshpërimën time: ruajna Zot!

Ditë më parë shfletoja shtypin ditor dhe syri m'u ndal në një fotografi, që më bëhej se ishte nga koha e Miliq Kërstës. Fatkeqësisht, kjo ishte nga marshimi i fundit serb në Kosovë. Tre adoleshentë të vrarë më 14 maj në Pejë (*Corriere dela Sera, 10 shtator, faqe 13*) qëndronin të masakruar para këmbëve të kryerësve të krimit, të cilët ishin fotografuar pas ekzekutimit të tyre. Asgjë nuk dallonin nga pamjet morbide, që i pëlqenin aq shumë vojvodës para gati njëqind vjetësh. Pra, Miliq Kërsta nuk ishte i pari as i mbrami serb që shqiptarët i konsideronin në nivelin e kafshëve. Fotografia dëshmonte se serbët nuk mund të ndahen aq lehtë nga krimi, zhytja e tyre vazhdon, por patriotizëm nuk është të shfarosësh me rrënjë një popull; rradakja e tyre po ashtu nuk diti kurrë të bëjë dallimin në mes njeriut dhe kafshës. Kështu, këtë fis krimi e ndoq pas e që është shenjë e popullit frikacak; tmerron kur kopeisht të turret. Me gjasë edhe këta kishin menduar se bënë një fotografi për histori. Në të vërtetë, kishin nxjerr arpallëkun e tyre si komb dhe të vjen keq për mjerimin e tyre nacional. Ekzekutorët e tre rinjve shqiptarë ishin renditur të krekosur para trupave të njomë. Dhe, tek i shikoja ata, parafytyroja sa e sa fotografi të tjera që nuk dihen ende.

Për dreq më kishte rënë ndërmend njëfarë dr. Mihajlliviq Bojan nga Shtërpca, letren e të cilit e kishin gjetur njësitë e UÇK-së në xhepin e vëllait të tij paramilitar dhe të publikuar në një gazetë tonën. Doktorit aty shkruante "... vetëm edhe diçka të them... kur të kthehesh prej andej gjithsesi të ma sjellësh një kufomë shqiptare; dua t'ia prej gushën në qafë..." Një letër tjetër, po ashtu, e kapur nga UÇK-ja, vëllai i drejtohet vëllait në ushtri, e cila gjendej në pastrimin etnik nga shqiptarët: "Nëse ka nevojë do të vij atje me mafien time dhe me vete

do të marr teslica, motosharra dhe sopata të druvarëve, që ta ndjejnë shqiptarët se si druvarët e kryejnë punën në kokat e tyre...”

Se me kë patëm punë, flasin më së miri varret masive, që çdo ditë shtohen. E, fotografi e letra të tilla nuk kanë të paguar, janë dokumente që dëshmojnë dhe për sakrificat e rezistencës shqiptare para një makinerie fashistovdekjeprurëse. T’i përdorim ne të njëjtat metoda?

Në Lyneburg, në një mbrëmje letrare (10 shtator), ku merrja pjesë, organizatori ma la në tavolinë revistën “Der Spiegel” (shtator). Ishte aty një fotoreportazh, përcjellë me një tekst për moralin tonë momentalisht. Tërë rruga iu kishte lëshuar një gorani, i cili paska folur me fëmijët e vet në një gjuhë tjetër (!). E, ç’është më e keqe, ndjekja kishte ndodhur në sheshin “Nëna Tereze”, e cila simbolizon humanizmin shqiptar në botë.

Momentalisht neve na mungon qartësia e gjërave. Së pari, dhuna serbe ndaj shqiptarëve nuk mundet, as nuk krahasohet me asgjë, është ekzemplar i mjerimit njerëzor; së dyti, hallakatjet e tilla, si në sheshin tonë, pakësojnë miqtë tanë në botë, na nxjerrin burraveca dhe trimërojnë kriminelët serbë; së treti, habit si asnjë micsokol yni nuk mund e mbrojti të gjorin, që të shpëtojë edhe nderin tonë para syrit të objektivit të Europës; së katërti, ne nuk jemi serbë e të pranojmë moralin e thikës. Revistën në fjalë ma kishte dërguar një mik gjerman, i cili nuk dëshiron të na shohë imitues të fashizmit serb. Huqet tona e neverisin, se këto çojnë ujë në mullirin serb. Mezi kisha pëshpëritur: fotoreportazhi është iritues, poshtërues për popullin tim. Dhe dëgjuesve të shumtë në Lyneburg, u isha drejtuar: në Ballkan është në krizë dinjiteti njerëzor...

Koha nëpër të cilën përbirohemi nuk përsëritet më. Lëndimet që na shkaktuan serbët nuk harrohen, por duhet ruajtur edhe këtë pak dinjitet që na mbeti. Në selinë e NATO-s pak më parë, zoti Holbruk, për herë të parë opinionit botëror ia kujtoi një të vërtetë historike: nga viti 1912 shqiptarët i ndoq një tragjedi e madhe...

Nëse bëme gjithçka për lirinë, t’ua mundësojmë edhe atyre, që të mirën e të keqen duan ta ndajnë me ne. Nuk i kemi më krah

shokun Lenin, tavarish Stalinin e aziatin Mao; krah i kemi  
nëntëmbëdhjetë vende demokratike në krye me SHBA-të... E, kur flet  
Holbruku, qëndron Amerika pas tij. Mbahuni, micsokola! Është koha  
e trurit. Bëhen të lemeritshme fotografitë e zeza! Dhashtë Zoti, të mos  
ndodhë ndonjë kob i ri!



## LUFTA TEK KA FILLUAR

Ca elemente krejt të rëndomta si shamia rreth kokës, djepi në cep të krahut, kokrra e mollës në shuplakën e shtrirë, syri i zmadhuar gati lëvizës, pika e lotit tatëpjetë faqes së rjepur, janë ca shenja mjaft të lexueshme e domethënëse në tablotë e Gjelosh Gjokajt. Dhe, kur ajo shami e djep, ajo kokërr molle në shuplakën e fëmijës, pakëz ilustrative në të parë, nuk janë të rastësishme, atëherë kemi të bëjmë me shpërbërje, boshatisje përmasash të një tragjedie kolektive. Shkaku dihet, po ashtu, dhe fajtori. Krijuesi bën të mbetet vetëm spektator?

Fati i Mbishkodrës, fati i pandarë i historisë kombëtare, Gjelosh Gjokajn e përcolli nga kur mësoi se kush është dhe ç'duhet vepruar para një boshatisje rrëqethëse. Nga Kroi i Trabuinit e gjithandej Malësisë ishin zbrazur fshatra e qit fare bajraqe; ishte shfaqur paça tij toka e shkretë, tamam si në poezinë e Eliotit, me një vetmi mbytëse që e nxitën të mendojë se çka më tutje? Në të vërtetë, piktori na përkujton një moment nga historia njerëzore e përsëritur kushedi sa herë në hapësirën shqiptare, por nuk di a i ra kujt ndërmend se boshatisja e vazhdueshme shpie te turrja e Atdheut, te zhdukja e një kulture e populli. Pra, shamia rreth kokës, djepi në cep të krahut, vënia e dryrit shtëpisë dhe braktisja shumoheshin dhe kolonës së refugjatëve nuk i shihej fundi.

Si ca krijues të tjerë edhe Gjokaj e kishte parandjerë të keqen që në fazën e parë të krijimtarisë së tij (1980), tjetër që interpretit i duhej parapërgatitje për të pabesueshmen. Pra, vizionariteti është veti e krijuesve të mëdhenj. Ata jetojnë më tepër me të ardhmen. E projektojnë atë ashtu siç e ndiejnë dhe e duan. I preokupon vazhdimisht e nesërmja, çka më tutje? Romani *1984* i Orvellit është vepër vizionare. Aty paralajmërohej shturja e diktaturës.

E, në të tilla vepra nuk luan rol vetëm imagjinata krijuese, por edhe guximi, reagimi intelektual ndaj tërmeteve shoqërore-historike-

njerëzore. Mesazhet janë të kapshme nëse e shikon të tashmen, ashtu sikur gjendesh para një gorreje. Dhe, nëse arrin ta lexosh, ta zhveshësh nga misteri, nuk mund të mos pyetësh: deri kur kështu?

Ngjashëm e kisha bezdisur veten në përçafimin e akulltë të Bllacës apokaliptike. Rrotull vetes shami, djepa, boshçe me plaçka, njerëz me nga një gjysmë buke bajat, me nga një këpucë, në këmishë e brek, gra me fëmijë të zdeshur e të përgjakur, surealizëm i tmerrshëm ngulitej në kujtesën time. Dhe më bëhej se ato fytyra të ngrira i kisha parë diku, po ku? Nuk mbaja mend as kohë, as vend. Syri magjik i kamerës nuk di ç'kishte shënuar nga turma e pakrye; nuk besoj, po ashtu, se vezullimi i saj i kishte zënë të gjitha të bëmat në Bllacë e në marramendthin njerëzor. Nuk është me rëndësi numri i varreve. Qeniesore është se aty kishte ndodhur krimi i paparë më parë...

Dhe tek i afrohej pikës, ku ndahej vdekja nga jeta, nuk e besoja se hapësira ime shndërrohej në një sampo gllabërues; se më bluante e më hidhte; se isha njëri nga ata të panumërtë në kolonën e pafundme të refugjatëve. Në një tablo shumë më herët këtë detaj trishtues e kishte hedhur piktori gjakovar me renome, Abdurrahman Buza.

Isha ndalur para saj shpesh dhe nuk kisha besuar se diç mund të ndodhë. E, para situatave të tilla shfarosëse njeriu humb edhe të folmen; i ngjan një egërsie, ballafaqohet me një rrënim njerëzor, ku më tepër vepron instinkti shtazarak. Regjimi kriminal serb i pa shqiptarët si farë që duhet zhdukur. Sipas logjikës raciste ajo duhet shkullur me rrënjë dhe në vend të saj të ngulë gurin e pansllavizmit, të alarmohet bota pastaj se deri ku shtrihet mbretëria serbe. Kosovën e lëshuan shqiptarët turravrap, hundebuzë, me biçikleta e duar në xhepa, me kuaj e traktorë, me kamionë e trena kafshësh. Ndodhi ky pastrim etnik shkaku i ndërrimit të gjërave në hapësirë, ku instalohet ligji i krimit. Nuk trillohej gjë, as nuk aktrohej me vdekjen. Nuk mbrohej liria. Ajo rrënohej, ose prapë grabitej e humbura. Ekzodi shqiptar i ngjau gjahut në njerëz. Dhe vitin 1999 e quaj vit bibliik shqiptar.

Ditën kur e lija Bllacën më ishte bërë se zgjohesha nga një ëndërr makbetiane. Fatkeqësisht, ky ishte realitet. Pëllumbin e zi në cep të krahut ma kishte lëshuar Kasapi i Shumadisë...

## 2.

Unë jam kundër ekzodit. Atë nuk e pranoj si zgjidhje; ekzodet, po ashtu, kanë diç që i dallon. Derisa shqiptarët deportoheshin me dhunë edhe nëpër fusha e male të minuara, pa teshekoteshë, zi e më zi, pas tyre mbetnin shtëpi të djegura, të rrënuara, puse të helmuara e përplot kufoma, varre masive që nuk dihet numri, dhe masmediat botërore regjistronin apokaliptikën e kohëve moderne, grithnin ndërgjegjen njerëzore se ajo që ndodhte në Kosovë nuk kishte asgjë me luftën; ekzodi serb është ana tjetër e të vërtetës, i kurdisur nga regjimi serb. Të ikin serbët! Pse ikin ata? Mos i ndiqnin shqiptarët? Po këta nuk e ndalin vrapin: me teshekoteshë, me kamionë plot plaçka të vjedhura nga shtëpitë e autoktonëve. E, kjo flet më mirë për moralin e tyre. Zaten, ky ishte “muzgu serb”, ikje nga fusha e kimit. Ata ikin nga errësimi i ndërgjegjes së tyre. Në Fushë-Kosovë nuk çeli bozhuri, po lulekuqi shqiptar, nën hijen e të cilit fikej ëndrra serbe.

Nuk them se në ekzodin serb nuk kishte dhe njerëz të pafajshëm, por regjimi kriminal serb përpiqej të luante rolin e viktimës; se ata që vrasin në Kosovë janë shqiptarët, ata zbrazin Kosovën nga serbët.

Mirëpo dredhia serbe është aq e lexueshme sa masmediat botërore nuk e panë të arsyeshme t'i japin vend më shumë se meritonin; në ekranet e tyre nuk dëshironin të defilonin edhe ata që kishin bërë aq shumë krime, jo vetëm në Kosovë. “Muzgu serb” mbyllej ashtu siç e meritonte. Kështu, vaji i Dobrica Çosiqit para Akademisë Serbe (1999) se “kufiri shtetëror nga Bjeshkët e Namuna na është bartur në Kopaonik”, te Rasi, bën të dyshosh se zotëria nuk e di historinë e vet ose shtihet. Më duket se, më në fund, bota ia tregoi se ku gjendet djepi serb. Qesharak është moderimi i tij, mbasi “në traumën memorandumiane” ishte kryesori. Kishte kërkuar disa herë copëtimin e mëtutjeshëm të Kosovës derisa një ditë të fshihet. Zotëria nga Pashalleku i Beogradit nuk e merrte me mend se vjen dhe dita kur Serbia mund të rrokulliset... Neve kjo nuk bën të na gëzojë. Kombi ynë gjendet në një testim të hatshëm. Lufta për ne tek ka filluar: rindërtimi e mbrojtja e hapësirës sonë jetësore-historike. Dinë gjë për këtë tanët?

### 3.

Vepra shkruhet të lirohesh nga zjarmia e brendshme, të artikulolesh vetveten dhe të vësh dialog me botën; vepra shkruhet të mos harrosh çaste, data, ngjarje, sisteme, kohëra. Krijuesi merr pjesë në projektimin e rindërtimit të ardhmes, duke luftuar të shëmtuarën, që zvetnon edhe të tashmen. Për një tekst të një miku, ku shihej Kosova nga një kënd tjetër, ma bën me dije njëri se temat nga Kosova kanë filluar të bëhen bajat, nuk ka institucion apo individ, që nuk merret me diç nga toka e djegur. Si duket, miku nuk e kishte të qartë se kurrë nuk është mjaft të shkruash për tragjedinë njerëzore; se ajo na ndjek edhe atëherë kur mendojmë se çojmë çaste të lumtura. Të tashmen ta ketë krijuesi ashtu siç dëshiron, ai patjetër duhet liruar nga hijet e shëmtuara. Nëse këtë nuk e bën, ai ka harruar se jeton për të nesërmen. Në momentin e pikërishtëm të shkruash për dashuri, e cila fisnikëron dhe pasuron njeriun, nuk di sa mund të ketë emocione e sinqeritet. Pranë një plage që kullon, mos luajmë shtazarakisht, siç ndodhën përdhunimet e të gjitha llojeve. Dashuria është diç hyjnore, e cila e kërkon kohën e vet. Apo, letërsia a mund të jetë një fjalëkryq letrar, të merret me të vetëm autori dhe një bus kureshtarësh? Të shkruash për morbiditetin njerëzor nuk do të thotë se krijuesi ngec në tekst, në ndërtimin e tij. Përkundrazi ideja, mesazhi e përmbajtja para krijuesit serioz, që letërsinë nuk e kupton vetëm vetëkënaqësi, shtron edhe problemin e tekstit, tjetër është ca nuk duan të shkelin nëpër gozhda, por kanë qejf të merren me një fjalëkryq letrar, pa gajle e shqetësime njerëzore.

T'i kthehem prapë ekzodit. Deportimi apokaliptik ishte një surealizëm që vështirë mund të përsëritet. Në përplasjen e turmës veneroje edhe atë shaminë të lidhur fort rreth kokës; valëvitej e përgjakur dhe në fusha ose në ndonjë hu gardhi, ku dora kriminele e kishte ngulur tamam si në mesjetë e kënaqej me qetësinë duke u fotografuar si triumfues, shihje nën muret e rrënuara vogëlushet si përkundnin djepa të zbrazët, si i mbulonin ata me copa ninullash e fjalësh të përgjakura; pastaj artin e mjeshtrëve shqiptarë në kulla të Junikut, të Dukagjinit, të Çarshisë së Madhe në Gjakovë, të Çarshisë së Gjatë në Pejë përpiqesha t'i kthej në jetë nën madhështinë e

Bjeshkëve të Namuna. Sapo vrapoja nëpër Kosovë, më trandi miku. Në Mbrëmjen e poezisë europiane në Berlin (Werkstatte, 3.07.1999), qetas tha: më vjen mirë që nuk e kupton se ç'lexoi poetesha. Më kishte folur pastaj për mesazhin bizar të atyre vargjeve. Nga shurra një qift vizatonin konturat e diçkafit..

Në tryezën: *“Të krijosh, të mendosh e të filozofosh në hijen e luftës”*, të mbajtur në Mynhen (5-6 qershor), kisha deklaruar se plaga më e rëndë që kam marrë në jetë është shkatërrimi i Kosovës. Ka një gjysmë shekulli që flas për këtë e pakkush më ka dëgjuar. Le të flasim tani ata që heshtën para krimit...

Nuk di a do të kem fjalë më. Ndodhin gjëra që nuk harrohen. Prapë pyetja: çka më tutje kur për ne lufta tek ka filluar...

## KUR VJEN E NESËRMJA

1.

More doja ta dëgjoja njeriun e gjallë të rrugës sime, të dheut tim. Nuk u besoja fotografive të zeza, as fjalëve, as kallëzimeve; nuk u besoja as syve, as veshëve. Kishte ndodhur përmbysje e madhe brenda e rreth meje. Njeriun tim të gjallë e kërkoja, atë që kishim pirë bashkë e qarë halle. E, ku të gjendej ai. Zhurmë bënte edhe guri e pakëz gjëra depërtonin nga qendra e tmerrit. Komunikimi elementar njerëzor, nuk e mbaj mend, se kur ishte ndërprerë. Masmediat vazhdonin të çthurin kujtesën; të mos e njihja as dheun tim, as qytetin e lindjes. Do të thotë kush nuk paska shpëtuar. Të mitë i quaja të gjithë. Kisha humbje këndeje e andej. Numri shumëzohet. Shokante bëhej ajo që e shihja dhe e lexoja. E, si të besoja se njeriu ishte shndërruar vërtet në kafshë, nuhaste jetën edhe në nevojtoje. Nëna më thoshte, njeriu kur shkallon, lëshoja udhën; ose vëre në pranga. Po udhën ma kishin zënë në të katër anët. Dhjetë ditë nuk kisha ditur se ç'ndodhte në kojshillëk, as dy fjalë nuk kisha mundur t'i ndërroj me ndokë. Telefonin e kisha parë si hiqte shpirt tamam si njeriu. Isha një i gjallë i vdekur. Pas vrasjeve, që kishin ndodhur, bota u bë më enigmatike, ishte kyçur edhe lufta speciale. Ca nga ata i njihja. Kisha pirë kafe e kisha marrë pjesë në takime letrare. Tani rrinin aty-diku para meje: pajja njerëzore e Latif Berishës me "Tufën" e tij, fjalët e fundit të mikut e avokatit Bajram Kelmendit: Shkreli nuk do ta përballonte këtë, do e lëshonte shpirti, pastaj recitimi kumbues i tij i "Lahutës së Malcis". Kishim ndezur dhe nga një cigare në "Polo" dhe ishim ndarë me shpresë se bëhet mirë dhe vdekja shpejt do ta braktisë dheun tonë. Keqas ishim mashtruar. Ajo kishte filluar të na hajë një nga një; të çelin vezët e saj edhe nën lëkurën tonë, të zgërdhiet, të na mbështillet rreth trupit, të luajë me ne si maca me mi, të mos na

konsiderojë fare për të gjallë se ne përditë ishim më të vdekshëm, më shumë i takonim mbretërisë së tejmë.

Ballë tmerit nuk vlente asgjë njeriu. Shtetrrëthimi na tkurte vazhdimisht, sa vinte e humbnim. Rezistenca e fundit: të mposhtësh këtë, ose të ngordhësh në ndonjë bodrum. Merre me mend, më kishte thënë një poet, vdes e te koka nuk ta thotë kush një fjalë! Çfarë kohe troket, o Zot.

Me ditë kisha qeshur pa të keq me shqetësimin e mikut. Pjesa dërmuese, më në fund, kishte zgjedhur shpërthimin e shtetrrëthimit. Nuk mund t'i fshiheshim më plumbit. Bëheshin ca ditë që NATO-ja ndiqte vdekjen e në emër të saj barbaria serbe rrëronte edhe objekte monumentale të një kulture ndaj të cilave nuk kishin ngritur dorë as nazifashistët, as hordhitë më të egra të osmanlijve. Ballafaqoheshim me një kope, që nuk dinte ç'është dinjiteti njerëzor, as nuk dinte të respektonte kulturën. Njeriu kishte veshur lëkurën e gjarprit, të ujkut, të hardhucit; e kishte fshehur fytyrën pas maskave, pas sorrave; artikulimi i tij i ngjante krrokatjeve të korbave në shkretëtirë. Lexohej kjo edhe në pikë të natës; edhe qorri i mëhallës e lexonte. Në gjysmë të javës së dytë të bombardimeve e pashë veten në kolonën e gjatë. Le të na bëjnë sapun për pisllekun e Serbistanit ose ta mposhtim shtetrrëthimin. Dihet fundi i marshimit... Njeriun e gjallë të vendit tim doja ta dëgjoja, atë që më bezdiste edhe në ëndërr. Po Zenuni, Ramizi, Ibrahim, Rexhepi, Shefqeti, Eqremi ku strehoheshin vallë?. Kap më vonë zërin e Bacës në radio. Ishte ngrehur para tytave. Trimërinë e tij e njihja edhe nga ngujimi njëmbëdhjetë ditësh në Kullë të "Rilindjes" (1993). Donim t'i shpëtonim gazetat e *Abetaret e fëmijëve* tanë. Bacës ia kishim lënë të gjitha. Edhe braktisjen e Kullës.

## 2.

Bllaca është turpi i Evropës. Me asgjë nuk mund ta lajë. Aty nuk lamë vetëm varre, aty fillon Bibla e modernitetit njerëzor...

### 3.

Abeja i Bokshit, Xaja i Nurës e ca të tjerë gjenden në Tiranë, më kishte lajmëruar Agim Gjakova. Rrëzë Sharrit bisedonim me Raufin për “*Gocën e Kaçanikut*”, me Muratin e Sedatin na ishin sosur fjalët për Kosovën; kjo ishte diç e ardhme, se kishte Zot edhe për ne. Me ndjenjë të akullt u ngujova në Kullë të Belëve. Kërkoja të përbashktën me Kullat e Dukagjinit. Dallimi ishte se kulla e Belëve kishte më shumë dritë dhe ishte e punuar nga një gur roze. Sidoqoftë, për herë të dytë pritja këtu haberin e maratonit që vononte. Prapë më kishte tundur zëri i Agimit: Fundekrye është djegur Çarshia e Madhe, zjarri ka rënë edhe në Çarshi të Vogël me të dy kishat e shtëpinë tënde, edhe mëhalla jote. Nëpër Evropë çfarë hajmalie të varësh rreth qafe? Zeqa i Canës, ai i vjetri; pas një kohe iu bashkohem për krejt dajës Cenë e Qumilit të Gexhës; me shkrumin e qytetit do përzihem e do kërkoj fërkemët e fëmijërisë. Dëgjo ore, gjë nuk ka mbetur nga fëmijëria jonë! Poshtelart i rashë Gjakovës, të ngjallë atë pjesë të vdekur. Din Mehmeti edhe këtë herë ia lagu vdekjes. Tani grindet me fjalë. Kryesore, janë njerëzit, shkrumi i ka bashkuar. Qytetin do ta ngrisin më të bukur për inat të hasmit thonë. E, për një pllakë mermeri, e gjejmë një mur. Mos u bë merak për këtë. Kthehen të gjallë e të vdekur... Zëri i tij ishte përplasar për kepa të Dajtit, pastaj. Në murin e Belëve kisha varur edhe një fotografi tmerri nga dheu im. Kërkoja aty rrugën time, shtëpinë time. Deri te e Dr. Izet Himës kisha kaluar mirë. Më tutje nuk ekzistonte asnjë shenjë. Isha njeri tjetër. Për Urën e Shenjtë dëgjoja gjithfarë kallëzime: ca tregonin se është këputur në kurriz e ca nuk kishin haber se kur do të bashkohen brigjet. Ura e Tabakëve ishte shembur nga ekzodi e Çabrati përdhosur. Nuk dihej a do të dalin më perënditë aty; në Tophane flitej se kurrë nuk ishin parë kasapë më shumë; Krena kishte humbur ditën kur kulmet e shtëpive fluturonin e njerëzit mbaheshin për cungë. Merre Biblën zotëri e lexoje prapë; diku do ta gjesh qytetin tënd dhe shtëpinë e lindjes. Pastaj, pastaj nuk di se ç’kishte ndodhur.



4.

Portretin historiko-mitologjik të qytetit tim mjaft mirë e kisha lexuar në një poezi të Kadaresë. Përafërsisht aty thuhet: *bie shi atje e gjakun nuk e lan...* Ky mendim i poetit ka mbështetje të fortë. Gjakova vërtet është qytet prej gjakut. Kur shpërthyen demonstratat gjithëpopullore në Kosovë (1982), në qafë e kisha bartur Europës Lumin. Në një kopsht veror të Pashallëkut të Serbistanit tek pinim kafe me Abejën, dy-tri tavolina larg nesh, një grup serbësh të çartur, i luteshin Zotit të mos ndodhin trazira rrezë Çabratit. I frikësonte ky qytet, i digjte më shumë se zjarri i xhehnemit. E, këtë frikë nga e kishin, nuk e dija. Gjatë kisha menduar për këtë, se unë ende nuk dija ç'kishte nën lëkurë qyteti im. E shikoja atë: një pëllëmbë tokë e gjithë ata gjakovarë të derdhur edhe aty ku nuk beson kush. Në të vërtetë, ky ishte guximi, fisnikëria qytetare për rrezatim. Marshimin tonë e kishte quajtur dikush irredentizëm të heshtur qytetar. Kështu, pa zhurmë rikthenim hapësirën e rrëmbyer.

Këtë e dëshmojnë tani edhe fotografitë e fjalët pa gjymtyrë, të copëtua. Kaq varre masive, kaq njerëz të humbur; qindra të rinj në kazamate të Serbistanit. Nga farefisi i nënës shpëtoi vetëm një shtatëdhjetëvjeçar. Bredh tani me një koc në dorë, nuk di i cilit fëmijë apo gruaje është. Miku i fëmijërisë dhe i mëhallës, Luan Mulliqi, disa herë ma përkujton nga Stambolli se Iliridës borxhin duhet kthyer. I duhen fjalët për një punë që bën.

5.

Shpesh thuhet heronjtë nuk dinë si shkojnë, as kur shfaqen. Kur i kishte parë, duke i rreshtuar para togut të pushkatimit dhjetëra të rinj, Profesori u kishte dalë para. Të gëzuar se kë shikonin, ata kishin lëshuar të rinjtë, por Profesori nuk ishte kthyer më. Askujt nuk u kishte ofruar vetëvendosje. Enklavat i konsideronte kanceroze. Katër gra pas dy ditësh e kishin përcjellë në udhëtimin e tij të fundit. Rast i rrallë i guximit intelektual e njerëzor në historinë e përbotshme. Në orë të hershme të Lëvizjes Demokratike, pa dyshim, akademik Fehmi Agani ishte truri i saj dhe vështirë t'i gjendet shoqi. Fundin e regjimit

kriminal serb moti e kishte paralajmëruar, por kush ta kuptonte nga folkloristët. Pa zhurmë iku profesori. Nga kodi njerëzor kishte mësuar ç'është dinjiteti. Populli ynë ka fatin e feniksit; rilindet e boshllëkun nuk e pranon si filozofi të veten.

6.

E konsideronim për njeri të urtë. Në mbyllje të marsit, në derë të secilit shqiptar, trokiti: pas sones, ne serbët do t'i mbajmë çelësat e hyrjes kryesore. Të nesërmen ishte parë në togun e paramilitarëve në një makine pa targa. Në vetëshërbim, ku nganjëherë bëja edhe pazarin, akull më pritë shitësja: nuk mund t'u shërbejmë më. Iku koha juaj. Krejt qetas ia bëra me dije gruas se me shfaqjen e racizmit mori fund edhe Serbia në Kosovë. Dhe, kur e linim Prishtinën, në mes Fakultetit Teknik e Spitalit, dy trupa pa jetë na bëhej se na dëshironin fat në jetë. Ishin shtalbet e parë, ndoshta nxënës të gruas, ose lexues të poezisë sime. Kolona e gjatë ngjitej qiellit të zymtë...

Në një poezi të hershme e kisha parandjerë fundin e turpshëm të dhunuesit të lirisë, e kisha bartur deri aty ku e theu qafën. Mund të bëhet se kjo ndodhi në Bllacën Biblike. E e nesërmja kur vjen, do Zoti e nuk e lë lëkurën time. Vrasësi kishte një tjetër, rrëqethëse. Në të pamë, thonë mos u harroftë; te Dritëro Agolli do e dëgjoj këngën përmetare: *Dita e diell kur vjen*, e do i kujtoj vajtajat e vendit tim ...

7.

Dikur mendoja se Bibla është pjellë e imagjinatës njerëzore. Nuk është ashtu. E pashë me sytë e mi të gjallë; se isha një tregim fantastik i saj, i kohërave moderne të njerëzimit.

Biblën kurrë më nuk do ta lexoj...

*(Korrik, 1999)*

## FUNDI I CARËVE

Kur mendonim se më në fund mbyllej edhe një luftë e përgjakshme në Ballkan, papritmas u shfaq koha e temjanit, me plot dredhi. S. Millosheviqi, tipik bari e dhelçerak, anadollak pakëz në sjellje, luan tani rolin e Car L Lazarit aty në Dedinje të rrënuar. Hipnotizon popullin e varfër me një rindërtim të një ure diku në Vojvodinë. E, populli i gjerë vazhdon të kremtojë humbjen e vet më të madhe në histori, përgatitet edhe për humbje të reja nëse prapë paranoja shkallëzohet. Nuk mbahet mend të ketë kremtuar kush humbje, ndodhka kjo me popullin “hyjnor”. Edhe humbja qenka fitore (!)

Cari tjetër, nga Sibiri i akullt, tovarish Jelcin, gjysmë i vdekur e gjysmë i gjallë, shtrëngo i dhëmbët kur Perëndimi mbështetej në të si njeri i proceseve, i mirëkuptimit dhe kur bënin çmos t’i shpëtonin miliona rusë të uritur. Nuk mund u shkëput nga bota e carëve. I zbuloi muskujt mos i frikësonte forcat e NATO-së. Në mënyrë tinzare pushtoi pistën e pikëlluar të Sllatinës. Në Kremlin ngriti gotën e shampanjës, siç kishte vepruar para ca vitesh cari i Shumadisë, me rastin e rrëmbimit të autonomisë shqiptarëve. Në këtë tradhti qëndrimi i akullt i grekëve dhe i ca qeveritarëve italianë e francezë mbetet i dyshimtë. Rrënimin e diktaturës në Serbi nuk e kuptuan edhe si liri të popullit të varfër serb.

Ra kjo vdekje, thotë populli, e na zbuloi miqtë tanë të dikurshëm e të tanishëm. Fati ynë paska qenë shpesh në duar të armiqve të përbetuar, që tani ua shohim edhe shpinën. Para një sfide të tillë duhet të ndërrojë edhe sjelljet, të shpëtojmë integrimin tonë në të gjitha forumet europiane. Me këtë do të çonim në vend amanetin e rilindësve, se jemi popull properëndimor. E, këtë mesazh një gjysmë shekulli e luftuam. Pse luajtëm?

Tovarish Jelcinin më shumë i pëlqyeka loja e carëve. Si duket, vetëm këtë më së miri e luan. Në këtë kohë ndërrimesh të mëdha, nuk

harrohet asgjë. Sidoqoftë, zotit Jelcin i ranë maskat. Tani ia shohim fytyrën më të plotë dhe gushën e fryrë nga europianët. Tregoi se ku është e ç'ëndërron: me jetue e me mashtrues me vjet e mot...

Marshimi i forcave të NATO-së në Kosovë u përçoll me gjakderdhje tamam si në legjendat ballkanase: nuk ngrihet shtëpi pa kurban. Në Qafë të Duhlës ranë tre gazetarë gjermanë nga dora e atyre, që ishin mësuar të vrasin fëmijë, gra e pleq. Nxitonin të raportonin për diç historike. Por ai që është mësuar të vrasë, do t'i vrasë edhe ata që shënuan një datë të re të historisë.

Babai im, ndjesë pastë, kishte ngrysur vite e vite dhiareve e shpellave të Alpeve Shqiptare si luftëtar i Bajram Currit. Dhe, e kishte pasur me vend: frikacaku kurrë nuk ka besë. Është e dhembshme vrasja e gazetarëve gjermanë, të cilët lanë kokën aty në Qafë të Duhlës. Ranë nga plumbi serb. Ngjarjet në Kosovë, pas hyrjes së NATO dhe zgjimit çmendurak të carëve të akullit, do t'i bindë europianët se ne shqiptarët nuk e kishim lehtë me fisin serb që nuk respekton asnjë normë njerëzore. Çmenduria e tyre zoti e di si do të mbyllet. Pastë ndjesë kaçaku im! Doli më i mençur se ca koka europiane, të cilat i mashtroi cari gjysmë i vdekuri e gjysmë i gjallë kur muzgu filloi të bjerë mbi stepën e akullit.

## KANTONIZIMI - FUND I KOSOVËS

Jugosllavia e mbeturinave është i vetmi shtet në botë, me kryetar e udhëheqësi të ngushtë shtetërore, që ndiqet penalisht për krime kundër njerëzimit; po ashtu serbët janë i vetmi popull që shtetin e vet nuk duan ta pagëzojnë me emrin e tyre, mbasi nuk mund të heqin dorë nga apetitet hegjemoniste ndaj të tjerëve. Megjithatë, kjo është çështje serbe, e mentalitetit të tyre. Por paradoksale është ky biçim shteti, që mund të quhet dhe Serbi e Madhe, i shpallur nga Gjyqi i Hagës e institucione të tjera ndërkombëtare si regjim kriminal, të diktojë ende se ç'duhet bërë me Kosovën, tani Protektorat Ndërkombëtar. Vështirë të pajtohen se Kosova ishte tokë e okupuar dhe kurrë serbe. Përmes kanaleve diplomatike, pionëve e organizatave sekrete, që veprojnë ende në Kosovë, kërkojnë kantonizimin e saj ashtu siç është parashtruar në elaboratet e memorandumet fashistoide të Akademisë Serbe. Bëjnë çmos në tkurrjen e hapësirës jetësore-historike të shqiptarëve, Pra, Kosova të bëhet më e gjymtë se në kohën e komunistëve (1945), derisa një ditë të fshihet edhe nga hartat e ndryshme e të flitet për të si për Atlantidën.

Copëtimi i Kosovës po qe se ndodh, atëherë Bashkësia Ndërkombëtare dhe SHBA-ja duhet të pranojnë se kanë humbur betejën dhe të çojnë dorë nga parimet demokratike e ndjekjet penale për krime njerëzore. Ky biçim shteti luan mu në këtë letër: të shfajësohet edhe përmes gabimeve të shqiptarëve, se çdo minus yni e pafajëson regjimin kriminal serb nga gjenocidi, jo vetëm ndaj shqiptarëve. Pra, karemi serb, varet kryesisht nga faktori shqiptar: sa do të jetë kooperativ me SHBA-në dhe Bashkësinë Ndërkombëtare. Vetëm atëherë do themi se jemi përshëndetur edhe me robërinë serbe.

## II.

Kantonizimi i Kosovës na sjellë para një akti të turpshëm. Së pari, gjunjëzimin para elaboreteve e memorandumëve fashistoide të Akademisë Serbe; së dyti, nëntëmbëdhjetë vendet demokratike del se paskan luftuar për realizimin e planeve sekrete serbe; së treti, Kosova nuk mund të jetë as të bëhet më xhuxhe. Për fatin e saj vendosin SHBA, Bashkësia Ndërkombëtare, autoktonët dhe të tjerët që pranojnë bashkëjetesën me shqiptarët; pra të liruarit nga urrejtja e racizmit nacional; Kosova kurrë nuk ka qenë tokë serbe. Vërtet, Car Llazar ra në hapësirën shqiptare. Kjo nuk do të thotë se mund të quhet tokë e tyre. Kosovën e braktisin kriminelët, që vranë e pjekën, që plaçkitën e rrënuan gjithçka që nuk ishte serbe. Pseudoshkencës serbe do i dalë problem: të pranojë para ardhmërisë serbe dhe botës se Miti i Kosovës është një mashtrim i kulluar, i ngritur për qëllime ekspansioniste jo vetëm ndaj hapësirës shqiptare. Po serbët a do kërkojnë ndjesë, vështirë se do bëjnë këtë mbasi janë humbës të përhershëm...

Se ç'mendoi kreu politik serb para barbarisë në Kosovë dëshmon edhe fakti: Nga Drenica deri në Gjakovë u dogj çdo gjë. Po të vijë deri te ndarja, pjesa më e shkatërruar do t'i mbetet Shqipërisë. Pjesën tjetër vetëm e plaçkitën dhe u ndërruan bravat shtëpive për kolonët nga Kroacia e Bosnja. Në elaboretet e tyre shkruhet se çka kujt t'i takojë. Nga kjo ide Serbia nuk heq dorë as tani kur Kosova ecën drejt pavarësisë.

## III.

Kohëve të fundit kalkulohet me të madhe me numrin e serbëve. Në masmediat alarmohet se Kosovën e lëshuan mëse dyqindmijë serbë. Në *Dojçe Wele*, një apartçik i tyre deklaroi se në Kosovë ka edhe afro nëntëdhjetëmijë. Nga regjistrimet e kaluara me tëra falsifikimet, numri i serbëve mezi arrinte dyqindmijëshin. Si u bë kjo? No coment! Fajtorë për braktisjen e serbëve nuk janë shqiptarët. Ata nuk panë kurrfarë perspektive, as nuk pranorin të çonin jetën me autoktonët, vazhdimisht ndërsheshin nga nacionalizmi serb. Kështu,

fatkeqësi e Serbisë u bënë vetë serbët e Kosovës. Ndërkaq, shqiptarët nuk patën ku të shkonin tejpragut të shtëpisë. Mirëpo, barbaria serbe nuk u ndal me kaq; desh t'i qesë fare ku janë e nuk janë, që të realizohet ëndrra pansllave për një Ballkan pa asnjë shqiptar. Micsokolat tanë nuk bënë të mendojnë vetëm për shkama. T'i dalin të keqes përpara. Rast për burrëri është.

Bastioni i fundit i diktaturës në Beograd bie, e ne duhet t'i bëhemi krah SHBA-së dhe NATO-s në ripërtërirjen e jetës, demokracisë e vlerave njerëzore në këtë skaj të Ballkanit. Të mbetet ky synimi ynë i vetëm. Dora e fortë e cenzura, etiketimet komuniste e marrja me vetveten u takojnë të kaluarës. Demokratizimi i shoqërisë shqiptare i tmerron vetëm shtetet përreth nesh, sidomos ato që treguan apetite të vazhdueshme për hapësirën shqiptare. Është koha të mos luajmë me fatin tonë. Përmes kanaleve të ndryshme sllavët e grekët bëjnë çmos të pengojnë proceset e reja në hapësirën shqiptare. Demokratizimin e Ballkanit e shohin si fitore të josllavëve. Të tregohemi popull me orientime properëndimore. Rilindësit vdiqën me këtë zhig. Kjo nuk do të thotë se nuk bënë të jemi vigjilentë. Na duhet një katarzë nacionale dhe mençuria e trurit.

#### IV.

Moti dihet se Serbia nuk ka opozitë. Kjo kalkulon dhe aktron moskënaqësinë. Është nën dirigjimin e fortë të Millosheviqit. Opozita serbe luan nën ritmin e instruksioneve të Vozhdit. Këtë e di edhe Perëndimi, por Vozhdi i duhet. Agonia e popullit serb nuk na konvenon, po ashtu. Nuk zgjidhen konfliktet qindvjeçare me pastrime etnike, le të merret ligji me krimin. Ne shqiptarët nuk kemi pse të frikësohemi, një të keqe kujt nuk ia bëjmë. Për këtë dëshmojnë tokat tona tej gurit tragjik.

Kam thënë më parë se lufta për ne tek ka filluar: të merremi më tepër me të nesërmen. Kantonizimin e Kosovës, besoj se nuk e nënshkruan kush. Serbët nuk kanë pse të frikësohen se kurrë shqiptarët nuk i ndoqën. Kontributi i tyre në demokratizimin e Serbisë

dhe në pavarësimin e Kosovës shpie te harrimi i hasmërive shekullore.  
Ky është momenti vendimtar, që ballkanasit të çballkanizohen...

Ndryshe, Kosovën nuk mund e shoh Atlantidë, as të flitet për  
të si për diç që ka ekzistuar dikur.



## A ËSHTË ÇLIRUAR KOSOVA?

Frikësues është titulli i këtij teksti, por në këtë moment frika është njerëzore, do të thoja dhe element vetëmbrojtës. Duke lexuar e dëgjuar shumëçka për e rreth Kosovës dhe duke parë se do gjëra kanë ngecur në gjysmë udhe, vetvetiu shtrohen pyetjet:

1. Nëse nuk funksionon asnjë organ nga ish-qeveria okupuese serbe në Kosovë, si bëhet të ngulë ende aty ish-kryeministri Z. Angjellkoviq, mbështetës i regjimit represiv të Millosheviqit dhe zbatues i gjenocidit në Kosovë? Thuhet se Serbia humbi luftën, pse nuk shkoi edhe ky pas kopesë? Për fatin e Kosovës vendosin fituesit dhe ata që respektojnë vlerat njerëzore.

2. Enklavat serbe, që krijohen në Kosovë, t'i përkujtojnë hartat e panumërta të Akademisë Serbe, që i lansonin si të duket Kosova nesër po qe se ndahet. Vënin gurin aty ku shihnin interesin e tyre ekonomik, pra dominimin e tyre në resurset e mëdha. Ndarja e Mitrovicës është shkaku i "Trepçës", dhe ngulja e forcave ruse në disa vende kyçe duhet të na brengosin e sidomos forcat paramilitare serbe, që thonë se i inkadrohen në radhët e rusëve për të vazhduar gjuetinë ndaj shqiptarëve. Evropa nuk bën t'i mbyllë sytë as të shurdhohet. Kjo nuk i kontribuon paqes në rajon as parimeve të Kombeve të Bashkuara. Shqiptarët nuk bën të lëndohen edhe më, shkaku i shantazheve serbe?

3. Flitet se bie shpejt regjimi i Millosheviqit. Unë pakëz besoj në lojën serbe. Arsyet: së pari, edhe për një kohë ky regjim u duhet faktorëve të jashtëm; së dyti, ky mund të gjallërojë edhe për nja dy vjet. Nga shqiptarët vodhi pasuri të mëdha dhe gjithë kjo gjendet në duar të makinerisë vdekjeprurëse serbe. Ndërkaq, protestat e opozitës shndërrohen në farsë. Nënteksti i tyre lexohet si pakënaqësi ndaj regjimit: *pse u humb Kosova?* Ne, gjërat duhet t'i shohim ashtu siç janë, pa zbulurime. Lufta jonë fillon me ndërtimin e mbrojtjen e kufijve të

saj, pa i fyer të tjerët që pranojnë të jetojnë me ne. Do të ishte tragjike të luajmë në letren e nacionalizmit serb.

4. Nëse iku ish-regjimi, si mund të zbatohen ligjet e saj? Qëndrimi burrëror i gjyqtarëve shqiptarë në Prizren sinjalizon se ligji serb mbetet në përdorim, nuk lejohet të zëvendësohet bile as me ligjin e Kushtetutës së Kosovës të vitit 1974, ose me ndonjë të ri të Kombeve të Bashkuara. Me ligjet që na dënuan është turp të vazhdojmë edhe ne...

5. Bashkëjetesa dhe multikultura janë elemente bazë të rendit të ri botëror. Me vjet ne kontribuam në këtë, por të tjerët nuk e pruan mirëkuptimin tonë. Tani si të shikohen në sy *xhelati* dhe *viktima*? Si të harrohen masakrat, varret masive, poshtërimet dhe shkatërrimi i Kosovës? Me çfarë morali të peshohet genocidi?

6. Në të kaluarën ne i mbrojtëm manastiret dhe objektet e tjera të kultit serb. I kemi mbrojtur ato se i kemi konsideruar për tonat. Shumica e tyre u ngritën në themelet e tempujve tanë: nuk mohohet kjo... Por çudit sjellja e faktorit ndërkombëtar, nuk i ra ndërmend kujt për objektet monumentale e fetare shqiptare! Shumë përmendore e buste të figurave tona u rrënuan. Pse nuk e ngriti kush zërin, por merren me ca përmendore e objekte politike të ngritura pas riokupimit të Kosovës në vitin 1989?

7. Është i marrë ai që përpiqet të barazojë viktimat shqiptare me ato serbe. Nuk mund të barazohet as ekzodi serb me atë shqiptar, që kishte përmasa biblike. Ne mund të mbështesim se gjëra të tilla të mos ndodhin me asnjë popull... Apo, çarmatosen vetëm shqiptarët, kurse serbët vazhdojnë të mbajnë armët. Dihet se krimet më të mëdha i bënë mu këta, kanë plaçkitur e vrarë edhe fqinjët. Se kanë armë serbët, tregojnë edhe bastisjet e rastësishme të KFOR-it. Paranoja serbe: edhe personelin mjekësor armatosi dhe fëmijët. Serbët në Kosovë kishin armë më shumë se forcat e UÇK-së.

8. Propaganda e tmerrshme serbe vazhdon “bombardimet” e Evropës me gjithfarë rrenash për shqiptarët e diaspora jonë hesht në momentin vendimtar të krijimit të shtetit tonë. Serbia vazhdon ta konsiderojë Kosovën krahinë të vet jugore me termin serb *Kosovo*. E,

këtë e gëlltitën edhe shumë masmedia, të Evropës bile, duke e forcuar edhe bishtin i *Metohija*, është çudi se kurrë më shumë intelektualë shqiptarë nuk kanë bredhur Evropës e të mos e ngrisin zërin kundër rrenave serbe, t'u bëjnë me dije se çka është shqiptare e serbe... Mbi tavolinën time gjenden tre libra më të rinj nga letërsia jonë e përkthyer në gjuhët frëngjisht dhe italisht. Në të tre librat përdoret termi serb *Kosovo*. Që të mos turpërohem edhe në këtë rrafsh, më mirë do të ishte Kosovës t'i kthehet emri i moçëm: Dardania.

9. Kosovarët e gjorë vazhdojnë t'i paguajnë dy taksa: njëren qeverisë maqedone dhe tjetrën qeverisë sonë, nëse arrin ta marrë. Në tragjedinë shqiptare vazhdon profiti, plaçkitja e viktimës. Pse? Ka edhe shumë pyetje që mund të shtrohen.

Vërtet, a është çliruar Kosova dhe liria e saj kë e frikëson?

*(Qershor, 1999)*

## NË KËRKIM TË DINJITETT

1.

E hidhur është, por tani për tani në Ballkan nuk ka popull më të çthurur se ne. Pse? Çfarë name na ndjek? Një të keqe nuk i bëmë kujt; e vritemi e tkurremi. Përjetuam edhe pastrimet etnike dhe vagonat e kafshëve e nuk u mbushëm mend. Vetërrënimi na përcjell nga herët. Kosova Lindore shpërngulet në qendër. Bëhemi më xhuxh. Nëse kam kënduar për njeriun e vendin tim, kam të drejtë edhe të protestoj. Them se jemi njëri ndër dy popujt më të vjetër në rajon; se qytetet tona kanë kaq vjet lashtësi; se kështjellat tona janë ndërtuar që në kohën e ilirit të parë; se vendit ia qitëm namin deri ku bën ve qoftëlargu; se bëmë shtet bir e dreq; se kaq vezirë e perandorë i dhamë Lindjes e Perëndimit; se vendi ynë është njëri nga trojet e para të krishtërimit; se gjuha jonë është ndër dymbëdhjetë gjuhët më të rëndësishme të botës; se në hapësirën tonë u ndeshën qytetërimet e pse ndodh diç tjetër tani me ne? Grimcohemi, rrënohemi, nënçmohemi. Faji nuk është vetëm i sistemeve, as i atyre që na ngujuan në lëvozhgën tonë. Pak gjëra bëmë, se na grryu lakmia. Me vendin e kombin u sollëm shpesh si me diçka të huaj, nuk treguam as respekt, se ajo që është imja nuk ka kandar që e mat...

2.

Të urtit e luftëtarët e devotshëm gëzonin nderime të mëdha edhe në mese të tjera. Flitet edhe sot e gjithë ditën për guximin e punën e tyre. Këtë nam e gëzuan edhe në shtete më të reja të Ballkanit: Slloveni, Kroaci, Bosnje. Ca nga ta pata nderin t'i njoh e të bisedoj për të bëmat në luftërat e fundit në Ballkan. Tek i dëgjoja rrëfimet e tyre, e ndjeja veten më krenar. Një popull i vogël kishte ndihmuar edhe të tjerët; se konceptin e lirisë e kishte kuptuar drejt, vlerë gjithënjëzore.

E, kur është në pyetje çështja kombëtare, dalin ca probleme të tjera. Disi shtangemi para vetes. Nuk dimë ku t'ia nisim e ç'të ngjallim më parë. Për të zezë, me bëhet se vendin e kombin e shikojmë me një sy tjetër, ndoshta nga lartësia e kunjit, të bajrakut, të oxhakësisë, të lagjes, apo pse brenda natës duam të jemi ata që nuk mund të jemi. Papritur sindronizohemi në një sindrom gjithëkombëtar dhe vështirë të lirohemi nga e keqja. Më dhemb që Shqipëria nuk u mëkëmb ende. Secili koçobash përpiqet ta vjelë, ta mjelë e ta qethë; të marrë ikën pastaj me disa valixhe. Kjo rrënon moralin tonë për të cilin shesim mend para botës. Vidhet e rrënohet vendi, ku ke parë more?!

Çfarë ligji zbatohet aty? I kohës së qyqeve? Si nuk na vrasin syrin gjithë ato rrëtime bile edhe të objekteve monumentale? Kjo dhemb se toka jonë qenka pa zot. Shkretërimi ndodh në vendin, që e nderuan më shumë të huajt se ne, sepse çdo pëllëmbë e tij është një datë historike. Mashtrohemi, po ashtu, se nuk mund e prek dora e huaj vendin tonë. Këto plaçkitje e rrëtime kush i bën? A duhet Shqipëria gjithmonë të nisë nga viti zero, siç thotë një analist yni?

### 3.

Dhe, kur kujton kush je e në çfarë mjerimi përpëlitesh, nuk mund pa e sharë veten edhe pse ca do ta quanin fatalizëm. U trilluan popuj e shtete, që nuk figuronin në asnjë hartë gjeografike dhe, të ashtuquajturat shtete, vazhdojnë ndërtimin e tyre edhe në dëm të tjerëve, bile duke ua vjedhur edhe të kaluarën fqinjve. E, Shqipëria me lashtësi e traditë kulturore vështirë e ruan drejtpeshimin kombëtar. Mbeti model i vetërrënimit, i vetasgjësimit?!

Është fakt se ne shpesh nuk ditëm t'i zgjedhim miqtë. Çuam “dashuri” me sllavë e rusë e kinezë. Fytyrën e të cilëve u pamë më së miri në zgjimin e Kosovës. Nga Bashkësia Ndërkombëtare e NATO-ja çfarëdo intervenimi, që kërkohej ndaj dhunës serbe, u shty shkaku i botës ideologjike. E, në Kombet e Bashkuara ne ngritëm zërin që në vitet e shtatëdhjeta: se Kina e largët e meriton vendin në mes popujve. Tani bëhet e shurdhër! Zgjidhja e çështjes shqiptare frikëson se ia prish drejtpeshimin e saj. Lidh kumbari me armiqtë tanë dhe ngrit

kartuçin e kuq. Është çudi, ca nga ne as sot nuk mund i lexojnë hilet e “miqve” të dikurshëm. Ne duhet të respektojmë kultura e popuj edhe nga Lindja, por fatin me ta nuk bën ta lidhim. Lexoni e rilexoni rilindësit: kush jemi, cilit krahu i takojmë, ku ishim e ku gjendemi. Nuk bën të kuptohen kërkesat tona si racizëm, por ecim rrjedhës sonë. Borxh e kemi futur edhe Perëndimin. Dy kishave botërore u dhamë njerëzit e parë: Vatikanit, Klementin XI; Patrikanës së Stambollit, At(h)enagorën. Me himnin e Nikita Dardanit, krishtërimi u zgjua në të dy anët e globit. Për Nënë Tereze dinë edhe fëmijët e xhunglës. As nga popujt e mëdhenj nuk e gëzon kush këtë dhunti. Nuk kemi nevojë, pra, të turpërohemi para të tjerëve. Ne duhet të turpërohemi nga vetvetja. Në vendin tonë nuk shkëlqyem si në mjedise të tjera. Shkaku: mungon organizimi ynë i brendshëm gjithëkombëtar, respekti ndaj vetvetes e vlerave. Të pajtohemi se kombi e vendi i takon elitës, ne kurrë nuk do të kërkonim drejtpeshimin kombëtar. Në mes nesh ka defekte, që të tjerët i kanë eliminuar. Me integrimin në rendin e ri botëror besoj se do të lirohem edhe nga primitivizmat e dikurshme. Çështja jonë kombëtare do të zgjidhet dhe në të mirë të njerëzimit, në mozaikun e të cilit do të ketë diç që do të na dallojë si identitetet. Shkaku i pakujdesisë është turp që Shqipëria të mbetet një ishull nga të gjitha anët i rrethuar me shqiptarë dhe me aq shumë kontraste. Një liqë i lagë dy qytete shqiptare: Poradec e Strugë, por imazhi ndryshon. Njëra anë ndryshe e kupton ndërtimin e tjetra, ruajna Zot. Apo të zëmë ngojë Shkodrën, seli e dikurshme e Ilirisë dhe djep i kulturës sonë të lashtë, por ç’ndërtoi dora jonë në këtë qytet? Ose të marrim Beratin e mijëra dritareve për të cilin një gazetar gjerman disa herë tha: Vetëm ky qytet peshon më rëndë se ca shtete në Europë. E si u bë neve të mos na zgjojë kërkshërinë një bukuri e fjetur para nesh?. Ne duhet të ndalim dorën nga rrënimi ynë. Përndryshe, vendi ynë, që poetët e quanin dikur edhe *zonjë të rëndë*, bëhet i gërditshëm. Ne i kemi të gjitha, na mungojnë idetë. Atëherë do binin edhe renegatët e shasit...

#### 4.

Ndodhi çka ndodhi, u bë edhe Kosova. Para nesh qëndron burrëroja, pret dorën e kujdesin tonë. Por armiqtë nuk pushojnë.

Përmes konflikteve, kantonizimit, tkurrjes e mënyrave të tjera të na fusin në grusht prapë. Këtë na paralajmërojnë edhe shpërnguljet nga Kosova Lindore. Por ç'popull jemi kur nuk mund e vëjmë kontrollin e rregullin në vendin tonë? Në Konferencën e Rambujesë nuk e nënshkroi Serbia asnjë dokument dhe nuk ka kurrfarë të drejte të vë dorë mbi tokën e huaj. Doli ushtari serb në kufi, Serbia humbjen e shndërron në fitore. E ç'lufta do bëhen atëherë, nuk dihet. Mu për këtë, të vëjmë rregullin ne që ditëm të vdesim.

Bashkësia Ndërkombëtare nëse kërkon në kufirin mes shqiptarëve të ketë rregull, ta bëjmë këtë ne; po ashtu ta bëjmë edhe në mbrojtjen e manastireve serbe, që historikisht janë tonat. Regjimi kriminal serb të mbahet larg shkaku edhe i qindra varreve masive se fyejmë ata, që na treguan nga lind dielli.

Me një bagazh të rëndë të së kaluarës gjendemi në kërkim të dinjitetit kombëtar. Fatin nuk bën ta hedhim në bixhoz dhe t'u kthejmë shpinën atyre, që na dolën krah. Dihet se Kosova u takon njerëzve të bërë nga dheu i saj.

## LOGJIKA E MEDIOKRIT

Një ulok që thotë se merret me krijimtari, më kishte besdisur rreth përcaktimit të artit; vepra është diç imagjinative e nuk ka asgjë me realitetin; ne duhet të shkruajmë gjëra që na argëtojnë e që harrojmë të keqen. Ta zëmë, të shkruajmë për e rreth ushkurit; ose për kohët që nuk do i prek paranoja. Dikur kishte zënë ngojë tërë letërsinë latino-amerikane. Kishte përmendur edhe emra, veprat e të cilëve kanë bazë realitetin dhe askund më shumë se në to nuk është derdhur gjak. Kështu, shqetësimin e ulokut e kisha të qartë 1.) nuk kishte guxim qytetari të thoshte se në vendin e tij ka ndodhur gjenocid, se varret masive nuk mund të harrohen shkaku i tekeve të Evropës. 2.) Letërisa e akcilit popull është më parë shpirti i popullit që i takon, se mexhliseve të metropoleve u imponohet vlera, jo servilizmi dhe 3.) Evropa mund të ekzistojë vetëm si mozaik i identiteteve. Në të vërtetë, unë nuk mund të jem më european se europeanët; të fal edhe vrasësin, i cili humbi çdo gjë e nuk u kërkon falje as atyre, që u shkaktoi kaq të keqja. Një ulok mund ta bëjë këtë; se nxiton të duket majë ndonjë kunji e të na shesë ders si të veprohet tash e tutje në tokën e shkruar. Artin e dhembjes vëshitë e kuptojnë ata që nuk e kanë ndjerë.

### 2.

Një mendim i Borhesit më ishte kujtuar: kur një varg është i bukur, ai është më shumë se stil... vargjet e mira, ashtu, si faqet e shkruara bukur, nuk kapen lehtë nga historianët e letërsisë... Përballë kisha pastaj mendimin e Orvellit: nuk shkruaj nëse teksti im nuk ka politikë. Nabakovin e kisha lënë për një kohë tjetër, më lirike. Por, unë, të pranoj se nuk kam jetuar në kohën e deportimeve biblike shqiptare dhe varrezave masive; se kur ndodhi kjo katastrofë njerëzore luaja bixhoz në një planet të humbur? Këtë mund ta bëjë ndonjë ulok,



që frikëson nga hija e vet edhe kur e qet fjalën në fletë të bardhë. Ballkanasi mund të bëjë punën e veriorëve, mbasi europeanëve nuk paska kush t'ua bëjë? Logjika e mediokritit: të jesh dikushi, vetveten duhet sharë, pastaj uturaku dhe radioterri të lehë.

Di një gjë: askush nuk mund të nderojë sa mediokri kur të shanë.

*(Këln, 1999)*

## MASKAT LOJË E RREZIKSHME

### Në kërkim të Ballkanit dhe cinizmi i stepës

Libri *Ballkani-tranzit* (1997) i shkrimtarit francez, François Maspero, është shpallim i dhembshëm i realitetit të sotëm të vendeve ballkanike pas rënies së komunizmit. Përmes detajeve dhe fakteve na jep edhe shkakun e përzjerjeve të mëdha të popujve në rajon. Arsyet: 1) formimi i vonshëm i shteteve nacionale dhe 2) interesi i fuqive të mëdha, që shpesh ishin dhe burim i fatkeqësive të ca popujve. Nënteksti: rajon i nxehtë, konfliktuoz. *Radio internationale franceze* e nderoi autorin me çmimin *Dëshmitarët e botës* (1997). Libri hapet me kaptinën: *Dy veta në kërkim të Ballkanit*. Në shtjellimin e ngjarjeve tronditëse inkuadrohet edhe një autor tjetër, fotografi i njohur Klavdij Sluban. Shtegtimi është me fjalë e kamerë, duke plotësuar njëri-tjetrin. Kaptina që na intereson është e dyta, *Vendi i Shqipeve* (afro njëqind faqe tekst e shumë fotografi). Befasia rrëqethëse për shtegtarët nis nga Durrësi. Kështu, shkrimtari shpesh detyrohet të ikën në antikitetin shqiptar, të bëjë krahasime të Shqipërisë në dy kohë. Me gjasë, e fascinon më shumë e kaluara, Shqipëria antike, gjurmët e së cilës frymojnë edhe në kohën tonë, por në trajta mjaft të mjera. Gjatë leximit të tekstit të shkrimtarit francez, sheh se ky fajëson për fatkeqësitë shqiptare edhe dy burrështetas: Bizmarkun (1878) dhe Stalinin (1945). Të dytë çështjen shqiptare e kishin parë me syza të fqinjve grabitës. Bizmarku nuk i kishte pranuar shqiptarët si komb, ndërkaq Stalini i kishte konsideruar si popull i mbrapambetur e primitiv. François na rikujton këtë se shqiptarët ishin në dorë të zotit, prandaj derdhjet e tyre u bënë me gjak. As më pak fyese nuk është dhe cinizmi i Hrushçovit në aterimin e tij të parë e të fundit në Vending e Shqipeve, i cili kishte thënë: bukë sa hani ju shqiptarët, aq hanë dhe minjtë në Rusi... Hallakatia ruse në vendin tonë aty kishte marrë

tatëpjetën. Për mua, në kohën kur Rusia bën çmos për shpërbërjen e Kosovës, telegramin e Jelcinit, dërguar udhëheqjes shqiptare (1999) e shoh si vazhdimësi të perfiditetit sllav. Në librin *Ballkani-tranzit* interesimin e shkrimtarit për antikitetin shqiptar dhe citimet e bollshme për të, e bën edhe për shkak të vërtetës se Shqipëria e dalë nga diktatura kishte një të kaluar të ndritshme dhe kjo që haste nga Durrësi e gjithandej ishte vetëm një shkundje e hijeve të trishta. François nuk mund ta fsheh respektin për Vendin e Shqipeve. Popullit shqiptar fatkeqësi të mëdha i shkaktuan dhe fqinjët, që vazhdimisht e tkurrën hapësirën tonë. Nuk mund të mos e citojë edhe një letër të një ushtari serb të viteve 1912, që e kishte shqetësuar shkrimtarin. E kishte parë se miqtë tradicionalë të Francës ishin një fis i shfrenuar, rrënues dhe shkaktarë të tragjeditive; tmerrin e tyre e kishin përjetuar edhe tej Drinit. Në letër shkruan: “Mund të them se Luma nuk ekziston më. Vetëm kufoma, pluhur e hi. Ka katunde ku nga 100, 150, 200 shtëpi nuk ekzistojnë fare... Në grupe nga 40, 50 veta i therrim me bajoneta deri në të fundit... “Me siguri prof. Zekeria Cana di më shumë për tragjedinë e Lumës dhe të lokaliteteve të tjera tej Drinit. Unë desha të them se Kosova (1999) është reprizë e krimit në Lumë. Krimi i para njëqind vjetësh dëshmon se serbët bënë pastrime të mëdha sistematikisht e në çdo kohë. Por habit fakti se mbetë enigmatik numri i shqiptarëve përkundër barbarive e ekzodeve të shpeshta. Kosova i ngjau një pusi që nuk shterë kurrë, megjithëse tragjeditë e saj u shumuan, sepse, siç tha zoti Bill Clinton, shqiptarët u luteshin një zoti tjetër. Luftën në mes dy popujve që ndodhi në Kosovë, e kap edhe si përplasje të dy qytetërimeve, që vlerat njerëzore i shikojnë ndryshe. Është koha të këndellemi dhe të ndërrojmë diç në sjelljet tona. Të vazhdojmë me mentalitetin bajraktaresk se nga unë fillon çdo gjë: askush para as pas meje nuk ka ekzistuar as do të ekzistojë, se shqiptaria jam unë, frikësohem se çështja shqiptare mbyllet në dëm tonin.

### Parandjenja dhe miqtë

Me Azem Shkrelin ishim për herë të fundit në një mbrëmje letrare në Lozanë (1997), pastaj ai ishte ngjitur Gjermanisë e unë kisha

dalë në Bled, bisedohej aty edhe për luftën në Bosnje e që ishte paralajmërim serioz për Kosovën. Izet Sarajliq prapë kishte thënë: Vetëm një poet i vdekur serb e kishte vizituar. Dhe, me Shkrelin isha dëgjuar dy ditë para se të ikte përgjithmonë. Nëpër fjalë ndieja zjarrin e të papriturës, aty pranë meje dhe nuk më ndahej hi ja e luftës.

Është diç e çuditshme, parandjenja e vë njeriun vazhdimisht në lëvizje. Azemi kishte një dert tjetër, frikësohej se nuk do ta shohë fundin. Vrap i tij do të pushojë një të shtunë, ditë e shtunë do të jetë kur do ik, thoshte. E kundërshtoja se me vdekjen merret një fuqi tjetër. Po këtë e kam thënë në një poezi, nëse nuk beson, gjeje. Vargu ishte ky: *mund të jetë e shtunë pas tërë një të premte...* (poezia *Katër e njëzetepesë* më vonë e vendosur në librin *Zogj dhe gurë*, 1997, faqe 89). Vërtet, ishte ditë e shtunë kur nuk dëshiroi të ndahet më nga dheu i Kosovës. Të dielën piva kafënë e hidhur e të hënën porosita edhe një për mikun. Ia lashë një cigare pranë filxhanit dhe kamerierit ia bëra me dije: kjo kafe është e Azem Shkrelit. Bisedën me hijen e tij e vazhdova aty diku. Ai ishte i fjalës dhe i kuvendit.

Në ekran pas një kohe të gjatë pashë Adem Demaçin. RTK-ja zhvilloi një bisedë me të. Ishte e urtë, njerëzore, bile e dhembshme. Nuk e merrja me mend se del ndonjë uturak rruge e quan qen (!) apo ndonjë piskamaxhi fjalësh dhe e nëpërkëmbë dinjitetin e një personaliteti të shndërruar në simbol rezistence të një populli. Për fat, njerëzit e mëdhenj nuk mbajnë inat, dinë edhe të falin. Demaçi kishte ndërjerë dhembje për mjerimin e atyre që iu kishin lëke. Burrëri nuk është të fyesh atë që di pse jeton, më së pakti ta shembësh atë se ma ka zënë udhën për në pedestal. Në sinqeritetin e Demaçit unë besoj edhe atëherë kur nuk ia qëllon, por nuk është e thënë se gjithmonë ky duhet ta zgjedhë lëmshin. Para meje kam njeriun që gjysmën e jetës e çoi nëpër kazamate të Serbisë e shpërlarësit nuk e morën një shuplakë nga asnjë polici. Demaçit i falet edhe ndonjë lajthitje. E të tjerëve? Kosova do të dalë nga hi ja dhe të keqen ta mund kur mëson të respektojë vlerat e veta, të mbështesë njeriun, luftëtarin e krijuesit, të krijojë shkollën e vet e institucionet bazë për të mbiëkzistuar. Shqipëria ekziston dhe vlerat e saj kulminante janë dhe vlera të kombit. Por Kosova duhet të forcohet. Është kjo në interes të vetë

kombit. Shpesh egoizmi na solli buzë varrit. Ne duhet ta kemi të qartë: atdheun e bën kolektivi.

## Maska nuk dihet e kujt është

Shkrimtari francez tek kapërcente kufirin shqiptaro-grek ishte ballafaquar me maska. Ishin ushtarët grekë të armatosur deri në dhëmbë. Kishin vënë përpara emigrantët shqiptarë të plaçkitur e të sakatosur. Ky kishte qëlluar, si duket, në kohën e “Fshesave të hekurta”. Maskat ia kujtonin kohët e mugëta të mesjetës, njerëzit ndiqeshin si kafshë pse ishin shqiptarë. Fatkeqësisht, kjo lojë u bart më vonë edhe në Vendin e Shqipeve. Rezultati ndërron vazhdimisht. François Maspero, i mahnitur nga peizazhi shqiptar, në librin e vet kishte lënë edhe këtë fjali domethënëse: Shqipëria vërtet është vend i shqipeve...

Në vitet e shtatëdhjeta kisha shkruar poezinë “Maska” (lib. *Torzo*). E kisha parë si një të keqe dhe gati nuk më kishte rënë koka nga maskat përreth. Ulurima e tyre u bë më vonë tmerr i gjallë për familjen shqiptare. Zbrazën e dogjën lokalitete të tëra; ca nuk dihen a kanë ekzistuar. Maska nuk është shenjë e mirë dhe asgjë nuk ka me kulturën shqiptare. Është mjeshtëri më tepër e ortodoksizmit të egër. Loja me maska është e rrezikshme. Humbasin shpesh edhe maskaxhinjtë. Vështirë të dihet se e kujt është ajo...

## BARIU SERB DHE BIÇIKLISTI SHQIPTAR

1.

Fjalët nuk thuhet me një frymë. Ca lihen për më vonë. Shembull më të mirë nuk ka se loja e ndotur e bariut serb. Në tokën shqiptare (Kosovë) kërkon haraç sa më të madh. Bile shkon aq larg e bën çmos t'i legjitimojë edhe forcat e NATO-s, të kenë viza. Pra, nëse mundet, do t'ua shtrydhë palcën si Kosovës. Kërkon dhe tenton gjithçka të zhvillohet nën diktatin serb. Ndërkaq, paradoksi shqiptar: Bajraktarët tanë nuk merren vesh ende dhe nuk duan ta kuptojnë se çështja kombëtare nuk është çështje e oxhakësisë as ideologjike; atë nuk e zgjidh individi as fisi. Është momenti i fundit të kuptojmë se Kosova u takon të gjithëve: të gjallëve dhe të vdekurve. Në një kohë robërie është turp të mos këndellemi si komb e kulturë. Bariu serb vazhdon punën e vet: përçan shqiptarë dhe përpiqet të përçajë edhe Perëndimin (lexo: NATO-n). Politika më së pakti është sinqeritet. Si duket, ne shqiptarët nuk e kemi mësuar ende shkronjën e parë të alfabetit të saj. Jemi këta, pra, që jemi. Të derdhur. Pikë e pesë.

2.

Shteti izraelit kur kishte filluar të ndërtohet, intelektualë e krijues më në zë kishin lënë metropolet dhe kishin nisur rimëkëmbjen e atdheut pranë oazave e lumenjve të vdekur, shpirtëronin një tokë krejt të vdekur. Ua kishin kthyer shpinën të gjitha të mirave vetëm të kenë një copë tokë që quhet: Atdhe. Kësaj udhe besoj se do të nisemi edhe ne, të rimëkëmbim Kosovën nga hiri që lanë pas hordhitë serbe. A mund ta quajë kush veten shqiptar e të qëndrojë anash, të merret me thashethëna e tregtil! Është momenti kur njeriu ynë të bëjë realitet edhe të pabesueshmen. Më tha apo e dëgjova, nuk është veti e krijuesve seriozë. Serbët ëndërrojnë në Kosovë të pakësohen shqiptarë, ose këmba e tyre të mos shkelë kurrë aty. Mirëpo kush

është ai burrë, që harron kulla e varre, kush është ai që vdekjen e bën në dhe të huaj? Njeriu pa atdhe nuk ka as ëndrra, nuk ka as kujtime, i ngjan njeriut shkretëtirë, që pret dorën e huaj ta mbajë gjallë. Mu për këtë kthimi ynë në Kosovë duhet të na trimërojë dhe të jetë ana tjetër e kallëzimeve tona biblike. Shumë nga ne e dimë se nuk do të ketë çati, por kjo nuk do të thotë se dera e shqiptarit mbetet e mbyllur. Më së miri dëshmon mikpritja në Maqedoni dhe Shqipëri, ku populli i thjeshtë bëri më shumë se organizatat qeveritare...

### 3.

Gazetarët shpesh më shtrojnë pyetjen se në poezinë time moti është paralajmëruar e keqja. Këtë ndjenjë më tepër profetike, kur e argumentoj, ata shuajavën; nuk mund e besojnë se të keqen e lajmëruaka edhe një fjalë, edhe një vijëz, edhe një vezullim thike apo dhëmbi të verdhë, lëre më libri, elaborate, memorandume apo një bibliotekë e tërë e urrejtjes serbe kundër qenies shqiptare. Për këtë, që shtrojnë gazetarët, kam pasur probleme edhe me ca mediokër shqiptarë. Trokitja e së keqes në derën tonë u dukej pakëz e pabesueshme, absurde. Në një kohë robërie kërkonin art krejt tjetër, të lakuriqar e buzëkafshuar, të merremi me gjëra efemere. Disi snobët letrarë i tmerronte drita e gjakut, që vetëtinte nëpër fjalë e poezi. I frikësoheshin vdekjes shkaku i burrërisë. Problemet ekzistenciale nuk pajtohen se janë për lexim. Unë që i lexoja ata dhe shfaqjen e të keqes, që e paralajmëroja përmes fjalëve dhe poezive, përpiqesha të lëkund njeriun para hatasë, që rrokullisej vazhdimisht në oborrin tonë e për të cilin bariu serb ngul këmbë se është i tij. Dhe gazetarët e huaj vazhdojnë të merren me profetizmin tim kur para tyre numëroja fakte morbide, që arsyetonin frikën jo vetëm në fjalë e poezi të mia...

### 4.

Nuk pranoj se Kosova është çështje e përfunduar. Kthimi ynë mbyll këtë plagë të gjallë. Ky do të jetë rast triumfal, i përmallshëm, i përlotur, se në Kosovë janë shtuar varret dhe kanë luajtur gurët e vendit. Mirëpo ne që u mësua shpesh të fillojmë nga fillimi, ky do të

ishite nderim edhe ndaj atyre që mbetën e ranë atje. Shumëçka na pikëllon, por nuk ka rrugë tjetër; çatia jona është aty. Ajo na ruan identitetin dhe dëshmon se kush jemi. Unë më së pakti flas nga rrafshi i patriotizmit, por nuk çoj dorë nga ajo që më takon.

Dhe derisa zihesha me vetveten arriti miku im i djersitur nga Brukseli. Tha: pas 22 vjetësh kthehem në Kosovë. Poshtë e lart do t'i bie me një biçikletë, të bukurës. Dua t'ia numëroj plagë e varre dhe të çmalle me të. Nuk prish punë se Kosova është djegur-rrënuar-fyer-përgjakur; se atje nuk më ka mbetur njeri imi, por jetën dua të mbyll nën hije të një lisi apo oxhaku, tamam si heronjtë në këngët tona të moçme. Nga hiri ynë le të çelë lulja e amshueshmërisë... Pasi i thotë edhe shumë fjalë qortuese njeriu, që e shihte veten në një biçikletë, tek shëtiste Kosovës, largohet vrap. Unë lëviz vendit dhe më shfaqet fytyra e vendit tim. Zgjas shuplakën pastaj, nga tavolina e huaj fshij pikën e lotit, nuk dua të bëhet lumë ajo. Kosova është dinjiteti shqiptar.

5.

Në marshimin e vet mortor, Hitleri kishte thënë: *Gjermania do bëhet ose nuk do të ekzistojë!* Pesëdhjetë vjet më vonë këtë fjali ogurzezë do e thotë një bari i keq ballkanas: *Serbia do bëhet ose nuk do të ekzistojë...*

Kthimi ynë në Kosovë lë pas këtë morbiditet. Ne jemi popull i së ardhmes...

*(Qershor, 1999)*



## BALADË PËR PAQËSORËT

Ra Çeçenia e u hoqën maskat e paqësorëve. Pushuan marshimet. Puna ecën si sahati: Në Rusi soldateska nuk e ndal pushkën. Pas shqirrijeve të përditshme gërditëse kundër bombardimeve të caqeve serbe nga NATO-ja në Kosovë, u pa se më të mençur dolën ushtarakët se ca biçim krijuesish, të cilët mendonin se paranoja serbe mund të ndalet. Si e kur? Ndoshta kur të vriteshin deri në një shqiptarët e të shndërrohej Kosova në një varr masiv. Një qëndrim i tillë më shumë përkon me absurdin e marroçëve. Në cilën anë paskan qenë këta paqësorë? Nëse kërkonin ndaljen e bombardimeve ndaj caqeve serbe pse nuk e ngrisin zërin kundër soldateskës ruse?

Droj se paqësorëve më së pakti u intereson mbrojtja e vlerave njerëzore. Ndryshe nuk mund të kuptohet kundërshtimi ndaj bombardimeve në Kosovë e Serbi dhe aprovimi i heshtur në Çeçeni. Vështirë ndoshta unë e kuptoj filozofinë më të re të “paqësorëve”. E lexon ndonjë ulok atë ashtu si duhet e na shpjegon. Por t’i dëgjonte “paqësorët” Evropa, në ujëra të Atlanikut do lahej Rusia, ashtu siç këndonin dikur bejtexhinjtë e stepes. Për shurdhimin e papritur të këtij soji protestuesish, pak më parë i shkundi zoti Abdi Baleta. Dhe, kishte të drejtë. Nuk vëhen maskat kur mbrohen vlerat njerëzore. Kahmoti ne shqiptarët gjendemi në thjerzën e Bashkësisë Ndërkombëtare, e cila bën bilancin e vet. Ta kemi të qartë, çdo gabim yni e liron regjimin kriminal serb nga krimi dhe aleatët e tij i bën më të zëshëm kundër nesh. Prapë nuk i bihet në qafë popullit, as nuk nxirret në ankand Kosova. Ndonjë mercenar yni nëse shkakton probleme, duhet parë në emër të kujt e bën dhe pse ia shton plagët Vëndit? Ai që e don Kosovën, ka fjalor të zgjedhur, as nuk tregon trimëri para romëve e të tjerëve. Është e drejtë e secilit të jetojë ku të dojë, as nuk mund t’i kontestohet kujt e drejta e jetesës. Me ata që i kanë duart e përgjakura

dhe kanë bërë krime ka kush të merret. Nëse ne nuk e kontrollojmë veten, vonojmë çdo gjë, edhe pavarësinë. Këtë e kërkon regjimi kriminal serb. Të humbasim fitoren...

Lufta e dytë në Çeçeni me turp mbyllet. Sa di i vetmi rus që i mbrojti çeçenët ishte Tolstoj. Kujt nuk i kujtohet *Haxhi Murati*? Nuk do të thotë kjo se kohërat e mëvonshme do të jenë më barbare se më të hershmet. Nuk i dihet kurrë çmendurisë njerëzore.

## FATET

1.

Në brendinë e Kishës së Shën Albanit (Sankt Alban) kisha vërejtur një shënim, të cilin ma përktheu miku. Aty shkruante: “Të arrestuarit presin të kthehen në vendin e tyre”. Shënimi ishte bërë me rastin e luftërave të mëdha dhe derdhjeve të popujve. Ishte identik me kërkesat e njerëzve të mi gjithandej Kosovës. Shumica nuk dinë ku i kanë të vetët e rrëmbyer nga forcat serbe. Tej shënimit të lartpërmendur qëndronin dy trupore, të cilat i kishte mbuluar zymtësia kohore dhe vështirë fytyrat e tyre të dalloheshin. E përkulura, na kujtonte Nënë Tereze, ndërkaq truporja tjetër ngrihej më lart, ishte e ndonjë hyjnorë. Dikush nga ne kishte thënë: Nëna Tereze gjunjëzohej para Shën Albanit t’i falë amshueshmërinë. Kishte edhe supozime të tjera. Hyjnitë nuk dëshiroam t’i bezdisim më shumë. E kisha udhën e hapur...

2.

Në muajin gusht u gjeta majë Sharrit, pastaj kisha zbritur në fshatin Shipkovicë, që ka një traditë bukur të gjatë të emancipimit kombëtar. Me mall e kisha shikuar bustin e Rexhep Vokës, i cili i kishte ngulur sytë në dritaret e panumërta të shkollës. Urtaku që në kohën e vet kishte paralajmëruar se pa dije nuk arrihet asgjë: “Shkollat t’i hapim edhe në mos paçim mundësi të ndërtojmë ndërtesa të mëdha. Në koliba me kashtë fëmijët t’i mbajmë vetëm që të mësojnë”.

Pas ca dekadash ishte dëgjuar një kërkesë e tillë gjithëkombëtare në Kosovë. Për shkak të identitetit tonë dhe atdhedashurisë, zbritëm në bodrume me minj e lagështi të ruajmë gjuhën e emrin tonë nga barbaria serbe.

Fletushkës për fëmijë “*Dardania*”, që del në diasporë dhe e cila ka shumë lexues jo vetëm të vegjël. rreth ca pyetjeve të bëra, iu kisha përgjegjur.

1. Identitetin kombëtar e përcaktojnë gjuha dhe atdheu. Një popull që i humb këto, fillon të humbasë dhe veten. Mu për këtë në diasporë duhet të mbahen gjallë këto dy vlera të shenjta. Në të kundërtën, do të jetë vonë gjithçka.

2. Ku ekziston shkolla, nuk ka robëri. Ai që kundërshton robërinë, e çmon shkollën dhe di për çka jeton dhe

3. Në kurbet *libri* duhet ta zëvendësojë *atdheun*. Ai që nuk e do librin, nuk di ta çmojë as atdheun (10.10.1998, Frankfurt).

Shumë nga tanët bredhin Evropës e dy libra nuk i kanë në raftet e tyre. Nuk është shenjë e mirë kjo. Loja me shkrepësa apo me ndonjë pisllek tjetër nuk shpie në Kosovë.

3.

Dieter Kuhn, prozator e kritik i njohur gjerman, na viziton shpesh. Pamja e tij ma kujton mikun e fëmijërisë e aktorin Faruk Begollin. Vazhdimisht rri në gaz. Në *Albumin* e Shtëpisë së Hajnrih Bëlit, ku lënë ndonjë shënim ata që kanë pasur fat të kalojnë ca kohë në këtë institucion kulturor, që në vitin 1994 në shkrimin tim kisha parandjerë të keqen: “Vendi im quhet Dardani (Kosovë), ku njerëzit momentalisht nuk dinë kur janë kërsëndellat apo ndonjë festë kombëtare. Aty njerëzit luftohen si minjtë: me uri, sëmundje e kërbaç. Pra, bëhet një luftë nga më të çuditshmet të shek. XX...”

Shkrimtari i nderuar, pasi e kishte lexuar shënimin tim në tërësi në përkthim të S. Gashit, më ishte drejtuar: more ti e paske ditur për atë që do të ndodhë! Pse nuk na shurdhove më herët?. Edhe në librat e poezive tua e kam veneruar këtë shqetësim, por nuk kam besuar se njeriu mund të shkojë aq larg. Ti kërkon aty dhe ndërrimin e emrit të Kosovës në Dardani. Po ç’është Dardania? Me vëmendje kishte dëgjuar kallëzimin tim për toponimin e lashtë. Ashtu, kishte shtuar shkrimtari i nderuar. E kuptoj tani nervozën serbe. Ju ballkanasit jeni

të çuditshëm. Kam njohur edhe ca të tjerë. Por si bëhet sehir para një kataklizme njerëzore?!...

#### 4.

Sapo i kisha kryer së lexuari ca mbresa për forcat e UÇK-së në Pashtrik, m'u kishte kujtuar nëna me atë kallëzimin pak biblik për një fat më tepër familjar. Me babanë e me një fëmijë ngryk kishin kaluar Erenikun në vitin e dytë të Luftës së Dytë Botërore. Kishin marrë udhën për në majë të Pashtrikut. Këtë udhë babai e kishte shkelur shpesh, qoftë kur shkonte në Kukës, qoftë kur dilte në Shkodër. Gjumë kishin bërë në Has të Gurit, siç thoshte një nun imi, dhe të nesërmen ishin ngjitur në majë të Pashtrikut, aty te Teçja, nga shihej në të dy anët Shqipëria. Lufta nuk kishte pushuar e familjet nga të gjitha trevat ishin shtuar aty. Fëmijën që e kishin bartur ngryk, nga ta ishte ndarë një ditë. Nën hijen e një qarri e kishin mbuluar ca njerëz me dhe. Prindërit kishin qëndruar edhe për një kohë se lufta ishte në vllug. Një ditë babai kishte qitur allti: Zoti na mori të vetin dhe na solli tonin. Gëzimi ishte kthyer prapë në fytyrën e nënës: ky do t'i ketë të gjitha shenjat e të parit. Nuk bën familja jonë të ketë ndonjë ndryshim. Ishim kthyer në Gjakovë kur më ishte ndërruar dhëmbi i parë. Me vete bartja shenjat e atij, që e kishim lënë atje lart në majë të Pashtrikut, nën hijen e një qarri. E kisha thënë këtë detaj edhe në një poezi. Tërë jetën nuk jam vetëm, se ngapak i ngjaj Konstantinit të baladave. Një mik imi kërkon emrin, që ia kisha humbur diku në mes Pejës e Prishtinës, kur më kishte gëzuar babai i tij. Ndërkaq, më vete unë bart dhe atë, që nuk dua të vdesë përgjithmonë që në majën hijerëndë e kishin lënë prindërit nën kujdesin e perëndive. Nga aty kisha zbritur në qafë të babait. Ua ritregova këtë detaj të mos i qes në telashe autobiografët nesër...

## DIELLI I ZI

### KY NUK ISHTE FERKU

Këmbëklinc, me vrap pastaj, ujin e ftohtë e lashë pas, te Mulliri i vjetër. Kisha humbur në natë. Tek përplasesha kapa pëshpëritjet e hijeve. Le të gërditen nga vetvetja, kishte thënë njëra. Le ta shohin sa të gërditshëm janë, kishte mbyllur bisedën tjetra. Rrobat i kishin ndërruar dhe ishin shpërndarë. Në kthesën tjetër nuk ishte dëgjuar gjë e gjallë. Isha strukur fshehur në zemër të natës. Dikur ishte skuqur horizonti. Ky nuk ishte ferku. Në hundebuzë ishte përplasur vendi im. Edhe neveria e mjeshtrit...

*(Prizren, 1999)*

## DIELLI I ZI

Kurrë më shumë nuk ishin shitur syza kundër verbërimit se atë ditë dhe nuk ishte folur aq shumë për ditën e kijametit. Ku do të çahet toka më parë dhe ç' do të ndodhë në botën e këtejme. Kishin truar edhe shtete, që kishin tërë këto armë vdekjeprurëse. Sipas tyre, katastrofa mund të jetë shumë më e madhe. Sa afrohej dita, njerëzit humbnin durimin, kërkonin vendstrehim më të sigurt. Taxi që më shpuri deri të biblioteka, ishte në boshatisje e sipër qyteti. Shoferi preris më tha: pa diell nuk ka gjallesë.

Ende pa u dukur farë shenje, njerëzit kishin filluar të rrëqethen. Pyesnin vazhdimisht se ç'kishte ndodhur para njëqind vjetësh dhe a do të përsëritet ndonjë lëkundje e tokës dhe ku. Thonin se për ditën e kijametit kishin lexuar në libra. Nga duart e lëvizjet e pakontrolluara hetohej ndjenja e frikës. Kjo venerohej edhe nga thyerje të shpeshta të gjërave të çmuara. Rreth meje sa vinin e shtoheshin syza gjithfarë formash e pa kurrfarë shije. Kishte asosh në formë të patkoit të kalit. Pas xhamit të tyre të errët nuk dihej se kush fshihej.

Isha ulur në verandën e Belëve. Sytë i kisha bërë katër. Nuk pranoja syza, as mendja nuk më shkonte për to. Isha mësuar me terr. Në vendin tim nuk dinte kush se kur ishte zënë dhe kur do të hapet. Në librin shqip pak gjëra lexoje për këtë ogur. Sytë e mi rrëshqitnin pas shpinës së zhugaftë të hënës. Prisja fundin e diellit ose shfaqjen e Ujit të Madh. Isha pajtuar me të keqen. Udhë nëpër terrin e dendur të vendit tim kishte vite që bëja.

Nga veranda e Belëve dëshiroja të shihja mbylljen e fundit tim; të prekja atë ose të kacavaresha në harkun e zjarrtë, në formë të draprit, që shihej atje mbi buçimën e fortë të Ujit të Madh. Tjetër zgjidhje nuk kisha. Po drapri vazhdimisht tëhollohej, i ngjante vetullës së femrës, që me orë e rregullon para pasqyrës. Në lëkurën time njollat e para, qimet ishin tërrqethur, mërdhica më kishte mbështjellë.

Ngadalë rrëshqisja në një botë apokaliptike, ndoshta. Më vonë, më kishte zgjuar zëri i femrës, e cila ndante syza kundër verbimit. Me një gaz sarkastik ia kisha refuzuar. Sytë i kisha endur prapë nëpër xhamin e verandës, i cili errësohej. Ajo kishte tentuar përsëri. Kam dëshirë, zonjë, ta shoh fundin tim. M'i kishte lëshuar syzat në tavolinë, ku nuk e shihja më as filxhanin e kafes. Padiktueshëm, pushtonte kthinat e Belëve dielli i zi. Tërësisht gjendesha në terr. Kisha urdhëruar të mos ndizet as llamba. Me eklipsin tim kombëtar isha mësuar. Ky nuk mund të ishte më i rëndë se imi, që zgjat kushedi sa vjet. Në mes meje e diellit ka mbi njëqind vjet ndoshta, që përbindëshi frymon e nuk më lë të shoh se ç'ndodh tej Malit të Shenjtë; nuk di çfarë drite e zbardhë as çfarë ere e rrah faqen tjetër. Gruaja me syza ishte afruar për të satën herë. Kishte prekur sytë dhe ishte larguar fluturimthi, duke pëshpëritur se unë do të verbohesha i pari. Rreth meje shtoheshin fytyrat e fshehura pas xhamit të errët. Unë nuk luaja çerpikun as vendin nga veranda. Sytë më bëheshin se ndritnin dhe se ishin ngjitur për xhamin e errët. Nuk dija ç'ndodhte tej.

Isha shkëputur tevona nga ky realitet. Turrevrap isha lëshuar Bllacës. Kërkoja të mitë në grumbull. Bregut të lumit kisha parë njerëz. Ngjiteshin kepave tërë duke ulëruar; shndërroheshin pastaj në zogj të mëdhenj dhe fluturonin dikah. Kërcimet e tyre priteshin me britma. Unë kisha kapur kokën. Mezi merrja frymë në luginën e vdekjes. Një kokëqethur keq kishte kaluar pranë meje. Pëshpëriste duke numëruar diç me gishtërinj. Ia kisha lëshuar udhën. Kisha prekur çdo pjesë të trupit tim dhe kisha vazhduar kërkimin nëpër grumbull. Befas isha shtangur para një trupi të shtrirë. Se ç'bënte gjumë të rehatshëm në një batanije të lagët! Flinte si në lumë. E kisha shikuar përmallshëm, pastaj ca drithma të tij më kishin trandur. Dikur një shkumë e bardhë ia kishte mbuluar fytyrën e nxirë, që mezi e kisha parë nën dritën e hënës. Nga goja e shtangur iu kishte përhapur edhe në pjesën e poshtme të mjekrës. Ishte ky njeriu i dytë pas Lumit, që e shihja si jepte shpirt. Kisha zgjuar tjetrin aty afër dhe njerëzit me maska në fytyra e të veshur në hekur si në përralla të moçme, na kishin hedhur në kokërr të shpinës. E kishin kapur në katër cepa batanijen e qulltë me trupin pa jetë dhe ishin nisur në drejtim të



panjohur. Më mirë kështu të shkosh se të dhiesh ndërveti në bodrume, kishte shtuar një i revoltuar dhe kishte sharë: në këmbë dua të vdes, he nënën e nënës... Shpinën grumbullit ia kisha kthyer. Njeriu që ishte parë pak më parë me kokë ndër duar, kisha qenë unë, i cili kishte sytë plotë terr e një bukë bajate nën sjetull, largohej përskaj dhomave të errëta, ku i vendosnin ata, që kishin humbur mendjen dhe bënin çmos t'u kthenin kujtesën. Në kthesën tjetër kishin plasur britma grash, fëmijësh. Pehateshin mbi ta njerëzit e hekurt. Dhe prapë nga thepat e bregut të lumit ishin parë njerëzit si fluturonin drejt qiellit të përcjellë me gazin e një kokëqethuri keq. Nga duart e mia koka ime kishte vazhduar të rrëshqasë sa nuk kishte rënë.

Isha përplasur për xhamin e errët të verandës së Belëve. Duartrokijet më kishin zgjuar. Dielli shploehej, nxirrte krahun nga ana e tjetër e Malit dhe ngrica rreth meje avullohej. Ishte shfaqur vasha, që ia kisha refuzuar syzat. Tani ia shihja sytë, fytyrën, flokët. Më kishte shikuar rreptas. Ishte përrulur t'i mbledhë ato. Të njëjtën gjë kishte vepruar edhe grumbulli. As një palë syza nuk kisha përreth. Me sy të mi të gjallë shikoja si zgjohej dielli mbi ushtëmën e Ujit të Madh, që sa vinte e pashitej. Hapësira ishte mbushur pëshpërimë. Gojë pas goje kishin arritur ca fjalë edhe në veshin tim. Kisha qeshur me të madhe. Në xhamin e verandës kisha parë gjithfarë fytyrash gërditëse, të lexueshme. Ca ma kujtonin kërmillim e Soreskut. Nxitonin të hipnin shpinës sime atje nga e kisha hedhur edhe Përbindëshin. Kisha përplasur derën dhe kisha vrapuar me sy të mjegulluar.

Isha shtrirë pak më vonë nën kurorën e një druri të madh nga kishte zbritur dathur një fëmijë, m'i kishte pastruar sytë me një ibrik ujë. Engjulli yt jam, më kishte thënë. Dritë e fortë ishte derdhur përgjatë udhës sime. Më kishin çuar fjalë se edhe në vendin tim ishte parë dielli, i cili rrokullisej e njerëzit bënin gara se kush më parë ta zë atë. Oh, Zot! Dielli është i të gjithëve, kisha pëshpëritur para derës së shtëpisë, që nuk e çilte çelësi im. Edhe anën tjetër të Malit të Shenjtë e kisha parë si në shuplakë të dorës. Të tjerët nuk di. Përmorraveshin ende, siç duket...

*(Këlm, gusht, 1999)*

## KOPSHTI DO FRYMËMARRJE

Në fillim e kishin vendosur në vend të pashëm. Nuk di se kush ua kishte sharë. E kishin rrokullisur pastaj. Kërkonin një qyshk për të. Dikur e kishin ngulur në fund të oborrit. Pas një therre, që kishte bi befas. I zoti e kishte punuar kushedi sa kohë. Megjithatë, nuk kishte mundur ta bëjë të flasë. Me gjasë, i mungonte dhe shpirti. Bota ishte e madhe aq sa krijesa e tij. E gjymtë. Pa gjak. Pa identitet. E vdekur. E kishin rrokullisur kujt iu kishte tekur. Kështu veprohet me gjëra të vdekshme, preras kishte thënë njëri nga nikoqirët. Isha skuqur. Më vinte inat. Me një çollak kisha lejuar të më shesin mend kalaveshët e Alesë. Në fund të kopshtit e shihja tani. Vend më të mirë nuk mund t' i gjenin. Pranë një therre, e cila kishte lëshuar shtat ditën kur atë e kishin ngulur aty në të dalë. Pritej momenti kur t'i shkulin bashkë mbasi vetëm hija u kishte mbetur. Kopshti ka nevojë për frymëmarrje.

*(Duren, 1999)*

## Ç'DO TË BËJMË PA KALDERONIN?

*Në Albumin e Shtëpisë së Hajnrih Bëlit, në vend të fjalëve ngjiti një nga një të gjitha biletat dhe fakturat e shpenzimeve. Në fund edhe fotografinë e vet më të mirë. Të dihet se këtu nuk kishte qenë çfarëdo burri. Mbylli derën. Më vonë dëgjova se Almelio Kalderoni kishte ikur. Ç'do të bëjmë pa të?...*

Fidel Kastro është i mirë? Jo, jo, Kastro është i mirë. Fideli është monstrum. Jo, jo, Kastro është i mirë. Fideli është, është, është bastardh...

Nuk hamë më as makarona me suxhuk nga na shikon trimi ynë. Se, kur i ra fama konjakut, pabesisht Skënderbeun e mbërthyen në pako të suxhukut të terur në tym të huaj. Për mend kurrë nuk ka vuajtur shqiptaria...

Pak pa zbardhur iku edhe Rokeri. Do ta mësoj vetminë të flasë, të na shurdhojë bile... Ja, i radhitën karrigat aty. Unë do të zë vend i mbrami.

Mbi Drinin e Bardhë mjegulla shtrihet. Majë Urës së Shenjtë veten nuk e shoh..

*(Këln, 1999)*

## NËN HIJEN E SHËN ALBANIT

### Njeriu i rrënojave

Për herë të dytë opinioni botëror kishte mbetur pa tekst. Kthimi i shqiptarëve në vatrën e rrënuara u bë në mënyrë të rrufeshme nga vetë shqiptarët. Dësh e dathur vraponin edhe nëpër fushat e minave. Kërkonin strehim nën hijen e oxhaqeve, që dëshmonin për katastrofën që kishte ndodhur. Përkundër barbarisë, oxhaqet nuk ishin mposhtur. Mbi kokat e hutuara të njerëzve, të bëhej se ato mbanin qiellin.

Opinionin botëror edhe njëherë ishte bindur se shqiptarët nuk shkoqen nga vendi i tyre. Ç'forcë i tërhiqte ata, që nuk i frikësoheshin as vdekjes?! Kisha kaluar kufirin. Nuk isha ndër të parët. Dy të malit më kishin përcjellë deri aty në Ulpianë. Në të ndarë, kishin thënë: poet, kërkoje shtëpinë tënde! Ndonjë dritë aty këtu dhe zërat që shtoheshin. Pas ca hapash kisha vrapuar nëpër natë. Isha ngjitur shkallëve me çelësin në dorë. Dera nuk ishte hapur. Prapë kisha provuar, dhe prapë...

Herën tjetër shkela në Kosovë me dritë. Dy të malit më kishin përcjellë dhe dënesat e gruas tërë rrugës. Në takimin e parë kisha vërejtur ndërrimin e madh të njeriut. Ai nuk ishte më i përbuzur. Ishte liruar nga dhuna dhe, kisha menduar, si do të frenojë veten njeriu i rrënojave?.

### Për urtakët bota është atdhe

Hija e Shën Albanit nga Iliria më kishte shoqëruar nëpër dherat gjermane. Emrin e tij sapo e shqiptoja, më kishin shikuar: po ku na doli tani ky Shën Albani? Unë vazhdoja të besoja se ky me siguri ka

ndonjë shenjë në këto anë. Kisha Gjermane e kishte shpallur për të shenjtë të vet. Ndërkaq, nëpër libra e enciklopedi thonin se ekzistonin të dhëna për të. Megjithatë, vështirë t'i bija në gjurmë. Më kishin thënë se në Majnc ekziston kisha me emrin e tij. U kisha folur për këtë miqve. Prapë më kishin shikuar në dyshim: nuk është e mundur të ketë kaluar këndeje ndonjëfarë Shën Albani. Bisedat mbi përhapjen e krishtërimin në dherat gjermane filluan të bëhen me sinkopa. Tatëpjetë Rajnës, jo larg Katedrales së njohur të Këlnit, ishim shtangur para një binaje, që i ekzistonin vetëm muret e kulmi i derdhur. Ende asgjë nuk ishte renovuar.

Al Paçino ka vite që jeton në këtë qytet përrallor. Si duket, na kishte ngritur befasinë: para nesh qëndronte binaja e zbrastë, për të cilën nuk kishte pushuar tërë rrugës: ilirët janë të njohur në histori si përhapës të krishtërimin. Për këtë nuk ka popull që mund të krahasohet me ta. Shën Albani nuk ishte i vetmi, i cili që në shekullin e katërt para kohës sonë, kishte shkelur në këto anë dhe në mënyrë të panjohur kishte vdekur. Pas bisedës së gjatë, kishte ngritur dorën në drejtim të murit të lartë. Aty shkruante: Kisha e Shën Albanit. Gaz e hidhërim ishin përzierë. Më në fund, gjeta një shenjë të njeriut tim të hershëm nga mund të vazhdoja udhëtimin e mëtejshëm. Edhe tani bëj udhën nën hijen e të shenjtit. Për urtakët bota është atdhe.

## MBI IDENTITETIN

1.

Se ç'do të thotë të kesh shtet, e pashë në bibliotekën "Humanisti" në Selestat të Alzasit (Francë), ku kishte dokumente nga shek. VII, të ruajtura e të sistemuara, të kohës kur zbritën fqinjët tanë nga Karpatet. Ç'është më interesant, pashë aty dhe certifikata të kurorëzimit, të lindjes e të vdekjes të vendësve nga shek. XV. Mësim ky si ruhet identiteti edhe pse në këtë hapësirë kishin ndodhur luftëra të mëdha në mes gjermanëve dhe francezëve. Me habi e kisha shikuar kustosin. Pasi kishte kuptuar shqetësimin tim, kishte luajtur vetëm kokën. Edhe pse gjendesha në një tempull zoti, kisha sharë. Ç'kisha hequr të zitë e ullirit me certifikatat e mia, të fëmijëve e familjes. Me plotë gabime e defekte m'i kishin lëshuar. E kisha të qartë pse ndodhte një gjë e tillë. Regjimi serb bënte luftë speciale ndaj çdo shqiptari edhe përmes një dokumenti të rëndomtë. Asnjë dokument të mos jetë në rregull dhe plaçkitja të ndodhë në mënyrën serbe. Turr e vrap pas identitetit që ndrydhej, përdhunosej e nxirrej margjinave ose pas grilave.

Vandalizëm i paparë ndodhi edhe në vendin e shqipeve në vitin 1997. Rrënimi i arkivave, i muzeve, i institucioneve kulturore me rëndësi kombëtare, bën të dyshosh se aty patën dorë edhe fqinjët tanë. Si u bë të rrënohet çdo gjë, që ka të bëjë me identitetin e një populli. Dhe, prapë nga fillimi, më të varfër e më të nënçmuar. Duke parë këtë asgjësim të vetvetes, nuk mund të mos pajtohesh se ngjashëm ndodhi rrënimi i Ilirisë; se atë vetë ilirët e zhdukën, të mbështetur ndoshta dhe nga faktorët e jashtëm. Pra, ç'zezë na ndjek? Bëhet çmos të na fshijnë edhe për së gjalli! Faji është yni... Një vandalizëm i tillë, kam përshtypjen se nuk ndodh as në Afrikë. Por ja, ndodhka në vendin e shqipeve, ku nuk ka shtet as pushtet, siç thotë një mik imi poet.

Vërtet, ç'ndodh me ne?

Bulshitë plotë i kemi atdhedashuri e nuk dimë të ngrisim as të mbrojmë një arkiv, një bibliotekë, një institucion me rëndësi kombëtare. Na humbasin dokumente e dëshmi elementare të identitetit tonë, se sillemi me vendin si me brek femre. Na i deformatojnë emrat, datëlindjet; na falsifikojnë shumë gjëra, ashtu si u teket. Nëse lejojmë prapë të na shkelin aty ku është më e dhembshme, pse atëherë mashtrojmë veten me gjithfarë përrallash?

Nuk është e thënë të kemi vetëm shtet, por atë ta mbajmë e ta forcojmë si i ka hije një populli të qytetëruar. Është turp të na përsëritet në hyrje të mileniumit të tretë balada e *Urës së Shenjtë*: prish e ndërto, ndërto e prish deri në asgjësim...

## 2.

Shënimi më karakteristik në *Albumin* e Shtëpisë së Hajnrih Bëlit ishte i Agim Çavdërbashës. Mbante datën 26 (e shtunë) mars 1995, shkruar në orën 15.00. Me gjasë, një ditë para se të largohej nga Langenbroich. Nuk ishte tekst lavdërues. Përmes emrave që i kishte shënuar aty, kishte lënë një mesazh. Për mua ishte i qartë. Tjetërkush mund ta konsiderojë ndryshe. Në tërë faqen ishin renditur emra, që tregonin për formimin, karakterin e synimet e krijuesit. Shënimi fillon me Drilon, Rrita e përfundon me Butrint (Sh.).

Emrat ishin burimor dhe vërehej se krijuesi mbështeste identitetin. Tentimi i tij thoshte shumë për të si krijues e njeri. Hedh dritë, po ashtu, mbi veprën e tij e sidomos mbi skulpturat e punuara nga guri-mermeri, që kanë një bukuri e abstraksion të veçantë. Dhembjen njerëzore e kisha hetuar edhe në një vizatim të pagëzuar "*Gratë e Lybeniqit*". Në luftën e fundit, nga barbaria serbe Lybeniqi u bë shkumb. Ra aty gati e tërë familja e mikut tim të ndjerë Gani Bobit.

Mirëpo mesazhin që e kishte lënë skulptori, duhet forcuar e pasuruar dhe duhet mbrojtur me dinjitet nga shpërbërjet e mëdha brenda e jashtë nesh, që ndodh nganjëherë edhe nga pakujdesia jonë.

Shenjën kombëtare nuk bën ta konsiderojmë si cohë të hedhur para këmbëve të djajve...

## PËRMENDORET

### Tyrli K.

Në midis të Shkupit u ngrit përmendorja e Nënës Tereze, e para në trojet shqiptare. Asgjë nuk u shënua në guri për origjinën e saj, bile të mos ia kishin shkruar emrin me çirlicë. Kaq di të respektojë një popull, që krijon historinë në dëm të të tjerëve. Befasi tjetër, përmendorja është vepër e një skulptori shqiptar të besimit ortodoks nga Reka e Gostivarit. Kjo malësi shqiptare dha shumë njerëz të kulturës e të politikës. Fatkeqësisht, gëlltitësit sllavë edhe këta i konsiderojnë të gjakut të tyre (!). Ç'u bëmë lodër për tyrlin k... Mirë që nuk na hedhin në ndonjë planet të panjohur.

### Fjalët dhe struci

Sheshi kryesor në Strasburg mban emrin e Marko Boçari(si)t. Nën bustin e tij shkruan se ishte luftëtar i madh i çështjes greke. Nga historia jo vetëm shqiptare dimë se ky ishte arvanit dhe shumë pak e dinte greqishten. Tregojnë se kishte luftuar për çështje epirote, të bëhet Epiri shqiptar, por dhëlpëria greke luftën e tij e kishte shpallur për të veten. Ata që e kishin vënë në atë shesh me atë shkrim nuk më çuditë. Të gjoret aq dinin për historinë shqiptare. Nipërit e tyre ndryshe e shikojnë të vërtetën. Derisa i shpalosëm fjalët shqipe para tyre, Evropa i ngjante një struci...

### Vaji i burrit

Pas kthimit të shqiptarëve në rrënoja kishte shkelur njëri pak më vonë. Në cilën derë kishte trokitur, të njëjtat fjalë i kishte thënë:



gëzohem që ju shoh gjallë, gëzohem që ju shoh gjallë... gëzohem. Dhe ishte ulur dikur pranë një pragu e kishte qarë...

Kallëzojnë refren më madhështor nuk ishte dëgjuar moti në Kosovë.

### Mishi i egër

Pa marrë parasysh se cilës parti i kanë takuar, të rënë për çështje kombëtare nuk bën t'i ndajmë edhe për së vdekuri. Po qe se veprojmë kështu, ne luajmë me fatin tonë, shndërrohemi në mish të egër që do të na pengojë vazhdimisht rreth çështjes sonë të pazgjidhur ende. Brehti do të thoshte: punuekemi për çështje të huaj.

*(Mynib, 1999)*

## MARATONI

### ETNIA PIKËMBËSHTETJE

*Universi: Ju në Prishtinë, kurse unë në Tiranë, kurrsesi nuk mund të zhvillojmë bisedën pa kaluar nëpërmjet nyjes këshqjellare Rambouillet. Çfarë jeni duke përjetuar me vizionin në mendje të fatthënësës sonë Rambouillet? A e hedhim vetë ZARI-n apo e hedhin të tjerët për ne?*

A.P.: Ne e hodhëm zarin. Por kam frikë se të tjerët do e bëjnë pazarin. Vështirë u besohet atyre që na kanë copëtuar vazhdimisht. Konkretisht, Konferenca e Rambouillet i takon së kaluarës. Po e peshojmë atë se ç'u bë aty, bindemi prapë se ne jemi popull apolitik. Në politikë, më së pakti, triumfon sinqeriteti. Në Paris u përballëm me "miqtë" e dikurshëm. Po ashtu, miqësia jonë pesëdhjetëvjeçare me rusë, kinezë paska qenë në dëm të çështjes kombëtare. Ndërkaq, befasues mbetet qëndrimi i Italisë. Për animin grek ndaj politikës së Beogradit nuk bën të flitet. Është i mjerë.

*UNIVERSI: 1913/1999! Ç'janë këto dy skaje kabore tepër tronditëse për shqiptarët, që, mua më shëmbëlajnë, njëherë me tryezën e kirurgut dhe, tjetrën herë, me tryezën e bilaridos? Rambouillet - Paris (1999) do të mund të jetë një simbol antonimik apo sinonimik me Londrën (1913)?*

A.P.: Do të ishte tragjike po qe se edhe më tutje copëzohemi. Është e tmerrshme atdheu të fillojë e mbarojë diku nën çatinë e fisit. Për shumë arsye, nuk bën të përsëritet Londra. Fuqinë e një populli e kulture e dëshmon etnia. E, kjo nuk bën ta frikësojë askë.

UNIVERSI: *Shqiptarët, të ndarë prej të tjerëve në pesë shtete, megjithatë kanë një gjubë letrare, një letërsi. Çfarë dëshmoi lëvrimi i letërsisë shqipe, këto pesëdhjetë vjet, në dy anët e saj kerabazë: brenda shtetit amë dhe jashtë tij, në gjysmën tjetër të trojeve etnike?*

A.P.: Megjithëse, të copëtuar trupërisht, shpirtërisht gjallërojmë. Nuk mund na mposhtën. Këtu qëndron ajo forca, ndoshta, dhe finiksi ynë për të ekzistuar për inat të rrënuesve të dukshëm e të padukshëm.

UNIVERSI: *Letërsisë shqipe i mungon diçka që të jetë plotësisht e integruar në një?*

A.P.: Kufijtë, që për mua mbeten zbulimi më tragjik i mendjes njerëzore, kufizimi i lirisë. Egoizmi makabër njerëzor.

UNIVERSI: *A paraqitet letërsia shqipe një në botimet e huaja? A e njohin të huajt letërsinë shqipe Një?*

A.P.: Njeriu normal Letërsinë shqipe e sheh Një. Mediokrit e shohin të copëtuar. Nuk mund e shohin veten në mes të të mëdhenjve. Fatkeqësisht, kjo paraqitet shpesh e copëzuar, ashtu si trupi ynë. Letërsia e një populli nuk bën t'i pranojë kufijtë e të marrëve. Letërsia ka shtrirjen e gjuhës mu për këtë duhet ta ruajë sovranitetin e vet. Në Shqipëri, për drejt, ca, Letërsi shqipe marrin vetëm atë që krijohet brenda kufijve politikë (!). Ky është njëri nga turpet e xhuxhmaxhuxhëve.

UNIVERSI: *Si e vlerësoni poezinë shqipe bashkëkohore? Cilën quani arritje kryesore të saj?*

A.P.: Poezia bashkëkohore shqipe i takon kahmoti poezisë botërore. Ajo vazhdon të gjejë lexues edhe aty, ku mendimi ynë politik nuk mundi të arrijë. Meritë e saj, para së gjithash, është gjeniu ynë krijues. Pranoi edhe rregullat e qytetërimit modern. Mu për këtë ajo

zgjton interesimin e metropoleve, por dhe ruan nishanin e vet, magjinë, origjinën.

UNIVERSI: *A ka vizione, koncepte, prirje të tejkaluara, pra, jashtë kohe në truallin e poezisë shqipe? Konkretisht, çfarë është e vjetëruar në të?*

A.P.: Çdo gjë në jetë synon cakun. Edhe poezia jonë ka vizionin e vet. Mos tjetër, ajo bën çmos të jetë një artikulum e pasqyrë e plotë e udhëtimit tonë, duke hedhur anash ato gjëra, që e bën atë demode dhe provinciale.

UNIVERSI: *Çfarë do të dëshironit prej poezisë shqipe?*

A.P.: Të mbështetet fort në dheun e vet, të avancojë atë maksimumin: pak e saktë. Është kohë e kursimit të fjalëve. Edhe një varg mund të thotë shumë, një histori të tërë.

UNIVERSI: *Çdo poet, me sa kam vërejtur, e ka në vizionin e tij një antologji vetjake të poezisë amtare prej së cilës është formuar e ndikuar më shumë. Nëse edhe ju keni një antologji vetjake të tillë, më të pëlqyer të poezisë shqipe, do të mund të na thoni autorët kryesorë të saj, pse jo, edhe disa poezi të veçanta?*

A.P.: Antologjinë time vetjake e kërkoj në mes Lasgushit, Serembes, Mjedjes, Camajt dhe Shkrelit... Kam edhe poezi, ku mund ta mbështetja këtë.

UNIVERSI: *Poezia juaj, bashkë me atë të shumë autorëve të tjerë shqiptarë të këtij gjysmëshekulli, jo vetëm në fillimet, por edhe më vonë, mendoj se ka diçka migjeniane, d.m.th. estetikisht rebeluese, emancipuese, e çliruar dhe risuese etj. Për ju, është i pranueshëm ky mendim?*

A.P.: Me Migjenin jemi rritur ne të revoltuarit, por nuk do të thotë se të këndosh për mjerimin social apo të mos pajtohesh me një rend, puqesh me një poet. Për Migjenin kam konsideratë. Por gjërat tani kanë ndryshuar. Pra, edhe artikulli i revoltës.

UNIVERSI: *Letërsia, thotë Sartri, është një veprim krijues, përfshues i historisë, sikur të kishte parasysh, pikërisht, një poezi si juaja, që nuk ngjezet dot pa tharmin e historisë. Ç'është për ju historia si lëndë poetike, në të cilën, pa dyshim, përfshihet edhe bashkëkohësia?*

A.P.: E ardhmja nuk mund të ndërtohet pa të kaluarën. Unë nuk mund të them se nuk kam pasur një copë histori, apo se nuk kam

jetuar në kohën e Jasharëve, bie fjala. Ata që mendojnë ndryshe, frikësohen nga e vërteta. Heshtaz pranojnë të keqen. Ndoshta edhe robërinë. Kujtoni pakëz Borhesin, ç'bën ai për të bërë simbiozën e kohërave. Asgjë nuk është e kaluar. Edhe historia është e pranishme. Nga ajo nuk mund të lirohemi as në sotmëri.

UNIVERSI: *Poezia juaj është e mbushur me shenjat domethënëse, me simbolet e historisë së shqiptarëve, sikurse janë ngjarjet, datat, toponimet historike, emrat e personaliteteve të mëdha etj. Çfarë keni synuar me këtë pyll gjelbërues të simboleve historike? Si funksionalizohen këta drurë të rrallë të historisë?*

A.P.: E vërtetë. Poezia ime është një pyll simbolesh, siç ka thënë një kritik, por aty shumë lehtë mund të hyhet; mjafton të ndalesh dhe të shfletosh historinë e popullit. Unë nuk jam nacionalist, e më së pakti, patriot i sertë, por më tmerron çdo nëpërkëmbje e gjërave të mia. Atëherë përpiqem të krijoj të pamundshmen. Kështu, shpesh simbolet e mia janë mjaft të lidhura edhe me fatet më të skajshme të kulturës së popullit tim. Unë sa jam kosovar, aq jam edhe çam. Bile, kohëve të fundit kam filluar të jem më çam se Xhaferrët, Suliotët. Mu për këtë dhe çdo skaj i etnisë është pikëmbështetja e ekzistencës sime si krijues e njeri. Në të vërtetë, unë nuk di të urrej. E çmoj të urtën e të bukurën edhe te të tjerët. Besa, përpiqem të mësoj edhe nga armiqtë...

UNIVERSI: *Dhe, megjithatë, poezia është tërësisht bashkëkohore me mendimin, atmosferën, gjendjen, situatën. Si përftohet bashkohësia nëpërmjet historisë?*

A.P.: Nuk do të thotë se të shkruash për të kaluarën nuk mund të jesh poet bashkëkohor. Mjeshtëria qëndron te qasja, ndjenja e masës, kopracia, gjeturia, mesazhi që u ofron njerëzve - pastaj magjia krijuese, kostumi, pudrosjet, sharmi...

UNIVERSI: *Poezia ju ka buruar në viset shqiptare më të ndryshme, deri në më të skajshmet. Madje, vetëm kështu, i kemi njësnuar dhe fituar trojet etnike, kurse edhe poetë të tjerë shqiptarë. Ç'është gjeografia për poetin? Ç'është gjeografia etnike për poetin shqiptar?*

A.P.: Mbasi të marrët ma derdhën etninë nuk më mbet tjetër veç të krijoj gjeografinë time poetike. Unë duhet të bredh diku, unë

duhet t'i kërkoj diku varret, rrënjët e mia. E, posaçërisht në momentin e tanishëm për poetin shqiptar është më se e domosdoshme ta forcojë këtë. Të mos harrohen gjërat edhe për së gjalli...

UNIVERSI: *Vargu juaj aforistik: **Kosova është gjaku im që nuk falet**, që e keni shkruar në rininë tuaj, 40 vjet më parë, duket se përmbledh në një gjeografinë dhe historinë. Mos vallë poezia kombëtare është figurë metafizike e vetëdijshme dhe e pavetëdijshme, e kryqëzimit të kohës dhe të hapësirës së etnitetit të poetit?*

A.P: Shumë gjëra linden rastësisht. Kamy thoshte se ato linden edhe në ndonjë kthesë rruge apo kafeteri. Vargun, që e cekni Ju, kamynçe ka lindur dhe, kurrë nuk më ka shkuar ndërmend se ai do të gjendet në ballë të qindra demonstratave shqiptare në tërë Globin. Këtë merreni si ta doni, çami im i dashur... Edhe letërsia është luftë: për të mbrojtur ose pushtuar të humburën. Ndoshta, më e tmerrshme është se ajo, që zhvillohet në fushën e mejdanit...

UNIVERSI: *Po poeti, cili është? Po poeti, ku është? Cila është përkatësia e tij?*

A.P: Nëse kush e ndien veten poet, duhet të jetë aty ku është njeriu, populli, i cili rastësisht është edhe një degë e njerëzimit.

UNIVERSI: *Libri juaj i fundit **Ishulli Albania** (1998) sikur e shenjon dëshirën për t'u shkruar shqiptarët jo vetëm me kontinentin por edhe me vetveten, jo vetëm gjeografikisht, por edhe historikisht. Ç'keni dashur t'i nxisni lexuesit me vizionin e rreptë, stigmatizues dhe dashurues, **Ishulli Albania**?*

A.P.: I tmerruar nga vandalizmi ndaj kujtesës së kombit dhe përçarjeve brendashqiptare, që dëmtuan shumë dhe çështjen shqiptare në Kosovë, shkrova librin **Ishulli Albania**. Nuk doja kë të fyej, por të lutem, që Shqipëria të mos jetë e zeza ime... Pra, as e miqve të mi...

*(Shkurt 1999, intervistoi Bashkëm Kuçuku)*

## NUK BËN TË PËRZIHIMI NË ZANATIN E PRIMITIVËVE

Podrimja: Ne e poetët jemi soj pakëz i çuditshëm, përçues e transmetues të mëdhenj të fateve njerëzore. Nga fjala duam të krijojmë mrekulli, të pamundshmen. Kur e them këtë, kam parasysh krijuesit e mirëfilltë, që shkruajnë poezinë e pastër, e që nuk janë të paktë në letrat shqipe.

Teuta: *Librat Tkurrja e Atdheut, Burgu i hapur dhe Harakiri*, paraqesin dëshmi të ditës, si përjetime të thella të gjithë kësaj të keqeje që ka rënë si hije zezë mbi tokat shqiptare, janë të imponuar, apo jo?

Podrimja: Kohë më të liga nuk mban mend rodi ynë. Është kohë kur vazhdimisht duhet gërvishur ndërgegjen se ç'bëj për fatin e një kolektivi njerëzor?

Teuta: *Në këta libra kryekëput është temë çështja shqiptare dhe dëshira që ajo, njëherë e përgjithmonë, të zgjidhet në mënyrë fatlume.*

Podrimja: E vetmja rrugë që na shpie të zgjidhja e çështjes sonë kombëtare mbeten proceset e reja shoqërore, demokratizimi ynë, jo në bazë farefisnore apo të bajraqeve, por si kulturë e komb i organizuar. Aty e shoh edhe mposhtjen e dhunës.

Teuta: *Në këto botime shumë shpesh haset çarshia, si nocion. Ç'përkufizim mund t'i bëhet çarshisë, kur mendohet letërsia?*

Podrimja: Në çarshinë tonë letrare bëhen të zhurmshme fjalë-bubullimat, të papeshat, retorika e sforcime të ndryshme odash, bejtet, çrregullimi i kriterëve, shija e bastarduar deri te irracionalja. Nga një dukuri anakronike e nga një çmenduri poeti distancohet.

Teuta: *Gjithë kjo e keqe që po ndodh ka rrënjët shumë më herët, ka një platformë shekullore të veshur me urrejtje sllave ndaj rodit tonë, siç thua ti.*

Podrimja: Ne jemi yrnek populli që nuk mëson gjë asnjëherë nga historia! Por disa gjëra nuk bën t'i harrojmë. Ato duhet të përsëriten më shpesh se poezitë e bardit tonë Naim Frashëri. Në fillim

të shekullit që po e lëmë, Ministri i Punëve të Jashtme të Rusisë Cariste kishte deklaruar: “Në shekullin XXI shqiptarët do t’i hedhim në det”... Kur ai e thoshte këtë, një burrë tjetër, presidenti i SHBA-së, zoti Uilson, Shqipërinë e kishte mbrojtur të mos bëhej më xhuxhe, pra, ishte kundër shpërbërjes së Shqipërisë.

*Teuta: Citati i mësipërm i referohet politikës globale sllave ndaj shqiptarëve, politikë urrejtëse.*

Podrimja: Politika është art që mashtron. Nuk them se e kuptoj lojën e saj, as nuk më shkon mendja të argëtohem me të. Vokacioni im është diçka tjetër, pra nuk më lejon. Brenda mundësive të mia, dëshiroj t’i ndihmoj secilit njeri. Nuk mund ta ushtroj dhunën ndaj tjetrit. Ndoshta është ky gabim, por ç’të bëj. Nuk është mirë të përzihesh në zanatin e primitivëve.

*Teuta: Në këtë kohë po ndodhin kundërtënie të çuditshme jo vetëm në raporte mes popujve të ndryshëm, këtu në Ballkan, por edhe mes njerëzve të një rodi, mes shqiptarëve.*

Podrimja: Fatkeqësisht, koha jonë pak gjë dallon nga e Vaso Pashë Shkodranit para një shekulli e tëhu, kur e shkroi poezinë e famshme të vajit burrëror e të mesazhit të fortë “Mori e mjera Shqipni”, aktuale dhe sot, kur bajraktarët më shumë çmojnë një karrige se atdheun e bërë skllotë. Përrjetojmë, pra, të pabesueshmen: askush askënd nuk e pranon as e merr si vlerë e as si gjak të vetin, nënçmohemi e shahemi tamam thuajse jemi në mëhallë të madhe. Bile, zihet në thue edhe në të vdekur, që nuk e preferon kodi ynë etik. Një shturje marramendëse bëhet shqetësuese edhe për të nesërmen...

*Teuta: A mos ky mendim, si refleks, vjen nga iluzionisti, meqë poetët shpesh mbajnë afërsi me iluzionet’?*

Podrimja: Nuk jam iluzionist. Njerëzit i pranoj ashtu siç janë, mbasi vështirë mund t’u ndërrosh sistemin e logjikës. Prekëse është se kjo dukuri c primitivizmit bëhet më rentabël me produkte të reja nga të gjitha mihjet; se intriga po bëhet profesion i teneqexhinjve... Nga etika dihet, lindet e vdiset me një fytyrë. Si duket, disave u duket pak një pëllëmbë, kërkojnë më shumë hektarë të jetë ajo...



*Teuta: Por, njerëzit janë të ndryshëm. U tha më lart se nuk mund t'u ndërrohet sistemi i logjikës. Kjo është e vërtetë. Megjithatë, te ta mund të betohen qasjet, ato që lidhen me trimërinë apo me qyqarllëkun.*

Podrimja: Ekziston një vijë e cila ndan trimërinë nga qyqarllëku. Vija shfaqet rrallë, kur vihen ose rrënohen mezhdat dhe kur duhet dëshmuar guximi. Ata që i afrohen asaj, e shohin veten jashtë vetvetes, ose u ngajnë atyre që kthehen nga Nazareti... Por unë e kam një të keqe se vështirë u besoj “patriotëve” që marrin dynjallëkun nëpër gojë.

*Teuta: Kjo gjendje kaotike në Kosovë, e ushtruar me dhunë të përhershme serbe, bëhet për shkak të kërkesës shkakullore të shqiptarëve që të kenë lirinë, pavarësinë, sovranitetin...*

*Ç'është kjo frikë aq e madhe serbe ndaj kërkesës së shqiptarëve? Çfarë mund të thotë poeti për këtë?*

Podrimja: Pavarësia e Kosovës nuk e frikon njeriun e urtë, i tmerron “disenjatorët e krimi”, ata që nuk mund të heqin dorë nga hegjemonizmi dhe nga nacionalizmi i verbër: të rrënojë çdo gjë që nuk është e gjakut tim. Pavarësia mund të frikësojë edhe ndonjë profiter shqiptar, që në kaosin kombëtar e rajonal sheh ngritjen e vet. Pranimi i sovranitetit dhe i ekzistencës mes ballkanasve është fitore për të gjithë, se pavarësia e secilit popull shpie te pavarësia e të gjithëve dhe shpëtimi nga ankthi makbetian.

*(Mars 1999, intervistoi Ibrahim Kadriu)*

## BESOJ NË TË NESËRMEN

**- A mund të na thoni se çfarë bën në Tetovë, në këtë kohë një akademik, Ali Podrimja?**

- Unë kurrë nuk kam bërë dallime në mes njerëzve, lëre më gjatë një kalvari më të rëndë kombëtar-njerëzor, që mbyllet shek. XX. Brenda mundësive, përpiqem të ndaj dhembjen me secilin, t'i inkurajoj, t'ua kthej besimin se momentalisht shohim një ëndërr të keqe, e cila nesër do të shënohet ndryshe.

**- Jeni protagonist dhe keni përjetuar deportimin ndoshta më të madh të shqiptarëve nga vendi i tyre. A mund të na thoni diç më shumë për mënyrën se si po ndodh kjo tragjedi?**

- Nuk di me çfarë fjalë (dhe a ekzistojnë fjalë) të përshkruhet gjithë ajo, që e pa e tërë bota. Pra, unë nuk kam fjalë dhe nuk di ku ekziston dallimi në mes njeriut dhe kafshës. Njeriuu ndryshe e kam parë si një mbjellës të mirësisë, por ja, ai ditka të vrasë edhe fëmijë, nëna e pleq... Sidoqoftë, ky është marshimi ynë triumfues drejt Majës. Ne njëherë duhet të mundim të keqen. Këtë ta bëjmë për hir edhe të njerëzimit.

**- Në Maqedoni ndodhet një numër i madh i shqiptarëve të dëbuar me dhunë. Si trajtohen ata në atë anë, ku janë të strehuar kryesisht?**

Shqiptarët e Iliridës treguan një patriotizëm të pashoq. Na hapën zemra e dyer. Si gjithë shqiptarët e kuptuan se kërcënohet palca e kombit, që quhet **Kosovë**. Se tkurret atdheu, se shpërbëhet gjithçka jona, se derdhet e nëpërkëmbët dinjiteti. E panë se kombit i kërcënohet eklipsi, më e keqja që është shkruar e ëndërruar në elaboratet mesjetare serbe, e “mendimtarëve” paranoikë, që mbi disfatat e tyre nacionale ngrisin mite të rreme e që me to vazhdojnë të mashtrojnë edhe opinionin e jashtëm. Car Sllobodani tani e sheh

veten si Car Llazari (1389). Shqiptarët, pra, e kuptuan orën e ligë dhe kudo shtohen përkrah botës përparimtare, Nuk bën të harrojmë se konflikti ndodh edhe për shkak të sistemeve. Pra, *viktima* (ne), simbolizojmë të nesërmen e ndritshme të Evropës, ndërkaq *xhelati* bastionin e fundit të diktaturës mesjetare...

**- Mediat e huaja kanë raportuar për sjellje (së paku) jokorrekte të pushtetit maqedon lidhur me trajtimin e shqiptarëve të deportuar dhunshëm. Si e sheh këtë segment (korrektësinë maqedone) faktori shqiptar atje, e ndaj të cilit ka pasur edhe kritika?**

Tani për tani vetëm shqiptarët e kanë hapur qesen, për pushtetarët vendës, më mirë flet Perëndimi. Do të dëshiroja që edhe populli maqedon të bindet se në fatkeqësinë shqiptare nuk fitohet asgjë pos turpit.

**- Ditëve të fundit u fol për zhdukjen e çuditshme të mijëra shqiptarëve të ngujuar në Bllacë, të cilët i erri nata për të mos i gjetur mëngjesi. A thuhet diç për fatin e tyre, kur dihet se në qeverinë maqedone ka pesë ministra shqiptarë?**

Bllaca mbetet njolla më e rëndë në ndërgjegjen njerëzore në këtë fund shekulli. Aty ndodhi apokalipsa e kohëve moderne. Merrja pjesë në arenat romake, ku viktima përleshje me xhelatë. Aty u binda se ne jemi më të fortë se vdekja... Nuk u kursye asgjë. Lindeshin aty nënat dhe vdisnin. Bllaca është holokausti shqiptar. Mbajeni mend, aty nuk dihet sa varre lamë... Ju lutem, nderim për ta... Kujtoni Bllacën, se nderoni veten...

**- Me herët, por edhe në këtë kohë, në sipërfaqe duket moskoordinimi i faktorit shqiptar, për të mos thënë përçarja. Si e shihni këtë fenomen?**

Nëse kjo tragjedi nuk na bashkon, atëherë ne nuk jemi popull. Ata që përçajnë, nuk punojnë për çështjen kombëtare. Mbiekzistenca jonë është triumf edhe i ndërgjegjes njerëzore.

**- NATO-ja dhe Bashkësia Ndërkombëtare po e dënojnë më në fund regjimin kriminal të Beograit. A mendoni se janë vonuar për të bërë këtë ndëshkim?**

NATO-ja dëshmoi se askund nuk do të lejojë të nëpërkëmbën të drejtat njerëzore, se do t'u kundërvihet regjimeve kriminale, që prishin rendin e ri botëror, do të jetë kundër atyre regjimeve që fyejnë dinjitetin njerëzor, do të mbrojë kultura e popuj të pambrojtur. NATO-ja dëshmon se mbron të ardhmen nga e kaluara, se i afron popujt dhe i mposht muret e dallimet. Me veprimet e NATO-së do të fitojnë edhe vetë serbët, do të lirohen nga e keqja, ankthi e paranoja mesjetare...

**- Si e shihni statusin e ardhshëm të Kosovës dhe a jeni optimist në zgjidhjen e drejtë të çështjes së Kosovës?**

- Para 40 vjetëve kam thënë se *“Kosova është gjaku im që nuk falet... “*Nga atëherë e kam parafytyruar udhëtimin tonë jo aq të lehtë. Dhe, si e shihni derdhet shumë gjak; fëmijë, nëna, pleq e luftëtarë po bëhen dhe Kosove. Mëkat do të ishte çdo fat tjetër pos fitores, kthimit të paqes në vatrat tona dhe në fytyrat e zbrazëta... Ne do të jemi qetësia e ballkanasve. Ne do të bëjmë çudira dhe do të shpalojmë nga ëndrrat fytyrën e vërtetë të Kosovës. Kjo do të jetë një copë diell me një realitet të ri njerëzor...

**- Ç’duhet të respektojnë shqiptarët?**

Ta duam veten më shumë, ta respektojmë punën e secilit se kulla edhe për shkak të një gurthi nuk mund të ngritet...

**- Ndër të fundit keni marrë rrugën nga Kosova në Maqedoni. A mund të na thoni diç për fatin e krijuesve dhe intelektualëve të tjerë që eventualisht kanë mbetur në Kosovë?**

- I lumtur do të jem po të isha i fundit. Kalvari shqiptar vazhdon. Derdhet çdo gjë, ndoshta për t'u ngritur diç më e fortë, më e shëndetshme... Nga ikja kam arritur të shpëtoj vetëm çelësin e shtëpisë, i cili do të ma kujtojë vazhdimisht se në Kosovë duhet kthyer: gjallë ose i vdekur!

**- Si e komentoni vendimin e presidentit Rugova për të mbetur në Kosovë edhe në këtë kohë të vështirë për kombin?**

- Me poetin e mikun tim të ndëruar, Dritëro Agollin, jemi pajtuar se nuk kemi shqiptarë të humbasim. Etiketimet dëmtojnë

çështjen shqiptare. Nuk bën të merremi me vetveten. Është mirë ca të bëma t'ia lëmë të ardhmes. Edhe ajo duhet të merret me diç. Kryesore, të kthehemi në Kosovë. Buzëqeshja dhe kulmi i saj prej ëndrrës fshihet në gjakun tonë, në mesazhin njerëzor: popujt duhet të jetojnë të lirë, të mëdhenj apo të vegjël qofshin. Kjo nuk është demagogji, as retorikë. Unë besoj në të nesërmen tonë. Ajo do të jetë edhe kreni e atyre që na përkrahin. Luftohet dhuna, që poshtëron dinjitetin njerëzor.

*(Prill 1999, Rilindja Demokratike, Tiranë. Intervistoi: Sabit Gecaj)*

## PËRBINDESH MESJETAR NUK MUND TA SHOH SHQIPTARIN

**“KJ”:** - Poeti i përjeton situatat që kalon populli i tij në mënyrë tejet poetike. Çfarë thotë Podrimja për situatën ku gjendet populli i tij?

A. Podrimja: - Druaja ndoshta, por atë që e kam parandier e projektuar në poezi, fatkeqësisht ndodhi me përmasa katastrofike. Disi përpiqesha të paralajmëroj të keqen, t’u bëj me dije se hasmëria sllave është e egër. Përmes një gjuhe ekuivoke e simboleve, të themi të një ndër dije shqetësuese, shpesh nëpër poezinë ishte vijëzuar më e keqja. Ja realiteti i sotëm kosovar ka dimensione të fantastikes. Kur isha nxënës dhe lexoja ndonjë libër për katastrofat e hershme njerëzore, pakëz besoja; nuk mund të pajtoheshja se kanë ndodhur vërtet Atlantida, përmbysje apokaliptike, holokausti e shumë ndodhi të tjera. Diçka nga kjo përjetova në mbyllje të shekullit XX, këtu në bisht të Evropës. Do Zoti të kem derdhur të keqen. Kështu para një realiteti morbid njeriun e shoh tepër të vogël, ndoshta dhe si qenie neveritëse...

**“KJ”:** - Veçantia në mënyrën e përjetimit është pikërisht fokusimi personal. Cili është ky fokus te ju?

A. Podrimja: - Edhe vdekjen, edhe zgjimin, edhe ndjekjet i shoh nga këndi im personal. Nëse shkruaj dhe luftoj të keqen, unë në të vërtetë kam ndihmuar dhe rrethin, popullin tim dhe njerëzimin. Çdo gjë duhet pasur një pikëmbështetje nga nis edhe udhëtimin, të them imagjativ. E në këtë marshim tim shpesh kam projektuar edhe gjeografinë e atdheut, ashtu të derdhur, kam ndier dhembje dhe kam respektuar edhe çamin, edhe shkodranin, edhe korçarin, edhe vlonjatën. Nuk kam pranuar të copëtohem dhe dashurinë time ta bëj me copa. Kjo do të thoshte, unë si krijues e njeri të pranoj orën e ligë. Pra, mua më ka shqetësuar ai zëri i thellë i një mbiekzistence të mbështjellë me mjegulla, ndoshta mitike... Edhe kur kam kënduar për

vdekjen e djalit tim të mitur, Lumit, nëpër fjalë të mia ka lëvizur dhe frymuar edhe njeriu, kuptohet në një dritë tjetër. Aty gjendet edhe populli im, pra.

**“KJ”:** - Në këto momente mos janë hakmarrja dhe dëshira për të arritur lirinë ndjenjat më të forta apo diçka tjetër që ju mund ta formuloni vetë?

A. Podrimja: - Thellësisht besoj se në momentin e pikërisht na duhet më shumë guximi se hakmarrja, sepse mbi të gjitha kategoritë etike qëndron njerëzorja. Unë nuk mund ta paramendoj shqiptarin në një përbindësh mesjetar, duke mos kursyer as foshnjat, gratë shtatzëna apo pleqtë. E keqja mundet me guxim, dinjitet e urtësi. Mu për këtë e tërë bota gjendet në anën tonë dhe kjo ndodh për herë të parë, ndoshta që të lirohet nga mëkatet e së kaluarës...Unë dua t'i ik ndëshkimit të zotërave, të mbiekzistoj si vlerë. Dëshiroj pra, vdekja ime të jetë e bukur, dinjitoze. Këtë e mësova nga populli im, të cilin kasapi i Ballkanit, pa fije turpi, e quajti popull rrugaç, që nuk e njih historinë. Unë nuk pranoj që në skenën ndërkombëtare të jem një palaço i gjorë, të prish imazhin tonë...

**“KJ”:-A mbizotëron në këto momente te ju ndonjë lloj pesimizmi, gjithmonë nga pikëpamja emocionale?**

A. Podrimja: - Gjysma e punës do të kryhet po qe se frenojmë emocionet, euforinë... Logjika e fortë çan udhë, bën të pamundshmen. Në këtë marshim kolektiv nuk ka vend zymtësia. Bëhet fjalë për ekzistencën e një kulture të popullit të lashtë, bëhet fjalë për hapësirën jetësore-historike, veprohet e kundërshtohet tkurria e një vendi, ngritet zëri kundër dëbimeve masive, kundër çelësave nëpër dyer kullash, shtrydhet vreri mesjetar. Mu për këtë frikësimi na lë aty, ku ëndërrojnë të na shohin eskadronet e vdekjes të neofashizmit serb. Mirëpo paska edhe krijues me renome, që u jepka krah masakrave, varreve masive, krimeve. Vërtet, më habit kurajoja e Peter Handkës! Ç'të bukur e njerëzore pa ky zotëri në masakrat serbe? Më bëhet se i nderuari gjendet në një orë të ligë...

**“KJ”:** - Po optimizmi shfaqet si emocion apo si logjikë e fakteve që janë intensive dhe të pakundërshtueshme?

A. Podrimja: - Më parë thashë se logjika e fortë duhet të na mbajë zgjuar. Mu për këtë rrallë u jam dorëzuar emocioneve. Kam fituar vetëm atëherë kur kam dëgjuar zërin tim: pas këtij muri fillon liria, pasi ta mundësh edhe këtë, të pret ajo që e ke ëndërruar tërë jetën. Kështu më ka trimëruar çdo ndërmarrje, lëvizje - se para meje shfaqej fatkeqësia. Sllobodan Millosheviqin nuk e shoh vetëm si fatkeqësi time, por ballkanase, bile dhe serbe. Në një poezi time të hershme (1988) e kisha vijëzuar portretin e tij: *një rebel trashaman / dbunues anadollak me dhëmbë prej gjarpri.../* Një “car” i tillë nuk mposhtet me klithma e vaje. Në raste të tilla duhet shkelur rëndë. Kam thënë dikur si gjimnazist (1960) edhe këtë: *Bukuria nuk është bukuri / nëse nuk e ka shëmtimin e vet...* Momentalisht jam tepër i bukur, por në pasqyrën e refugjatit pashë një pikë gjaku në lulen e ballit tim. E kuptova se ishte shpërbërë edhe harmonia.

### **“KJ”:- Cili është raporti midis jush dhe politikës?**

A. Podrimja: - Fati më bëri të jem i pakënaqur me veten e rrethin. Ndoshta do të më çilet ndonjë deriçkë diku dhe me këtë rebelim do të krijoj paqen time olimpike, pra dhe të popullit të fyer, të përgjakur e të ndjekur. Nëse dëshira për të ekzistuar është politike, atëherë çdo gjë qenka e tillë. Për mua, liria kurrë nuk humbet, ajo pasurohet vazhdimisht. Fatkeqësisht, tani ajo më është gjithnjë me e paktë. Kjo nuk do të thotë që unë të jem dele...

### **“KJ”:- A do të mbetet dashuria për Kosovën - dhimbje për të kaluarën e saj?**

A. Podrimja: - Kosova mbetet buka jonë e përditshme. Vështirë t'i mbyll sytë pa e parë aty ku ëndërroj ta shoh. Me të vazhdoj të grindem, pra. Le të fitojë njëri nga ne të dytë.

### **“KJ”:- Poeti brenda jush - si e përjeton tragjedinë kosovare, duke ëndërruar të ardhmen, duke thirrur harresën apo duke dëndësuar të tashmen?**

A. Podrimja: - Duke u ngjitur Majës dhe duke e parë qiellin edhe në rrëzë, aty në rrënjë.



**“KJ”:** - Nëse Kosova bashkohet me Shqipërinë - si i paramendon poeti lidhjet shpirtërore me kombin e përgjysmuar?

A. Podrimja: - Shqipëria shpirtërore kurrë nuk është shpërbërë edhe pse padrejtësitë e të mëdhenjve na bënë pikë e pesë. Sidoqoftë, fytyrën e etnisë ia shoh, ajo nuk është as Shqipëri e Madhe (term serb) as Shqipërizë, por hapësira ime normale. Pra, normaliteti ynë, ua kthen paqen ballkanasve, gjumë të rehatshëm, bile edhe serbëve. Etnia do të formohet për inatin tonë. Ashtu kanë vendosur Zotërat.

**“KJ”:** - Cila është dhimbja juaj tani?

Podrimja: - Të vetmit perëndi, që u përulëm janë fëmijët. Në syrin e tyre nuk mund ta shoh lotin, lëre më plumbin në trupin e njomë... Ata na kujtojnë mirësinë dhe na largojnë nga egoizmi njerëzor.

**“KJ”:** - Çfarë fjalësh poetike në këto momente që po përjetoni, ju kanë ardhur në mendje? A do të kthehen ato në vargje?

A. Podrimja: - Mund të ndodhë, por shumë fjalë do të dëshiroja t'i flak nga fjalori, ca janë vrastare e ca të bëjnë të skuqesh. Pasi e kalova kalvarin shqiptar të kohëve moderne, në kabinën e parë, aty në Shkupin tonë, ngrita telefonin: gjallë jam - i lajmërova miqtë - dëgjoni ore, gjallë jemi...Nuk ka kjo diç me të bëmat biblike apo jam vonuar tepër ndoshta?

*(Prill 1999, Koha jonë, Tiranë)*

## BUKURIA TRISHTUESE

Braktisin mite, përralla, ëndrra. Duan të jenë më njerëzor. Kush mban emrin rrokaqiell, antenë, shleper; kush nuk heq dorë nga të mëparshmit. Ca u shndërruan në semaforë se mungojnë shenjat e komunikacionit; kush nuk e sheh fundin nga maja. Në mes njerëzve veten kërkojnë, heronjtë të lodhur nga mitet, përrallat, ëndrrat. Unë vë syzat të shoh më mirë defilimin e bukurisë pakëz trishtuese.

*(Mymben, 1999)*

## NGA SHËNIMET E NJË FRIKACAKU

Në vrimë se na qitën fare, por ne paskemi qenë të pavarrosur moti.

*(Këh, 1999)*

## CREDO

Të kesh kujdes ndaj zotërave. Mund ta terrojnë udhën s'e gjen dot Itakën.

*(Këh, 1999)*

## FUNDI I ËNDRRËS

Më në fund u lirova nga iluzioni. Ajo ishte nevojtoe në fushë.

*(Mymben, 1999)*

## HAPJA E LIBRIT

Dhe nuk vdiset krejt se Maratoni kujt t'ia kumtojë lajmin...

*(Këlln, 1999)*

## SHËNIM

**Dielli i zi** është sajuar nga ca tekste të shkruara brenda vitit bibliik shqiptar (1999). Ngrysja e ndërgjegjes europiane mbi çështjen shqiptare është pikënisje. Çka më tutje? Nuk bëhet fjalë për melankolinë, brengën, egon, siç e elaboron këtë nocion estetja bullgare, Julia Kristeva, në veprën e vet po me këtë emër. Pjesa më e madhe e teksteve janë botuar në gazeta e revista tona djathtiste e majtiste. Doja të di deri ku shkon ndërgjegjësimi ynë për fatin e kombit. Zgjidha udhën time: pakënaqësinë.

*Ulpianë, 4 prill 2000*





# ËNDRRA KALLËZOHET NË MËNGJES

Rilindja, Prishtinë, 2001



## MUZGU

Bajraktari ishte vrenjtur. Nuk i shkonin punët mirë me Kullën. Mes turmës së hallakatur e kishin parë tebdil. Habergyli bënte me dije se na ishin shuar një grusht shpirtrash shkaku i lirisë së tij. Lum e lum për shqiptarinë! Hiye e rëndë na i binte Arbërisë...

*(Iiridë, prill, 1999)*

## MASKENBALLI KOMBËTAR

### 1

Prapë e kisha lexuar një poezi të Henri Mishos për zbrazëtinë. Nuk ka gjë më trishtuese se kur të sundon ajo. Mjedisi ynë ka diçka të tillë. Fryn nga të gjitha anët, brenda nate kurrkushët duan të bëhen yje të kombit. Por ndodhin aksidente nga më të dhembshmet. Vrima, në të cilën ishte përqendruar poeti, ma kujton dhembjen e gjeneralit plak. E kishte parandjerë se në hapësirën tonë vërtet po hapej një vrimë me përmasa të mëdha. Kjo fjalë shkakton drithmë. Ndjen rrëqethje të ngjashme me atë të zbrazëtisë së Mishos. Kyçesh në një plagë. Nuk dallon fare nga fjala vrimë. Dhe nuk do të zë goja të thuash: tingëllon rëndë në kujtesën kolektive. Më e rëndë bëhet sidomos kur nga dëshpërimi i gjeneralit plak shkapet fjalën pleh. E, një popull i tërë hipte mbi tanke dhe e shpaloste flamurin kombëtar!

### 2

Të kujtohet pastaj Faik Konica me rebelimin e tij: do të thoja me guximin e tij prej intelektual: *Shqipërinë shpëtoje, Zot, nga shqiptarët!* E njëjta gjë mund të thuhet tani për Kosovën. Në kohën e monarkut të kuq kjo lutje vetëm ishte pëshpëritur. Pas 28 vjet robërie Demaçi pranon ta bëjë udhën edhe me “xhelatët” shkaku i çështjes kombëtare. Po këtë e bën vetëm ai që vërtet e do atdheun, popullin e lirinë. Të kërkosh famën e kërmillit në kaosin kombëtar, nuk është burrëri. Shfleton historinë e me dëshpërimin e gjeneralit plak mund të puqesh diku.

Në librin e shkollën e atdheut pesëdhjetë vjet i ishte ndalur hyrja toskës së rebeluar pse kishte dëshiruar ta shihte ndryshe shqiptarinë. Guximi intelektual mbeti në periferi. Pse ndodh kjo edhe me mjedisin tonë kur nuk kemi bërë ende asgjë? Përkrah urtakët dhe

nuk pranoj ndëshkimin si zgjidhje, as nuk jam për konfrontizëm. Po ashtu, nuk mund t'i pranoj alpinistët e rastit në një kaos të dhembshëm kombëtar. Bisedën për vrimën e lëmë për kohë më të esëllt. Qerratenjve dhe kujdestarëve të patriotizmit të rremë nuk dua t'ua mundësoj kënaqësinë në pushtimin e Olimpmit të paqenë. Po, shtetit tonë më të ri në Ballkan, ç't'i uroj kur faqe e re e historisë hapet në një udhëtim të përhënë?

### 3

Ka kohë që më fton miku im zezak, Hove, të zdirgjem atje poshtë në Afrikë e të shoh si duken fosilet e një antiqytetërimi, por ç'më duhet Afrikë? Kërko model më karakteristik. Ngre dolli, pra, për ndonjë fitore të re. Na duhet një çik të argëtohem e të lavdërohem për hiç punën tonë. Na lodhën ndjekjet, përndjekjet, hasmëritë, vëllavrasjet, përdhunimet trupore e mendore, hafijellëku i hapët e tinëzar për një copë karrige; na lodhën mediokrit e pseudotë, imituesit e verbër të Evropës e bashibuzukët anadollakë. Nuk paska peshë asgjë jonal! Nga dritarja e nxirë shoh si zgjohet shteti ynë, më i riu në Ballkan. Mos po i shmangemi edhe asaj vrime gllabëruese?

### 4

Toska i rebeluar la fjalë me vend: shqiptaria, që të dalë në dritë, duhet të lirohet nga injoranca anadollake, nga kurrkushët. Lexim ky nga vepra e tij. A bën të qelbet më pak mjedisi ynë? Zgjohe mi në krah të majtë, në krah të djathtë; na shkumbojnë bulçitë dhe fjalët aty nën dritën e hënës. Por, dëshpërimi i gjeneralit, megjithatë, nuk na lë rehat. Herri Misho më bezdis, se diçka e tmerrshme fryn nga vrima...

Tekefundit, nuk është keq të ketë maskenballe në një kaos. Dëgjon edhe jehonën e fjalëve: liria të jetë e pastër, këmishë gjerdeku të mos peshojë më lehtë se një gjethe në dritaren e vetmuar. Për hir të filan atdhetarit, vlerë e madhe e shqiptarisë, nuk bën të mos ngrihet dollia. Bindesh se ky popull vërtet i ka punët më mirë seç është dashur. Nuk ka pse të frikësohet për ardhmërinë. Fati i tij lexohet në shpatull pule (Fishta: "Lahuta e Malcisë"). Në dinjëtetin e tij nuk bën

fare të dyshohet. Nga çatia jonë rrëshqet edhe copa e fundit e natës. Andaj, pse të ndalet maskenballi kur nuk turpërohem as nga fjalët tona.

5.

Maskenballi, megjithatë, është pasqyrë e “ndritshme”: nuk shkëlqejnë aty vetëm fytyra, nuk bubullojnë vetëm fjalët e vogla e të mëdha për patriotizmin tonë, nuk ke nevojë të ndezësh ndonjë llambë e të shohësh se ç’ndodh në hapësirën e shthurur. Mjafton kërcitja e dhëmbëve të mediokërve e neobolshevikëve e të humbësh në një dritë më se fantastike. Vërtet ky popull nuk heq keq... E pashë edhe në fytyrën e mikut, i cili kishte zënë vend në krye të senisë. E kishte një gaz krejt tjetër, një fjalor me një sintaksë pakëz të ndezur. Dikur e tërhoqa dorën nga e tija, e cila mbeti në ajër. Atë që ma tha, respektonte hierarkinë. Vërehej kjo në lëvizje: si e kap pirunin, si e priste mishin, si përtypej, si i fshinte bulçitë, si pozonte. Në maskenball, kur na është patriotik, nuk bën të fyhet hierarkia, se shkrepëtijnë edhe fjalët.

6.

Ulesh diku dhe ndjen praninë e vrimës gllabëruese. Parafytyron gjeneralin dhe dëshpërimin e tij: pleh. E tha në një moment kur ishte jashtë lëkure, pranë së keqes, ku e shihte atë vrimë, që vështirë mbyllet. Sillesh rreth saj. Të kap tmërri, se lëkundet edhe guri. Të vjen turp se nuk mund të ndryshosh gjë.

7

Bëhemi shteti më i ri në Ballkan? Pavarësohemi? Shkëputemi nga e keqja? Dhe, në mungesë të dinjitetit, ligjit e shtetësisë vazhdon maskenballi. Harron se ç’ndodhi pakëz më parë tek e shikoje vrimën si frynte nga terrina...

# LEXIMI I XHAMIT TË ERRËT

## SHKRIMTARI I FËMIJËRISË SIME

1

Secili lexues ka edhe shkrimtarin e vet të fëmijërisë. Unë isha pakëz romantik, dhe më pëlqenin ata shkrimtarë që kishin një të kaluar të bujshme. Kështu, në qytetin tim buzë Erenikut, Petro Marko hyri me romanin “Hasta la vista” dhe kujtimet për Asim Vokshin e për luftëtarët nga Revolucioni Spanjoll. Më vonë këtë kolos të letrave shqipe e takova më 1971, më 1972, më 1979 dhe takimi i fundit (1991) ishte më i dhembshëm, hiqte shpirt në një shtrat pranë dritares në drejtim të Himarës. Parafytyrimi im për të mbeti ai i fëmijërisë: përrallor dhe dinjitoz, që pakkush nga shkrimtarët shqiptarë mund të krahasoheshin. Në lagjen time, aty nën Çabrat, dëgjohej deri vonë kënga “Hasta la vista”.

Hyrjet e daljet e tij të rrufeshme në një hotel të Tiranës, ngritja e gotës me rrëmbim pranë një banaku të drunjte e të vjetër, kaçurrelat e pakrehura dhe shikimi engjëllor flitnin çartë për atë që e mundonte. Vërtet, ai kishte diç të fëmijërisë sime. Edhe tani ajo pamje e tij më shfaqet në do ngjyra të purpurta kur hap ndonjë libër të tij...

Para meje kisha një luftëtar, një humanist e një krijues të formatit të madh. Dinte shumë fshehtësi për jetën dhe artin e fjalës. Ishte krijues me potencial të madh. Magjiplotë i fjalës dhe i rrëfimit. Predikonte vëllazërinë kombëtare e njerëzore. Nuk mund të pajtohej me atë që ndodhte në Vendin e Shqipeve e që ia rrëronte imazhin e burrave të devotshëm të rilindësve. Shpesh e fyen dhe e ndëshkuan. Në këtë tatëpjetë kombëtare morën pjesë edhe shokët e tij të luftës. Këtë e konsideronte amoralitet njerëzor, poshtërsi, por nuk mund e mposhtën. Diktaturën e shihte si fatkeqësi të qenies shqiptare. Nuk ishte kjo që i tubonte shqiptarët. Udhëtimi ynë ndodhte nëpër mjegull e me plot të papritura. Trojeve tona u kërcënohej rigëllitje e egër nga të tjerët, në emër të një ideologjie të zymtë që derdhej Ballkanit e që i ngjante më shumë hegjemonisë.

## 2

Shtetin ideologjik shqiptar Petro Marko e sfidoi vazhdimisht përmes qëndrimeve e veprës së tij plot shqetësime e dhembje, bile dhe përmes një kompozite domethënëse Jamarbër, emri i djalit, por në kohë nokdaunësh, pakkush e kuptoi këtë kompozitë të çuditshme.

Libri postmortum i botuar (2000) me një titull provokativ “Intervistë me vetveten” (Retë dhe gurët) është udhëtim i një të rebeluari, ku përmes kësaj autobiografie të romanizuar jepet dhe udhëtim i rëndë shqiptar në kohën e iluzioneve e të diktaturës. Cinizmi i tij lexohet: me kë të qash hallin mbi fatin kombëtar e njerëzor në kohë izolimesh e dyshimesh të mëdha? Më mirë të rropatesh me vetveten për rrënimin moral e varfërinë njerëzore në Vendin e Shqipeve.

Edhe me botimin e dramës “Skënderbeu” në revistën “Nëntori” me rastin e gjashtëdhjetëvjetorit, nuk i shpëtoi censurës, e cila i rrinte mbi fjalë e faqe të pashkruara ende. Ndëshkuesit bënë përpjekje krijimtarinë e tij ta nxirrin margjinave si të pavlerë e të dëmshme për shëndetin e kombit. Por Petro Marko u përballoi ndërskamcave e paradokseve shqiptare. Ishte ortek njerëzor që hapte udhë.



E dua Kosovën gjer në dhembje, thoshte. Do të thotë, pranonte sakrificën dhe e tmerronte kur kujtonte se Kosova, tokë dardane, gjendej tej gurit tragjik, që e kishin vënë mes nesh padrejtësitë dhe dora e huaj. E Kosovën, krah i fortë i çështjes kombëtare, nuk e zbuloi rastësisht e për ndonjë lëvërdi, por shkaku i kulturës, i historisë, i gjuhës dhe i gjakut. E ardhmja e Shqipërisë, për të cilën ëndërronte dhe besonte, kishite hapësirën e shpirtit të tij. Aty ishte Kosova. Ky vizion shfaqet edhe në veprën “Intervistë me vetveten”, botim i “Omsca-s” të Tiranës.

### 3

Petro Marko në letrat shqipe hap dhe një shteg: është nismëtar i shkrimit të romanit tonë modern. Këtë e mbështet edhe kritika shqiptare. Kujt nuk i kujtohet “Qyteti i fundit”, përfundimi në portin e Durrësit: Lekës i ra cigarja nga dora... Kushedi ç’kishte veneruar shkrimtari në horizont.

Rebelimi i tij dhe i të pakënaqurve paralajmërojnë divorcin me diktaturën, dhunën brenda kombit; fundin e kazamateve që kishin mbirë si kërpudha gjithandej Arbërisë kinse ruanin pastërtinë kombëtare e ideologjike. Ky errësim i piramidës shqiptare shpesh u lexua edhe si turp nacional...

Kohë të mira vijnë për shkrimtarin e fëmijërisë sime.

## LEXIMI NË XHAMIN E ERRËT

1.

A ju kujtohet “Qyteti i fundit”? Filli i romanit tonë modern. Autori i tij, Petro Marko, legjenda jonë nga Spanja e Lorkës, pas të ashtuquajturës LNSH, regjimi diktatorial e akuzon për agjent të shërbimit amerikan. Dhe, duke parë se krimi kishte filluar t’u hyjë në gjak pushtetarëve, të bëhet “art” i preferuar dhe truri ynë të bllokojë, shkrimtari nis rebelimin, të cilin do ta vazhdojë i biri Jamarbër Marko, por në një mënyrë krejt tjetër.

2

Jamarbër Marko është poet karakteristik në poezinë më të re shqipe. Një disident i heshtur, i tërhequr në vetmi dhe i dashuruar në fuqinë e fjalës, ironik i akullt, i cili do të hyjë në letrat shqipe pa bujë, dinjitoz e i veçantë. Pakkush dinte se ai portretizonte fytyrën e vrazhdë të diktaturës. E bënte këtë me xhelozinë e një artisti të njëmendtë. Përmes poezive të tij sarkastike vetëtijnë sekuenca nga kazamatet e spitalet neuropsikiatrike, ku në mënyrë më të poshtër fyhej e thyhej qenia shqiptare. Se, shkatërrimin kombëtar kësaj here e bënin vetë shqiptarët. E gëllitnin vetveten, se kërkonin të shiheshin edhe në fund të pusit ashtu qyqë.

3

Libri i tij “Rastësisht me dashje” është titull provokues. Pse rastësisht me dashje: Krimi mos ndodhte vërtet me dashje, apo aksidentet e vrasjet pa nishana, burgimet e internimet ishin të rastësishme?

Jamarbër Marko ngre çështjen e moralit politiko-shoqëror, duke e zhveshur nga dhuna e hipokrizia. Dhe nuk ngurron të shënojë

shkaktarët e asgjësimit brenda qenies sonë në baza farefisnore të një pastërtie ideologjike, që më tepër përkon me utopinë e fisit e të oborreve mesjetare. Dhe si t'i quaje ndryshe ata pos xhelatë; se ata ishin kreatorë të së keqes kombëtare, cungimit të vazhdueshëm, izolimit shpirtëror e shtetëror.

*“Ju lutem xhelatë*

*Më buzëqeshni*

*Nuk jam fotograf*

*Jam thjesht*

*Vrasësi juaj”*

(“Në gjyq”)

Rruga e errët e gjakut shpie nga pragu i shtëpisë, sepse krimin e kishin përjetuar familjarisht: nga babai tek i biri – se lirinë e paqen e shikonin pakëz më njerëzore; se popullin e kombëtares e mbronin më kombëtarisht; se Atdheun nuk mund e shikonin një konservë të hedhur nga gjithkushi, aty pranë Ujit të madh, ku nuk ekzistonte as Bregu, as Varka, as Gjeniu. Narratori nuk është lirik se lirinë nuk mund të ketë ku dhuna poshtëron e rrënon çdo gjë rreth teje. Kemi të bëjmë me një ashpërsi koncize, me një kundërvënie intelektuale të sistemit totalitar, pa shpenzimin e fjalëve. Pra, narratori në poezinë e Jamarbër Markos është i traumatizuar; ka elemente të dramatikes. Flet nga ndërvoja e njeriut të ndjekur, të fyer, gati përçarë flet diçka që ka arritur t'i shpëtojë ferrit njerëzor, aty ku “toka digjet si letër”. Ka dhe segmente të tjera, që këtë poezi lypset lexuar si një sintezë mbi dhunën e lirinë e individit. Kanë kohën e vet dhe mund të kapen, para se gjithash, nga rrafshi sociopsikologjik.

Një poezi e tillë, e kultivuar në zgur të krimit, dhe e thënë me vrer çekuilibron poetikën tonë; më mirë të themi, e pasuron atë. Para nesh nuk kemi vargnim banal; kemi një poet që të vë në lëvizje me artikullimin karakteristik, duke prekur rëndë dhe në etikë. E binda vrasësin të buzëqeshë. Po cili vrasës di të qeshë me viktimën? Ky farë

vrasësi mësoi e ushtroi zanatin e krimit. Një e zezë e tillë na kishte gjetur edhe ne të këndej murit. Pra, në të dy anët një dorë e padukshme kurdiste mbrapsht orën tonë, dirigjonte ecejaket tona të kërmillit.

Në mes fërkimeve e kundërvënieve ekzistojnë dallime. Petro Marko filloi si disident politik dhe përfundoi në atë letrar. Kujtojeni dramën “Skënderbeu”, tinëzisht gati e kishte parë dritën në revistën “Nëntori” dhe ishte ndalur për: 1.) në Kështjellën e Krujës kishte më shumë frëngji se duhet, 2.) logjika e reduktuar moniste frëngjite i kishte parë si tentimi i hapjes së shoqërisë shqiptare, të dalë nga vetërrethimi e izolimi dhe 3.) censurës i tërhiqej vërejtja se cenonte vetekzistencën shqiptare. Pra, Petro Marko e humb besimin edhe në rrafshin krijues. I biri, Jamarbri, u përcaktua për këtë rrugë të vetme e më të tmerrshme. Të burgosur mbahen mend pak për burgjet e tyre, por veprat që kanë rrënuar, nuk harrohen dot.

Duk përcjellë diskursin në “Rastësisht me dashje”, merr pjesë në shpalosjen e shpirtit dhe mendimit të një krijuesi, i cili di ç’kërkon. Ca nga poezitë janë krijime kristale, të pastërta që më vete fshehin mesazhe që mund t’i dijë vetëm poeti. Në to nuk bëhet fjalë vetëm për problemin ekzistencial të shqiptarit. Shtrohen aty dhe shumë çështje. “Në përplasjet e rrëzimin”, poeti mban qëndrim dinjitoz, kërkon vetëm “për ta ndrequr gabimin”, të korrigjohemi si shoqëri e komb. Mbetet kjo dhe një provë jona e mëtutjeshme. Prandaj libri i tij vazhdon të shkruhet në vetminë e persiatjet njerëzore për atë që ka ndodhur e që poeti beson në kërkimin e tij këmbëngulës: u nisa të gjej të ardhmen...

4

E pastaj leximi i vetvetes në xhamin e errët

*(Variant nga një tekst më i gjatë)*

## ZË I NDËRGJEGJËSIMIT

*(Para fëtÿrës Naim Frashërit)*

*Fëtÿr, o fëtÿr, bie Gjeniu!  
Ti s'kie mish, as kie gjak...  
As që je mvesh në korç njeriu,  
Për me hap gojën e me m'fol pak.*

*Nuk të kujemi ma, ah! Nuk gjallon,  
Oh! Keq të ndrpi mortje e zezë,  
Po Shqypënia kurri s'të harron.  
Se me t'vertet Ti e ki ndezë...*

*Kush mund me msbeh shërbimin Tënd?  
Librat me vjersha. Ty predykojn:  
Ton Shqypënia me kta u trond!...  
Dhe Ty gjithnjë kënk dot këndojn...*

*Ka me u huq, doba tradhtor  
Po emni yt, kurri s'harrohet.  
Vjershat ç'ke shkru, Ti, o vjershtor.  
Dhe trat'ori sot pendobet...*

*(Josip Bageri)*

## 1

Ishte pikërisht ditë e diel kur zbrita me mikun te varrezat. Dëshironte të më befasonte me një fenomen të rrallë të njerëzve të asimiluar. Për atë që ma tha, kisha dijeni. Nuk kisha pasur rast të dëgjoja vetëm kujën. Gratë në të zeza ishin shkepur nëpër varreza. Ma çonin mallin e gjirokastriteve në romanet e Kadaresë. Kishin zbritur nga ana e epërme e Grykës. Te varri i më të dashurit secila ia kishte plasur kujës. Ne bredhnim të heshtur dhe dëgjonim vajin karakteristik, pakëz të turpshëm. Dhuna maqedone vetëm atë nuk mund t'ua fshijë nga kujtesa. Qanin shqip dhe ishte bezdisëse si i artikulonin fjalët e një gjuhe, që e mbanin gjallë vetëm mes varrezave ndoshta. Gjuha e dhunës nuk u shkante për kujë. Përballë Mali i Thatë e ndonjë zog, që kërkonte çerdhen diku mbi kokat tona. Ditë e diel kishte qëlluar. Thekshëm vajtonin gratë në të zeza.

## 2

Te një mik imi në Tiranë kisha dëgjuar shpesh një këngë përmetare. Quhet *Dita e diel kur vjen*. E këndon një femër përcjellë nga kori i burrave. Bart më vete dramën shqiptare të kurbetit. Mund të fillonte te Lëndina e Lotve ose diku në Fushën e Mëllenjave. Kurbeti mbeti plagë e rëndë e qenies sonë. I zënë në mes të kësaj drame vetvetiu kisha filluar ta recitoja më vete poezinë “Vajtojcat e Rekës” (17.2.1993). Pas Malit të Thatë me atë zogun në qiell, e sosnim ditën e diel, me muzgun e së cilës ngjiteshin dhiareve gratë në të zeza.

## 3

Gjendesha në Iliridën e Josif Bagerit. Poezinë për vajin e rekasve mund t'ia dedikoja vetëm atij. Kisha edhe arsye. Nacionalizimi maqedon, siç kishte vepruar me asimilimin e shqiptarëve ortodoksë bënte çmos që edhe këtë figurë të shquar të kulturës sonë ta shpallte të vetin. Ndjeja neveri. Poezia ime i rrinte ndesh kësaj egërsie sllave. Në të vërtetë, unë kurrë nuk jam deklaruar për shqiptar të sert as rrahagjoks. Patriotizmi është diç boshte kur nuk di të veprosh me të. Kryeja detyrën time si pjesëtar i një kolektivi që i përkas, duke

mbrojtur kulturën e historinë e tij. Pra, mbroja një fragment të kulturës sonë së cilës i kanosej rrënimi i identitetit, duke u shkullur me dhunë. Vetëm ai vaji, iu kujtonte se kush janë.

4

Në takimet letrare “Naim Frashëri” në Tetovë (tetor 2000), mbi tavolinën time miku im nga Sofja, Thoma Kacori, ma la një poezi të Josif Bagerit. Për mua ishte një sihariq. Përmes saj unë e shihja Bagerin në një dritë tjetër. Poezia ishte botuar te “Shqypeja e Shypënis”, në numrin 4 korrik 1908. Me gjasë ishte shkruar fill pas vdekjes së Naimit. Titullohet “Para fëtyrës Naim Frashërit”. E, si e sheh personalitetin e Naimit ky rekas? Para se gjithash, kemi një lirikë me emocion të lartë dhembjeje për ikjen e poetit, ngritjen e tij në gjeni kombi:

*“Fëtyr, o fëtyr, hie gjenin”*  
(vargu i parë).

Cilësi tjetër është se jo vetëm me këtë poezi, Bageri rrënon thashethemet e shkencëtarisë maqedone për origjinën e tij e të gjithë Rekës. Kryesore është se kjo poezi është thirravaje, forcon mendimin se çdo gjë e humbur nuk mund të humbasë përgjithmonë. Pra, gjaku nuk bëhet ujë, siç thotë populli. Edhe një ofshamë dëshmon diçka tragjike. Bageri është njëri nga zërat e ndërgjegjësimit të lëvizjes sonë kombëtare. Rol të rëndësishëm luajti edhe në hapësirën bullgare, ku jetonin një numër shqiptarësh.

5

Poezia “Para fëtyrës Naim Frashërit” është strofike dhe ka 16 vargje, një rimim të krijuar kryesisht nga foljet dhe e thënë përmes një patosi. Ka një mesazh për generatat që vijnë, për mbështetjen e meritave të Naimit. Dhe, nga vargu i parë e konsideron për gjeni kombi, para madhësisë së të cilit përulen edhe tradhtarët:

*“Dhe trat’ ori sot pendohet” (16)*

Kishte bindjen se personaliteti i Naimit thoshte shumë për kulturën e popullit: “Por Shqypënia kurr s’të harron” (7). Thirravaji i tij është një përjetësim i gjenit: “Dhe ty gjithnjë kënk do të këndoja” (12). Me iluminizimin e tij ky rekas i pamposhtur mbet besnik i çështjes shqiptare deri në frymën e fundit.

6

Vaji i rekaseve mbi varre shpalos edhe anën tjetër tragjike të historisë sonë: shkombëtarizimin. Zonat e humbura Kadareja i shënoi në një poezi me një guri e bar të rritur rreth tij, ku nuk shkel këmba e njeriut tonë: pra një zonë që vdes (“Vendet e shkombëtarizuara”). Ky problem më ka tmerruar vazhdimisht, ndoshta pse ne gjendeshim në zgrip të zhdukjes dhe se kjo fatkeqësi u përsërit shpesh. Tkurrja e hapësirës sonë u bë drojë më e theksuar. Megjithatë, nga kjo barbari e fqinjëve arriti të shpëtojë diçka e veçantë: vaji shqip. E pse ndodhte kjo vetëm në varreza? Çfarë tmerri u mblodh në kujtesën e tyre? Nuk guxonin një fjalë ta thonin diku tjetër! Drithma hyri dhe në tekstin e poezisë sime, e cila befas u krijua një të diel, derisa përcillja ardhjevajtjen e rekaseve në varreza.

7

Portreti i Naimit nga Bageri është ai që do e hasim te pjesa dërrmuese e poetëve dhe naimologëve: atdhetar i pashoq, kryetar i një idealizimi të vendit dhe heroizmave të Skënderbeut, të vëna në funksion të vetëdijësimit të shqiptarisë. Sipas referimeve të dr. Sali Bashotës, Çabej e konsideronte Naimin, para se gjithash, edukator (1945). Bageri e sheh edhe si flakandezës:

*“Se me t’vertet Ti e ke ndezë” (8)*

Qiriri i Naimit nuk u shua kurrë. Kaloi dorë më dorë, duke kërkuar njëri-tjetrin dhe duke u plotësuar Majës së lartë që i thonë shtet.

8

Gjaku nuk bëhet ujë, thotë populli. Të besohet se as gjaku ynë nuk do të jetë i pijshëm për gëlltitësit e hapësirës sonë.



## ANTIKITETI NË MODERNITET

### 1

Kurrë nuk më ka shkuar mendja se do të sajtoj Antologji të krijueseve shqiptare. Shkak u bë një nënë e re dhe e pashme ndanë udhe, në të dalë të Bllacës biblike. Me trupin gjysmë të ndeshur dhe të zbatshur, e kishte mbuluar foshnjën dhe ja ofronte gjirin te goja. Më vonë ia kishte plasur kujës, tërë duke u dridhur bënte çmos t'ia vërë gjirin, por ai nuk jepte kurrfarë shenje se është gjallë. Diç të tillë nuk kisha mundur të paramendoja: zonjë, e shikoni? Fëmija juaj është shndërruar në engjull. Vinë tani të Zotit dhe kujdesen për të. Prapë kishte tentuar me gji, pastaj e kishte shkundur fëmijën dhe në turmë ishte humbur. Nuk e di jeton më ajo, por imazhi i saj hyri në një poezi timen si dramë tronditëse e femrës sonë në vitin biblik shqiptar (1999)...

### 2

“Take të larta” është borxhi ynë ndaj qenies e shpirtit të begatshëm të femrës sonë. Në periferi të gjërave, u soll kjo fatkeqësisht. Meshkujt diktuan diktaturën e tyre më të çuditshme dhe rrallë e konsideruan si pjesëmarrëse të fatit kombëtar: e konsideruan femër, që duhet kujdesur për familje, lëre të merrej me diçka të vlefshme, art...

Krijimtarinë e femrave shqiptare nuk mund ta konsiderojmë befasi. Është një realitet i pathënë me kohë, një akumulim shekullor i traumave, i ëndrrave, i shpresave që shpërthejnë me spektrin e ngjyrave të papara. V. Woolf do të thoshte: “i ka munguar liria... e pafuqishme të ndikojë në çfarëdo rrjedhe të shoqërisë (Editoriali i Sfingës)”.

“Take të larta” është antologji artistike, njëherësh dhe historike, e përpiluar nga tekste të krijueseve shqiptare në shkallën kombëtare, pra kufij as kurrfarë ndasie nuk pranon; mbështet etninë dhe vlerat estetiko-letrare, që ca nga krijueset mund t’i marrim individualitete në letrat shqipe. Antologjia bart edhe një mesazh të kapshëm e më se njerëzor: një shoqëri nuk mund të jetë e emancipuar pa ngulitjen e femrës në qendër dhe lirisë së saj. Shoqëria shqiptare bëhet më e qëndrueshme po që se në të dy anët nuk do të mungojë emancipimi në shkallën kombëtare. Deklamimet banale më së pakti gjenden brenda kopertinave të kësaj antologjie; po ashtu begatia shpirtërore dhe talenti i krijueseve vë në dyshim antologji e tekste të ndryshme, lëkund gjërat e krijuara me zor e eufori nga mediokrit; kodin etik e zhvesh nga paragjykimet e mungëtirat trunore, që zvetënonin shoqërinë shqiptare, në një farë mënyre, kulturës e shoqërisë i imponon vlera, fuqi të mëdha krijuese e shpirtërore.

Lexuesi i vëmendshëm mund të vjelë edhe mesazhe të tjera, por nënteksti është ky: me ndjenjën e patriotizmit, mos manipulua si shumë dhe shumëçka u tha shkaras; për një kulturë vlere e njëmendtë duhet të jetë patriotizëm, gjërat duhet thënë bukur e me dinjitet qoftë edhe përmes një skice apo poezie erotike; se jeta njerëzore është kompleks ndjenjash e fatesh; aty asgjë nuk është tabu apo privilegj për njërën anë të duetit. Mund të elaborohen në detaje edhe gjërat më intime të qenies, se arti kërkon të pamundshmen. Dhe, vetëm në këtë mënyrë mposhtet një tradicionalizëm i rëndë, primitiv. Pjesa dërmuese e teksteve në antologji, paralajmëron hapjen totale të qenies së femrës; shpesh edhe me një cinizëm për rrethin apo tokmalët, që gjërat i shikojnë në relacion: qendër-periferi. Kështu, shoqëria shqiptare evoluon në të mirë të ideve, përmbajtjeve e ndjesisë së re. Vath Koreshi do të thoshte: qytetari evropiane, lule të shpresës mbi gjerdhet tanë të vjetër dhe të murrmë.

“Take të larta” me një orientim evropian, preket në dhe tonin. Në shumë tekste hetohet prania e nënqiellit shqiptar e ballkanik; bile aty-këtu frymon dhe tradita e shëndoshë, elaborimi i lashtësisë, mitologjisë, por me një petk bashkëkohor e thellësi meditative;

refleksesh me tekst të ngjeshur e mjeshtëror. Ajo që trimëron është se femra shqiptare nuk është vetëm shtyllë e familjes, por dhe pjesëmarrëse në rrafshin intelektual e në ndërtimin e fatlumit shqiptar.

4

Tek lija Bllacën me imazhin e antikitetit, dhimbja njerëzore e femrës sonë më kishte goditur, vështirë të lirohesha. Kur i flisja një miku për ca ide, ia kisha përmendur edhe këtë projekt. Ai më kishte shikuar: liria jote aty qëndron. Dhe, “Take të larta” gjenden të papërfunduara ndoshta. Kryesore është ndërgjegjësimi ynë se pa femrën e emancipuar nuk ka triumf. Gjatë përpilimit kisha parandjerë ardhjen e krijueseve të formateve të mëdha. Mund të venerohet kjo nga motoja:

*Jam qenie  
due gjanat  
që nuk kam*

(Ledia Dushi)

Elena Gjika dhe Nëna Tereze nuk mund të jenë rastësi të gjakut tonë.

*(Ulpianë, 15 prill 2000)*

## TRIPTIKON

### 1. Vargu në gurin e mikut

Si gjimnazistë, ishim shoqëruar e bërë shokë. Me shkrime merrej kur i tekej. Ishte tepër inteligjent. Ai e donte Niçen. Unë adhuroja Migjenin. Më vonë, vazhduam t'i lexonim të dytë. Dhe, kurrë nuk ishim zënë. Që atëherë hetoheshin ca lëvizje të tij, që shpënin në vetmi të thellë. Dhe, nuk më kishte shkuar mendja asnjëherë se në gurin e varrit të tij do ta gjeja vargun tim me emër e mbiemër. E, ky varg më kishte qitur në bela.

Ka shtatë vjet që nuk është më ai. Herën e fundit u takuam në Panairin e Librit në Frankfurt. Më fliste me një fjalor diplomati, seç zihet rreth nesh në Parlamentin Evropian në Strasburg. Nuk kaloi shumë kohë dhe dëgjova se e kishin vrarë para një semafori në një udhëkryq në Bruksel. Por, ky nuk ke pushtet as shtet, siç thotë një poet, i bie kavallit.

Më ishin skuqur majat e veshëve nga turpi. E shkruaj këtë tekst me një vonesë prej shtatë vjetësh. Nuk kërkoj asgjë. Dua t'i shpreh admirimin mikut edhe për atë copë fëmijërie, që na mbeti rrugëve të Dukagjinit.

Nuk kisha qenë më parë në Bruksel. As nuk mund të shtyhesha me patriotë të zellshëm. Atje më çoi poezia ime. Mes dy mbrëmjeve letrare, pyeta se ku e kanë varrosur. Një i tij, që më shoqëronte, të nesërmen më shpuri aty, nga nuk mund të vinte miku i fëmijërisë në mbrëmjen time.

Pas një copë udhe, u gjeta para gurit të tij të akullt, ku fillonte jeta e dytë e Enver Hadrit. Amshueshmëria. Befas më ishin ngulur sytë tek shënimi në gur: “Kosova është gjaku im që nuk falet”.

Ishte xhiruar dhe një dokumentar, e kushedi sa plakata bërë. Gati në të gjitha rastet qëndronte shumësi i përemrit. Mungonte revolta ime personale. Prapë u solla rreth asaj ftohtësie mortore. Nuk nxora zë. Nëna më thoshte: në raste të tilla nuk flitet për të vdekurin, as për varrin. E lashë mikun aty në veri, nën kujdesin e engjëllit të akullt. Ndërsa një re u zbraz mbi shkronjat e emrit dhe vargut tim në gur. Zgjata shuplakat. Mblodha pakëz ujë për sytë e mi.

(1997)

## 2) Pavdekësia e solli mes nesh

1

Për të rënë flasim tani si për heronjtë mitologjikë. Koha e tyre i ka të gjitha moshat. Guri i padrejtësive midis hapësirës shqiptare ishte ballafaqimi me tragjikën. Ndër të parët atë e shkulën Agim Ramadani me shokët. I kishte tmerruar ajo hije e rëndë. Ngjashëm e kishte fatin me muret e Kavafisit, që i shihte si fatkeqësi njerëzore. Pra, kufizim i lirisë ose copëtimi i saj, njeriun e vë në rebelim.

Pa marrë parasysh se cilës parti a grupacioni i takonin të rënë për çështje kombëtare, pranë e pranë e kanë vendin në altarin e kombit. Ndryshe të vepron, luajmë me fatin tonë, fyejmë rezistencën shekullore e gjithëkombëtare. Brehti do të thoshte: “punojmë për çështje të huaj”.

3

Në librin e poezive “Një jetë tjetër”, botuar nga shtëpia botuese “Rilindja” (2000), Agim Ramadanin e shohim në një fushë tjetër të mejdanit, që nuk është hiç më e lehtë se e para. Poeti zjarrin e brendshëm e shndërroi në fjalë, në mesazh; na ofroi një jetë vërtet njerëzore, pa kufizim lirie.

Librat e këtyllë kanë dhe një rëndësi të posaçme në momentin e pikërishtëm, dëshmojnë se në radhët e UÇK-ës kishte njerëz të mençur, nuk ishin të tillë apo të atillë, siç propagandohet për fuqinë tonë gjithëpopullore.

4

Agimi tani i takon pavdekësisë. Ne merremi me mjeshtërinë fjalës së tij, që arriti deri te ne. Dhe, ky libër poezish, jo vargje, bashkë me të tjerët që do na vijnë, paralajmërojnë shkrimin e historisë sonë më të re. Se, historinë e shkruajnë fituesit, ka thënë një shkrimtar i huaj. Njëri nga ata është dhe Agim Ramadani. Pavdekësia e ktheu mes nesh prapë...

*(Ulpianë, 11 prill 2000)*

### 3) Libër i nënteksteve domethënëse

Nuk është e njëjtë të shikosh si të vësh diçka në veprim kur fjalëve u vjen era gjak, dhembje, vdekje; kur nga ato bën çmos të ngrit kallëzimin mbi fatin e një populli, që përjetoi më të pabesueshmen të ekzistojë në një pëllëmbë toke të veten. Diku në libër Naim Maloku thotë se UÇK-ja dy mijë vjet kishte fjetur në zemër të popullit të Kosovës. Kishte pritur pra ditën e vet të ngadhënjimit mbi të keqen. Do të thotë ndjenja për liri e atdhe ka një histori të çuditshme. Marshi i kësaj fuqie gjithëpopullore nuk bën të na çudisë kur u shndërrua në ortek kombëtar-njerëzor. Të dhembshme janë varret e shumta dhe rrënimet, por liria i ka nishanat e vet.

Naim Maloku, që konsiderohet i moderuar dhe pragmatist në këtë forcë ("New York Times") me gjasë qysh se kur mësoi për popullin e tij i parashtrou vetes: çka më tutje? Mund të ishte fillimi i një të bëme historike, ku Naimi ishte dhe numër në atë marshim historik përmasash të paparamenduara nga mendja njerëzore. Por historia dëshmon: të keqen e mundin të vendosurit, ballafaqimin me vdekjen e

kuptojnë amshueshmëri. Në njëfarë mënyre lufta është zanat. Atë nuk mund e bën gjithkush e si duhet. Lexuesit të bëmat e atyre, që i dolën në krye kësaj katrohure njerëzore, i lexojnë tani si guxim, urti, bile dhe si vaj burri. Dhe, kallëzimet e tyre kur i dëgjojmë, në të vërtetë, ne shfletojmë faqet e ardhshme të historisë sonë; përpiqemi t'i gjejmë dhe pikat bashkuese më të hershmit. Rilindësit thonin: dielli ynë lind në Perëndim. Ky mesazh përcillet edhe në kallëzimin e Naimit, pra nuk shkëputet nga ëndrra e njerëzve tanë të devotshëm. E përkrah këtë me një qasje të moderuar dhe dinjitoze të problemeve, e sheh se fati ynë qëndron dhe në rreshtimin tonë në zgjedhjet globale, siç ka zënë të flitet kohëve të fundit.

Ky libër nuk shquhet vetëm për fakte e dëshmi shpesh me plot tensione dramatike; ka dhe dinjitet, krenari njerëzore dhe dhembje. Është libër që edukon dhe të bën më të fortë para rreziqeve të ndryshme; është libër udhërrëfyes si ecet e nga duhet shkuar. Realiteti ynë i ngjan një përralle të pabesueshme dhe pyetja: a është e mundur?

*(Ulpianë, 27.4.2000)*

## KADARE: PAKËZ LETËRSI KOSOVE (!)

### Për ose kundër

Debatimi rreth çështjeve, që mund të konsiderohen të hapura, shpiejnë te konstruktimi i të vërtetës, jo të shembjeve të vlerave dhe idhujve. Nëse shpreh mendimin për diçka që më duket se nuk është e arsyeshme, më së paku e fyej Kadarenë. Vepra e tij është e bollëkshme, e larmishme, e gjithanshme, që mundëson dhe dialogun. Të mos ishte e tillë, ky shkrimtar nuk do të ishte çfarë na është. Viteve të fundit interesimi i tij për Kosovën e fatin e saj është i gjithanshëm dhe nuk mohohet kontributi i tij. Është e natyrshme të ketë ndonjë paqartësi e moskuptim, që nxisin të mendosh: ku qëndron e vërteta dhe pse tërë ky mlllef?

Në shkrimin “Letërsia e dokrrave avangardiste”, parathënie e romanit “Nata e Kosovës” të autorit Rexhep Hoti, botuar në të përditshmen e Prishtinës “Zëri” (15 prill), bëri shkas si ca vepra më parë, shkrimtari ynë ngrit çështje jo vetëm letrare-intelektuale në një kohë të rëndë. Dhe jo vetëm ky shkrim na vë para aktit për ose kundër asaj që e shtron: konkretisht për letërsinë e krijuesit e këtij krahu të letrave shqipe. Shtresimet e teksteve të tilla paralajmërojnë rrënim, asgjë thuaja nuk paska këndeje murit. Kadareja mendon se krijuesit kosovarë nuk ishin të angazhuar aq rreth çështjes së Kosovës dhe vrapuakan pas “dokrrave avangardiste”, të jenë “më modernë se shkrimtarët e Parisit apo New-Yorkut” dhe gjithnjë sipas shkrimtarit të nderuar “e ndanë përfundimisht letërsinë e tyre nga populli i vet”, bile ia kthyen shpinën edhe letërsisë amë (!) dhe ç’është më e rëndë “populli i Kosovës mbeti pothuajse i pambrojtur nga kultura e vet”. Fundifundit asgjë nuk u bë në Kosovë rreth mbrojtjes së çështjes kombëtare. Nga një lexim i vëmendshëm interpretimi del ndryshe: për fatin e Kosovës nuk mbahet mend në historinë shqiptare të kenë



vdekur e shkruar kaq shumë. Unë kam frikë se pak gjëra do të mbesin nga një inflacion shkrimesh, ku euforia shpesh ngulfati arsyen. Mllef i Kadaresë nuk është vështirë të kapet as shkaku t'i gjendet. E, këto persiatje e akuza për letërsinë dhe krijuesit kosovarë fatkeqësisht bien ndesh me akuzat e përsiatjet e mëparshme.

Në librin “Bisedat në Paris” (1997), që ka për autore malazezen Branka Bogavac, e të botuar edhe në gjuhën serbe, zoti Kadare ua sheh për të madhe krijuesve kosovarë se na qenkan të ngarkuar me nacionalizëm dhe për këtë na paska tërhequr vërejtjen disa herë (!) Nëse krijuesit kosovarë na qenkan të tillë dhe paskan mbështetur ndjenjën nacionale shkaku i mbiekzistencës (për këtë ndryshe mendoj) si ndodhi pas një viti të heshtë guximi i tyre krijues e njerëzor për fatin e popullit e të Kosovës? Çështja kombëtare është preokupim i përhershëm në Kosovë, bile dhe “imituesit” e metropoleve merren me këtë çështje të shenjtë; e trashëguan nga rilindësit dhe e fisnikëruan se copëtimi i gjërave tmerron. Mbet e shenjtë dhe NJË. Kosovën nuk e panë çështje fisnore, bajraktareske; as fatkeqësinë e saj nuk e shfrytëzuan për vetëreklamim.

## Hipokrizia e metropoleve

Marramendthin e masmediave dhe autorëve të huaj gjatë vitit bibliik shqiptar (1999) nuk i shoh me zerzele si zotëri Kadare. Ato lexohen më parë si hipokrizi. Shumë tekste, libra e fotografi për dhunën serbe në trojet shqiptare i kanë ditur dhe i kanë nëpër raftet e tyre, por pritonin të zbritnin në biblioteka, t'i shfletonin e t'i shikonin fotografitë trishtuese që me vite qarkullojnë nëpër metropolet e Evropës. Pjesën dërmuese të elaborateve e memorandumëve serbe, po ashtu i kishin Tirana dhe Evropa. Mirëpo, zotërinjtë nuk u besonin fjalëve, librave e syrit tonë. Thonin se i tmerronin ato fjalë e fotografi dhe i linin pa gjumë. Diçka e tillë nuk ndodh në Ballkan. Fisin serb e konsideronin dinjitoz e civilizues. Nuk mund e merrnin me mend se te këta mesjetarë krimi ishte shndërruar në art nacional. Dhe, kur ndodhi katastrofa njerëzore, e paparë në kohën e modernitetit, ndodhi

disi edhe këndellja intelektuale e metropoleve shkaku i ndërjegjes dhe i frikës se mos ballkanizohej edhe Evropa. Zotëri Kadare e di këtë se as reagimet e tij të shpeshta e revoltuese ndaj mendjes së fjetur të metropoleve nuk e kanë shkëlqimin e romaneve “Kronikë në gur”, “Prilli i thyer” dhe “Viti i mbrapshtë”. Nuk është fjala vetëm e potencës krijuese, do të thoshte një kritik.

Brenda një shtettrrethimi të paparë, mund të bënin diçka më shumë krijuesit kosovarë se të vdisnin? Dhe, nëse këta nuk e alarmuan botën si duhet, pse këtë nuk e bëri një armatë krijuesish në Shqipëri dhe diasporë? Çështja e Kosovës nuk është vetëm çështje e krijesve kosovarë, është çështje e pazgjidhur e kombit, para së gjithash. Interesimi e marramendthet e të huajve për fatin shqiptar është i vonuar, çështja jonë nuk di sa u intereson. Fajtor për këtë jemi edhe ne. U morëm më shumë me vetveten, me etiketime gjithëfarëshe, me zhvlerësime dhe me reklamimin vetjak.

### Teksti i mirëfilltë nuk është vetëkënaqësi

Shkrimi për “dokrrat avangardiste” është mlllef i shkrimtarit në një kohë të ligë dhe grindje me vetveten ndoshta. Unë nuk jam aq i guximshëm të nëpërkëmbë e fyej gjysmën e kulturës kombëtare, t’i akuzoj krijuesit pse bëjnë përpjekje tekstet e përmbajtjet e tyre t’i ngrisin në një shkallë më të lartë letrare, as nuk mund t’i vë në klishe të imituesve nëse ata shkrimin e tekstit e kuptojnë punë filigrani, kulturë; po ashtu nuk mund të pranohet se këta “imitues” na qenkan të shkëputur nga letërsia amë, refuzimi i të vjetrës është pasurim i një kulture. Pra, nuk është braktisje e kombëtares një shkrim i mirëfilltë letrar e më së paku vetëkënaqësi, por mjeshtëri bezdisëse: të thuhet përmbajtje e bukur. Dhe, ku të kishim fanatikë të tillë më shumë, nuk do të na konsideronin rastësi. Të menduarit ideologjik dhe yrneku i demoduar na sollën shpesh buzë humnerës. Të mbështesim logjikën se shqiptare është vetëm ajo që frymon e krijohet brenda nesh, më bëhet se nuk avancojmë asgjë tonën dhe nuk na kurset se ç’të re ka tej murit. Pakëz banale, me modën ndryshe veprojme, na gëzojnë kur

rrobat e Nju-Jorkut a Parisit u rrinë bukur të rinjve tanë dhe nuk mallëngjehemi aspak për tonat, që i shohim ndoshta vetëm nëpër arka të vjetra e muzeume.

Transparenca e tekstit të lartpërmendur është evidente. Kuptohet për kë është fjala. Por pse? Unë, megjithatë, mbështes shkrimin e tekstit të mirëfilltë. Angazhimi intelektual-krijues mund të jetë shumë më i theksuar aty se tek disa shkarravitës, që patriotizmin e kanë mall tregu të përcjellur me një retorikë bezdisëse. Nga më fanatikët e një shkrimi filigran mbetet shkrimtari i ndjerë Anton Pashku. Opusi i tij letrar shpesh u shikua me një sy tjetër shkaku i tekstit se nuk mund ia gjenin kuptimet; cave u mungonte dhe përgatitja e kuraja qytetare. Një fat të tillë kishte pasur dikur edhe Lasgushi, mjeshtëria e tekstit dhe farfuritjet e tij shpirtërore i kishin tmerruar vargnuesti, vrapimi për një shqipe të pastër e konstrukt të ri. Fatkeqësisht, me ndërrimin e sistemeve manipulohet me ndjenjën e patriotizmit, shitet gati çdo gjë në petkun e tij të purpurtë. Patriotizmi i respektuar i një kulture e populli mbetet vlera, qoftë ajo dhe një pikë në kujtesën njerëzore. Në veprat e krijuesve të këtij krahu parandjenja e tragjedisë së Kosovës është një imazh trishtues, të themi fat. Anton Pashku kishte paralajmëruar derdhjen kombëtare deri te një kasaphane (romani “Oh” dhe tregimi “Kulla”) dhe kishte gjetur mënyrën ta thotë, mbështetur në letërsinë amë e sidomos te autorët e Veriut, konkretisht te Koliqi. Letërsia mbetet enigmë, vështirë të kuptohet, i tmerron posaçërisht ata që nuk janë mësuar të fusin rruaza në pe.

### Krijuesit kosovarë nuk e zbuluan vonë vendin e vet

Mirëpo, Pashku nuk është i vetëm. E zë ngoje me këtë rast edhe një krijues, ta quajmë të skajshëm, Eqrem Bashën. Vitin e kaluar botuesi francez i Kadaresë “Fayar” botoi tregimet e tij. Kritika franceze nuk kaloi në heshtje si me ca vepra, e cilësoi botim të suksesshëm. Dhe këtë nuk e bëri shkaku i mesazheve. “Thikat” e Neshat Tozajt, bie fjala, e ca të tjera nuk i shpëtojnë as shkrimet e

Kadaresë kur atyre u mungojnë dhe mjeshtëria e niveli i tekstit. Me botime të tilla mund të manipulohet vetëm letërsia shqipe e të dy krahëve. Për mua është e qartë dhe në këtë kohë krize, bile morali, sporti popullore më së paku është atraktiv. Shkrimi i lartpërmendur na bën të dyshojmë edhe në mendimin tonë kritik fort të çmuar mes nesh. Gjithë ato libra kritikash, të holla e të trasha, qenkan shkruar kot mbasi munguakan vlerat. Na del problem edhe me ata që i peshojnë gjërat. Si të shkruhet për diçka që nuk ekziston? Duke përcjellë veprimtarinë e Kadaresë, që është edhe fati ynë, besoj se kur të ketë kohë, këndeje e andej murit, do t'i lexojë letrat shqipe dhe të mendojë ndryshe jo vetëm për krijuesit kosovarë e veprat e tyre – se paskan merituar një respekt tjetër.

Posaçërisht më gëzon përkrahja e Kadaresë, që i bën një të riu kosovar. Disi m'i kujton kohët kur botoja librat e autorëve, që gjendeshin në burg ende (Adem Gashi, Mustafë Xhemajli), të atyre që plotësonin radhët e UÇK-së (Hajdin Abazi, Bedri Zymberi, Metush Zenuni) apo kur vumë në bixhoz gjithçka me botimin e “Nënë Shqipëri” të D. Agollit (“Të pagjumët”, 1982). Mirëpo, shkrimtari ynë nuk na tha asgjë për romanin “Nata e Kosovës”, pos për zymtësinë e imazheve që vetëitjënë kaherë nëpër tekste e libra të pjesës më të madhe të krijuesve kosovarë.

Shkaku i respektit për Kadarenë e shkrova tekstin. Shkrime të tilla, njëri nga ta dhe ky që e lexuam në “Zëri”, nuk i bëjnë nder, mund t'i duartrokasin mediokrit dhe ndonjë halabak që letërsinë kombëtare e sheh sa oborri i vet, ose nga Durrësi e në Tiranë. Etnia është pakëz më e madhe. Fat është, po ashtu, se krijuesit kosovarë nuk e zbuluan vendin e vet në mbarim të mileniumit të dytë kur ndërgjegjija njerëzore u lodh nga thashethënat dhe bën luftë për dinjitet krijues.

## E SHTUNË PAS NJË TË PREMTEJE

1.

Përzgjedhja nga opusi letrar i akëcilit krijues është krijim i një vepre të re të mbështetur në konceptet e përpiluesit e që është dhe lexim i tij. Ky bart dhe përgjegjësinë. Kam menduar gjatë si ta kap e si ta mbyll një udhëtim imagjnativ me poezinë e Azem Shkrelit. Çfarë të mbështesë në universin e tij dhe ku fshihet qenësorja, që e bën të veçantë këtë poet në letrat shqipe. Përballeshja dhe me mikun, që dëshiroja ta shoh në dritë tjetër. Frikësoja se mos e lëndoja diçka në strukturë apo mos lëja jashtë kopertinave ndonjë poezi të përzemërt për të. Me njërezit që nuk janë më, kujdesi duhet të jetë maksimal. Megjithatë, bota shpirtërore e artistike e tij mundëson të nisësh nga disa rrafshje. Te unë gjithmonë ka zgjuar kërkimin shkëmbor i poezisë meditative i Shkrelit, ku ngrit filozofinë jetësore mbi kodin e fortë etik të njerëzve pakfjalë e që e voli nga një ambient i akullt e gati hyjnor. Pos qiellit, shkëmbit, zogut a vije uji pak gjë tjetër mund të kapë syri, ma kishte bërë me dije kur fliste për Rugovën e imazhet e saj.

2.

Se ç'kërkoi nga fjala, arti e jeta ky poet, dëshmon mu shkrimi i poezisë meditative-shtresore, asociative e me ekuivoke. Kur i bie në fund, e sheh se diçka të ka mbetur pa e shpaluar: prapë gjendesh mes reales e fantastikes, ku humb pas ndonjë ideje e mesazhi dhe të bëhet se dëgjon diku në brendi zërin e poetit, i cili dallon edhe për një nuancë e refleks nga krijuesit e tjerë. Azem Shkreli njihet si fanatik i vargut, i latimit të tij, i ritmit, i muzikalitetit tekstor, i ironisë që shpesh na shfaqet në sarkazmë. Me pak mundohej të thotë shumë. Kjo është veti e krijuesve të mëdhenj, të cilët dinë pse shkruhet dhe artin e kuptojnë punë mjeshtërore. Nuk mund të pajtohet se teksti është kryer nëse fjalës e figurës nuk ia ka gjetur vendin e vet. Nga fanatikë të

tillë lind dhe madhështorja, që vazhdimisht i kthehesh. Duke pasur parasysh jo vetëm imazhet e narracionin e heshtur rrëmbyes, idetë dhe temat që shtron, ky poet i afrohet më shumë botës mitike e që e mbështet këtë shkaku i dëshmisë për lashtësinë e një kulture e populli.

Edhe më parë janë marrë me përzgjedhje të poezisë së Azem Shkrelit. Që në vitin 1984 njëri nga sajuesit pati thënë se ky është njëri ndër poetët më të shquar të Kosovës. Mendoj se i ka hyrë në hak. Azem Shkreli është ndër poetët më të shquar në letrat shqipe. Verbi i tij nuk mund të vlerësohet përmes librave të parë, ku dominonin motivet rurale. Me një kujdes më të rreptë mund të kapej edhe atëherë pak më ndryshe bota e këtij poeti. Këtë e dëshmon një sajues tjetër, i cili më herët ishte marrë me përzgjedhjet e Shkrelit e që lexuesin do e shpjerë në botën e refleksive, tërmeteve, duke vënë në spikamë artikullimin e tensionet emocionale, të themi. Kritiku Ali Aliu iu kishte qasur botës imagjinative të poetit në kërkim të vlerës së njëmendtë. Ndërsa, Kadarenë, si duket, e kishin mahnitur më shumë motivet nga Rugova, pra poezia peizazhiste që pak shkëlqen në ligjërimin e vërtetë shkrelian. Mendohet se këtë duhet kërkuar në leximin e shtresimeve, e fjalëve, e shushurimave të tingujve, e kompozitave, në përsëritjen e tingujve shkaku i atmosferës dhe imazheve. Interpretimi mund të ishte avanturë e këndshme aq sa e rrezikshme, mund të pësonte dhe poeti. Por gjërat zbulohen edhe përmes një figure, që për dikë është e parëndësishme. Nuk mbaj mend një bisedë të Azem Shkrelit të mos e ketë zhvilluar përmes një gjuhe figurative e pakkush ta ketë kuptuar.

### 3.

“Zjarri i fjetur” u sajua kryesisht: “Nga bibla e heshtjes”, “Kënga e hutinit”, “Nata e papagajve”, “Lirikë me shi” dhe “Zogj e gurë”. I fundit u botua pas ikjes së tij e ku mbyllet udhëtimi imagjinitiv e jetësor i poetit me një vaj burri: *Sonte / Qava sonte për ty / Arbëri... / Më vjen turp se s'munda / të bëj tjetër/ Nga turpi qava... I zhgënjyer nga situatat traumatike e të papritura që u ndesh populli ynë (1997), poetin do e tmerrojnë vetëbesimi që e kishte krijuar për njëfarë force të pamposhtur. Në poezinë *Pas heshtjes, do të këltbasë. S'i besoj më /**

as këshqjellës sate prej guri... E këshqjellën e kombit e shihte mbi çdo gjë, pastaj gurin, që i bëhej se ia dinte të gjitha fshehtësitë nga koha ilire e këndeje. Ndodhka pra të të tradhtojë edhe besimi mbi qëndrueshmërinë e, sidomos, kur nuk mund ta frenosh tatëpjetës qerren e kombit. Vaji i burrit në “*Kënga e turpshmë*” do na e shpalosë poetin edhe nga brenda. Vandalizmin, asgjësimin e vetvetes, nuk mund e pranonte. E kisha dëgjuar disa herë poezinë e lartpërmendur si ma thoshte, pastaj atë pyetjen: mos na mallkoi kush? Si një retorikë humbësi e lexoja ligjërimin e tij plot drithmë.

#### 4.

Azem Shkreli ishte një kërkues i rrallë i fjalëve, i strukturave, i formave. Pikënisje të ideve kishte ndonjë imazh a lëvizje shenjë të lartësive të Rugovës nga e kishim parë edhe Rrafshin e Kosovës si në shuplakë dore. Ndjenjë të tillë kisha edhe në Majë të Tomorrit. Më ishte bërë se tërë Shqipëria lëvizte e frymonte në shuplakën time të hapur. Nga kepat e Hajlës kishim veneruar zgjimin e gjymtyrëve të antikës sonë. Aty e kisha kuptuar edhe tragjikën e fluturimit të zogut të lartësive e që diku mbi grykën e pafund e të frikshme ishte përgjakur për ndonjë re, pastaj kisha kujtuar nekrologun e poetit për zogun. Më bëhej se njolla e gjakut ma kishte kuptimin mjaft domethënëse të lirisë e të ëndrrës, që e kishte projektuar. Nuk më habit as shqetësimi i tij, që është dhe nacional: *Ku janë njerëzit? Nga janë nisur bimët?* - (Kafshë e zezë) e që përfundimisht Azem Shkrelin e shohim në anën e të revoltuarëve, që e duan një atdhe më të atdheshëm e njerëzor. Dhe në këto përplasje grykës së eksodeve dherave të huaja, përballesh me shpërthime të brendshme të poetit, pajtohesh me revoltën e tij: *Luftrat dhe fitoret kanë uri për famë dhe koka njeriu...* (Varri i trimit të panjohur). U varka fati i një populli nga “zotrat” që, fatkeqësisht, zgjedhja e tyre na qe e gabueshme shpesh, se përgjakja mbi grykën e eksodet vështirë të pranohen. Asgjësim dhe humbja e të shenjtës nuk ka asgjë me kodin e moralit të njerëzve të akulltë e pakfjalë, që Azem Shkreli do i vë në poezinë e tij si njerëz të antikitetit tonë, që assesi nuk bën të harrohet.

Zhënjim tjetër i poetit është derdhja e këtij antikiteti, tentimi i tij pastaj për të krijuar bile gjeografinë e poezisë së tij, të kujtoj edhe një trohë të gjakut të tij. Beson se të mbrosh tënden, qoftë ajo dhe e humbur, mbron dhe tjetrin, të ardhmen. Në poezinë e tij ka tone elegjiake, dhembje, por nuk mund të gësh smirë apo urrejtje ndaj racës njerëzore. Në ato pyetje e përgjegjeje grith dregzën në faqet e pakryera të një historie njerëzore e cila nuk dihet si kur do të mbyllet. Para dilemave rreth ngjarjeve e figurave historike, frenon veten, se i intereson e ardhmja. Do të lëvizë ai guri në hapësirën e tij të copëtuat siç dëshiruan të tjerët dhe në atë meshapësirë sa mund të gëlojë bima e tij? Poezia e tij shtron çështje fundamentale dhe ka një taban të fortë kombëtar në ruajtjen e identitetit dhe hapësirës jetësore. Tekefundit krijuesit me çfarë të merren e çka të shkruajnë nëse poezinë nuk kanë kujt t'ia dedikojnë? Një i huaj kishte thënë se në letërsinë shqipe ka tepër zymtësi. Mos duhet të çohet dorë nga historia jonë përplot luftëra e rrënime e të shkruajmë për bodrumet e metropoleve, po me atë mund të identifkohemi? Të zezën ta quajmë të bardhë, po me kujtesën ç'të bëhet?

## 5.

Është interesant të shikohet dhe qëndrimi i poetit ndaj Evropës, e cila me kongrese e konferenca na solli shumë tragjedi. Së pari, poezitë drejtuar të mirës sonë, kanë një tekst gati të përsosur dhe një fjalor të zgjedhur. Mendonte ndaj atyre që na bënë pikepesë, duhet pasur kujdes në sjellje. Së dytë, ia qan hallet dhe me një ironi të sofistikuar tallet me guximin e saj të marrë: *Nxjerr gjymtyrë popujsh dhe harta dhe historia*, thotë poeti në “Antihimn”. Do të thotë i qet vende e popuj në tryezë, ku vepron më tepër instinkti. Dhe pyetja: *Sa luftëra, sa kusfj, sa popuj të ha mangall?* Së treti, Azem Shkreli, në qortimin e tij mbron etikën krijuese: nuk rrihet duarkryq kur të rrëzohet edhe lisi i fundit. Edhe pse i derdhur, nuk mohon begatinë as të mirat e saj, e cila mund të bëjë edhe gjëra më të turpshme rreth çështjes shqiptare. Së katërti, Azem Shkrelin e tmerron krijimi i hartave në dëm të shqiptarëve. Në një shkrim diskurziv këtë sëmundje ballkanase e quan kromë hartash. Në përfitimin e fqinjëve e shihte paaftësinë e



shqiptarëve në tokën e të cilëve rrëshqiti thika e hasmit e nuk mund i bashkoi kundër shpërbërjes; pra nuk i dolën zot as mund e krijuan një mik të besës. Kjo është ajo fatkeqësia jonë kombëtare. Nuk mund e quajmë tragjike vetëm kohën e diktaturës. *Pamë e ç'pamë*, thotë poeti. E keqja nuk na u nda gjatë historisë sonë mijëvjeçare. Mu për këtë dhe krijuesit vështirë të shkëputen nga ana e errët e saj. Së pesti, me qëndrimin e tij u bëhet krah rilindësve. I drejtohet kësaj të gëzuarë: *Zonja Evropë, e rënda. Dhe Zonja Evropë, e mira* (Antihimni). Si duket, ia lë ndërgjegjes bile edhe mashtrimet e mëdha të kohës së “hasretit” Leninit, kur kasta politike shqiptare, në të dy anët e murit, rrënonte majat e kulturës dhe të Kombit në emër të njëfarë ideologjie, që asgjë nuk kishte me synimet kombëtare.

## 6.

Poezia e Azem Shkrelit është artikulum modern nga e cila mësohet e vështirë të emitohet. Pa figurat: guri, zogu, fjala, bima nuk di si do të dukej teksti i tij. Këto janë fuqia magjike, që vijnë në lëvizje një botë të tërë. Zëra lashtësie i këndeje të dëgjonte në pyllin e madh njerëzor dhe të zgjedhë atë që i duhet. *Guri* simbolizon qëndrueshmërinë. Në tekstin e tij ky na shfaqet edhe si një masiv, (shkëmb) e ku mbështet durimin shekullor. Por ajo që e fascinon poetin është *zogu*, fluturimi i tij mbi grykën e pafund e të frikshme, që shpesh ma kujton Tunelin e Sabatos. Pra, rreth tij krijon dhe mendimin për lirinë. E tmerrojnë ndërrimi i pendlave të tij, prandaj nekrologu për të ndodh të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Pas bredhjeve e shestimeve bindet se madhështia e jetës fshihet në *fjalë*, e cila ushqen dhe bimën në gur. Do e përjetojë dhe ngrysjen, shëtitë natën në një hapësirë të padefinuar. Në atë meskohë, të një meshapësire shkallëzon tragjika. E kishte parandjerë edhe ikjen: *Mund të jetë e shtunë pas një të premtjeje* (Katër e njëzetepesë). Le përshtypjen se ai ishte i bindur, çdo gjë e tij lëviz mes së martës e të premtës. Mbyllja e harkut kohor do të ndodhë të shtunën.

Është theksuar nga kritika se kredo jetësore e Azem Shkrelit është poezia *Katër këshilla vetes*, e shkruar në fillim të viteve '70. Kishin

veçuar vargjet: *Mos u bë poet nëse s'mund të vdesësh / për secilin varg, të vdesësh për secilën fjalë...* Mirëpo me madhësinë e poetit ndeshemi edhe në poezi të tjera, ku hulumton genin e bimës së vet; t'i tund kambanat e fatumit njerëzor; të prish atë meskohë të meshapësirës së tij, që pikon dhembje e nuk e lë ta shohë veten në tërësi; as nuk dihet kur do të fshihet nga kujtesa e kombit.

E shtunë pas një të premteje do të paralajmërojë poeti fundin e një jete, e cila vazhdon të rrapëllojë në bibliotekat tona; se është një zjarr i fjetur, që nuk e mbulon dot hiri i fjalëve. Mund ta dëgjoni edhe në këtë përzgjedhje nëse kuptoni lojën e fjalëve...

*(Ulpianë, mars 2001)*

## MUNGESA E NDERIT

Kohëve të fundit botohen aq shumë sa është vështirë leximi i një udhëtimi njerëzor, se ka edhe mjegulla. Nganjëherë mjafton të lexohen vetëm titujt e teksteve e të vendosësh çka të kërkosh. Më 25 maj më gëzoi intervista me krijuesin Sulejman Krasniqi, që e botoi e përditshmja “Rilindja”, në faqe 6. I kisha lexuar veprat e tij dhe doja të di ç’tre na thoshte për të kaluarën dhe të ardhmen tonë. I rashë intervistës në fund dhe aty diku, në mbarim, hasa emrin e një miku tim në një dritë krejt tjetër, që nuk isha mësuar ta shoh unë as miqtë e tij. I lexova prapë ata dy-tre rreshta dhe më erdh keq për atë që thuhej. E dija se Anton Pashku nuk është marrë kurrë me atë sport e më së pakti të ndajë kombin në toskë e gegë...

Sipas zotit Sulejman Krasniqi, Anton Pashku pasi e paska lexuar romanin “Qielli i përflakur”, na i paska çuar fjalë kushedi për kë dhe kur, dhe na i paska thënë: “Pse i ke prurë gjithë ata toksë në Prizren?... Mirë që i solle në Prizren, po pse e çove Abdyl Frashërin edhe në Drenicë?!” Në konfuzitetin e këtij mendimi nuk dua të hyj se nuk ishte karakteristik për Pashkun, por më dhemb një gjë: ku u gjet Antonin në një kontekst tepër të ndjeshëm për çështjen kombëtare? Sa di unë dhe miqtë e tij, që një gjysmë shekulli kemi kaluar bashkë, Pashkun kurrë nuk e ka mundur çështja toskë e gegë dhe kurrë nuk ka dëshiruar t’i shohë pikepesë. Edhe pse ishte mbyllur në vete e me një tekst unikat në letrat shqipe, ai mbështeste unitetin gjithëkombëtar në mënyrën e tij, bile edhe ishte i skajshëm; bënte përzgjedhje dhe nuk lexonte gjithçka. Zatën, krijuesit e njëmendtë në Kosovë kurrë nuk e kanë shikuar çështjen kombëtare në toskë, gegë apo bajraqe, por si një trup të pandarë dhe kanë gëzuar respekt të të gjithëve në Kosovë, pa marrë parasysh, ishin nga jugu apo veriu. Këtë e dëshmon dhe lufta jonë e fundit, ku në Drenicë vdiqën me armë në dorë edhe djem e vasha nga Toskëria. Zotin Sulejman e njoh edhe nga udhëtimet, e kam

takuar në Cyrih, ku kemi biseduar aty dhe për disa toskë (Agollin, Kadarenë, Arapin, Spahiun) që na janë miq të përbashkët, por kjo që lexova në intervistën e tij për Anton Pashkun, më shtyri të shkruaj këtë tekst, mbasi shkrimtari i nderuar nuk gjendet moti në mesin tonë. Fjalja kinse na i paska thënë: “... Mirë që i solle në Prizren, por pse e çove Abdyl Frashërin edhe në Drenicë?!” është rrënuese dhe nuk mund të mbështetet në kohën kur bëjmë çmos për unitetin gjithëkombëtar. Pashku e ka pasur për zakon, ndoshta nga mosbesimi apo frika, kujt të mos i çojë fjalë as t’i pëshpërisë për diçka morbide që mund të konsiderohet.

Ndoshta njerëzit që kthehen pas një kohe të gjatë nxitojnë t’i thonë të gjitha menjëherë, është e mundur dhe t’i përziejnë gjërat. Kështu dhe zotit Sulejman iu ka përzier Pashku me ndonjë karafil. Por ne duhet të kemi kujdes e të mos prekim aty, ku të tjerët duan të na vëjnë thikën, po ashtu të mos thirremi në shkrimtarë që nuk janë gjallë apo nuk kanë lënë diçka të shkruar për problemin që e zëmë ngoje, atëherë vështirë të na besohet edhe për gjëra të tjera. Pushkini e kishte një fjalë të mirë: *mungesa e nderit është më e tmerrshme se vdekja...*

## GRAFOMANËT

### 1

Fije xheloze nuk ka ky shkrim, e bëj për shkak të ekologjisë dhe pse ndiej dhembje. Nëse xhelozoj kë, atëherë më tmerron rruga për në Majë. Shkak u bë bezdisja e grafomanëve, e shkrimtarucave, e shkrimtorëve (Barti) e shkarravitësve, që mendojnë se me lekë mund ta luajnë edhe rrotën e mullirit. Zatën, këta janë diktatorthë të mundshëm, shkaku i mungesës së vetartikulimit. Tërë energjinë e vënë në destruksion, pa marrë parasysh se përballen me vlera të njëmendta. Ata që heshtin para kësaj të keqeje, pranojnë lojën e turpfit dhe fenomeni i grafomanëve, i pranishëm dhe në mjedisin tonë, del në sipërfaqe. Erenik as Dri nuk kanë ç'të bëjnë më. Thashë se nuk dua askujt t'i dal në udhë, por vetmashtrimi mbyllet me skandal. Në kokorr nuk ngjitet me të shtyme e më së pakti me shqerrje, me përjargie, me një fjalor karakteristik që e përcakton dhe vetë mediokrini. Ka të tillë edhe në mjedise të tjera, por tanët janë të ngarkuar pakëz si tepër me vetveten. E të ishte një, do ta merreshim për model se si nuk shkruhet, por...

### 2

Vështirë ta gëlltitësh, personi që nuk di ta shkruajë një fjali, një gjysmë vargu apo një periudhë normale të çfarëdo teksti, mund të botojë libra serialë e të bombardojë e kush të mos ia tregojë vendin. Unë nuk jam që të grindemi, por të bisedojmë për ekologjinë e mjedisit tonë letrar dhe cilën udhë ta ndjekim. Nëse nuk kemi nevojë për art të vërtetë, atëherë të kënaqemi me zhurmën e mullirit. Problem i gjithë kësaj do të na dalë më vonë, kur bëhet verifikimi dhe kërkohet e vërteta. Në një farë mënyrë, grafomanët luajnë me shpirtin e mendimin e një kolektivi njerëzor.

E këtë e vëren sapo lexon një gjysmë vjershe, tregimi apo një çerek libri e të hetosh nëpër sa duar ka kaluar teksti i filan “gjeniut” dhe kjo bëhet për të fshehur paaftësinë. Kjo është temë më vete, don një elaborim të hollësishëm. Pra, kemi punë me “libra” që nuk u dihet autori i vërtetë.

Mungon i treti, ai që pranon të krijojë një krijues me shpirt e mendim të huaj, për një grusht lekësh (dardanësh), e jo të udhëzojë atë, siç bën gjithkush në botë...

### 3

Dhe, ustai mund të jetë ndonjë apartçik, që ushtron variantet e veta dhe i liferon. Shiko, thotë një i tillë, varet nga përmbajtja çdo gjë. Nëse do roman patriotik nga e kaluara ose nga lufta jonë e fundit, lëviz dhe çmimi. Heroi dhe prania në hirarkinë kombëtare bën të lëvizë edhe leku. Nuk është njësoj të shkruash si për Jasharjt dhe si për kartuçët. Nëse do një roman cullkahane, e bëjmë edhe këtë, por a ke lekë? Apo, nëse do një rebus romani, një fjalëkryq të zakonshëm, e bëjmë për pak para, se ai shkruhet e lexohet ku ta kapësh, ndaç nga fillimi, ndaç nga fundi, kryesore aty e ke edhe mesin e artë. Është të zgjedhësh, ç’do? Shkrimtari i ardhshëm kishte përcjellë me kujdes aparatçikun e vjetër, pastaj përdorimin e celularit, si korrespondonte me të tejmit dhe dikur mezi ishte dëgjuar: Usta, dua një roman të ndërmjemë, as këndeje e as andej, që bën bum në Moskë e Athinë e... kuptoni? Edhe portën e fundit të kokorrit do e hap me lekë...

Fundi ishte mbyllur me shtrëngim dore. Pas një muaji bubullimë: më në fund një gjeni. Po autori, po lekët, po telashet? Kemi të bëjmë me një prostitucion të paparë shpirtëror që, fatkeqësisht, kemi filluar të mësohemi.

### 4

Pas rënies së komunizmit, Shqipëria i ngjante një shkretëtire. Ngarendje e hatashme për të shnukur diçka nga shteti që vdiste. Momente të rënda ishin për shqiptarë, e cila dilte nga bunkerizmi

pesëdhjetëvjeçar. Dëgjohesha shpesh me miq dhe rrëfimet e tyre ishin trishtuese. Në shkretëtirë ishin shfaqur ndonjë zhapin, urith, hienë. Brenda në të shembeshin vlerat nacionale. Nga Naimi, Skënderbeu e deri te fëmija në bark të nënës etiketoheshin dhe shpalleshin mish i huaj. Ata që ishin puro shqiptar zbritnin nga planetet e tjera dhe i ngritnin tendet në shkretëtirë. Fillonte koha e kartuçave, e havllës, e supës së peshkut. Me nga një gjysmë vjershe, tregimi e me nga dyqindmijë faqe të shkruara në pushimoret e diktaturës, fillonin torturat e demokracisë. Duroheshin dhe shqerrjet, sharjet. Por kush mendonte se ajo e keqe do të kalonte dhe murin e krejt punën do ta luajë leku...

Pas vitit biblik shqiptar (1999) kthehesha me një mallëngjim se kë do e shoh, se kush mbeti gjallë, se a ishte e vërtetë gjithë ajo që kisha parë në ekran e lexuar? Dhe pëshpërimat e grafomanëve. Gjithfarë pyetjesh e zënkash në një kohë zgjimi nga varri. Njëri shkoi aq larg, ishte prekur në brez: me shokun tënd nuk më latë të bëhem shkrimtar. E shikova me dhembje. Shoku im dhe unë kishim bërë çmos nga kurrgjëja të rritnim korin; edhe një grimë vlerë ta kishte kush, e botonim, por ç'mund të bënim nga hiçkrijuesi? Pa të keq i thashë: pse nuk i boton ato vepra tani?

Shfletoj revistën tonë të moçme, nr. special (!), qershor 2000, më dhimbset botuesi dhe artikullshkruesit: po ashtu, dhe vetë objekti i trajtesave e panagjierikëve. Ç'të bësh, kohë të rënda për intelektualët. Për një grusht lekësh vënë në pyetje dinjitetin krijues e njerëzor. Të kuptohemi, nuk kam asgjë me ata që me para duan të krijojnë emër, bile ndiej dhembje për ta, se duhet analizuar e parë nga një rrafsh tjetër. Ngjitja në kokorrin letrar është e mundimshme. Tek shfletoja botime të tilla, një rebelues i mençur, kishte shpërthyer: ky është krim kulturor.

Kushedi se deri kur do të na ndjekë. Do mbyllet turpi me kaq...? Shkaku i ekologjisë e shkrova këtë. Nëse do vuaja nga farë xhelozie, atëherë do më tmerronte Gyntër Grasin, bie fjala, pse nuk mundem të shkruaja si ai: pra xhelozia e ka edhe fuqinë e shtytjes përpara. Por kjo? Çfarë interpretimi tjetër, është pjellë e të marrëve, që nuk dua të merrem. Ka punë më të mençura...

## MEDIOKRI VRASËS I MUNDSHËM

### 1

Arti ka punë me magjinë dhe me të menduarit. Ndodh të jetë variant i ideve, i motiveve, i mesazheve. Përkushtimi i njëmendtë ngreh krijues dhe në individualitete. Por ka gjëra universale, që nuk mund të vesh dorë se je i pari, që merresh me këtë apo atë çështje. Përpjekjet për origjinën e parë janë sizifiane. Bota është harxhuar shumë dhe aq shumë është eksploatuar gjuha sa njeriu dridhet kur tenton të lërë diç në fletën e bardhë.

Rreth motivit të labirintit ishte diskutuar gjatë kush kë e ka imituar: Kafka apo Borhesi. Por ndikimi për e rreth labirintit të këta dy kolosë ishte nga një i tretë, sofisti i lashtësisë greke, Zenon. Gilles Lapouge, në një tekst të tij rreth këtij problemi te shkrimtarët e nderuar, e shihte te bigëzimi dhe degëzimi i ideve.

Borhesi mbështet se: shkrimtari krijon pasardhësin e vet. Do të thotë se ne jetën e jetojmë dhe e lexojmë në variante.

### 2

Kisha dëgjuar edhe më parë për përkimet mes Lasgushit dhe Emineskut. Kanë ndonjë afri idesh, motivesh, simbolesh, formash; do fjalë karakteristike nga leksiku, por nuk mund të pranohet rrënimi i një gjeniu shqiptar shkaku i ambicieve të ca liliputanëve, që artin e jetën e kanë parë nga një dritare. Një imitues të Emineskut e shpallën për gjeni, fajtorë janë kosovarët (!). E, ç'bënim ne kosovarët, kërkonim më të çmuarën në një grumbull fjalësh, atë që peshonte dhe ia rriste famën fjalës shqipe. Dialogu pritej të mbyllej me ndonjë sharje e zgërdhirje. Kështu e ka kur jeta jetohej pa mund.

Buzë plazhit të Ilirisë më ishin shpalosur vitet e 60-ta. Në poezinë e këtij krahu hetoheshin përkimet e para me poezinë spanjolle



e sidomos me Lorkën e Maçadën. Dhe, kjo kishte ndodhur përmes një të tretit. Ndonjë poet po qe se përdorte figurën kalë, menjëherë rojtarët ta bënë me gisht, yrnec ka Lorkën. Të giorët, harronin se baladat e epika jonë gumëzhinin nga ta; ose prekja e motivit të nënës, të britnin pas, ja Jesenini. Pra, nuk e kuptonin elementaren, esencën e gjërave. Mendohet se përkimet luajnë dhe një rol të veçantë në afrimin e popujve dhe kulturave. Ca motive nga lashtësia sot e gjithë ditën trajtohen në mënyrë të vet si te shqiptarët, ashtu dhe te grekët e sllavët, edhe pse murimin në e mbështesim si tonin.

Rasti i Lasgushit me Emineskun dhe zhurma rreth përkimeve të tyre bëhet edhe për qëllime të tjera. Një krijues i formatit të Lasgushit i pengon ata që janë nën hijen e tij, ndërsa degëzimet e tij në poetikën shqiptare sa vijne e shtrihen. Shpirti krijues i Lasgushit është i një artisti, jo i ndonjë matrapazi a kalkulanti, që ngritjen e sheh në rrënimin e një vlere. Lasgushi nga fjala shqipe voli maksimumin dhe pasardhësve ua tregoi udhën se fjala është ajo që bën çudira në ngrehinën e poezisë. Nëse Eminesku paska shkruar për gjenium krijues, liqenin apo për ndonjë motiv nga lashtësia hinduse, nuk bën të shkruajnë Lasgushi e të tjerët, se mund të quhen imitues. Letërsia mbështet avancimin e ideve, të mesazheve, elaborimin e vazhdueshëm të motiveve e formave dhe mbetet ajo që është më e arritshme.

Në përkime, megjithatë, ekzistojnë nuanca të theksuara që dallojnë krijuesit. Eminesku me përkushtim rumun, por universal me art, disi kështu thotë Tudor Argjezi. Lasgushi është diç tjetër, më latues i vargut dhe më ëndërrimtar; ka një të menduar të veçantë për probleme jetësore e artin, mbetet një bashkëkohës. Pra, edhe pse përkojnë në ca poezi, janë individualitete të veçanta e të paarritshme.

Rreth origjinës së Emineskut ka supozime të ndryshme. Në fillim quhej Mihal Eminoviç. Sufiksi *viç* nuk është karakteristik për rumunët e më së paku parashtesa *emin*. Në një shkrim të vetin Mitrush Kuteli thoshte se ky më së paku është rumun edhe pse kritika rumune kishte zënë ta quante: Eminesku është Rumania. Një nder i tillë nuk mbaj mend se i është bërë dikujt. Kjo është çështje rumune. Por mbiemri i tij Eminoviç lë mundësinë t'i kërkohet origjina e vërtetë, megjithëse Kuteli e zbriste në hapësirën tonë. Ka mundësi se njerëzit

tanë mërgonin dhe shumë nga ta bënë emër në mjedisin e ri. Ndërrimin e mbiemrit e kishin bërë me një arsye: më bukur i rrinte Eminesku.

Pa marrë parasysh, është i anës sonë apo puro rumun, Eminesku nga leukonia e mediokërve përjetoi sharje të mëdha dhe gjithë kjo bëhej shkak i xhelozisë dhe famës së tij që gëzonte jo vetëm në Rumani. E, kjo përndjekje vazhdoi derisa e çmendën. Pas dy vjetësh Rumania humbi njërin nga poetët më të mëdhenj.

Dhe tek i dëgjoja shqerret rreth genialitetit të Lasgushit, buzë plazhit të Ilirisë, më kishte stërpikur një valë deti dhe gati i ngjaja Martin Idnit të Xhek Londonit. Isha zhytur thellë. Nuk doja të dëgjoja paçavura mediokrësh rreth një vlere kombëtare. Gjërat vazhdonin t'i shikonin nga dritarja e tyre tepër e ngushtë.

Mes këtyre poetëve veç diç i afron: ndërrimi i identitetit. Pse e kishin bërë këtë, ka kush të merret.

### 3

Rrënim vlerash ndodhin në çdo mjedis dhe ngaherë. Vitet e 60-ta në kulturën serbe lanë një njollë të rëndë. Poetin e estetin e njohur Branko Milkoviç, i cili kishte fituar famë me veprën e tij, kopea e mediokërve e solli para një akti të rëndë: vetëvrasja. Ishte shpërngulur nga Beogradi dhe mendonte se në mjedisin e ri do të gjente qetësi, por ndodhi më e rënda. Një mëngjes herët me një litar ia kishte mësyre parkut të madh të Zagrebit me një cigare në gojë dhe pas dy orësh e kishin gjetur të varur. Ylli i tij ndrit dhe tani, por për mediokrit nuk dëgjohet fare.

Një polemikë e rëndë kishte ndodhur mes D. Jeremiçit dhe D. Kishit rreth originalitetit të librit me tregime “Varreza e Boris Davidoviçit” (përkthyer në Prishtinë e Tiranë nga babë e bir Kelmendi). E akuzonin Kishin se në tregime kishte inkuadruar edhe ca fragmente nga një libër rus. Në të vërtetë, Kishi lexuesve u kishte shpalosur shtetin totalitar, duke mbetur autentik në historinë, që kishte ndodhur në të kaluarën. Ato ishin inserte nga një botë e vdekur, ku spikatej diktatura, dhuna, ndrydhja e njeriut, liria njerëzore. Kështu

kishte vepruar edhe Kadare para se ta shkruante romanin “Dimri i vetmisë së madhe”. I ishte dashur të lexonte gati një arkiv me dokumente dhe të gjitha procesverbalet e Konferencës së Moskës, ku ndodhi çarja e rëndë mes shtetit shqiptar dhe Bllokut Lindor. Në një vepër me motiv nga historia nuk mund të trillohen gjërat. Mediokrit këtë nuk e kanë të qartë. Titulli i këtij teksti thotë shumë dhe nuk e shoh të arsyeshme ta elaboroj edhe më.

## DINJITETI DHE SHKRIMTARI

### 1

Shkrimtari është pushtet më vete. Tekat e përsiatjet i ka institucione të brendshme e të jashtme, mbrohet e asgjëson kur kupton lojën dhe nuk mund të pajtohet me realitetin. Është ëndërrues i fuqisë, i perëndisë. Mund ta ketë parë në ëndërr, ose kur e ndëshkon injoranca. Ka të drejtë të inatoset e të shajë, shkaku i pastërtisë e ndërrimi-korrigjimit. Annë Michaels, në një roman të vetin, thotë: kurrë mos u besoni biografive. Ngjashëm mund të thuhet edhe për paqen e krijuesve të njëmendtë.

Poeti gjerman Hans Magnus Enzensberger është një brehtian që me konceptin e tij mbi poezinë dhe realitetin, rebelimin e avancon në një shkallë tepër rrënuese. Nga përballimet e tij me realitetin mësojmë se kur ka guxim krijuesi, nuk ka forcë që e mposht. Para shumë vitesh në Takimet Poetike në Strugë, para publikut vendor e të huaj, në një pyetje pakëz provokuese, me kopili ishte përgjigjur: nga Ballkani njoh vetëm Ismail Kadarenë. Me atë ditë ky poet nuk u ftua më në Strugë, edhe pse ishte fitues i Kurorës së Artë. Po kush është Enzensbergeri? Një poet që nuk përfill zakonin. Në feudin e vet, në periferi të Munihit, më bëhet, shëtit me kalë. Në veprimtarinë e vet shkoi gjithmonë kundër. Poezia e tij bart vrerin ndaj realitetit, lexohet si një sarkazmë e njeriut që kërkon rend. E shkruan “poezinë si kritikë dhe kritikën si poezi”. Mbështetur në një thënie të Ch. F. Gollerit: Zakoni zbukuron gabimin. Enzensberger kishte hetuar që në moshën e re se aty fshihej fuqia dhe shkruan poezinë “Forca e zakonit”, e cila paralajmëronte me disa poezi të tjera, se shfaqej një poet i inatosur me realitetin:

*Njerëzit e zakonshëm  
nuk i bonepsin dot njerëzit e zakonshëm.  
Dhe anasjelltas.  
Njerëzve të zakonshëm u duket e pazakonshme  
që i quajnë të pazakonshëm.  
Tani nuk qenkan më njerëz të zakonshëm.  
Dhe anasjelltas.*

*Një ndodhi e pabesueshme.  
Një punë muti e zakonshme.*

Kritika gjermane dhe shtypi i kohës nga paraqitja e tij me librin “Mbrotjtja e ujqërve” (1958) e cilësoi lart, “i vë botës së paskrupullt një botë tjetër përballë, bota për të cilën bëhet fjalë indirekt, është utopia e paragjykimit dhe e lirisë...”

## 2

Fort e kam çmuar një shkrimtar dhe kam pasur dorë në përkthimin e një libri të tij në një gjuhë botërore. Pas botimit, një shtëpi letërsie e një metropoli e fton për ca mbrëmje letrare, të krijohen kontakte mes metropolit e një letërsie që sapo shplohët. Zotëria shkel pikërisht në ditën e caktuar kur fillonte aktiviteti i tij letrar. Dhe Shtëpia e Letërsisë, ku dhe debatohet, gumëzhinte nga vizitorët e shumtë. Për organizatorin ishte kënaqësi kjo. Por, para se të fillojë takimi me shkrimtarin e nderuar nga Ballkani, ky i thotë nikoqirit se nuk do të lexojë po që se në këtë sallë ka qoftë edhe një shqiptar. I shqetësuar nga ky gjest i papritur, organizatori i drejtohet publikut që kush është shqiptar ta lëshojë sallën, kjo është kërkesa e të nderuarit nga Ballkani. Sa çel e mshel sytë salla ishte zbrazur dhe mbesin vetëm shkrimtari dhe organizatori. Pas një konsultimi bien në dakord prapë të lejohen shqiptarët, që kryesisht ishin kosovarë. Mirëpo, nuk zuri vend askush më. Shqiptarët që kishin ardhur, ishin

kthyer të zhgënjyer nga sjelljet e të respektuarit dhe të bindur se bunkerizmi kishte lënë pasoja të mëdha edhe në dinjitetin e tij. Biseda ishte mbyllur me sallën e zbrazët e karriget e çrregulluara. Tek i tregoja një miku të respektuar, ky më tha: si të mos sillet ashtu kur ia kishin hëngër shpirtin. Miku i tij, që është dhe imi, nuk bënte dallime fare mes popullit e diktatorit. E publikun e përbënin kryesisht kosovarët.

### 3

Në ditën e pranverës mbahen Takimet Poetike në Elbasan, ku shpesh jam mysafir. Udhëtova atje dhe shkaku i Nikollë Markut, prift shqiptar me themel. Të them, ndoshta, është i vetmi shqiptar që mbron Kishën Autoqefale Shqiptare, që e pavarësoi Fan Noli, por që varfëria e guximi i shtetit shqiptar u përul para marshimit të egër të kishës greke. E, këtë rrënim të poshtër e kundërshtoi vetëm Nikollë Marku, me të cilin më njohu poeti e miku, Moikom Zeqo. Dhe, sapo shkela në qytetin e mimozave e kërkova priftin tonë, i cili kishte vajtur jashtë të ngrisë zërin për Kishën tonë Autoqefale mbasi shteti shqiptar nuk çan kokën; se i puth dorën Janullatosit. Karrigexhinjtë thonë se paria politike këtë e bëjnë shkaku i gjestit politik, por kisha greke shtrihet edhe atje ku nuk mendohej.

Ditën e dytë të takimeve organizatorët na thanë se shkojmë në Manastirin e Shën Jon Vladimirit, ku do të lexojmë e hamë drekë. Rast i mirë mendoja të zbuloj edhe ndonjë Mark dhe pas një gjysmë ore me autobus u gjetëm në manastirin e rregulluar për bukuri, që dallon nga të tjerët, bile edhe nga Kisha Autoqefale Shqiptare në midis të Elbasanit të Vjetër, që sapo vjen e rrënohet.

Pasi shikuam freskat në një rrënojë, në sallën e madhe zura vend pranë Dritëro Agollit. As vetë nuk e di si m'u ngulën sytë në murin përballë, ku qëndronte portreti i Janullatosit. Këtu nuk mund të ha, as të lexoj një varg, u thashë miqve dhe braktisa Manastirin e Shën Joan Vladimirit. Nuk e bëra këtë se e urreja priftin grek, por se turpërohesha ndaj Kishës sonë.

Gazeta e shkrimtarëve dhe e artistëve të Shqipërisë “Drita”, në faqen 2, e diel, 19 mars 2000, kishte shënuar këtë gjest të pahijshëm të

një rebeli nga shteti i Kosovës: “Në mjediset e bukura të Manastirit Shën Jona Vladimirit, poeti Ali Podrimja e la edhe drekën, mbasi nuk mund të hante nën hijen e portretit të Janullatosit”. Por ç’do të vepronte një poet grek, në një manastir të Athinës apo të Larisës, në Kishën Greke, përballë tij, të qëndronte portreti i Nikollë Markut apo i Nolit?

Në mbrëmje nuk më lanë të qetë telefonatat. Më ftonin në Tiranë dhe ma thoshin arsyen: në Sheshin Skënderbe ka kohë që portreti i të gëzuarit nga Greqia qëndron dhe nuk e frikëson as trimi ynë në kalë. Nuk shkova. U lashë të merret me të shteti shqiptar e ose ndonjë guximtar, që ende bredh atypari...

Nga krijuesit, më agresivët janë ata që bien duke u ngjitur në tempull, ose që nuk i kanë krahët e vet...

## DEFEKTI NJERËZOR

### 1

Letrën lamtumirëse të lëshuar në internet, në emër të nobelistit hispanoamerikan Gabriel Garcia Marquezit nga ndonjë mazoist, e radhis në dokument makabre. Të shohësh se ku shkon hipokrizia njerëzore. Edhe në momente më kritike të individit mungon paqja shpirtërore. Falsifikimi i kësaj letre paralajmëroi fundin e autorit të romanit të famshëm “Njëqind vjet vetmi”, por Gabo nuk i përulet mjerimit njerëzor, i cili me të drejtë e përbuzi si një kicë të llojit të vet. “Në të vërtetë, ky tekst, thotë shkrimtari i nderuar, është i një meksikani, i cili e ka shkruar për kukullën e vet dhe kurrë nuk i ka shkuar ndërmend se mund të manipulohet”. Por një i tretë e paska hedhur në Internet dhe letra arrit edhe te ne. Unë këtë e marr për defekt, që e paska shkaktuar një imcak i panjohur. Dhe, tek lexoja reagimin e Gabos, në anën tjetër të telit dëgjoj mikun e poetin, Halil Matoshin. Nxitonte të më thoshte diçka habitëse. Ma përmendi një antologji në gjuhën italiane. Qenkan prezantuar aty tre poetë tanë: Din Mehmeti, Shefqet Dibrani dhe unë. Shqetësimi i mikut ishte: pse aty ishte edhe poeti i minoritetit serb Rade Zllatanoviç (!), i njohur për të keq edhe pse viteve të fundit përktheu ca autorë tanë në gjuhën serbë. Kishte të drejtë Halili. Ku mu Zllatanoviç?! Më foli edhe për ballinën e antologjisë, e cila ma përkujtonte një tjetër të botuar para dy vjetësh. Ishin prezantuar dhjetë poetë tanë e përkthyes ishin ca emra.

### 2

E kërkuam në internet atë farë antologjie, ku na qenka prezantuar Zllatanoviç me tre poetë shqiptarë (!). Pasi u shfaq në ekran ballina e saj, nxora antologjinë “Poesia dal Kosovo” (1999), kopertina e së cilës nuk dallonte fare nga ajo që shihej në ekran. Kishte për botues shtëpinë “Besa”, që në Tiranë ka për firmë një emër të



madh të gjuhësisë sonë Eqrem Çabej. Vazhdojmë të kontrollojmë dhe tekstin në anën tjetër të kopertinës, ishte i njëjti, por i vetmi dallim qëndronte se në faqen e parë nuk ishin emrat e poetëve të prezantuar në antologjinë e parë. Na bëhej se ishte një kurdisje nga ndonjë imcak për të luajtur majtap në këtë kohë “patriotike”. Ia përkujtoj Halilit letrën lamtumirëse të Gabos. Dhe, pse të mos luhet edhe me krijuesit tanë? Mirë është ta lëshojmë një “wanted” në internet për këtë defekt nacional bile, që dikush përpiket të nëpërkëmbë edhe identitetin tonë...

### 3

Rreth antologjive e panoramave në gjuhë të ndryshme, që botohen ende në emër të ish-bashkësisë, ma kishte bërë me dije në Bled (1997) poeti nga Sarajeva Izet Sarajliq. Në mes të tjerave, më thoshte se ca përpilues e përkthyes nga gjuha serbokroate vazhdojnë të botojnë antologji si në kohën e “vëllazërim-bashkimit”, e që dikush i përdor edhe për qëllime nacionaliste. Kishte përmendur raste, ku nuk ishin vetëm Izeti, Zajci, Dizdari, Berkoviqi, unë e ca poetë të letërsive të tjera. Mund të ndodhte kjo pa dijeninë e botuesve, por nacionalizmit nuk mund t’i mbyllën të gjitha deriçkat, vazhdon të shesë mjegull edhe në metropole të Evropës. Por, nuk di, jemi ne të parët që na ndodh diçka e tillë...?

### 4

Para ca ditësh Halili ma jep një postë elektronike, që kishte arritur në emrin tim. Blerta Suta, përkthyesë në gjuhën italiane jo vetëm e poezive të mia, por edhe të poetëve të tjerë e që gjenden edhe në “Poesia dal Kosovo” (1999), më lajmëronte edhe për një antologji të poezisë sllave, ku më kishin prezantuar. Me gjasë ishte njëra nga publikimet për të cilat kishim biseduar me Izet Sarajliqin në Bled. Suta shkruante: “Në një antologji të botuar nën kujdes të një profesoreshe serbe ju prezantoheni si poet sllav dhe përktheheni direkt nga serbokroatishtja. Bëra një përkthim direkt në shqip, vazhdon ajo, për një antologji mbi poezinë mesdhetare, të së njëjtës poezi, duke

demaskuar në fund të faqes operacionin e përkthimit të poezisë suaj nga një gjuhë, që nuk është gjuha origjinale e shkrimit të poezisë”.

Për admirim është gjesti i guximshëm i përkthyeses. Vështirë të dish ku, çfarë, me kë dhe qëllimet e botimeve të ndryshme. Shqetësimi i saj është në një oktavë me të Matoshit. Me sa shoh, përkthyesja nuk di ndoshta se në gjuhën e fqinjve veriorë i kam ca libra të përkthyer. Mund të gjenden ato edhe në katedrën e gjuhëve sllave në Romë. Por kush i përdor ato, nuk mund ta di. Me siguri ky nuk është rast i vetëm. Keqpërdorime të tilla hyjnë po në atë thesin e mjerimit njerëzor, ku u hedh ajo letër falso në emër të Gabos.

Nacionalizmi është farë e tmerrshme, ndoshta dhe fundi i një mjedisi. Nuk pushon as kur mendon se e ka braktisur planetin tonë. Kështu që manipulohet në çdo rrafsh e ku t’i jepet mundësi. Në një libër të vet Branka Bogavac e kishte vënë edhe Ismail Kadarenë. Pos emrave botërorë të arteve, kishte aty edhe ca sllavë. Kadaresë nuk mund t’ia shihja për të madhe pse ishte aty, por unë kisha reaguar rreth konstatimit të tij se krijuesit kosovarë kultivojnë nacionalizimin (1997). Mirëpo krijuesi i madh di edhe të pranojë gabimet e veta. Disi këtë e bëri edhe Kadareja në intervistën dhënë Dojçe Veles (dhjetor, 2000), pranoi se ka pasur nguti në ca konstatime të tij. Ç’të bësh. Krijuesit kurrë nuk janë vetëm. I ndjek ata edhe hija e një të treti. Ndoshta mu aty fillon edhe defekti njerëzor.

Dhe zhgënjimi.

## NDËRRIMET, TRIUMF I RI

1

Mario Vargas Los thotë se me përcaktimin për ndërrime fillon dhe qytetërimi i vërtetë. Ndërkaq, Adem Demaçi apelonte për ruajtjen e paqes, që ishte dhe pajtim kombëtar. Hasmëritë na sollën shpesh buzë varrit. Motoja e tij: *jo atyre që rrudhin gishtin, por atyre që zgjasin dorën e pajtimit* ishte dhe sinjal ndaj së keqes që kanosej. Ndërrimet vështirë të ndodhnin pa ndërrimin e mentalitetit: bën shqiptaria pa mua? Apo: bën të jem vrima e fundit e kavallit? Ato që ndodhin në hapësirën tonë më shumë janë të dhembshme, tragjike.

2

Para teje vështirë ngrihet mjegulla. Pakëz gjë sheh atje se çfarë ka ndodhur. Prapë merr të lexosh “Tunelin” e Sabatos. Dikush ta kujton se e keqja nuk mundet me të keqen. Por lirohu nëse mundesh nga mentaliteti. Kjo përshtypje lexohet apo dëgjohet për ndonjë kronikë tonën të zezë. Mua më tmerron ajo që e shoh e nuk është plagë. Vazhdoj të bindem se gjendem diku në tunel dhe varet nga unë kur do ta lë.

3

Përpara ke një mostër të së keqes. E lexon: nuk bën të përsëritet. U lë mesazhin brezave. Autobiografia e krijuesit është dhe autobiografi e popullit. Këtë e heton vazhdimisht se nuk je më vetëm i vetvetes.

4

Ngritet problemi edhe i së ardhmes. Nga frika e së kaluarës vështirës ta parafytyrosh të ardhmen. Libri kombëtar vazhdon të shkruhet. Problemi tjetër: kur të kryhet ky libër, e mundim të keqen? E ardhmja do të jetë ajo e ëndërruara?

5

Vrasja e Xhemës (M.) na kujton se e zeza mund të gjejë edhe ty, apo thirrjet: koka, vota. E sheh se gjendesh në tunel. Fije drite nuk di a sheh. Ndërrimet për të cilat flet edhe Mario Vargas Losa vështirë të pranohen shkaku i sedrës. Njeriu ynë ndryshe predikon e ndryshe vepron. E sheh se edhe në atë që ke besuar, të thotë një hipokrit. Të vjen të vjellësh e të pajtohesh se mentaliteti ynë është i tillë, vështirë të ndodhin ndërrimet. Ndoshta këtë do e kuptojmë se vrasjet janë një tjetër robërim: dyshimi.

6

Misteri i vrasjes së Mehmet Shehut: i vetëvrarë apo i vrarë, mbetet çështje e ndërgegjegjes së shtetit ideologjik. Në librat e të birit, Bashkim Shehu, vështirë t'i bihet në gjurmë. Turpin ua la atyre që e bënë krimin. Dhe tragjedinë familjare e depersonalizo: diktatura nuk rrënoi vetëm majat e veta. Ishte një farë asgjësimi i vetvetes, i cili na përsëritet shpesh se ne vetë kontribuojmë në të keqen. Pse të vritemi? Pastrimi ideologjik në veprat e Bashkim Shehut lexohet, para së gjithash, si dramë kombëtare, por dhe si derdhje e së keqes për ndërrim: por bën shqiptaria pa mua?

7

Faik Konicën e çmuan më shumë të huajt. Shteti ideologjik e kishte përzënë të themi nga të gjitha trojet tona mbasi vështirë pranonte “enciklopedinë që ecën” (Gyom). Frikësohej se guximi i tij qytetar mos bëhej lektyrë e të menduarit tonë. Duke parë se ku rrëshqasim, pajtohëm edhe me sjelljet e fjalorin e tij, megjithëse nuk e

kishte derdhur tërë vërin e tij. I kishte lënë shqiptarët të bëjnë gjumë të rehatshëm në një kohë kur lypsej një vetëdijësim më i madh. Si duket, ne mungojmë vazhdimisht kur nuk duhet.

8

Fjalët e mëdha janë zbrazësi. Dëgjoen edhe në letërsi, edhe në politikë, edhe në fjalorin e përditshmërisë. Është mirë të distancohet se mbjellin shpesh fatkeqësi. Kur i dëgjoj ato më kujtohet një becri: më mirë të më ruaj zoti se robi. Bile zoti e di kur duhet të ik.

9

Si mund ta priste festën pa i marrë erë rakisë. Shpesh kishte shaluar dhe qen varresh. Kishte hedhur anash reçeta e këshilla mjekësh. Kishte zënë vend mes miqve. Gotë pas gotë. Dikur u kishte kërkuar falje për çdo të keqe nëse u kishte bërë. Në një vend më solemn të sallës ishte shtrirë dhe kishte dhënë shpirt. Miqtë ia kishin vënë te koka një shishe me raki dhe një gotë. Ishte ndarë nga të gjallët, i përbuzur nga injoranca, një qejfli i pashoq i boemisë shqiptare, që nuk kishte pranuar të jetojë gjysmë i vdekur e gjysmë i gjallë...

10

Prapë fillon ta lexosh “Tunelin” i bindur se gjendesh diku aty. Dëgjon ndonjë klithmë dhe nuk i përgjigjesh. Nuk pranon ta ndërpresësh leximin, se nuk ke fuqi të ndërrosh asgjë. Por ndërrimet janë të domosdoshme për një kolektiv se shpiejnë përpara. Andaj të pajtohemi me poetrokerin Peter Gabriel: *Çfarëdo që bëni nuk mund e ndalini lindjen e ardhshme...*

## DERSI I AKADEMISË SUEDEZE

Gao Xingjian është nobeliste i njëqindtë me radhë. Evropa do ta mbajë mend se detektori i Akademisë Suedeze e zbuloi kur pakkush e njihje dhe kur mezi ishin shitur afro treqind ekzemplarë të veprës së tij.

Kjo nuk do të thotë se shkrimtari e disidenti kinez nuk mund të ketë vlera, as ndoshta nuk e ka merituar nderimin më të lartë. Në të kaluarën ka pasur raste të tilla kur janë nderuar autorë pak të njohur e shumë shpejt janë harruar. Mund ta presë edhe shkrimtarin kinez kjo? Shtrohet pyetja: mund të jetë kandar vetëm juria e Akademisë Suedeze e t'i zbulojë vlerat, që nuk njihen as në vendin ku strehohet shkrimtari? Nuk është rasti i vetëm i Gao Xingjianit. Apo mos do të thotë kjo se gjenitë janë të pavërejtshëm në mesin tonë dhe ata mund t'i zbulojë vetëm detektori i Akademisë Suedeze?

Nobelistet Tomas Man, Elioti, Fokneri, Kamy, Sartri, Hemingueji, Tagora, Elitis, Markez, Gras me veprat e tyre fascinuan botën dhe që më parë ishin të njohur për lexuesin botëror. Juria e Akademisë Suedeze kishte një qëndrim krejt tjetër ndaj veprës së një Tolstoji, Borhesi, Shashës... Po kjo mund t'u ndodhë edhe Sabatos, Loses, Kunderës, Kadaresë, Kemal Jasharit, S. Ruzhdisë... Kjo Akademi, po ashtu, ka nderuar edhe shkrimtarin kroat të serbizuar, Ivo Andriçin, por kurrnjëherë nuk e pa të arsyeshme të distancohet ndaj laborateve të tij fashistoide, që u zbatuan edhe gjatë spastrimeve të mëdha etnike në Ballkan. Ndodh që ky çmim të shkojë shpesh edhe atje ku nuk besohet, pra detektori suedez mund të gabojë e opinioni botëror ta kapë edhe si befasi.

Nderimin e Gaos e përshëndeti edhe zoti Klinton. Ndoshta i respektuari ka njohuri më shumë për veprën e shkrimtarit e të disidentit kinez.

Megjithatë, shtrohet pyetja: duhet të ekzistojë njëfarë kufiri mes artit e politikës? Nuk besoj se ky çmim mund të jetë çelës që mund të na hapë misterin e Lindjes së Largët. Këtë nuk mund e bëri as Tagora e letërsia japoneze, që është mjaft e botuar në Evropë. Por, mbështes se bota duhet të hapet dhe komunikimi njerëzor të jetë më i madh. Sa më shumë që e njohim njëri-tjetrin, aq më pak do të ketë dhe hasmëri në planetin tonë. Kina është vend i madh, ku ka edhe kulturë të madhe e të panjohur për ne.

Arsyetime i kreut të Akademisë Suedeze, nuk di a mund të na bindë se Gao qenka merituar dhe paska shkruar disa drama, njëra “Stacioni i autobusit”, bëka fjalë për masakrën në Sheshin Tienanmen, ndërkaq nga proza veçon romanin “Mali i shpirtit”. Një udhëtim ky të themi magjik i shkrimtarit, përgjatë lumit Jance (1986) u kundërvihet edhe autoriteteve kineze. Po ashtu, romani qenka një kombinim i formave të të shprehurit dhe në fushën e dramaturgjisë vërehet edhe ndikimi i Beketit, do të thotë nuk qenka i shkëputur nga ne evropianët. Por, a mjafton kjo? Nuk mbështes se nuk bën të nderohen me këtë çmim edhe krijuesit e Lindjes së Largët. Vlerat imagjinatave, kudo që shfaqen, duhet respektuar. Pra, nuk do të thotë se vetëm në kontinentin tonë ka vepra të mëdha fascinuese. Këtë më së miri e dëshmon dhe Amerika Jugore e ajo Latine. Por, pse Lindja e Largët na shfaqet si një mister, nuk është faji i evropianëve.

U dha edhe Çmimi Nobël për paqe. I është dhënë personit të merituar, i cili arriti të ulë tensionin mes dy Koreve. Por, çmimi për letërsi vërtet a do të jetë çelësi që na hap befasitë e reja? Duke përcjellë atë ç’u shkrua gjatë ndarjes së çmimit, një mik imi që jeton në Paris dhe është një intelektual me emër, ishte më i befasuar se unë. Nuk kishte dëgjuar asgjë për Gaon, i cili jeton në periferi të Parisit, ku jeton edhe miku. Ngjashëm kishte ndodhur me botuesit me renome jo vetëm franceze, e të mos flasim për kritikën evropiane.

Kjo befasi me Gaon mund të lexohet edhe si ders i Akademisë Suedeze. Ai që shpërblen ka të drejtë edhe të zgjedhë laureatin. Megjithatë, nuk dëshiroj që Gao ta përjetojë fatin e të harruarve.

# NJERIU I DY MILENIUMEVE

## VRIMA E MISHOS

1

Bekria e thërriste vrimë. Ne e quanim Bythkuq. Tek kalonte Gardhiqet e Parrucës, ia kishte rrahur prapanicën me hithër një i panjohur. Më vonë zjarmia ia kishte mbuluar tërë rrashtën neoilire. Ishte një mish i gjallë. Binte në sy kudo.

2

Kush nuk e mban mend të ketë shikuar në një pikë. Kur mendonim se shikonte majën e xhamisë, ai i ngulte sytë në një vrimë në mur. Njëri, që kishte lexuar Librin e Perhirtë në Shtëpinë e Frikshme, na kishte thënë se ky kishte dhe një emër.

3

Fjalori i Bekrisë njihet në tërë kasabanë. Nga ai kisha veçuar fjalën vrimë. Gjatë kisha menduar rreth saj. Mund të ketë njeriu një vrimë në gjoks? Çfarë mund të depërtojë nëpër të. Çarjet e shoqërisë hetoheshin. Kalonin nëpër to dhe qerret me buaj. Por njeriu? Vrima



ma kishte kujtuar një poezi të Henri Mishos, ku thoshte: “*Fryn një erë e tmerrshme. Është veç një vrimë e vogël në kraharonin tim*”. Bythkuqi do të ishte me fat po ta kishte atë vrimë aty. Buzëqeshja e tij në fotografi, që e kishte imituar dhe interneti, ditën kur ishte bërë anëtar i Shoqatës së Dhelprave, le të kuptosh diçka tjetër. Vrimë e Mishos shëtiste nëpër trupin e qytetarit tonë. Kryesore rrugën e kishte dyz.

#### 4

Më kishte dalë menç kur e pashë shkallëve me Britmën. I kisha fshirë sytë. Vetë ai ishte. Sa pihet një kafe, biseda zgjati. Me aq mendoja se mbyllej karriera e tij. Në takimin tjetër ishte më azgan. Ia kishte hëngër rriskën dhe Britmës. E vëreja këtë nga toni i fytyrave. I panjohuri vërtet kishte qenë një katil i regjur. Djegia nuk dihej në cilën shkallë ishte dhe vështirë të konstatoja se ku vrima e Mishos bridhte në trupin e tij. Megjithatë, shkeponte dhiareve. Ishte dëgjuar pastaj Britma: nuk bën të na harroni.

#### 5

Jogurt revolucioni kishte ndodhur. Kosova nuk ishte më ajo që ishte. Përballë qëndronin dhuna e guximi. Kasabajë jonë i ngjante një gonxheje që me ag lexohej. Na kishte kurdisur dikush orën. Kjo binte te koka e secilit. Unë e kisha dëgjuar moti tiktakun e saj. Bekria thoshte: i lumi ai që do ta kurdisë me dorën e vet.

Tek dilja në pazar, lexova një ditë në murin e lartë të kasabasë reklamën: mileniumi i dytë mbyllet me veprën madhore: “Patriotët dalin në gjueti të mynafikëve”. Flitej se rendi i lexuesve do të jetë i gjatë dhe se ekziston interesim i madh për vepra të tilla. Pas ca ditësh dëgjova se botuesi kishte bankrotuar bashkë me autorin. Nga vrima në kraharonin e Mishos frynte tmerrshëm. Në një vijë horizontale ishte shndërruar. Unë shkëlja udhës sime me plot kthesa e të papritura se kisha punë edhe me të vdekur.

6

I kishte shkrepur edhe kësaj here. Çudi tjetër nuk kishte ndodhur. BMGJ, BNB, BÇ ishin në anën tjetër të vrimës. Pasi e kisha pirë kafënë dhe ia kisha dhënë djalit të Bekrisë poezinë time bashkë me kasetën e Ilirit, kisha pyetur, sa është ora? Do të tregojmë, zotëri sapo të zbardhë. Kasabaja jonë njihej për shaka e bishta. Dëgjiova dikur dhe nofka që nuk m'i zë goja t'i them dot.

7

Fare nuk e kisha hetuar kur u ul Bythkuqi në tavolinën time. Nga rrashta e tij neoilire më bëhej se i kishte rënë udhës një sy. Vrima dukej qartë në kokën e tij. Këputa aty në kopsht një fije bari dhe e përbirova përmes vrimës në lule të ballit të tij. Nuk lëvizi fare. E tërhoqa prapë. Aman, bre TA, i thashë dikur. Qy, qy. Habiteni. Nuk është koha për t'u habitur. Ishte përgjegjur pasi e kishte ngritur edhe një fyt. Pyetni Alltenziun, Sedtullën... Vëllimi i dytë “Patriotët dalin në gjueti të mynafikëve”, ishte dalë me një firmë tjetër dhe kishte kaluar më keq. Dikush kishte shënuar se rënia ishte katastrofave. Kinë e Paris bënin gjurmë të mirë. Një lexues kishte shkruar: more kam menduar se vetëm të pjekurit i shkruajnë gjërat bashkë...

8

Ditën kur e varrosën Bekrinë, ligjëratat mbi patriotizmin kishin marrë fund. Në këmishë e brekë ishin parë dhe askush nuk mund të besonte se deri ku kishte rrëshqitur kasabaja jonë. Ishte folur pastaj se një i panjohur në një lis e kishte hedhur një litar. Rapsodi ka të drejtë t'i çkëndojë heronjtë. I fismi, që kishte kaluar pranë lisit e kishte parë trupin që luhatej, kishte shtuar: ky nuk është Sefë Kosharja.

9

Bekria moti nuk është dhe e mbajnë mend e Bythkuqi jeton e nuk e kujton kush. Kisha ndezur Koralin 45. Një fishkëllimë ishte përplasur në anën e përjashtme. Dola dhe gjeta një gëzhjojë të plumbit qorr. E mora dhe e mbylla vrimën, ku frynte tmerrshëm.

## LIRIA NË KOHËN E KAOSIT

1

Qenushin e punësova, shpresoj se në ndonjë kancelari do gjejë vend edhe macja ime. Më vonë do të vë në dispozicion tërë kopshtin. Kohë me bollëk e me kallaballëk kurrë nuk ka marrë. Leh e faro minj. Shpalo het horizonti para kollës së thellë të një tepeleku. Kate-kate do të pushtoj dhe qiellin...

2

Dhe zotëria që ishte shtrirë në kanape, u zgataraq edhe pak. Pasi e çoi me fund gotën në formën e një amfore ilire, u ra shuplakave me një takt të çuditshëm. Në sallonin e ndritshëm hyri një këndues, i cili u ndal para tij. Si u morën vesh, nuk e di. Pas dy-tre minutash ia solli pijen e porositur zotërisë. E mbante në mes dy krahëve të hapur, që deri më gjysmë ia mbulonte kaçeruba e kërleshur. Zotëria e mori me një gaz të thartë, që nuk mund e lexoja si ironi. E bëri atë gjest thujse desh të thotë ja çfarë rregulli ka në perandorinë time. Unë përcillja lëvizjet e tij. Pas fytit të parë, zotëria i zbuloi dhëmbët. Deri në rrënjë ia kishte mbuluar një shtresë e verdhme. Sapo veneroi se hoqa rrëmbimthi shikimin nga dhëmbët e tij, iu kujtua se me ta nuk mund të krenohet askund. Nisi historinë e oxhaqeve aty ku e kishte lënë. Një fjalë nuk e tha qysh kishte arritur deri aty dhe si në kopshtin zoologjik kishte vënë rend e që nuk ishte pa vizitorë.

3

E shikova në lule të ballit. E kishte një pikë të zezë e që e kishte marrë në një farë përplasje. Pasi pushoi i thashë: e di, zotëri, më pëlqen puna jote e ky luks, por në këtë kaos mjeshhtëri është të mos humbasësh një qime floku. Rreth lirisë sime, kam krijuar membranën

time tepër të sigurt. E shikoni makinën time atje poshtë nën ballkonin tënd? Edhe pse rri e hapur tërë kohën, nuk e prek askush. As nuk më ka shkuar ndërmend ta mbyll. Unë besoj në polenin dhe rrenë është ajo që flitet për të. Shikoni, çdo gjë imja rri hapur. Për mua nuk është i përdorueshëm asnjë dry. E urrej gjithëpushtetshmërinë e çelësave. Ju paskët specializuar tërë kopshtin e nuk mund të linin hapur asgjë! Megjithatë, ka defekt në perandorinë tënde. Unë e ndjej veten të lumtur edhe me atë Koralin 45, edhe me një grusht lekësh, edhe me makiaton time të mëngjesit që e pi diku në kasabanë tonë. Lirinë time nuk e vë në pyetje, zotëri.

#### 4

E pamundur, pëshpëriti më tepër për vete zotëria derisa qeni i tij lehte para derës dhe përzihej në bisedën tonë. Si ndodh kjo? Pyeti si në gumë. Në qafë nuk i bie askujt, as nuk ha më shumë se një bark, zotëri. Të bindeni, ja zbres shkallëve aty te Korali 45. Asnjë çelës nuk do e vë në veprim, as kur e mbyll as kur e ndez. Unë nuk frikësohem nga liria ime.

Dhe isha në shkallën e fundit kur zotëria kishte dalë në ballkonin e madh. Kërkonte makinën time. Unë ia bëra me dorë. Pa çelës hapa derën dhe ndeza motorin, po ashtu, pa çelës. Sa desha të nisem, më ftoi atje lart. Fika motorin dhe u nisa duke fishkëlluar. Sapo i afrohesha derës së tij atje në fund të korridorit, ndjeja zhurmën e rëndë të çelësave. Kur e ndjeu praninë time, e hapi derën e hekurt. Të këmbët e tij qeni lëvizte bishtin dhe thellë diku nën një kanape macja lozte me një mi, që kishte filluar të përgjaket.

#### 5

Zura vendin ku isha pak më parë. Përballë zotërisë. Më bëhej se ky ishte pakëz i humbur ose kishte ndonjë problem me perandorinë e vet. Mezi i deshifrova fjalët, që m'i tha në sinkopa: edhe pa targa të reja, e njeri i botës! E lëviza kokën, në anë të kundërt të lëvizjes së tij. Prapë u ra shuplakave me atë taktin karakteristik të kateve të larta. Kënduesi, që nuk di a e ka dëgjuar ndonjëherë çfarë këngë ia thotë,

krahëhapur qëndronte me një gotë uiski para tij. Pasi e zbrazi edhe një, i çatalloi sytë tek dëgjoi atë që ia thosha e që ma kishte treguar një njeri i urtë nga Drinia.

6

Në vendin tonë njëherë paska marrë dimër i madh. Babë e djalë dalin për dru. Dhe kishin mbledhur deri në kranden e fundit. I kishin paluar nën dritare. Ditëpërditë ato pakësoheshin e dimri nuk zbutej. Kishin mbetur edhe ca krande. Nga forma nuk dihej ç'ishin. Plaku i kishte shikuar një nga një dhe i kishte thënë djalit që këtë ta kthejë në pyll. Djali kishte qeshur, edhe këtë do e bëjmë gacë. E kishin futur krënden afër vatrës. Dikur ajo kishte ndërruar edhe formën, ngapak të lëviz. Babë e bir derisa ngrënin darkë, rreth tyre kishte kërcyer diçka dhe kishte kafshuar djalin. Mbi trupin e tij kishte uluruar plaku: ç'zezë ra në shtëpinë tonë...

7

Pyllin e nëmur e kisha lënë pas dhe nuk di në cilin km gjendesha kur përmes radios dëgjova lajmin fatkob për zotërinë, që kishte punësuar mace e kuce dhe ishte përpjekur, të imitojë më vonë lirinë time. I rashë sirenës së makinës. Nuk mund e dëgjoja kollën e një tekeleku...

8

Të keqpërdoruarit e lirisë mbyllet me fatkeqësi.

## MAGJIA E NJË DEGE

### 1

Kam qenë nxënës kur dëgjova për herë të parë vargun: *Mori e bukura More* dhe sintagmën trishtuese: *gjak i shprishur*. Si dhe ç'ishte ky mallëngjim e trishtim në të njëjtën kohë? Dhe, më bëhej se zbuloja një planet kur i pëshpëritja këto nga frika se mos i harroja. Po ç'ishte Moreja dhe ku binte, nuk kisha fare dijeni. Kur nisa ta zbuloj, kuptova se paska shqiptarë edhe diku tjetër dhe dhimbja e tyre nuk dalluaka nga imja.

*Mori e bukura More*, ishte kompozuar dhe kënduar nga shumë solistë deri të Inva Mula, vajzë e metropoleve dhe e rrugicave të qytetit tim, të cilën e dëgjova edhe në Sallën e Kuqe. Ky mallëngjim njerëzor, një vajthirrijeje për diçka të largët e të humbur ndoshta përgjithmonë për një kolektiv njerëzor me kujtesë të fortë që nuk të lë të qetë, më bëri të përqendrohem në fuqinë e saj magjike e të shpalos tragjedinë arbëreshe.

### 2

Ditë të tëra humbja pas kangjelave dhe ngjyrave farfuritëse nëpër fshatrat arbëreshe. Duke biseduar me ta zbuloja dhe rrugën për në Morenë, që ma përshkruanin si një ëndërr. Ajo copë tokë, ç'forcë kishte? Në fshatrat buzë detit dilnin deri vonë dhe bënë me dorë nga pika, që vështirë shihej, se deti ishte në mes tyre. E kishim shikuar atë pikë të largët edhe nga ballkoni i De Radës. Dhe atë udhë e shkela një ditë. Mes arbëreshëve dhe arvanitasve kërkoja atë që i bashkon, ku lidhej entiteti i copëtuar? Degëzimi ishte fati i tmerrshëm i trungut arbëror, që vështirë mund të kontrollohet. Pak më harrestare ishte me arnautët e Damaskut e çamët. Pak gjë lëvizte hapësirës së tyre se kishte rënë mortja. Aty-këtu mund të kapej ndonjë fjalë apo klithmë

në gjuhën time, por ishte e paktë për një gjallërim. Dhe nga këto shpërbërje, më bëhej se vetëm arbëreshët e Italisë gjallëronin edhe pse i ngjanin një degë të pikëlluar, siç kishte thënë një poet i tyre. Bota e tyre shpirtërore kishte një burim të thellë, që duhej kërkuar në lashtësinë tonë, ndoshta te baladat e murimit. Por fjalët e moçme, kangjelat që shtoheshin vazhdimisht për fatin e të bëmat e tyre në dhe të huaj, sa të pikëllonin aq dhe të trimëronin. Qëndresa arbëreshe mund të jetë lektyrë për qëndresën njerëzore dhe shembull si duhet mposhtur harresën. Dhe kjo degë e pikëlluar është botë specifike në gjallërimin tonë. Në kulturën shqiptare nuk mund të mendohet asgjë pa De Radën, Zef Seremben, Skiroin e deri te Vorea Ujko, Skiro di Maxho, Altimari, Abato e shumë e shumë krijues nga të gjitha rrafshet. Unë kur lexoj diçka nga këta, i marr erë edhe mallëngjimit dhe ndiej zërin e largët, që përpillet në dhe të huaj.

### 3

Nuk mund të pajtohesh se vendi amë ka bërë diçka në mbrojtjen e të drejtave të tyre njerëzore, në ruajtjen e identitetit të tyre kombëtar. Me slovenët e pakicat e tjera në Itali ndodhi tjetër gjë, patën fat më të mirë edhe pse në krahasim me arbëreshët janë në numër tepër të vogël, por këtyre nuk u mungoi kujdesi, me ta vazhdimisht ishte prania e amës. Ndoshta neve shqiptarëve na bëhet se atdhe e kemi tërë botën dhe bën të çohet dorë nga një degë jotja. Por e vërteta është tjetër fatkeqësisht, prandaj jemi këta që jemi dhe duhet të pajtohemi se gjallërojmë në mëshirën e fatit. Mbi pesë shekuj arbëreshët i bëjnë ballë asimilimit italian. Shqiptarët e Anadollit pa shkelur mirë ndërronin emra e kombësi dhe pranonin identitetin e huaj. Me arbëreshët nuk ndodhi kjo, e dinin cilit gjak i përkisnin dhe nga janë. Prandaj mallëngjimi për Morenë është i veçantë në tragjedinë shqiptare në përgjithësi. Shkaku edhe i disa arsyeve të tjera, admiroj këtë degë të pikëlluar. Në njëfarë mënyrë rrugëtimi i tyre është rrugëtim i shqiptarisë. Kujtoni çamët e therur e të ndjekur, depërtimet e tyre kanë ngjashmëri të madhe me depërtimet tona në fund të mileniumit të dytë, por për çamët nuk lëvizti as vendi amë, gjendej mes popujve paranoikë, të cilët kanë dy mundësi: të vriten ose të vrasin,

tjetër rrugë nuk dinë, se përplasen për murin njerëzor. Po atëherë vetëdijësimi botëror nuk qëndronte në këtë nivel të sotëm. Pra, grekët bënë me çamët atë që kishin vepruar edhe me arbëreshët.

4

Arbëreshët kanë diçka që u mungojnë degëve të tjera të kombit: krenarinë dhe mallëngjimin e një kujtese historike. Njëra nga arsyt që nuk mund t'i asimilojnë është se i takojnë ritit ortodoks. Mendohet se shqiptarët e këtij riti më vështirë asimilohen se myslimanët e katolikët. Kjo të mbetet çështje për elaborim nga njerëzit kompetentë. Ndonjë injorant mund të më shpallë edhe për grekofil. Por shqiptarët e ritit ortodoks dëshmuar për atdhedashuri të lartë edhe në mjedis të Athinës, me dhjetëra demonstrata kundër vrasjeve e depërtimeve të shqiptarëve në Kosovë. Gjaku nuk i la të qetë as arbëreshët. Në trupin e qenies kombëtare nuk mund duruan thikën e huaj. Dhe kuptuan se besimi nuk mund t'i shkëput nga trangu i kombit. Hedh dritë e përkrah paqen dhe në zona të mjegulluara.

5

Kisha pyetur për Morenë dhe kisha filluar ta ndiej veten arbëresh, se me ta nuk më lidhte vetëm kënga dhe gjuha, por dhe dhembja. Një varg për besnikërinë time e kisha grimcur me dhëmbë, frikësoja nga nderi...

Ja, pse i dua arbëreshët, atë rrënjë të fortë të kombit, siç tha një poet arbëresh. Dhe duhet t'i besojmë.



## BUKURIA E TMERRIT

### 1

Shpesh kam qenë në Palermo. Sebej ishin dhe arbëreshët. Sa herë shkilloja në këtë qytet, kisha ndjenjën e frikës; ballafaqimin me ndonjë fytyrë, që e kisha parë në ekran apo lexuar diku në libra. Vendosësja në një hotel pranë hekurudhës. Mendoja se do të më shpëtonte zhurma, që më bënte t'i vëja tapat në veshë. Më vonë kuptova se ishte rrenë dhe qyteti nuk e kishte një ngjashmëri me filmin e tmerrit. Epiteti i frikshëm, i tmerrshëm, i përgjakur, i ankthshëm, qytet i mafisë, më bukur i rri ndonjë kasabajë ballkanike. Palermo as nuk është qytet i tërmeteve, i gjarpërinjve, siç flitej. Imazhin e tij e dëmtuan regjisorët e pandërgjegjshëm që kërkonin irrealen.

Ngjashëm më ndodhi dhe mua “në mes të gjithë atyre kufomave” tek shikoja një palë sy lëvizës të një fëmije të balsamuar në Katakombet e Kampuçit, kisha derdhur lot dhe mezi kisha dalë nga një labirinth tmerrri, ku bukuria e syve të fëmijës së balsamuar më kishte shtangur; para meje qëndronte trupi i pajetë, që kishte diçka të veçantë. Në marramentin tim zbulova dhe shtegun, ku mbrëmjeve shëtiste shkrimtari i famshëm italian, Leonardo Shasha. Ishte parë dhe Santaxhelo, një poet fin, i cili që në vitet e shtatëdhjeta shkroi poezi për Kosovën e që m'i recitonte Zefi ynë. Po asaj gjarpërore deri në Horën e Arbëreshëve, më bëhej se njëqind vjet ngjitesha. Dhe ky kur fiku makinën para një pllake të mermerit, më kishte pyetur për filmin “Nuni” të Kupolos me Marlon Brandon në rolin e Don Vito Korleones. Mes tjerash, i kisha thënë ka ngjashmëri aty me odat tona, veç dhoma e grave dhe veç ajo e burrave, pastaj kallaballëku. Pas pak më rrëfeu historinë trishtuese të asaj shtëpie, që nuk e keni parë në filmin e Kupolos.

## 2

Pas Mazzaro del Valos e takimeve të tjera, Palermo më bëhej se gumëzhinte aty buzë Erenikut. Karadakliu më tha dikur se këtë qytet e paska shkelur para nesh Plaku i Vlorës. Ç'ishte më befasuese, ne banonim në të njëjtin hotel në dhomë, ku kishte bërë gjumë ai. Me siguri ka fjetur në shtratin tim, njerëzit e mëdhenj nuk i lënë afër dritares, i thashë. Karadakliu më foli edhe për rrugën të cilës ishte ngjitur me suitën e vet deri në Horën e Arbëreshëve. Nga të dy anët numri i arbëreshëve kishte qenë tepër i madh, nga dalja e Palermos e tejllart gjarpërores. Në të vërtetë, ky më fliste për rrugën, që e kisha shkelur edhe në ëndërr; se gjërat që zbulohen rastësisht, ato mishërohen me ty dhe vështirë të shkëputesh nga hija e tyre.

Mbasi banonim në një hotel aristokrat, kisha kujdes të mos e ndotja imazhin historik. E kisha lënë Palermon të zgjohej vetë me atë bukurinë e llahtarshme, siç do të thoshte Lasgushi. Dhe sapo gjendeshim tek kreshta historike nga ishin nisur Garibaldi me poetin tonë, Francisko Krispin, të mposhtnin Mbretërinë e Napolit, nën rrëzën e frikshme të malit, veneronim trupin e qytetit si notonte mes Ujit të Madh. Prapë e kishim zënë ngoje iluzionin e Naim Frashërit në poezinë për Krispon. Dikujt iu kishte kujtuar dhe koha e shtatë pashallarëve, kur Mesdheu ishte në dorën tonë. Po tani? Historia është e tmerrshme kur popujt nuk e gjejnë veten në hapësirë e kohë. Dhe për gjithë atë rrugëtim kisha kërkuar fjalët e mundshme: E largët dhe e lartë, kur njerëzit bëjnë punë zotërash. Kështu e shihja Horën e Arbëreshëve dhe njerëzit e saj.

## 3

Do të shohim Leonardo Shashon? Edhe pak gjendeshim te shtegu i humbur në blerim. Ora soste me të shpejtë natën. Shkaku i harresës njeriu që nuk dinte të buzëqeshë, u zgërdhi. Në hotelin tonë banonte dhe Ismail Qemali, i tha karadakliu. Ai prapë u zgërdhi, ashtu siç na kishin thënë halabakët dhe iku dikur pa na thënë si ia luajti një hienë mesjetare. Nga një dokument i gjetur rastësisht e i cili u shpëtoi tërmetejeve, thuhet se shqiptarët e pushtuan Palermon për herë të

fundit kur zbuluan se deti kalohet edhe këmbëklinc. Dhe tek dëgjoja karadakliun mbi hienën dhe trimin e përrallave, shikoja faqen e malit të mistershëm si zbardhej. Kisha vërejtur ca gropa të zeza për të cilat Zefi na tha se ngjarje të dhembshme kishin ndodhur aty. Unë nuk besoja se trupi i balsamuar i një fëmije me sy lëvizës në Katakombet e Kampuçit tregonin diç tjetër, na përcillnin. Gjendesha në një labirinth magjik. Palermo ishte afër, e tepër larg njëkohësisht; i ngjante frymëmarrjes së femrës, që pret të zgjohet në takimin e ardhshëm. Një valë rrënuese përplasej për brigjet, por ai syri lëvizës i një fëmije ishte bukuria që më bëri ta kafshoj dhe tmerrin. Nuk di, e dëgjon kush dhembjen...?

## MOLLA

### 1

Në oborrin tonë e kishim një mollë, e cila ushqente një mëhallë. Sa herë tentoja të hipja në të, nëna vraponte dhe lutej të zbrisja. Nuk di nga e kishte këtë frikë; se, kush bie nga molla, vështirë ngrihet më. Kurrë nuk mund e mësova këtë. As tani nuk mund të lirohem nga frika e nënës. Pse nuk ngrihesh kur bie nga molla?

### 2

Kisha kaluar dhera e kisha kaluar dete e ku kisha parë ndonjë trup molle, më ishte kujtuar nëna. Pse ajo frikësohej? Tokës si bridhja dëshironte të më shihte dhe të ndiente praninë time. E shikoja mollën në oborrin tonë si e mbushte me erë e kuqëlim. Tinëz merrja gurin. E shënoja më kuqëloshen në degën më të lartë, e cila pas pak fluturonte te këmbët e mia. Me skajin e këmishës e fshija. Ndieja dhembje për lëngun e derdhur nga goditja ime. Edhe shijen, mendoja, se nuk e kishte. Dikur e vendosja dhëmbin mbi lëkurën e saj. Lëngun, që e kishte humbur, më bëhej se kishte pikur thellë në dhe, ndonjë pikë ndoshta dhe mbi trupin e nënës, e cila ka vite që frymon tek rrënja e saj. Vazhdoja grimcimin me frikë se mos ia prishë qetësinë dhe ndjeja mallëngjim: po re nga molla, vështirë të ngrihesh.

### 3

Gjendesha në një livadh, ku kisha humbur nga hija e mollëve dhe kënaqesha me bukurinë e tyre në rremb, por nuk kisha guxim dorën ta zgjasja. Nën hijen e tyre nuk shihesha. Një namë ndoshta ato i ruante, që nëna nuk ma tha kurrë. Vërtet pse nuk ma kishte thënë? Me ditë, me vite shëtis nën mollët dhe kur me ndonjë gur marr hez ta

rrëzoja, atje lart shoh një sy si loton dhe ndjej thellë më vete qortimin e nënës.

4

Nga një rrugëtim kthehesha. Në oborrin tonë nuk e ndjekja as shushurimën e gjetheve të mollës. Trupit të zhveshur iu afrova. I kishte mbetur vetëm hija. Degët i mblodha e ca u përpoqa t'i kthej në pozicionin e mëhershëm. Më ishte kujtuar nëna. Dhe tek i lidhja ato, ndieja dridhmë në vete. Më bëhej se i lidhja edhe fjalët e saj. Një fëmijë më ishte afruar dikur: e di pse nuk bën të hipësh në mollë? Oborrin e shkretëron dhe e tret erën...

5

Imazhi i mollës më ishte ngulitur në kujtesë. Nuk funksiononte asnjë lidhje me vendin tim. Provoja ta krijoja atë në murin e huaj dhe përmes saj fytyrën e nënës, e cila frymonte diku tek rrënja e saj. Kisha zënë të flas më shumë për mollën si për një çudi përrallore dhe për oborrin tim si për një planet të pazbuluar ende. Kush bie nga ajo, vështirë ngrihet më. Ajo fuqi e padukshme ishte diku te nëna; se fjalët e mia ishin të nënës e që përcilleshin gojë pas goje: ai që bie nga molla nuk ngrihet më. Kisha punë me magjinë. Vërejta një ditë njerëzit e panjohur si shikonin në një degë dhe kënaqeshin me mollët e kuqëluara. Iu kisha thënë pastaj se në një planet ekziston një mollë në një oborr, që ushqehen një mëhallë... Këto aspak nuk i afrohen mollës së oborrit tim.

6

Në një dhomë të errët, hermetikisht të mbyllur, ku më kishte përplasur tragjedia e vendit tim, dikush ndezi një qiri, ma la te koka. Një tjetër ma kishte fikur. Kisha humbur në terrin total dhe nuk di s'kishte zgjatur ky ankth. Dikur një dritë e kuqërremtë, në formë harku, e kishte mbushur pjesën e epërme të kthinës, pastaj ishte shndërruar në një rreth të plotë. Kisha brofur në këmbë. Nuk isha

vetëm. Molla e nënës kishte rrëshqitur aty te koka ime dhe frikësohesha ta prek. Kisha qarë.

7

Një dynja hi. E, ku rruga ime, shtëpia, oborri e molla që ushqente një mëhallë? Një njeri për be. I kisha rënë qytetit dhe kisha kaluar lumin. Në shtëpinë me derë në hava, isha matur të trokas në një dritare të mbyllur me gazeta. Një dorë e padukshme ishte zgjatur dhe në shuplakën që ishte hapur më vonë, vërejta diçka të mbështjellë. Krejt afër meje ishte dora. Në njërin gisht kishte një unazë, e cila i ngjante një rës që e kisha në kujtesë. E kisha ulur shikimin. Nga shuplaka e hapur kishte rrëshqitur një mollë dhe ishte rrokullisur deri te unë, që isha ulur para një trangu të prerë. Majë Çabratit ktheva shikimin nga një botë e derdhur, ku mungonte edhe oborri im me mollën që ushqente dhe një mëhallë. Përbindëshi kishte hipur në të dhe nuk ishte zgjuar më nga përplasia e fuqishme. O Zot, përnjëmend nuk u zgjuara ai që bie nga molla. Detaje të tjera mund t'i lexoni nga Zhak Preveri në poezinë për mollën e Pikasos...

# KARAGJOZËT

1

Një hamall e qet udha në një manifestim kulturor në Shqipëri. Sapo shkel, poshtë e lart i bie metropolës shqiptare. Kë kishte takuar, më njihni më vonë. Unë jam rrokoteli. Ia kishin ofruar edhe mikrofonin. E kishte dëgjuar një mik tek lëshohej Krrabës. Një të zezë pa e thënë nuk e kishte lënë, bile edhe për xhematin e vet. Në hapjen e manifestimit kishte zënë vend. Gojë pas goje kishin dëgjuar gazetarët se në qytetin e tyre paska shkelur një karagjoz. Mund të zbulohet ndonjë skandal edhe tej Pashtrikut.

Hamalli i ngazëllyer nga gjithë ata gazetarë, fërkon duart e ia nis me radhë. Nga gjithë ai pisllek, në kujtesë u kishte mbetur një detaj: Dëgjoni burra, një çetë shkrimtarësh (emrat e tyre shpesh dëgjohej edhe në Radio-Fushë), i kisha renditur e me një shkrepje plumbi i kisha paluar. Gazetarët, që dinin për të zënit ngojë se kush janë e ç'kanë shkruar, ishin larguar një nga një të mllefosur. Skandali vërtet kishte ndodhur. Zgërdhihej, një paranik para tyre. Por nuk e kishin të qartë si kishte shkelur aty. Njëri që kishte përcjellë lëvizjet e të vetëshpallurit krijues, e kishte ndërruar vetëm karrigen. Pasi kishin mbetur vetëm, e lut ta thotë edhe një herë atë që e kishte deklaruar pak më parë. Si një pllakë gramafoni hamalli ia kishte përsëritur me çetë e emra derisa iu kishte tharë pështyma. Ai, që e kishte lutur, nuk ishte shkrimtar as gazetar. Me një buzëqeshje të hidhur ishte larguar.

Pas një kohe në “Nikolino” pija kafe me një poet. Tek bisedonim për ndodhitë më të reja në Kosovë, na ishte ofruar një zotëri. Pasi ishte përshëndetur me vlonjaten, ma kishte zgjatur dorën. Sapo kishte mësuar emrin tim, kishte buzëqeshur me skaj të buzëve, duke pyetur edhe për një hamall. Për nja dhjetë minuta ishte larguar. Kryente punë tepër të rëndësishme. Dikur ishte kthyer me një “reporter” dhe na kishte lëshuar një shirit. Zërin e njihja. Po ku

dëshironte të na varroste? E kisha pyetur zotërinë. E di karagiozi, kishte pëshpëritur ai.

Edhe tani kur dal në Tiranë, shpesh bie fjala për hamallin, i cili brenda nate ia kishte kaluar edhe Skënderbeut.

## 2

Pas rënies së diktaturës në Shqipëri dhe hapjes së bunkerizmit, deti nuk u binte shqiptarëve as te zogu i këmbës e lëre më malet e larta për të cilat kishim lexuar në poezinë e Naimit. Në Rrafshin e Kosovës kishte zbritur një shkrimtar. Kush ishte ai që nuk mund t'i bënte sajti një krijuesi nga Nëna Shqipëri. E kishte nderuar edhe një shoqatë dhe i kishte mundësuar biseda me publik e gazetarë. Për herë të parë na fliste për Shqipërinë diç që nuk besonim as nuk e kishim parë ashtu. E kishim lënë të flasë se kishte nevojë dhe me siguri dinte më shumë se ne çfarë kishte ndodhur gjatë pesëdhjetë vjetëve të shkuara.

Diku në Gjermani takohemi pas një kohe. I pavuajtur e me tërë Shqipërinë në shpinë, kishte vazhduar bisedën ku e kishte lënë. Dikur njëri nga kapot e diasporës, që na kishte marrë erë dhe na kishte gjetur aty ku nuk mendonim se na gjen kush, e kishte dëgjuar me vëmendje. Dikur nga xhepi nxjerr tre pasaporta dhe ia kishte vënë përpara mikut. Njëri i Hekuran Isajt, tjetri i Herleviqit dhe i treti i vendit ku jetonte. Mua nuk më kishte bërë përshtypje. Mikut iu kishte ndërruar çehra. Një poet nga cepi verior i Ilirisë heq vintjakën e rriptë nga trupi e ia hedh krahëve. I thotë: bukur të rrika. E bajsh me shnet!

Kapoja kishte marrë udhën e vet e ne e kishim përcjellë mikun në hotel. Flitej më vonë se në një farë tefteri nuk kishte lënë të zezë pa thënë kinse për përzjerjen e kosovarëve në Shqipëri. Pas ndërrimit të qeverive prapë ishte parë diku në kokorr. Personalisht ndjeja dhembje. Asnjëherë nuk ma kishte thënë pse kishte ndodhur kjo. Nuk e di as tani.



### 3

Bezdisin e lashtësisë nuk e kisha parë moti. Zumë vend në një stom. Pas shumë bredhjeve nëpër kohë të shkuara, ma zë ngoje një mik. I them kurrë punët më mirë nuk i ka pasur. Më gëzon kjo, më thotë. Por, fjalë pas fjale mikun e kisha parë në një dritë tjetër. Nuk di se ku ishin takuar, ku i këtejmi nis t'i flasë edhe për njerëz të kësaj ane. Bezdisi i lashtësisë i thotë prerat se nuk merret me ato punë. Por i këtejmi nuk ishte ndalur. Për pak nuk kishte mbetur një puro shqiptar. Kjo e kishte bezdisur të tejmin. Sapo ndërronin lokalitë e bënin një shëtitje në rrugën kryesore, ishte dukur njëri i cili ishte zënë shpesh në bisedën e tyre. Seç do të ndodhte, kishte menduar i tejmi. Por të dytë ishin përqaftuar thujtse bashkëshëtitësi i tij një fjalë të keqe nuk e kishte thënë për personin që e takuan në rrugën kryesore të një qyteti, ku ta di unë. Kështu dua t'iu shoh, kishte thënë i tejmi, duke u larguar nga ata. Derisa ma thoshte këtë në stom, më ishte kujtuar tregimi për odisejadën e një makine nëpër zonat gri, që tregohet në kasabën tonë e unë nuk besojta.

### 4

Është më se e vërtetë se kosovarët e duan një Shqipëri pakëz më të madhe. Të tillë e shohin sa herë bie fjala për të. Diç tmerruese për ta janë kufijtë. Po ashtu, është e vërtetë se dashuria ndaj saj ka kaluar bile dhe te pagëzimet e fëmijëve tanë, që rrallë i dëgjon te tejmët. Ka edhe diç tjetër, që kosovarët nuk mund t'iu harrojnë të tejmëve. Ajo gjithmonë na kujton se kush jemi. Pra, nuk besoj se marrëdhëniet brendashqiptare janë ftohur. Të tri kallëzimet e më larta paralajmërojnë se në këto "prishje" mund të kenë dorë të pacipët, që në këtë turravrap tonin duan të dalin në sipërfaqe. Kuptohet pra se fusin huti edhe te ata që nuk besojnë. Në akademinë solemne, pak më parë të organizuar në Prishtinë me rastin e 80 vjetorit të lindjes së akademik Shaban Demirajt, u dëgjua një e vërtetë që rrënon çdo dyshim. I nderuari e tha edhe këtë: Të mos ishte Kosova, do të ishim ende pa Gjuhën e unjësuar letrare. Pastaj kishte falënderuar për

kontributin që jep Kosova për kulturën e historinë shqiptare në përgjithësi.

Shqipërinë që e duan kosovarët, do të ndodhë njëherë. Karagjozët nuk do e bëjnë atë. Dhe të mos qitet menç, një popull nuk e bashkon vetëm gjuha, historia e gjaku...

## VENDI KU NUK VDISET

1

Hijallë ishte shfaqur dikur Bajraktari. Në Kukunënë gjithçka ishte pëshpëritur pastaj, por pak mund të besohet. Deri vonë thashethënat ishin treguar e komentuar sipas qejfit. Udhën e kishte bërë kalli vetëm, krejt i padukshëm.

2

Jashtë nuk pushonin krismë e britma. Nga kati i lartë Shekspiri vështirë kishte pranuar të zbresë në bodrum, ku ndonjë shpirt kishte braktisur tragjeditë e tij dhe mund të kishte probleme diku në terrinë. Atje lart qiellin e kontrollonin mavia e engjëjt. Dëgjohej pastaj ndonjë ushtimë e përplasja e popullit, të cilin e kishin vënë përpara. Tek hapte portën e fundit të bodrumit, Shekspirit ia kishte terruar sytë një dritë e fortë e cila zmadhohej. Mos ishte drita e ndonjë ashti apo shpirti? Me kujdes iu kishte afruar. Pranë një kompjuteri të vjetër qëndronte një njeri, i cili bënte çmos të komunikojë me botën. Ky iu kishte ngjarë në Orfeun, i cili duke u grindur me fjalë, kishte shkelur udhën tjetër.

3

Më poshtë nuk mund të zbresim, kishte folur njeriu pranë kompjuterit, që nuk e kishte ngritur fare kryet, por e kishte marrë me mend se aty mund të zbriste edhe Shekspiri. Nga këtu vetëm mund të ngjitemi, kishte shtuar më vonë, kur kishte kapur sinjalet e para. Shekspiri e kishte dëgjuar pakëz në ethe. Mezi e kishte çelur gojën: ne vdesim pa na parë kush e pa na qarë. Edhe Bajraktari e ka braktisur kullën. Ne jemi të fundit në këtë fund të fundit..

4

Njeriu që merrte e jepte diçka me kompjuter, për herë të parë e kishte drejtuar shikimin nga Shekspiri. Iu kishin parë pastaj vetëm dhëmbët, gjysma të thyer e që i kishte kapluar një e verdhë gati e ngjashme me atë në pikturat e Van Gogut. E kishte lutur Shekspirin të zë vend pranë tij. E konsideronte njohës të hollë të intrigës. Mund të trillonte edhe të fundit.

5

Kompjuteri prej kohësh qëndronte aty dhe nuk e dinte kush pse e kishin sjellë në fund të bodrumit. Njeriu që qëndronte pranë tij bënte çmos të vëjë kontakt me të gjallët e tejmë. Orfeun thonin se e kishin parë më vonë në një kolonë të gjatë me një boshqe tesha. Megjithatë, Shekspiri kishte vendosur të zbresë në bodrum. Në fillim kishte pasur frikë. Më vonë zbuloi se edhe aty mund të shpikësh gjëra të mrekullueshme. Dikur i kishte rënë ndërmend një mesazh, pakëz makabër. Një tjetër që qëndronte pranë kompjuterit e kishte dëgjuar me kujdes. Dhe kur i kishte thënë nga sot, na paska vrarë mavia dhe ne jemi të vrarë për botën, Shekspiri kishte kërkuar toaletin. Lajmin sapo e kishte dëgjuar, njeri i tejmureve të kullës kishte pëshpëritur: nuk është e mundur. Ka nevojë bota për klaun.

6

Bajraktari kishte sa vjet që dergjej. Mbasi kishte dëgjuar më të keqen, kishte urdhëruar arkat t'i sillnin në odën e madhe, ndërkaq çelësat ia kishte sjellë gruaja. Pastaj kishte ngritur vetëm dorën. Oda ishte zbrazur. Kishte sa vjet që nuk ishte çuar në këmbë të veta. I kishte hapur arkat. Nëpër tërë odën urdhëron të derdhet pasuria dhe kishte filluar ta pëshurrë. Njëri që e kishte shikuar atë skenë të pahijshme të Bajraktarit, kishte zbritur shkallëve shpejt, i kishte lajmëruar edhe të tjerët. Tërë ajo që kishte ndodhur brenda në odë, e kishin parë me rend. E fundit kishte arritur gruaja e tij. Pasi kishte parë seç ndodhet dhe kishte dëgjuar pastaj një gaz rrëqethës, kishte urdhëruar të hapet dera. E qeshmja e tij ishte dëgjuar deri atje poshtë.

Dikur ishte përplasur gjerë e gjatë. Në një cep letre kishin gjetur ca fjalë: ç'më duhet e gjithë kjo pasuri kur nuk ka liri. Tregojnë pastaj se një i çmendur ia kishte vënë flakën kullës. Botën e shikonte ndryshe.

7

SZ kishte parë në ëndërr vendin ku nuk vdiset. Do vish, e dashur? - i kishte thënë në vesh. Ajo vetëm kishte pëshpëritur: sa bukur! Dhe pas katërdhjetë vjetëve SZ kishte shkëlur në vendin që i thonë Kosovë. Me ditë, me net kishin bredhur dhe kishin pëshpëritur: ky është vendi ku nuk vdiset. Kishte dëgjuar ajo edhe shumë kallëzime. Një mesditë SZ e kishin përcjellë në rrugën e tij të fundit. Pranë gurit të tij, e dashura ishte dëgjuar: vërtet këtu nuk po u vdiska. Me një lule kishte vazhduar të bredhte: sa lumtur. “As në ëndërr nuk e shoh vdekjen...”

8

Poeti Visar Zhiti kishte hapur librin e vet më të ri “Si shkohet në Kosovë” me këto vargje:

*copëza eposi  
të mosvajtjes  
të luftës në mes  
dhe të ëndrrës.*

## MBAMENDJA

### 1

Kulla e Jasharëve nuk është rastësi. Është kujtesë, mbamendje. Faqet e para të historisë sonë më të re mund të fillojnë nga aty. Ajo ma kujton shkakun e ngritjes së kullës sonë, funksionimin nëpër kohëra, kodin e saj që ka kultivuar. Disi bashkon breza, fate. Kur gjendem ballë ndonjë kulle të tillë, më bëhet se dëgjoj zërin e dheut, të baballarëve; mesazhet që duhet përcjellë pasardhësve. Këtë përshtypje e kisha edhe ditën kur u gjenda në odën e Jasharëve.

### 2

Fenomeni i ndërtimit të një kulle ka diçka të legjendave. E kisha përcjellë ngritjen e njëres aty në krye të lagjes. Më plaku kishte thënë nuk qëndron po qe se në themelet e saj nuk derdhim një pikë gjak. Dhe e kishin dëgjuar. Hedhja e gurit ishte përcjellë me një kurban. Kishin sjellë pastaj gurë gjithfarë formash nga Gryka e Drinit. Ishin gjetur dhe latuesit. Një mëngjes kishte nisur: gur mbi gur, lidhja e çuditshme e gurëve dhe harqet plot fantazi. Në mbarim të stinës gati nuk e kishte prekur qiellin. Isha fëmijë atëherë. Botën e shihja me ngjyra. Me të lagjes gjendesha shpesh aty, mes mjeshtërive. Përditë ngrehina prej gurit dallonte nga shtëpitë tona. Dikur ia kishin qitur kulmin dhe kishin nxjerrë oxhakun. Më vonë, në atë majë, ishte lëshuar një lejlek dhe nuk e kishte harruar kurrë çerdhen e re. Ky është fati, thonin, por kulla shpesh humbi nga diçka në përjetësinë e vet.

### 3

Guri është jetëgjatë, i shëndetshëm, na flitnin më të moçmit, që kishin pasur punë me të. Ngrihesha në majë të gishtërinjve, i lëmoja ata duke u renditur, vëja faqen e rjepur nga dielli në gurin që mendoja

se fshihte magjinë e çuditshme. Dikur largohesha pa bëza. Nuk kisha mundur t'ia zbuloja fuqinë e tij. Më vonë tek flitej se filani ishte bërë guri. Ia lexonim emrin. Ai nuk ishte vetëm. Lëvizja e përgjakesha mes gurëve. Fillova të mësohem me heshtjen e të folmen e tyre.

4

Pas ca vitesh kisha shkruar edhe një poezi, ku përpiqesha të vëja në spikamë madhësitinë e saj. Aty thoja: për shkak të dashurisë, për shkak të urrejtjes babai im ka ngritur një kullë... Diçka për t'u admiruar pra, diçka për t'u vetëmbrojtur. Dhe kur gjendesh mes mureve të saj, ndjehesh njëfarë zoti që mund ta drejtosh fatin tënd. Nëpër dritare kisha përcjellë fluturimin e lejlekut, vrapin e fëmijëve të lagjes. Mund e gjente çerdhen e dikurshme ai zog shtegtar dhe mos i kishte rënë peri i kuq nga këmba?

5

Kisha qëlluar në Vjenë. Bota përcillte nëpërmjet ekranit rrënimin e Kullës së Jasharëve. Paranoja serbe ishte në shkallën më të lartë. Nën një çati renditëshin trupat pajetë: fëmijë, gra e burra. Nxirreshin prapë nga dheu. Në heshtjen mortore kisha dalluar historianin trim, dr.Zekeria Canën. Në kujtesë më mbetën edhe lëvizjet e burrave të tjerë në atë muzg të ftohtë që kaplonte Kullën e Jasharëve dhe tërë Kosovën. Kisha mbyllur sytë. Barbaria serbe nuk mund të rrëronte edhe imazhin për kullën shqiptare, që për mua shndërrohej në një tempull të shenjtë. E Kulla e Jasharëve nuk ishte rastësi, që kishte tmerruar armikun.

6

Nuk di ideja e kujt është as ç'mendon kryezoti i tashëm, por aty shqiptarët duhet të kthejnë më shpesh; të shohin ç'do të thotë të kesh një copë vend tëndin e të jesh i lirë. Para portave të saj të pushojnë të gjitha hasmëritë brendashqiptare. E, sidomos kur nuk dihet ende kur e si do ta mbyllim maratonën tonë. Është mirë të mësojmë edhe nga të

tjerët; t'u përlesh atyre që nuk kursyen as jetën, nderon vetveten dhe të kaluarën tënde. Na duhet guxim intelektual e njerëzor. Në një kullë kombi vepron kodi etik, nuk ndahen etiketime. Në të parë, dikujt kthimi ynë aty i duket pakëz i tejkaluar, por efekt mund të ketë të populli në uljen e tensioneve e fërkimeve brendashqiptare. Armiku është tjetërkund. Para të tjerëve nuk bën të lëmë përshtypje se nuk jemi popull. Këtë e trumpetojnë edhe fqinjë tanë.

7

Nëse nuk e respektojmë të kaluarën tonë, kush ta bëjë këtë? Pra, kush kërkon të mbesim popull pa kujtesë, të harrojmë Prekaz, Reçak, Bllacë...?

8

Kisha bredhur Kosovës dhe kisha veneruar se nga lufta e fundit më përshëndetnin vetëm oxhaqet e ndonjë muri, që i kishin shpëtuar vdekjes serbe. Në lagjen time kisha zgurdulluar sytë në një kullë gati të rrënuar. Isha sjellë rreth saj. Kërkoja edhe fëmijërinë time, buzët e mia të çara në gurin e qëndrueshëm e të shëndetshëm, një rrënjë guri për t'u mbajtur më tutje...



## PSE KY TEKST KA ZJARRMI?

1

Një i Kalemhanës ma zuri pusinë e më tha se pesëdhjetë peshkatarë kanë nënshkruar një peticion për të më dëbuar mua nga Vilajeti i Errët. Brenda dy ditësh, më tha trimi, ta braktisësh Atdheun se nuk na çelin lulëkuqet nën hijen tënde, as bien peshqit në rrjeta. Mora janxhikun dhe kërkova azil diku në plazhet e Ilirisë. Dhe, kur mendoja se më kishin harruar, mësova nga një lajmëtar se peshkatarët ishin shumuar dhe përgatiteshin të më mbulonin me gurë ose të më digjinin në një turrë teftërësh. Nuk kishte më hajgare. Kokat e zbrazëta prinin në krye të një kalvari të ardhshëm, por ende nuk dukej Kryekungulli.

2

Duke parë Shkëmbin e Kavajës, kisha parafytyruar Çabratin. Nuk ishte asnjë pëllëmbë më i lartë se Pylli i fëmijërisë sime. Dallimi qëndronte: i pari u këndua në një këngë kavajase, kurse ky imi hyri në poezi të shumë poetëve. Dhe tek e matja lartësinë e Shkëmbit, më ra ndërmend poeti i rezistencës franceze. Ai quhet Pol Elyar. Në vitin 1949 kishte braktisur tinëz Francën dhe ishte nisur për në Greqi t'u dalë zot luftëtarëve të lirisë. Në rrugë e sipër ishte ndalur edhe në Shqipëri. Dhimitër S. Shuteriqit i kishte lënë një autograf në një libër. Këtë e përktheu pastaj bezdisësi i lashtësisë, Moikom Zeqo, por titullin e poezisë së Elyarit ia vura unë.

## Shkëmbi shqiptar

*Si është e mundur? Unë nuk kam parë kurrë  
qiell kaq të qetë e zemra kaq të qeta.*

*E megjithatë furtuna po çmendet  
rreth shkëmbit tuaj.*

*Qielli u përngjet zemrave. Në Francë ai është  
po aq i bukur, veçse: plagë e zemrës  
plagë e qiellit!*

### 3

Qeni me emër Monaliza nuk kishte mundur ta linte vendin e vet pa e nxjerrë pasaportën. Dhe atë ia kishin dhënë mbasi bënte udhëtim në Ballkanin e shqetësuar. Rastësisht e takova dhe ia lexova emrin në pasaportën e gjelbër. Të them të vërtetën, ndjeva ligësi. Derisa Evropa lëshon pasaporta edhe për qen, unë vuaj burgimin tim në liri dhe parafytyroj si do të duket pasaporta dhe fotografia ime në të. Thonë se pasaportat e ardhshme vështirë falsifikohen. Deri atëherë do vuaj edhe pakëz mes hienave...

### 4

Kur nuk ka mace, minjtë e bëjnë lëmë shtëpinë. As shi nuk bie më në kollomoç. E keqja më e madhe se mund të mbesim pa çati, por dikush mund t'i ketë ruajtur tendat dhe shiu nuk do të na kalbë deri në rrënjë. Pas vërshimeve, ata që do të vijnë, do ta kenë rrafsh këtu e në Trojë. Do e shohin edhe Kryekungullin, duke luajtur me zjarr...

### 5

Më tha njëri nga ata: katër fjalë të veta nuk i ka në teftër. Për këtë na vjen keq të tregojmë. Moti kemi vdekur e fshihemi

pas fantazmave tona, të mos na varrosin edhe pak. Ai që e tha këtë është burrë katërqind dërhemësh. Kurrë nuk i ka rënë mohit...

6

Ku e keni Kryekungullin? Dhe, ai që kishte pyetur, kishte mbledhur një tufë të freskët lulësh dhe secilës xhenaze ia kishte lënë te koka me të vetmen fjalë: na falni që u ramë në qafë. Kishit të drejtë, por ashtu kishte urdhëruar Kryekungulli.

7

Nëse nuk keni ku ta ndezni cigaren, fërkojeni për lëkurën time. Ka zjarr edhe për një planet...

8

Zoti u pastë në dorë... Ja pse ky tekst nuk mund të lirohet nga zjarmia.

## NJERIU I DY MILENIUMEVE

1

Askush nuk mund të demantojë se nuk kam jetuar në dy mileniume. Të dytin e mbylla me një klithmë njerëzore. Të tretin do ta hap se çfarë ka. Brisku i berberit vazhdon të vezullojë prapë. Edhe mileniumi i ri nuk do të jetë pa probleme. Ndonjë mik i pavrarë ende, do ta lë epitafin: lindi në mileniumin e dytë, të tretin as e grithi.

2

Do t'i kem mbi njëmijë vjet. E dashura ajo e ditës së parë: e freskët, e bukur dhe e pavdekshme...

3

Ata që nuk e përjetuan, as nuk ia panë surratin mileniumit të dytë, do thonë: çfarë njerëz paskan qenë baballarët, nuk paskan ditur të vdesin. Deri në kohën tonë gdhijnë!

4

Në mes dy mileniumeve ndodhën vërtet çudira mbi çudira. Vizuelisht e lexuam Biblën moderne. Kjo ndodhi para një mijë e një viti. Nëpër Blacë kisha mbledhur fjalët e therura. I solla në mileniumin e ri. Mund të bëni ç'dëshironi me to.

5

Ne kishim probleme të tjera. Mbetëm kokëfortë se besonim në dinjitetin njerëzor. Na gëzon nëse kush gurin e vë në vendin e vet.

6

Do të flitet si për diçka tepër, tepër të largët. Kjo ngjarje ka ndodhur në mileniumin e dytë, do të thonë. Kishin arritur të shpëtojnë nga xehneni ca libra dhe një flamur. Më pak do të dëgjohet se shqiptarët ishin njëri nga dy popujt më të vjetër të Ballkanit dhe gjuha shqipe ishte e dymbëdhjeta gjuhë botërore, siç e mbështeti këtë edhe një shkrimtar i hershëm. Me ardhacakë do të ketë telashe prapë. Nuk mund të shkulen nga mesjeta, e cila paska ekzistuar tash e një mijë e pesëqind vjet më parë. Por deri ku qenka shtrirë Vilajeti i Kosovës?

7

Udhëtimi i mëtutjeshëm varet te organizimi. Do e bëjmë udhën si fis apo komb? Na pëlqeftë nocioni i parë, mileniumin e ri vetëm do ta prekim. Ndokush mund të shkruajë: në Ballkan kanë ekzistuar edhe ca fise. Po që se mbështesim nocionin e dytë, do të mundim të keqen. Prapë fqinj veriorë do t'i kemi fiset sllave dhe grekët do t'i luten Zotit të mos zbresim më poshtë. Por ç'bëjmë me shkamin që na mbet fatkeqësi.

8

Detrat tanë do të lagin çdo pëllëmbë të tokës sonë, e cila zdirgjet e del nga ta. Besoj se më të copëtuar nuk do të jemi. Do ta gjejmë edhe ne Zotin tonë. Mund të ketë edhe ndonjë luftë. Por kufiri kohor shqiptar mbetet Bllaca. Tej vitit 1999 dardanët shtriheshin deri aty, në mileniumin e tretë arritën deri këtu.

9

Shkaktar do të jetë Evropa për gjithçka që ndodh me ne. Kur të kthehen ata me Liburnë, lëjuni hapur librat tanë të moçëm...

I besojnë këtij shkrimi ata që pranojnë se nuk kanë kremtuar asnjë përvjetor të rëndësishëm. Vargun e thënë në mileniumin e dytë:

*Kosova është gjaku im që nuk falet, më vjen keq të përsëritet edhe në mileniumin e tretë. Fundi kurrë nuk dihet.*

10

Shoh se çdo gjë jona ka mbi një mijë vjet. Të kujtojmë ku ishim, ose rrotën e historisë ta luajë ai që nuk beson. Rileximi i ngjarjeve bëhet i tmerrshëm.

Një telefonatë nga mileniumi i kaluar: a sheh, na bëjnë shtet! Në këtë qyshk, moti e kishim, i them, por nuk ditëm ta mbajmë, se nuk kishim Zot..

Më i vjetër se dy mileniume jam megjithatë. Ngris dollinë për dashurinë që vazhdon të ndritë udhën teht të kepit.

## TI DHE VRASËSI

### ËNDRRA KALLËZOHET NË MËNGJES, NË KOHË TË BUKUR

1

Pasi isha nun, nuk bënte të mos gjendesha në përvjetorin e parë të “Alternativës” (qershor 1990), e cila ishte shndërruar në një armë të fuqishme kombëtare për rrënimin e robërisë dhe të servilizimit të shoqërisë shqiptare. Salih Kabashi njoftonte se në krenim nuk do të mungojë askush. Me aeroplanin e parë pra, me autobusin ose trenin e parë, të nisemi. Milazim Krasniqi i siguroi biletat dhe në Fushë-Kosovë, pas një debati me një gjynah krijuesi të minoritetit, hipëm në Akropolis. Tërë udhëtimin e kaluam në këmbë, pa bërë një kokërr gjumë. Të nesërmen pasdite arritëm në Lubjanë. Na pritnin Jasha Zlobec dhe Vladimir Sheks, i dalë taze nga burgu.

2

Pa pirë as kafe, zumë vend në sallën përplot njerëz. Qartë shihej se “Alternativa” e kishte përnjëmend dhe shkonte deri në fund me shpejtësinë maksimale. Asnjë centimetër nuk luante nga udhëzimet e shoqatës “Migjeni” dhe këshillat e intelektualëve. Dëshmonte se

shqiptarët, kur janë të organizuar dhe kur dinë ç'kërkojnë, i dalin në krye çdo marshimi. Pas paraqitjeve të organizatorëve dhe të miqve vendës, dolëm edhe ne. Unë i lexova poezitë “Kush do ta vrasë ujkun”, “Fajtor është shqiptari” dhe “Egërsinë”. Në gjuhën sllovene i lexoi një aktor i Teatrit Slloven. Milazimi mbajti një fjalë entuziaste dhe përmbajtësore, që u përcoll me duartrokitje.

Shkilnim në rrugën që nuk ka kthim.

### 3

Për herë të parë u njohëm aty edhe me disa miq, që më vonë do të gjenden në radhët e UÇK-së. Çdo gjë punonte si sahati. Lubjanën e njihja edhe më parë. Kisha miq dhe dy libra të botuar në gjuhën sllovene. Moti e kisha hetuar se aty vepronin rryma të ndryshme dhe binin ndesh me lirinë e të drejtat nacionale që ofronte ish-bashkësia, e cila mund të emërohej edhe Serbi e Madhe. Krah i fortë i lëvizjeve të tilla ishin masmediat sllovene. Jashën e kisha shpallur me kohë avokat të ligjshëm të çështjes shqiptare në shtetin e tij. Nuk besoj se kush ka bërë nga të huajt më shumë se ky. Dhe, në Bruksel, si ambasador i Sllovenisë, Jasha bëri më shumë se një mik imi nga Tirana, që kryente ambasadorllëkun në hapësirën frankofone. Këtë e mundonte një problem: nëse sllavët i bashkon shumëçka nga kultura e historia, ç'ju shtyri juve, shqiptarëve, të gjendeni në këtë bashkësi fantom. Në asnjë rrafsh nuk keni asgjë të përbashkët me sllavët. Ky ishte në lëvizjen sllovene. Bashkë me kroatët kërkonin aleatë. Më të guximshëm nuk mund të paramendonin se ca intelektualë tanë.

### 4

Në këtë afri, ndikim të madh kishin prijtarët e “Migjenit” dhe të “Alternativës”. Varej momenti se kur do të eksplodojë. Edhe bunkerizmin e shoqërisë shqiptare e pushtonte revista. Ç'ishte qenësore, nga numri në numër kërkesat e saj bëheshin më të fuqishme për pavarësinë e Kosovës dhe për mposhtjen e diktaturës. Revista kërkohej si mall kontrabandë. Dorë pas dore shpërndahej edhe ku



vështirë shqiptohej gjuha shqipe. Për pak kohë, “Alternativa” i bashkoi të gjitha skajet e shqiptarisë.

## 5

Arti e jeta nuk kishin censurë, as krijuesit t'i frikësoheshin gogolit ideologjik. Edhe pse rrethi ngushtohej, ne e kishim të hapur dritaren dhe gjallëronim. Salih Kabashi, kryeredaktori i saj, i ngjante drugëzës së vekut. Shpërndante shpirtin e mendimit shqiptar ku ekzistonte edhe një frymë. Tirazhi ishte habitës, fantastik edhe për metropolet me traditë.

Pas 50 vjet robërie, shqiptarët flitnin siç u ka hije. Me shkrimet e tyre kultivonin guximin krijues e njerëzor. Nuk u treguan grindavecë e bajraktarë nahijesh. Çështjen kombëtare e shikonin si çështje gjithëkombëtare. “Alternativa” mori këmbë në Lubjanë, ku nuk mungonte përkrahja e opozitës dhe e intelektualëve të shquar sllovenë: Jasha Zlobec, Petar Bozhiç, Matjazh Hanzhek, Viktor Blazhiç, Dane Zajc e shumë të tjerëve. Ishin këta kundërshtarë të pakompromis të shtetit totalitar dhe të cënuesve të lirisë njerëzore. Shtëpitë e tyre na ishin bërë edhe çati tona. Na njoftonin edhe për grackat e policisë sekrete. Na furnizonin me informata të dorës së parë, me shkrime e elaborate të panjohura për çështjen shqiptare. Rezistenca jonë u bë edhe çështje sllovene. Ata gjendeshin më afër burimit dhe mbanin lidhje të forta me “Alternativën”. Shumicën i njihja. Poshtë e lart i kishim rënë asaj krijese fantom, që asgjë për be nuk kishte timen. Vërtet, habitësja ç'i kishte shtyrë baballarët tanë të ishin aq të verbër ndaj sllavëve?

## 6

Shkaku i guximit dhe i së vërtetës, u vunë më vonë në shënjestër shoqata “Migjeni” dhe “Alternativa”. Por, guximi njerëzor e intelektual çfarë nuk mund të bëjë. Rezistenca shtresohej. Merrte kuptime të reja. Ballafaqohej me të papritura. Lidhjet mes veriut dhe jugut, megjithatë vështirësoheshin, informata e shkrime me rëndësi arrinin edhe në skajet më të harruara të Kosovës.

“Alternativa” dhe botimet e saj të mëvonshme kërkoheshin e lexoheshin tamam si një abetare e guximit njerëzor. Ishte e qartë se shpirti i të revoltuarve dhe i të përbuzurve është vështirë të mposhtej. Nëpërmjet miqve, që shtoheshin, siguronim shkrime më se sekrete. Ndër të parët dispononim edhe me elaboratin monstruoz të albano-fobit e nobelistit Ivo Andriq, për zhdukjen e shtetit dhe të popullit shqiptar. E kishte nxjerrë në dritë prof. Bogdan Krizmar nga Zagrebi. Poeti Xhevahir Spahiu (1978), tërë kohën sa ishte në Kosovë, kishte rënë e ishte zgjuar me të në gj, nga frika se mos ia zbulonin. Siç lajmëronte më vonë, ishte përkthyer dy herë nga një mik yni kosovar. As kreu i shtetit shqiptar nuk mund të besonte se ç’shkruante një nobelist. Ishte zhytur thellë në gjenocid të një kulture e populli. Do të thotë, vepronte një vetëdije e lartë besimi e guximi i ndërsjelltë mes të rebeluarve. Merita u takon, pa dyshim, prijtarëve të “Migjenit” dhe të “Alternativës”: Naim Malokut, Salih Kabashit, Fadil Demirrit, Gani Buçincës, Ukshin Hotit, Halil Matoshit, Bislim Elshanit e shumë të tjerëve, të njohur e të panjohur. Nëpër faqet e “Alternativës” dhe të fletushkave të tjera gjithandej Evropës ngriteshin çështje fundamentale për kombin e të ardhmen e Atdheut. Shqiptarët kishin zënë ta lexojnë edhe fshehtësinë dhe bunkerizimin “ta bombardojnë”.

Ishte bërë e lexueshme edhe intriga serbe. Unë kisha mbrojtje një poezi të shkruar qysh si tinejxher. Ajo mban titullin “Flamur shekujsh”. E ç’fshihej pas atij “flamuri”, dëshmonte më së miri rebelimi i fjalëve të mia. Ta quajmë mjeshtëri ezopiane këtë, e kishin kuptuar fare mirë miqtë e mi. E lexonin si alegori dhe mençuri në një zezonë. Njeriu nuk hiqte as sa një mi. U kishte rënë në sy edhe sllovenëve e kroatëve. Zhonglerizimin e fjalëve e lexonin si thirrje për rrënimin e një politike. Nuk e fsheha kurrë këtë vargim, edhe për arsye të tjera. E kisha njëfarë mburoje. Pra, nuk veprava si ca aparatçikë, që kishin shkruar me tonelata për Mareshalin e shokun Stalin. Manipulimi është zhgënjim, ikje e distancim nga historia. Këtë mund ta bëjnë ata që kanë bërë faje ose duan të gënjejnë se gjithmonë ishin ari.

Gjatë pesëdhjetë vjet robërie nuk mbahet ndërmend të ketë ekzistuar në trojet shqiptare një revistë si “Alternativa”. Dërmuese dhe e guximshme, i bashkoi të gjithë shqiptarët e të gjitha ngjyrave partiake. Ishte moment vendimtar i zgjimit kombëtar, të manipuluar e të fyer. Jehona e saj hetohej edhe nëpër metropole. Nuk kursente askush asgjë. Revista sensibilizoi dhe preku temat tabu të shoqërisë. Në përvjetorin e dytë, “Alternativa” u shndërrua në një tribunë të vërtetë shqiptare. Për herë të parë paraqitej edhe Demaçi në mesin e miqve dhe të bashkëvendimtarëve. Për tubimin në Lubjanë nuk ishte shkas vetëm revista. Kryeqyteti slloven tri ditë gumëzhiu. Kënga “Bjen një tupan në Dardani”, paralajmëroi hallakatjen shqiptare. Shkëputjen nga muzgu i stepës dhe kthimin tonë definitiv nga vlerat perëndimore. Ëndrrën e rilindësve, por edhe shfaqjen e varrezave masive diku në tokën dardane.

## 8

Të vonuarit dhe të painformuarit mund ta konsiderojnë këtë diskurs si lajthitje të një përgjumuri. Por me guximin e viktimizimin e gjeneralit tonë të pavdekshëm, Adem Jashari, dhe të tjerëve, ndodhi çudia shqiptare...

## 9

Pas dhjetë vjetëve, kur flasim për “Alternativën”, ne flasim si për një ëndërr, që do të lexohet nesër. Unë e kallëzova vetëm një detaj të saj, se ëndrra kallëzohet në mëngjes, në kohë të bukur...

## VRASJA E ËNDRRAVE

Petro Marko thoshte: “E dua Kosovën gjer në dhembje...” Por ç’ndodh? Brenda një kohe të shkurtër ranë dy komandantë të UÇK-së Murrizi dhe Drini. I kishin shpëtuar plumbit të armikut, por nuk mund i shpëtuan plumbit, që bredh në hapësirën tonë të shkrepur nga kushedi kush. Nuk i kam njohur as më intereson se të cilës parti, formacioni e bajraku ishin. Ishin çlirimtarë të Kosovës dhe na turpëron ajo që ndodh. Kjo më dhemb dhe më shtyn të derdh vrerin si krijues e njeri, se para nesh trimëria jonë rrallohet... Vrasësi nëse mendon se ka bërë punë patriotike, ai nuk mund të jetë i asaj dhembjes së Petro Markos. Por duke vrarë veten e duke nëpërkëmbur amanetin e atyre që u bënë tokë Kosove, ne kemi bërë punën e armiqve tanë. Dhe, nuk di çfarë burrërie është të vrasësh çlirimtarin tënd?

Në krye të udhëve e në udhëkryqet tona, nënat, motrat, vashat, fëmijët i presin më të dashurit nga kazamatet serbe; ende shpresojnë për të zhdukurit; ende dheu ynë nuk frymon si duhet; ende oxhaqet tona të nxira luhaten në ajër; ende rrobat tona nuk na janë tharë nga gjaku e loti. Jemi popull a fis? Vritemi për gjëra banale në një kohë kaotike; vritemi dhe për një karrige, pse i këtij apo i atij krahu qenka! Por ne jemi shqiptarë, bre burra.

Lajme kobi nga dheu ynë mund ta gëzojnë vetëm regjimin kriminel serb dhe bashkëmendimtarët e tij; mund t’i gëzojnë qyqarët e servilët, që vrapojnë si hiena duke ndarë etiketa e prish ekologjinë shqiptare. Lajmeve të tilla u frikësohen dhe miqtë tanë, që na dolën krah gjatë vitit biblik shqiptar dhe që duan të na bëjnë atë që e ëndërruan dhe rilindësit tanë. Aq shumë trumbetuam për etikën tonë, ne populli më i fyer e më i nëpërkëmbur jo vetëm në Ballkan. E tani, e tani shtimë në njëri-tjetrin. Vrasim vetveten ose na vrasin se nuk dimë

të respektojmë as t'i mbrojmë vlerat tona. Vrasja në kohë lirie është veti burracakësh.

Është çudi ne që e luftuam armikun, duam më shumë se e meritojmë: brenda nesh prodhojmë armiq, se ajo kafshë e zezë na u fshihka vetëm në ne, prandaj dhe kobi na derdhet si trup para derës. Kjo rrënon dhe madhështinë e UÇK-së.

Për një çast t'i kthejmë sytë nga varrezat masive dhe të lexojmë mesazhin e më të dashurve tanë; të pyesim veten: të ishte gjallë gjenerali ynë Adem Jashari me trima të tjerë, do të na pranonte në radhët e veta apo mallkonte për sjelljet tona?

Ne kemi vetëm një ideal: lirinë dhe atdheun, evropianizimin tonë dhe respektin ndaj vlerave njerëzore. Pushka që kërset në kohë të rindërtimit të qenies sonë dhe të vendit, nuk është gjithmonë pushkë gëzimi.

Ndalen! dorën, burra! Nuk është trimëri të vrasësh veten. Ky është dhe vaji i atyre që e duan Kosovën, lirinë e çlirimtarin e saj...

Petro Marko turpin tonë do ta quante vrasje e ëndrrave, e shpresave dhe e jetës...

## BALADË PËR NJËQIND E KATËRDHEJTË E TRE

Nitën e vogël që më shikonte dhe përpiqej të më bënte të qesh, me një gaz jo të zakonshëm e pyeta: di vogëlushe të numërosh deri në 1632. Pa të keq më shikoi dhe ia nisi. Dikur, pa sherr, më tha: më fal, nuk mundem më. E shikova atë dhe mezi i thashë: këto nuk janë ditë, janë vite burgu për liridashësit tu, vogëlushe. Kur të rritesh, do të mësosh kuptimin e kësaj fjale dhe pse ishim shpesh numër e të rëndë në tokën tonë.

Për pikë qejfi vritet, masakrohet e fyhet shqiptari, për pikë qejfi dënohet pse është shqiptar dhe pse lirinë e konsideron si të drejtë njerëzore dhe nuk do të dallojë nga të tjerët. Por në këso raste nuk ban me u ligshTue, do të thoshte Gurakuqi. Vetë numri i viteve flet shumë, është numër absurd; bart dhembjen e lotin jo vetëm të familjeve gjakovare e rrethinës së saj heroike, por dhe të botës së qytetëruar, që di vlerën e lirisë. Ky antihumanizëm lexohet edhe si fundi i një regjimi kriminal; si fundi i një çmendurie dhe primitivizimi serb.

143 shpirtëra të qytetit tim, i veçantë për shqiptarinë, duhet të na bëjnë më të fortë e më të mençur në pakthimin tonë, duhet të na forcojnë para ligshTisë njerëzore. I kuptoj nënat, motrat, vëllezërit, fëmijët e gratë e tyre, por e keqja nuk mundet me të keqen, por me dinjtet dhe këta të 143 tani më janë fëmijë e vëllezër e baballarë të të gjithë shqiptarëve dhe liridashësve anembanë botës. Të dënosh njeriun (dhe të miturit) pse është i gjakut tjetër dhe pse do të ndërtojë ardhmërinë e vet ashtu siç dëshiron e ëndrron, është krim ndaj vlerave njerëzore dhe qytetërimit perëndimor që mu në Kosovë ndali regjimin kriminal serb...

Dënim më absurd nuk mund të dëgjohet në një vend të civilizuar. Kjo është ajo xhungla serbe, që flet për dinjtetin e racizmin e qyqarinë serbe njëkohësisht. Një shtet që dënon liridashësit, ai nuk di

ç'është liria; fatkeqësisht ai bën përpjekje të jetojë edhe më nga gjaku e thika. Por ne nuk bën t'ua mundësojmë këtë kënaqësi.

Me rastin e trevjëtorit të ikjes së mikut e poetit, Azem Shkreli, tek flitja në Pejë, kisha ndër të tjerë si nëpër fjalë më ishte përzier edhe një vaj burri për baladën e lirishtësve dhe isha bindur se qyteti im nuk ishte më vetëm qyteti i gjakovarëve e i rrethinës, por i tërë shqiptarisë. Më ishte kujtuar dhe Drenica kur ndezi pushkën e parë, na u shndërrua në vendlindje të të gjithëve. Dhe pikërisht ditën kur varrosej Familja e Jasharëve, ish-ministri i Punëve të Jashtme të Austrisë, Alojz Mok, kishte thënë: Evropa duhet të jetë pranë Kosovës. Dhe ashtu ndodhi...

Vërtet numrit pikëllues nuk mund i rashë në fund as unë. Nita më ra në qafë: e sheh? E putha atë edhe për ata dhe gjithë të tjerët që në mënyrë më dinjitoze fyejnë “drejtësinë” serbe. Nuk di çfarë opozite e intelektualësh mund të rrisë një soj i tillë, që nuk ka guxim njerëzor t'ia zgjasë dorën fituesit dhe të mbesin fqinjë të mirë.

Ky nuk është turpi ynë. Kjo duhet të na trimërojë dhe, siç tha shkodrani i dijshtëm: Nuk ban me u ligështue. Qyteti im nuk është më vetëm imi. Ai është i veçantë. Edhe në mort e gëzim. Qytet antik...

## LOT E DASMA

Nuk kam asgjë kundër gazmendeve tona, bile të ketë sa më shumë se mjaft hoqëm të zitë e ullirit, por erdhi koha e hallakatjeve, e ahengjeve? I kujtohet kujt se ende kemi zi dhe ende varrezat masive nuk janë shpluar as dihet numri i tyre? A mendojmë se dikë e lëdojmë me këto britma të paartikuluara e me gjithfarë dekoresh orientale? As ndaj familjeve, që pësuan gjatë luftës, as ndaj të huajve këto hallakatje nuk lënë përshtypje të mira. Po ashtu, si u bë brenda një kohe të shkurtër të harrojmë tragjedinë tonë e gjithë ata të zhdukur e të burgosur që shpesh me tubime e shkrime tona alarmojnë shtete e institucione më të larta ndërkombëtare?

E, rrugët tona gumëzhijnë nga gazmendet, shpesh në dekor të huaj; nuk mund t'i shpëtojë as flamuri kombëtar, edhe pse e vëjnë në krye të kolonave. Pak gjë kanë me traditën shqiptare. Brengosëse është kjo. Mos e teprojmë e bëhemi gazi i botës?

Më poshtë banesës, ku gjendet imja, banon një familje dukagjinase, e vendosur pas luftës. Dritaret e saj gjenden karshi të miave. E, kur gumëzhin rruga e fluturojnë makina me trupa gjysmë të lakuriqar në dritare, pastaj ato britma, një dorë burri a gruaje lëshon roletat me rrëmbim dhe derisa të kthehet qetësia nuk ngriten ato. Ajo dorë shpesh duket në dritare.

Trokita një ditë në derën e tyre. Ajo që mësova ishte pikëlluese. Kishin humbur disa anëtarë të familjes dhe burrë e grua ishin vendosur në banesën e djalit që paska punuar në mesin tonë, por edhe këtë lufta e paska hedhur diku e nuk dinin për fatin e tij. Tek bisedonim, u dëgjuan sirenat e zërat e paartikulluar, pastaj u pa ai dekori i përditshëm i kasabasë sonë. Plaka u ngrit. Me rrëmbim i lëshoi roletat. Nuk dija ç'të bisedonim dhe ku t'ia nisnim. Ika në shtëpi dhe në shenjë të dhembjes së tyre lëshova roletat edhe unë. Dëshiroja



të shkëputesha pakëz nga çmenduria jonë e përditshme dhe t'i kujtoja të gjithë ata, që nuk janë më në mesin tonë.

Pas një jave në derën time dëgjova një trokitje të lehtë. Ishin pleqtë fatkob. M'u lutën t'i shpieja deri në periferi, ku ishin ekspozuar teshat e të masakruarve e të varrosur në Dragodan. Dy orë qëndruam në atë ekspozitë të dhembjes me shpresë se gjenin ndonjë shenjë nga djali. Vetëm për këtë nuk dinin gjë. Të tjerët i kishin parë e varrosur vetë.

Në drekë u ktheva. Prapë venerova dorën e cila i lëshoi roletat me rrëmbim. E kisha të qartë se nëpër rrugë kalonte ndonjë kolonë me atë zhurmën bezdisëse, që fyente rëndë... Tollovia ndoshta është ringjallje për dikë(!) por...

## ROMANI PËR HALLËN DUDI

Ne të lagjes Dudinë e qylit e quanim hallë dhe tërë rrëzëçabratë e thirrnin kështu. Sokaqet e tjera gruan topolake e mollëlaqje e thirrnin sipas gjatësisë së dimive, që i zbrisnin nganjëherë nën zog të këmbës. Dhe, ku ishte ajo, ishte edhe burri i saj, i cili e ndiqte pas me tespihë në dorë, të cilët ia kishte sjellë një akraba nga fundi i botës. Vetëm kur flinte ato nuk i rrotullonte, ose kur dredhte mustakët vesh e më vesh. Një munafik i Rezinave na kishte zbuluar enigmën pse Bajrami i Pashës, kështu e quanin burrin e Dudisë, nuk i hiqte tespihët nga dora, që i rrotullonte me aq mjeshtëri.

Dudia sapo dilte në pazar, i shoqi ishte hija e saj, e kur ajo bënte punët e shtëpisë, ky dilte para derës së oborrit dhe zgërdhihej me tespih. Dikur ia thoshte një këngë të zamanit dhe ne të lagjes e rrethonim: hajdeni se këndon Bajrami! E, pse këndonte askush nuk e dinte, por ky ia thoshte në mënyrën e vet. Skena të tilla shikonim gati çdo ditë, derisa familja e tij u shtua dhe kush nuk e dinte kur halla Dudi ishte me barrë, mbasi nën dimi fshihej gjithçka e saj. Fëmijët e tyre shpejt morën veten. Të parit i kishin lënë emrin Vllaznim, të dytit Bashkim, e vajzën e kishte pagëzuar një shoqe e Dudisë. Shtëpia e tyre kishte tani dhe Lirinë.

Kur fëmijët e tyre veç ia kishin dhënë, nuk kishte më qetësi në shtëpi, as në lagjen tonë. Dëgjohej herë Vllaznimi, herë Bashkimi, por më pak Liria, e cila ishte një vajzë tepër e bukur sa që mbi qeramidhe të kulmit të tyre kishin filluar të fluturonin gurët e parë. Para derës dilte halla Dudi e zgërdhihej: tani vjen Vllaznimi e u tregon qejfin. Dilte pastaj Bajrami, duke i dredhur mustakët, dhe ia lëshonte një za Bashkimit: dil, bre bir, se na i thyen xhamat për Lirinë! Por asnjëherë nuk e qanin kokën për motrën e tyre: hajt bre se Lirisë nuk kanë shka i bajnë. Xhyl mahalle asht dhe nuk ka plumb që e rrëzon.

Me top cuklash luanim një ditë kur na tha dikush se Vllaznimi ishte shkuar diku larg e për Bashkimin nuk dihet, ndërkaq Lirinë e kishin grabitur.

Prapë halla Dudi ishte parë çarshisë në dimi të Stambollit, pas me tespihë e ndiqte i shoqi. Ne fëmijët nuk pranim t'i pyesnim se kur do të vijë Vllaznimi e Bashkimi. Bajrami e ngrinte dorën me tespih e shtangej: kaq shumë u ka marrë malli... do vijnë, do vijnë. Halla Dudi me rend na buzëqeshte dhe mbylleshin në shtëpi. Munafiku i Rezinave kishte zbuluar edhe diç tjetër, por më nuk ia kishim vënë veshin. I kishim fishkëlluar sa atij i kishte rënë kapuçi dhe nuk ishte parë kurrë. Në shtëpinë e pashajve nuk kishte më zhurmë, as dëgjohej gramafoni i vjetër me këngë të gjata e të përgjumura. Sipas gjasave fëmijët e tyre kishin shkaktuar gjithë atë poterë në mëhallë. Mbasi nuk ishte koha e megafonave, e kishin lutur njërin të ngjitet atje lart e t'ia thotë.

I fshiva sytë dhe pashë një shok të fëmijërisë. Katërdhjetë vjet i kishte që bubullonte në një guaskë. Po ato tabiate i kishte, ato lëvizje dhe atë humor, por në kokën e tij shumë pak qime. Pasi ishim çmallur, na ishte kujtuar halla Dudi. Nuk di gjë për Vllaznimin as për Bashkimin. Liria, kam dëgjuar, se i kërkon fëmijët bregut të Drinit. Me të ndieme e kam, tha, halla Dudi jeton ende. Thonë se është veshur allafranga dhe Bajrami e shëtit me benz. Nuk i mban më tespihët, na paska shkruar një teftër bejte e nuk di kujt t'ia ofrojë. Çka nuk ndodh në lagjen tonë të poshtme. Dhe, mirë që mungueka Vllaznimi e Bashkimi se... Vakti i parë ishte falur në xhami, kur e nisa romanin për ndodhitë e hallës Dudi dhe ndjeva një rrëqethje në trup: mund të harrohen kaq shpejt? Liria do t'i gjejë fëmijët bregut të Drinit? Me kaq nuk mbaron rrëfimi se nuk di kur do të mbyllen plagët. Ndoshta ai që na rri mbi kokë, më gjen diku në këtë qyshk...

## LUFTA E DYTË E FEMRËS SONË

Lufta na la një luftë tjetër që ndodh brenda nesh dhe nuk dihet si e kur do të përfundojë.

Nën dritaren time shpesh kalon një grua e heshtur, e verdhë, e frikshme, disi dhe e turpshme. Nën squetull mban ndonjë plaçkë dhe e përcjell një femër, të cilën e ndala një ditë dhe mezi më foli për historinë e dhembshme të gruas që e ndiqte.

Zonja, që kalon nën dritaren time për në pazar të qytetit, nuk është e vetme. Ka humbur dy fëmijë dhe ia kanë rrënuar shtëpinë me themel atje në malësi dhe ç'është e tmerrshme, e kishin prekur edhe në nder. E kishin poshtëruar bandat çetnike. Pas luftës tregon fajtorin dhe ç'i kishte ndodhur. Me të marrë vesh e lë edhe burri. Zonja braktis familjen, ik larg syve të të dashurve të vet me shpresë se tragjedia e saj do të kuptohet një ditë.

Regjimi kriminel serb me vjet kishte hulumtuar pikën e dobët të shqiptarëve. Bie fjala, Mihailo Laliq gjatë ishte interesuar për karakterin e njeriut tonë. Pra, kodi etik shqiptar i kishte vënë në lëvizje nga kasapi deri te shkrimtari. Kishin pikasur familjen dhe shtyllën e saj femrën. Kjo ishte ajo “bomba” biologjike, që i tmerronte. Pra, duhet prekur shqiptarin në nder dhe të rrënohet familja.

Historinë e njërës nga ato e kisha dëgjuar me vëmendje. Ditë më vonë e ndala zonjën, që bartte me vete luftën e dytë. Nën vetulla më shikoi. Mos u turpëro, zonjë, nuk je fajtores Ti, i thashë. Për tragjedinë tënde duhet të turpërohet regjimi kriminel serb. Ajo rrotulloi shikimin dhe filloi të qajë. Më shikoi edhe një herë, pastaj shikoi përcjellësen dhe u nisën.

Shtrohet pyetja: duhet femrat e tilla t'i paguajnë edhe mëkatet e luftës, kur të gjithë në një farë mënyre ishim të poshtëruar dhe të dhunuar: Pse femra të përjetojë edhe një luftë? Këta diktatorthë të

etikës pse nuk mund e mbrojtën këtë qenie të ndjeshme para shfrenimit paranoik serb?

Këtë zonjë shpesh e qet udha nën dritaren time dhe nuk di ç'shet a blen në pazar. Dikur vonë kthehen me përcjellësen dhe humbet rrugicave të qytetit tonë thuajse e ndjek kush. Nga dita kur e hetova, më mundon një zjarr: burrëria matet vetëm me nder? Lufta shumëkë mori nëpër këmbë, pse femrën fatkobe, e cila përjetoj edhe fyerjen, e lamë të digjet në flakën e luftës së dytë? Zonja ishte nënë dhe nënat qajnë me shpirt. Unë jam krijues dhe di ç'është tragjedia. E di, po ashtu, se kjo nuk është e vetme, por ku është familja, rrethi të na shpëtojë nga ndonjë tragjedi e re? Është koha ta mundim edhe këtë luftë. E di se është vështirë, por duhet të mbështetemi në forcën e arsyes. Edhe femra jonë ishte në luftë dhe kontributin më të madh e dha në ngritjen e familjes...

Ka ditë zonja e pikëlluar nuk kalon më nën dritaren time me përcjellësen, e cila mund të ishte motra, vajza apo ku ta di unë. Mos e dhashtë zoti t'i ketë ndodhë diçka. Do të ishte turpi ynë. Nderi është i shenjtë, por ka diçka që ia kalon. Ne duhet të respektojmë edhe tragjeditë njerëzore...

## NDËRRIMI I IMAZHTI FYEN

Verës ktheja më shpesh te krojet e Xhamisë së Hadumit. I shikojta arabeskat e shkrimet, që i kishte lënë dikush moti nëpër muret e larta dhe që më bëhej se mu aty fshihej dhe misteri. Besoja se një herë tjetër do ta zbuloja edhe atë që nuk kisha mundur. Në të vërtetë, kjo xhami gjendej në kompleksin e Çarshisë së Madhe. Bri saj gjendeshin edhe varret e çikave të Gjakovës. Kishin përvëlur veten se nuk kishin pranuar t'i përdhunojnë ushtarët e huaj. Tempulli ishte dhe njëfarë orientimi për të ardhurit. Nga aty një vrap e kishin Fushat e Bajram Pashës. Në fillim të viteve të nëntëdhjeta një shtetar shqiptar më kishte pyetur si duket Çarshia e Madhe. Për të i kishte folur babai, që kishte zbritur aty shpesh mes dy luftërave botërore. I kishte folur edhe për Xhaminë e Hadumit, ku malësia kishte falur Bajramin. Dhe tek e dëgjoja, ia kisha kujtuar, mund ta shikoni zotëri po qe se keni një kalë të fortë hekuri. Shtetari kishte ndërruar temën, se kjo ishte çështje e rëndë ndërKombëtare, e cila njëherë do të zgjidhet patjetër.

Është e vërtetë se në kompleksin e Çarshisë së Madhe asnjë ushtri okupuese nuk kishte çuar dorë. Si duket, regjimin kriminal serb e kishte tmerruar lashtësia e bukuria e saj. Kishte vendosur ta rrënojë e ta bëjë shkrum. Rrënimin e kësaj çarshie, kullat e Junikut dhe ato të Deçanit, Çarshinë e Vjetër të Pejës masmediat botërore i prezentonin si vandalizëm të një fisi që ka frikë të çmojë kulturat e të tjerëve. Me ne ndodhi diçka tjetër, asnjëherë nuk dëshmuam vandalizëm ndaj tempujve të tjerë. Ne ata i konsideronim si tonat, sepse ishin ngritur mu në themelet e tempujve tanë.

Fotografitë që vinin nga Ballkani ishin trishtuese edhe për metropolet evropiane. Nëpër muret e Kullës së Hanjrih Bëlit i kisha vendosur disa nga ato dhe përpiqesha të krijoj imazhin e qytetit tim. Por ishte e kotë. Nuk ekzistonte thuaja asgjë nga fëmijëria ime. Ishte derdhur dhe njerëzit mund ta parafytyronin qytetin përmes

fotografive dhe kallëzimeve të ndryshme. U gjeta një ditë në atë shktrum dhe përballë Xhamisë së Hadumit, ktheja në kohën e adoloshencës. Kisha humbur orientimin.

Flitet tani se Çarshia e Vjetër do të ngritet bashkë me Xhaminë e Hadumit. Si do të duken dhe a do të kenë diç nga lashtësia? Është për t'u frikësuar se ata që na ndihmojnë më se pakti u intereson imazhi ynë i dikurshëm. Kompleksi i Çarshisë së Madhe nuk mund të ketë atë bukurinë e dikurshme nëse aty ndërtojmë si duan të tjerët. Ndihma arabe është e mirëseardhur, por bën të luajnë me ndjenjat tona? Në librat e shenjta thuhet se nuk është as sevap të shfrytëzohet fatkeqësia e një mjedisi për qëllime tjera. Na janë rrënuar vërtet tempuj të besimit islamik, por nuk bën ta lëndojmë sedrën e Kosovës. Duhet të bëjmë përpjekje të ruajmë çdo gjë autoktone të kulturës sonë. Para tri dekadave Gadafi ngriti një xhami në Zagreb. Kallëzojnë se kjo është njëra ndër më të mëdhatë në Ballkan. E përcjell një infrastrukturë e moderuar e në kuadër të arkitekturës vendëse: aty gjenden biblioteka, salla për manifestime të ndryshme kulturore, spitali e objekte të tjera përcjellëse si dhe vendi për lutje. Do të thotë, të ndihmosh një kulturë e vend duhet kontribuar në ngritjen e vetëdijësimin e tij kombëtar e assesi t'i ofrosh një ideologji të re. Kosova ka nevojë për ndihma nga të gjithë dhe për objekte më së pakti politike. Çdo ndërrim i imazhit të vendit, në njëfarë mënyre, i ngjan një pushtimi të ri. Pa marrë parasysh se në çfarë shtate ndodhemi, ne nuk bën të luajmë me lashtësinë e traditën tonë. Do të na përbuzte dhe Zoti ynë.

## IDENTITETI I KËRCËNUAR

As dhjetë metra nuk kishte vitrina gjigante, ku ndodhi “tërmeti”. Hipiku i përgjakur e i dehur tapë thyente edhe krahun tjetër. Publiku dhe dy policët e shikonin krejt indiferente atë që ndodhte para tyre. Ky nuk ishte spektakël i rrallë që ndodhte në një metropol e nuk kalonte pa e kapur edhe objektivi i ndonjë aparati. Diku nën çati, atje lart, mbi atë derdhje të hatashme, valëvitej flamuri i vendit ku ngjante kjo. Para mbylljes së “shfaqjes” hipiku kishte nxjerrë nga xhepi një shkrepse dhe ishte hedhur në drejtim të flamurit për t’ia vënë flakën. Policët, që kishin filluar të përtyreshin edhe më fort, shtynë masën dhe ishin hedhur mbi hipikun.

Më ishte kujtuar një shkrimtaruc ynë përgjyrran, të cilit shpesh ia zë udhën flamuri, nuk i bën përshtypje fare, herë e quan cohë e herë me ndonjë epitete tjetër. E, në kohën e vet, Isa Boletini kishte rënë në gjurin e djathtë aty në kalldrëmin e Vlorës dhe e kishte puthur. Luftëtari i devotshëm e dinte pse kishte vepruar kështu. E konsideronte simbol të shenjtë dhe të vetmen fuqi që mund të bashkojë popullin e të dëshmojë se i kujt është. Dy policët e metropolës me gjasë e kishin konsideruar tamam si plaku Isë: në gjëra të shenjta të kombit nuk çohet dorë, as lëshohet pe. Në anën veriore të Mitrovicës, atje në Boletin, Isa i ka pasur kullat dhe nuk di ç’është bërë me to. Shpesh një mik më flet për peshën e secilit gur dhe prej sa gurësh janë ndërtuar. Me hyrjen e NATO-s, çlirimtarët nuk e kishin parë të arsyeshme t’i marrin në mbrojtje edhe ato. Kishin harruar, si duket, se ka Kosovë edhe tej asaj ure të zyrtë. Thonë se katër ditë kishin bredhur andej qentë e macet. Ana veriore i kishte ngjarë një vakuumi planetor. Pas katër ditësh, kur serbët ishin të bindur se shqiptarët nuk e kishin ndërmend të kalonin urën, ishin kthyer e fortifikuar. Shumë nga ata, vrasës e rrënues të çdo gjëje që ka lidhje me identitetin tonë kishin mbetur andej, pra dhe resurset e mëdha dhe



kullat e Isës, që nuk do t'i lejonte asnjë popull i civilizuar. E, ç'do të thotë identitet kombëtar, e pamë nga shembulli i policëve me hipikun, të cilët e kishin lejuar gjithçka, pos djegies së flamurit. Pra, edhe në vendet më demokratike mbrohet, pasurohet e restaurohet vazhdimisht e kaluara, se është udhërrëfyese për një kulturë e popull. Ky nuk është nacionalizëm, po nderimi ndaj një pjese të historisë.

Paranoikët serbë vazhdimisht, e sidomos në marshimet e tyre mortore, kishin për qëllim jo vetëm t'i shkulin shqiptarët nga vatrën e tyre e gjithçka që është shqiptare, por t'ia ndërronin fytyrën edhe Kosovës me ndërtime sllave e surrogate politike të ngritura mu në rrënojat tona. Dëshironin të dëshmonin para Evropës se këtu askush nuk ka ekzistuar më parë, se hanedon na paska qenë rodi serb! Kosova u shndërrua në një mit të rremë edhe për vetë serbët, të cilët u ngujuan thellë në Mesjetë. Njerëzit e mençur ndryshe e lexojnë këtë paranojë, pos ortakëve dhe aleatëve, që vazhdojnë të mbështesin të "vërtetën" serbe. Fati ynë gjendet në duar tona po qe se e duam Kosovën, ne jemi kreatorë të tij.

Bredh Kosovës shpesh, bile depërtoj edhe nëpër enklava. Ajo që më tmerron janë oxhaqet, kullat monumentale dhe shumë objekte të kulturës e të qytetërimit tonë të lashtë, që nuk janë më. Kanë filluar të tregohen gjithfarë përrallash. Me ndonjë fotografi të kullave të Dukagjinit apo të Çarshisë së Madhe të Gjakovës e të Pejës, mjafton të mbahet gjallë kujtesa historike? Dhe, brezat e ardhshëm na besojnë se kishim aso objektet, që vështirë gjendeshin në Ballkan? Disi rrënimet na janë bërë fat, që unë i lexoj si turp kombëtar. Nuk ngrihen mbi ato zhdukje surrogate që nuk u dihet cilës arkitekturë i përkasin e të mos flasim se pakgjë kanë të trevave tona. Ne nuk mund të shndërrohemi në Afrikë: ndërsa si ta merr mendja dhe pa kurrfarë shije estetike.

Pas Luftës së Dytë Botërore ishin bërë rrafsh me tokë shumë qytete e lokalitete në Gjermani. Kur kishte filluar rindërtimi e riparimi, gati asnjë detaj nuk kishte munguar nga ndërtimet e mëparshme. Nuk kishin pranuar të dëmtonin të kaluarën as të shkëputeshin nga ajo. Ky ishte një qytetërim që fisnikërohej e mbrohej. Logjika se me ne çdo gjë fillon është fatale. Këtu e shoh edhe fatkeqësinë tonë, primitivizmin

anadollak, se harrojmë shpejt kush jemi e ç'duam. Bashkësia ndërkombëtare e ka vërejtur këtë si duket. Nuk investon asgjë që ka të bëjë me identitetin tonë, sepse e konsideron ringjallje të nacionalizmit shqiptar. Pra, na servohen hibride. Do të kemi punë me mundjen e harresës, konkretisht asnjë identitet nuk më pengon po qe se nuk keqpërdoret. Pse të shikohet identiteti ynë nga prizmi i nacionalizmit?

## KU ËSHTË SHTETI YNË?

Kur ta bëjmë shtetin, mendoja, do e bëjmë lule, të na e kenë zili hebrenj e palestinezë. Ashtu mendoja se isha iluzionist. Besoja se shumë gjak u derdh e shumë breza u bënë dhe. Nuk mund ta shihja shtetin tim sa një karrige, rreth së cilës mund të ndodhin dhe tragjedi për t'ia pasur lakmi dhe Shekspiri. As më shkante ndërmend se shteti mund të shndërrohet dhe në një tezgë dhe kjo ta ketë madhësinë e ëndrrës: të ketë kaq kate, ose ky bëhet nga disa dyqane, e të tjerët plebej. Faik Beu në shkrimet e tij na përkujtonte shpesh Zululandin dhe tani revoltën e shkrimtarit rebel e lexoj kudo e çdo ditë: se ne vështirë lirohemi nga disa vese, që na turpërojnë para fëmijëve dhe të huajve. Dhe më dhemb kur shoh e ndjej se ç'ndodh në shtetin tim dhe pse me të sillemi si nuk duhet? Shpesh takoj inkasantët. Vijnë e shkojnë duarthatë. Qytetarët nuk i paguajnë obligimet që ia kanë shtetit dhe nuk e kuptojnë ende se shteti duhet të mbiekzistojë. I pyes ata dhe vështirë përgjigjen shkaku i turpit ose pse besojnë se më mirë do të bëhet nesër, se për këtë shtet kemi bërë gjithçka. Në mesin e inkasantëve ka edhe ndonjë që e bëri luftën. Dhe tek i shikoj, si vinë e shkojnë, më del parasysht njëfarë Zhika, as një pëllëmbë njeri, por kur e shihnin në fund të lagjes, gumëzhinin hyrjet: vjen Zhika, bëni gati paratë. Dhe na i merrte deri në dinar edhe për korrent, edhe për ujë, edhe për pleh, edhe për telefon e takravate të tjera, që i kishte menduar shteti serb. Në lagjen time kishte dhe patriotë, por para Zhikës një fjalë nuk e thonin, se në ato fatura ishin futur edhe për TV e Radio, që nuk i kishim, bile edhe për kisha e manastire e shtëpi refugjatësh nga Bosnja e Kroacia...

E tani ç'ndodh? Nuk duam të paguajmë se është shteti ynë dhe njerëzit tanë në të. Po si të mbiekzistojë ky shtet yni pa lekun tonë? E, kur është fjala të ngrisim kat pas kati e t'i ndërrojmë makinat si gratë

fustanet, e zgjidhim qesen. Po kjo nuk ndodh as në Afrikë. Mirë e kishte Faik Beu që nuk na kurseu as neve të mileniumit të ri.

Duke parë këtë anarki, nuk mund të mos frikësohesh se ne pavetëdjshëm instalojmë injorancën dhe krimin dhe se me to do të merremi gjatë dhe, a do të ndalet kjo rrëshqitje jona? Dhe, si duket, shumë shpejt harruam betimet e atyre që u bënë drita jonë. Vetëm ne ose ca nga ne duhet të jetojnë dhe të shnukin çdo gjë e asgjë të mos i japin shtetit tonë. Sjelljet e tilla lexohen edhe ndryshe, mbasi nuk kontribuojmë në ngritjen e shtetit tonë, ne nuk dimë ta mbajmë atë as të nderojmë ata që u bënë themele të tij. Shesim mend me makina, kate pas kateve e dyqaneve, shesim mend se me patriotizmin tonë do t'ia ndërrojmë dhe imazhin Ballkanit: se me ne nuk ka. Por lexojeni Faik Konicën e shikojeni se ku mund të jemi! Ideali ynë ishte të bëjmë shtetin e fortë dhe të mos i fyejmë askë se shteti nuk bëhet për një grusht njerëz, as nuk është bashqë e babait.

Është koha të kuptojmë se kemi shtet; se ai jeton e frymon me ne dhe obligimet tona t'i kryejmë. Po ashtu, të mos harrojmë se lekun që e japim na kthehet prapë, se nëpër institucionet e shtetit tonë gjendemi ne, që duhet të marrim pagat dhe me tepricën t'i riparojmë objektet vitale të ekzistencës sonë. Të jemi më dinjitozë para botës dhe të shkëputemi nga Zululandi i Faik Beut.

Edhe tani më habit ai Zhika. Nuk ishte as një metër njeri, e na i mblidhte të gjitha paratë. E, shteti ynë çdo ditë na troket në dyer e nuk ia hapim? Pse? Nëse vazhdojmë të sillemi kështu me shtetin tonë, atëherë ç'duhet të bëjë shteti për ne? Ku është ky shteti ynë, ju lutem?

## TI DHE VRASËSI

Nga dritarja sheh diçka si bisht, që ngrihet nga aty ku para një kohe kishte rënë edhe bomba e parë e NATO-s. Bishti ngrihet dhe ta mbështjellë një copë qiell. Syve nuk u beson se të kujton të shkuarën.

Rrëqethesh. Ikën nga dritarja dhe ndez me rrëmbim TV , të mbushet shtëpia zhurmë. Përpak përjeton të harruarën. E pamundur. Nuk je në ëndërr. Rreth vetes prek, pastaj shtrydh një puçërr në trup. Pëshpërit: do e shoh prapë vrasësin tim në sy, ai do të ma zgjasë dorën, ose do t'i shtrëngojë dhëmbët ndoshta pse nuk paska arritur të më shkulë nga dheu dhe të mos e shoh më atë pamje nga dritarja, që ma kujton bombën e parë të NATO-s. Mos qofsha në lëkurën e atij, kisha pëshpëritur me sy të zgurdulluar në horizont, ku ai farë bishti ishte parë. Me vrasësin prapë do të ha bukë e do të bëj qejf, ai do të m'i numërojë lugët, do të m'i shikojë nofullat si përtypem. A di të përtypem. Deri kur mund të përtypem. A kam mësuar diç nga përtypja, nga shkolla e të vjellurit kur ky nuk ishte e unë mendoja të zgataraqem më tepër se duhet e, sa dua e si dua, se jam në shtëpinë time. E, kur të jesh në shtëpinë tënde, bën ç'të duash dhe sillesh si ta dojë zogu i qejfit.

Por, ja, edhe në shtëpi ka rregull. Nuk mund të hapësh nevojtooren kur të rrokë barku, para teje ka hyrë një grua me yzër. Dhe, derisa të dalë ajo, ti mund t'i mbushësh brekët siç i mbushe në bodrum kur të kërkonte vrasësi, se i pëlqente lëkura jote, buzëqeshja. E tani të thuhet se duhet pranuar se ke parë ëndërr të keqe, se ai nuk ka qenë vrasësi, prandaj duhet t'i bësh vend, të ndash kafshatën në sofër, të pish ujë nga një krua dhe në syrin e tij ta kërkosh engjëllin tënd nëse ende nga bebza e tij nuk ka rënë në hon para kullës, ose nuk e ka përzënë me thikë derisa ripte diçka në oborrin tënd. Bindesh më në fund se edhe koteci yt nuk është shtëpia jote. Ke qiraxhinj ose je qiraxhi. Në asnjë dritare më nuk mund të shikosh. E ka zënë vendin

dikush para teje dhe duhesh të mësohesh me pritje derisa zotëria të thotë mjaft u kënaqa me këtë pamje. Po ku është ai bisht për të cilin na bezdiste pakëz më parë? Urdhëro e na e gjej! Ku është ai bishti? Nuk ka pasur vrasës në këtë hapësirë.

Ik dhe nga dritarja, se nuk je më vetëm në shtëpi, as nuk e ke të qartë se kush është qiraxhiu: ti apo vrasësi yt. Por, ç'Ë'u kumtosh atyre jashtë? Mund t'Ë'u thuash se ajo që kam folur nuk ka qenë e vërtetë; këmisha ime e përgjakur në degë të lisit nuk ishte imja, as plisi, as opinga ndanë udhe; nuk është e vërtetë se në pusin e ftohtë ma ngulfatën të dashurën; as ky zotëria që më ka kërkuar në bodrum të ma heqë flamën derisa me *Internet* lajmëroja botën për vrasjen time. E sheh, nuk ngul vetëm femra. Dallon diç nga dashuria jote e ngulfatur në pus? Hajt, kafshë e zezë, të nxjerrë përjashta edhe shtëpia jote!...

Më vonë mëson se bishti paska qenë një copë kaltri e shkëputur nga qielli i Zotit. Njerëzit paskan dalë në ballkone për ta parë. Të fundit paskeni qenë ti me vrasësin tënd. Nuk ke mundur t'Ë'a puthësh dorën nga turpi, ishe hyjniu që të besonim deri në çmendi...

## SHNDËRROHET KOSOVA NË REZERVAT?

Mospajjsja e shqiptarëve me dokumente identiteti i konvenon më së shumti regjimit kriminal serb. Kjo është njëra ndër ndihmat më të mëdha, që i bëhet këtij regjimi nga bashkësia ndërkombëtare. Ndërprerja e qarkullimit dhe e komunikimit me botën, Kosovën e shndërron në një rezervat, ku eksperimentohet e do të eksperimentohet deri në skajshmëri, siç thoshte më parë një mik imi. Pra, Kosova e lirë shndërrohet në një burg të hapët, ku shqiptarët nuk mund të dalin as te Kullat e Isa Boletinit e as në Malet e Sharrit. Brenda një hapësire tepër të ngushtë mbajnë gjallë identitetin e tyre.

Në të kaluarën kishte bërë përpjekje edhe Beogradi, të pengojë lëvizjen e komunikimit e shqiptarëve me botën. E kishte të qartë se komunikimi i tyre me botën shkonte në të mirë të çështjes shqiptare. Pse bashkësia ndërkombëtare nuk e shpejton këtë? Pse edhe shteti amë nuk ndërmerr asgjë rreth kësaj çështjeje të themi jetike për këtë krah?

Edhe pse ekzistojnë ndalesa të ndryshme ndaj “SFJ”, shumë nga të ashtuquajturit “intelektualë” gëzojnë beneficione e përkrahje të mëdha nga metropolet evropiane. Kjo shihet edhe nga “turnetë” e opozitës. Lidhjet e tyre edhe tani ekzistojnë e shtohen me gjithë deklamimet e ndryshme nga forumet botërore. Dikujt kjo i konvenon edhe pse këta farë intelektualësh zënë në thua shpesh në bashkësinë ndërkombëtare e në NATO-n për praninë e tyre në të ashtuquajtur krahinë serbe(!)

Nuk mendoj se të ndëshkuarit duhet lënë ku janë, por duhet mundësuar edhe të tjerëve një qarkullim më njerëzor. Nuk është e mjaftueshme se bota na qenka në Kosovë dhe Kosova nuk ka nevojë për të parë e mësuar nga ajo. Po qe se bashkësia ndërkombëtare vazhdon t’i mbajë të izoluar shqiptarët nga të tjerët, do të ishte më mirë atëherë Kosovën e shqiptarët t’i shpërngulë në Afrikë ose në

ndonjë planet të vetmuar. Kufizimi i qarkullimit shpie tek më e keqja, me çka më së pakti mund të krenohet edhe bashkësia ndërkombëtare.

Pajisja e shqiptarëve me dokumente përkatëse nuk është e kufizuar, as privilegj, por diç e shenjtë dhe e çmuar, që njeriun e bën njeri.

Vitin e kaluar (1999) e kisha përkrahur gjestin e gjyqtarëve në Prizren. Nuk kishin pranuar të veprojnë me ligjet e ish-Jugosllavisë. Ata nderonin e mbronin dinjitetin e tyre. Ishte diç absurde të gjykohej me ligjet e një shteti, që nuk funksionon në këtë anë. Dhe, në një shkrim për një gazetë në Perëndim, i kisha bërë pyetje edhe vetvetes: a është çliruar Kosova dhe kë e pengon liria e saj? Përderisa njerëzit tanë me orë qëndrojnë para sportelit të zyrës së ish-regjimit, diku aty në qendër të kasabasë sonë, për të marrë një dokument udhëtimi, nuk di deri ku arrin liria ime dhe pse bashkësia ndërkombëtare na turpëron kur ekzistojnë mundësitë që edhe shqiptarët ta kenë e të ndjejnë veten si pjesa tjetër e botës? Ndoshta, kancelaritë kanë filluar të harrojnë se Kosova gjendet diku në Evropë.



## TESTIMI I DINJITETIT

Nuk besoja se kufizimi i lirisë është testim i çuditshëm me njeriun. Për shkak të vulave maqedonase në Qafë Thanë, kisha mbetur dy vjet pa dokumentin e udhëtimit. Më kishin mbetur zhig takimet e para e të fundit “Lasgush Poradeci”. Ishin ftuar krijues nga tërë etnia.

Edhe më parë kisha pasur probleme. Në një udhëtim në Frankfurt isha ballafaquar me dyshimin. Shtëpia botuese “Rilindja” merrte pjesë çdo vit në Panairin Ndërkombëtar të Librit dhe konsiderohej njëri ndër botuesit më të mëdhenj të rajonit. Isha caktuar edhe unë. Në zonën kufitare pala gjermane dokumentin tim e kishte mbajtur më gjatë se të kolegëve të tjerë, që më pritnin në anën tjetër.

Ma kishin kthyer dikur gati të derdhur. Pas refuzimit tim se nuk e pranoj të tillë, kishin bërë përpjekje ta sjellin në vete. Dhe tek kisha shfletuar shtypin kisha zbuluar edhe misterin rreth dokumentit tim. Mësova se në aeroportin e Frankfurtit kishim zbritur ditën kur një aeroplan gjerman ishte ulur me dhunë në Gadishullin Arabik. Keqkuptimi kishte ndodhur rreth emrit e pamjes sime. U kisha përngjarë në ndonjë palestinez.

Më vonë mësova se një detaj sado i vogël e zbulon këtë testim, të themi zoologjik të njeriut. Në një rajon ku njerëzit shikohen përmes grykës së pushkës, e drejta për qarkullim të lirë shikohet edhe në bazë të interesit. Dokumentin e udhëtimit serbët e materializuan, bashkësia ndërkombëtare hamendet, e shteti amë, për arsye të ndryshme, nuk mund të vendosë. Pra, kufizimi i lirisë bëhet më i rëndë. Nuk përfillet as e drejta ndërkombëtare. Reagimet, megjithatë, nuk bën të keqkuptohen.

Shkaku i qarkullimit të lirë dhe të frikës për dokument, njeriu ynë shpesh u gjend në situata qesharake. Kalonim kufirin, që copëzonte në mënyrën më të poshtër trojet tona. Një koleg, që e

njihja edhe për trim, u djersit sapo kufitari ia nxori një libër, i cili ishte i tij e i përkthyer në gjuhën e pushtetarit. Me dy gishtërinj e shkundi dhe me një gaz përbuzës të vrastarit ia ktheu në çantë.

Bashkudhëtari mori frymë më lehtë dhe u krekos, thuajse asgjë nuk kishte ndodhur. Frikën e tij e kuptoja në mënyrën time. Sapo u gjendëm në minishtetin tjetër, e pyeta se ç'iu desh libri i përkthyer, po ashtu ne nuk kalonim Karpatet. Ku ta merrja me mend se një krijues dëshironte edhe në pikën kufitare të dëshmojë se kush na është. Pasi i kishte përbirë edhe të sharat, bashkudhëtari vazhdoi me të veten. Prapë e kishte hapur çantën dhe i kishte rregulluar gjërat. Kishte zënë të më flasë pastaj për politikën; se armikun duhet mposhtur edhe me gjëra të rëndomta. Po ne bënim një udhëtim thuaja kaçakçe brenda trojeve tona të copëtuara, siç iu kishin tekur të tjerëve. Dhe kjo ndodhte në fund të shek. XX. Kisha shkruar shumë poezi edhe për ato pëllëmbë të humbura. Kisha qeshur me një thënie të Dritëro Agollit: me poezi po t'i bashkoja trojet shqiptare, moti e kisha bërë, por... Kisha pëshpëritur në vete ca vargje nga Molla e Kuqe, pastaj për Morenë e Anton Bellushit. Vit për vit arbëreshi i urtë zbriste atje poshtë Korinthit derisa organet greke e kishin përzënë një vit. Dyshonin se mos ishte njeri i Enver Hoxhës. Në të vërtetë, këtij më së pakti i interesonte politika. Dëshironte të zbulojë gjurmët e gjyshërve, që nuk e linin të qetë...

Po ç'është kjo politika? E kisha ngacmuar prapë bashkudhëtarin, i cili rropatej në minakllëkun e vet. Kur e lamë edhe të ashtuquajturin shtet, gazi im e bëri të eksplozojë. Prapë më kishte thënë se armikun duhet mundur edhe me gjëra të tij. Me bizantizëm kishte përvojë të hershme si duket. Dikur ma tha troç: dokumentin e konsideroj liri personale, dua ta vë edhe në shërbim të të tjerëve. Po ti? Unë ndryshe mendoj dhe më duhet një arkë. Ia kisha përmendur Kadarenë. Ta qitte udha këndeje, sa gomarë do t'i duheshin për librat e tij të përkthyer edhe në gjuhët e fiseve ballkanike të dëshmojë se kush është? E kishte hedhur librin nga çanta tërë nervozë, të cilin ia ktheva se vendin e kishte në bibliotekë. Ishim ndarë duke e kuptuar politikën secili në mënyrë të vet.

Gati e kisha harruar trimin e hudutit kur e pashë në Alenë e Shpëtimtarëve të Kombit. Grimcohej majë një kunjxhi. Ishte një ekzemplar kombëtar dhe atë psikologjinë e minakut vazhdon ta tjerre edhe më hollë. Të ishte vetëm, do e shpëtonim Kësulkuqën. Por nga historia kam mësuar se me përulje nuk mundet poshtërimi. Ndoshta gaboj. Kanë ndërruar kohërat, po njeriu?

## TROKET ANARKIA

Një natë dimri, në Mynhen (1999), më kishte zgjuar një zë i brendshëm. Dhe e kisha ndjekur pas atë zë kosove. Mbi dyqind km i kisha bërë me tren. Rreth e më rreth qytetit i kisha rënë. Kur isha zgjuar, në pasqyrë kisha parë lotin në syrin tim. Në letër kisha shënuar: Në Kosovë vetëm vdekja nuk vonon. Marri ndoshta ishte kjo, por e thoja një të vërtetë.

Ik java e protestave tona për lirin e të burgosurve. Prapë më bëhet se dëgjoj atë zë. Kishte qenë zë i ndonjë të masakruari, i ndonjë të zhdukuri apo i të ngujuarve nëpër kazamatet serbe. Këta të fundit i shihja si pengje të lirisë sonë. E kisha lutur Zotin, kur Kosova nuk është mëkëmbur ende, të mos ndodhë diçka pikëlluese. Vrapimi pas zërit më kishte nxjerrë jashtë vetes, e vetja më dukej asgjë. Nuk kisha haber ku janë njerëzit e mi e ç'kishte ndodhur me ta. Ndoshta ata ishin një forcë që vënin në lëvizje gjymtyrët e dërrmuara të Kosovës, ndoshta bari i kishte mbuluar.

Dhe, derisa prindërit, motrat, vëllezërit, gratë me fëmijë, bëjnë me dhjetra km nga Gjakova e Rrafshi i Dukagjinit, më bëhet se ndjekin atë zë, që kisha vrapuar edhe unë. Por njeriu nuk duhet të ligështohet në këso raste të rënda, jo vetëm për familjarët? Të mbështesim shpresën. Pra, i lumi ai që beson, se dhembjen e mund. Në lot e fjalë përditë përpiqem të zbuloj fuqinë dëshpëruese që nuk është në dorën e asnjë shqiptari, e më së pakti të zotit Kushner. E gjithë kjo e keqe është në trurin serb, i cili nuk mund të ekzistojë pa i shkaktuar tjetrit dhembje e bashkësia ndërkombëtare ia hapi udhët. Por ne duhet të dalim jashtë vetes para një ligështie fisnore serbe? Aty moti ka pushuar arsyeja, se nuk mund të lirohen nga gjaku i zi.

Populli ynë i njeh burgjet serbe, është plakur në to, por kurrë nuk ka lëshuar pe në dinjitetin kombëtar. Të mos turpërohemi edhe tani para botës e të fyejmë guximin njerëzor të të rënëve e të atyreve

nëpër kazamatet serbe. Edhe me burg atdheu është mbrojtur. Është e dhembshme kjo që ndodh me të dashurit tonë, por do të ishte më tragjike të humbasim Kosovën. Për hir të këtij ideali të frenojmë veten dhe të dashurit tonë t'i shohim ndryshe. Të gjallët kthehen kurdoherë, por ç'veprohet me familjet që humbën dhjetëra anëtarë? Ç'të themi për familjen Jashari të Drenicës, e Delijajve, e Hëni Hoxhës nga Gjakova, e Popajve nga Drinia, e Bobëve nga rrethi i Pejës? Të kemi kujdes, mos po i lëndojmë edhe shumë familje të tjera.

Histeria është e kobshme. Me vrapimet e pakontrolluara kënaqim hasmin dhe fyejmë më të dashurit tanë. Lufta këtë e ka. E dhashtë Zoti të jetë e fundit. Kjo hallakamë lë përshtypjen se me ndjenja tona luan dikush. Me dhembjen kombëtare bëhet edhe marketing politik. Ky është një mjerim i dështakëve, që popullin e turpërojnë dhe e nxjerrin rrugëve, duke fyer edhe etikën tonë në kohën kur për Kosovë flitet më pak. E, ky popull, që u përball me dhunën serbe, mund të përballojë edhe dhembjen. Guximi i tij është treguar me shekuj.

Gjë më të turpshme nuk ka se me shqerrjet tona të argëtojmë hasmin. T'i kujtojmë ata që nuk kanë më shpresa t'i shohin ndonjëherë të masakruarit, etikën tonë ta dëshmojmë edhe në këto momente tepër të dhembshme për kombin. Tanët nuk ranë në fushat e betejave e kazamate për punë të liga, por për ideal. Dinjiteti është pjesa e luftës sonë, që nuk ka përfunduar fatkeqësisht.

Një infermiere, e familjes Popaj, përditë zbret nga kati i katërt diku në Ulpianë. E heshtur nisat në spitalin e improvizuar në Teatrin Kombëtar, në sheshin Nëna Tereze, u jep ndihmë njerëzve të alivanosur. E kryen punën pa bënë. Por kësaj kush një zë nuk ia ka dëgjuar që dy vjet, edhe pse pesëdhjetë anëtarë i janë masakruar buzë Drinit. Shembuj të tillë ka mjaft. Ju lutem, mos po turpërohemi edhe para të huajve. Histeria nuk është dinjitet. Në dyert tona ka zënë të trokasë anarkia. Këtë duhet ta ndërpresim mu për hir të vetë Kosovës. Ndryshe na mallkojnë generatat që vijnë...

Mesazhi i këtij teksti është: t'i rrimë larg të keqes. Shumë punë nuk i kemi kryer ende rreth shtetësisë së Kosovës.

## PËR NJË KATEDRALE NË PRISHTINË

Ndonjë karafil do të më qortojë se ç'na duhet një katedrale në Prishtinë dhe pse pikërisht në momentin e tanishëm? Unë kam arsyet e mia. Së pari, ne duhet të lirohemi nga dyshimi evropian dhe i fqinjëve se jemi anadollakë, fundamentalistë të përbetuar dhe se i takojmë një bote tjetër; së dyti, duhet të nderohen tempujt e besimeve tona dhe të mbajmë gjallë tolerancën tonë për të cilën na lakmojnë dhe mëson shumëkush në Evropë; së treti, nëse dhjetra tempuj islamikë e ortodoksë u ngritën në hapësirën tonë dhe respektohen nga të gjithë, pse të mos e kemi edhe një katedrale në Prishtinë, që do të mbante emrin e bamirëses sonë, Nënës Terezë, nëntëdhjetëvjetorin e së cilës e festojmë sivjet; së katërti, ne duhet t'u kthehemi vlerave, që i nderon edhe njerëzimi.

Për nobelisten e shenjtoren tonë të kohëve moderne mbyllim fundvitin me dy shtatore. Njëra ngrihet përballë Teatrit Kombëtar, kurse tjetra në Gjakovë. Ngritja e dy shtatoreve dëshmon se ne shqiptarët i afrohem Evropës, e cila mbeti ëndërr për rilindësit. Bota i ka nderuar shumë figurat tona historike. Metropoleve kam parë shtatoret e Skënderbeut, Marko Boçarit. Mehmet Ali Pashës, Nënës Terezë; bile dhe të shenjtërve tanë nga lashtësia e thellë iliro-shqiptare iu ngritën dhe katedrale, siç është njëra nga to, ajo e Shën Albanit në Këln. Veprat e tilla kanë rëndësi të posaçme dhe të shumëfishtë. Në momentin e pikërishtëm për ne është më se qenësore të dukemi në një dritë tjetër, që fqinjët nuk mund të na shohin. Një katedrale e tillë ka edhe qëllimin ekzistencial të një kulture e populli.

Kur Nëna Terezë u nderua me Çmimin Nobel, rreth origjinës së saj ç'nuk kishin bërë maqedonasit dhe ca të tjerë, sepse një figurë e tillë rrezaton larg dhe i sjell nam secilit popull. Madhështia e bamirëses sonë mblodhi tërë botën atje në Kalkutën e largët për t'i dhënë

nderimin e fundit. Mbasi të ngremë katedralen, në dheun dardan duhet të pushojnë dhe eshtrat e saj. Ishte e kësaj toke.

Në faqet e të përditshmes sonë para sa kohe preku këtë çështje me interes kombëtar dhe zoti Gj. Gjonlekaj, se ngritja e një katedraleje i forcon shqiptarët. Ndërkaq, Ndoc Simonlaj nga Shën Gjergji i Ulqinit, me banim në Amerikë dhe i njohur për kontributin e madh kombëtar rreth ndërtimit të tempujve tanë, ofroi njëqind mijë dollarë. Diaspora pra zbret në Dardani të japë kontributin e vet edhe për këtë vlerë të pakontestueshme kombëtare. Nëna Terezë simbolizon edhe humanizmin tonë; se ne shqiptarët nuk i ramë në qafë askujt. Ishim dhe mbetëm mbrojtës të vlerave njerëzore; pra thashethemet sllavo-greke duhet rrënuar edhe në këtë mënyrë, se kemi mundësi të triumfojmë. Po ashtu, ne nuk na bashkon vetëm gjuha, gjaku e historia, por edhe besimi i ndërsjelltë dhe Zoti. E ata që na quajnë kështu apo ashtu, nuk dëshirojnë të na shohin asnjë nishan tonin mbi dhe.

Para sa vjetësh me mikun e poetin e ndjerë Fahredin Gunga, redaktonim librin “Lule për Nënë” të Dom Lush Gjergjit dhe parafytyronim shtatoren e katedralen e bamirëses sonë. Do të vijë ajo ditë? Dhe kohë e rilindësve gdhin.

Ne jemi edhe popull i së ardhmes.

## TRAGJEDIA SI MESAZH

Nuk kam asgjë kundër akëcilit zot, por nuk di a mund të ngulë edhe në një tempull dhune. Në hapësirën tonë diku, filloi të ngrihet një kishë thjesht për qëllime politike. Hegjemonia serbe veprroi siç kishte vepruar më parë, se duke ngritur tempuj të tillë, forconte rrënjën e vet në një tokë të huaj. Tani mbrohet, por aty asnjë zot nuk mund të ulet pas gjithë asaj që ndodhi në Kosovë. E kjo kishë, që ndan etnitete, nuk mund të jetë tempull Zoti. Por, duhet të shndërrohet në diçka tjetër, që mban gjallë kujtesën njerëzore. Ndoshta është zgjidhja më fatlume kjo karabina midis qendrës sonë të shndërrohet në një muze për holokaustin shqiptar; nëpër mure të shënohen emrat e gjithë atyre që ranë për Kosovën dhe për vlerat njerëzore dhe jo vetëm këta të luftës së fundit. Se ç'rëndësi do të kishte një muze i tillë në këtë hapësirë të zymtë të Evropës, mjafton se entiteteve do t'u kujtonte se ku shpie çmendia njerëzore dhe ç'mund të bëjë njeriu për lirinë e vet. Zatën shndërrimi i këtij objekti në muze përkujtimor do të lironte edhe bashkësinë ndërkombëtare nga një ankth ballkanas.

Ajo që ndodhi në Kosovë nuk mund të harrohet lehtë e shpejt. Kosova mbetet një problem i rëndë, të cilin nga shekulli i kaluar e krijoi vetë Evropa. Nuk ishte e drejtë në përcaktimin e fatit shqiptar. Shpesh me trojet tona bëri tregti. Është koha që bashkësia ndërkombëtare t'i kuptojë njëherë edhe shqiptarët dhe serbët t'i lirojë nga iluzioni. Nuk është me rëndësi kush është autokton dhe ardhacak. Është me rëndësi se në këtë hapësirë në të gjitha kohët dominuan shqiptarët edhe pse ekzodet e tyre shpesh kishin përmasa biblike. Dhe, çdo përpjekje për të ndërruar realitetin shkaktoi gjakderdhje të madhe.

Ajo që ndodhi në Kosovë nuk mund ishte reprizë, bie fjala, e Lumës së tej Drinit apo e Toplicës, që kujtesa njerëzore i mban mend



si turp. Një kishë e ngritur me dhunë është mëkat dhe ndaj vetë Zotit të entitetit që i takon.

Konkretisht, objekti për të cilin bëhet fjalë, nuk e ka vlerën e rëndësinë e Kishës së Deçanit, Graçanicës apo Patrikanës së Pejës që i mbrojtëm. Shqiptarët mbetën populli tolerant dhe objekte të tilla i konsideruan dhe pjesë të historisë së vet. Por brenda hapësirës universitare, e garantuar me ligjin e ish-bashkësisë dhe shkaku i rrënimit të rendit dhe kupolave të Bibliotekës Kombëtare, që ndonjë mendjeje të errët ia kujtonin plisat, disenjatorët e dhunës bënë çmos që mu në këtë kompleks të diturisë të bjerë muzgu i stepës. Dhe kjo karabina, nëse nuk do të ketë një funksion tjetër, që i bashkon entitetet e kësaj hapësire, mund të ndodhin gjëra të rënda dhe për vetë bashkësinë ndërkombëtare. Po ashtu, e pafalshme është nëse dikush nga të jashtmit përpiqet të ndërrojë edhe arkitekturën shqiptare, që ka rëndësi historike për kulturën tonë. Xhamia e Hadumit, bie fjala, nuk mund të ngrihet në stilin arab, siç e ceku edhe zoti Stefan Shfarc. Hapësira jonë duhet të mbrohet nga objektet politike dhe varfëria jonë të mos shfrytëzohet për qëllime të errëta.

Organet universitare kanë të drejtë të akuzojnë ndërtuesit e një kishe politike në këtë hapësirë, ku edhe është derdhur gjaku i njerëzve të pafajshëm. Zotin serb, i cili ishte shpesh në krye të vrasësve, do pendohej për atë që ka bërë dhe do e lironte nga e keqja nëse një karabina e pakryer të shndërrohet në objekt me funksion edukues për entitetet e kësaj hapësire nevrrike. Bashkësia ndërkombëtare duhet ta ndjejë dhembjen dhe tragjedinë ta shndërrojë në një mesazh gjithënjëzësor.

Kisha e shndërruar në muze holokausti pa dyshim do të ishte edhe një monument i çmueshëm për historinë më të re të njerëzimit.

## LETËR E HAPUR Z. KUSHNER

I nderuari z. Kushner,

Kam qenë në një metropol kur kam dëgjuar për emërimin Tuaj për administrator të OKB-së në Kosovë. Nga fjalët e miqve dhe atë që e mësova për punën e personalitetin Tuaj prej humanisti, besoja se një populli të traumatizuar i duhet fjala e kujdesi Juaj. Në krentrimin e nëntëdhjetëvjetorit të Nënës Terezë dëshmuat respektin për figurën e nobelistes shqiptare. Fjalët nuk i thatë shkaku i kurtoazisë. Përmes madhështisë së saj ju shprehët dhe admirimin për humanizmin e tolerancën shqiptare, që mbetet shkollë edhe për ca metropole.

Me ndërrimin e rrufeshëm të ngjarjeve në kontinent, e sidomos në rajonin tonë, duket sikur keni filluar të humbasni kontrollin mbi fjalët Tuaja. Nganjëherë bëhet se dikush tjetër i thotë ato. Megjithatë, respekti për Juve nuk bie. Bëni atë ç'mundeni, duke u ikur grackave dhe të ndonjë fuqie të padukshme nga anëtarësia e bashkësisë ndërkombëtare. U kam lakmi për retorikë. Në një vend ku ka ndodhur gjenocidi i paparë në fund të mileniumit të dytë, kontrollin mund ta humbasin edhe kokat më të ndritura. Nuk është lehtë të kontrollohen ndjenjat njerëzore.

Ç'na mbetën nga fjalët se krimi duhet të ndëshkohet?

Me vite autoparlantët serbë çmos bëjnë të na shtojnë të këqijat dhe të na paraqesin sa më zi. Pse veprohet kështu, e dini Ju më mirë.

Në një mjedis çfarë është yni, shkalla e krimit megjithatë është shumë më e ulët se në shumë metropole e të mos flasim për pashallëkun serb. Fatkeqësisht, gishti vazhdimisht drejtohet kah mesi ynë. E kuptueshme është kjo, se gjërat te ne nuk e kanë jetën e një blic

revolucionin të ashtuquajtur demokratik serb. E shikoni, brenda nate na shpallen për demokratë ata që vranë e djegën në Kroaci, Bosnjë e Kosovë. Kush mund të thotë se nesër nuk do t'ia vënë flakën edhe Malit të Zi? E bënë “revolucionin” paramilitarët e vrasësit ordinerë, që i kërkon Tribunali i Hagës! Poeti i njohur amerikan, Ezra Pound, do të thoshte se këto janë përralla për fëmijë dhe ne e kemi kaluar moshën. Ndodhi vetëm ndërrimi i dy karrigave, i vrasësit dhe i mësuesit. Ashtu ishte kurdisur nga të padukshmit. E gjithçka tjetër i njëjti dekor mesjetar: kisha e qiellorët.

Ç'na mbetën nga fjalët se krimi duhet të ndëshkohet? Nga një burg labirinth ikin kriminelët ordinerë e u bënë konak Serbia, njofton se nuk dihet kush është engjell e kush djall. Janë shumuar dhe paniku nuk zbret. Do e bënëin pyetjen e lartpërmendur edhe mijëra të vrarë shqiptarë e kushedi sa të zhdukur e të burgosur, që nuk u dihet nishani. Kam pyetur dhe të tjerë: mos mendohet si në Serbi se shqiptarët janë minj e duhet shfarosur? Në pyetje është liria e një populli e vendi, që bën përpjekje të mbiekzistojë qyshse padrejtësitë e të mëdhenjve (dhe shteti Juaj) Kosovën ia falë Serbisë (1913) për qëllime që dihen. Ka të drejtë Serbia të vë dorën prapë mbi të kur Kosovën e shndërroi në varr të gjallë? Me çfarë të drejte ndërkombëtare e planetare mund të lejohet një marrë e re dhe deri kur t'u besohet mashtrimeve dhe teatrit serb?

Nëse mbështesim logjikën mesjetare serbe, kemi të drejtë dhe ne të deklarohejmë se është jona deri ku shtriheshin të parët tanë - thellë në Evropë e gati në tërë Ballkanin; pra ku ekziston dhe një varr. Do të shpallnim edhe ne Jerusalemin tonë; se ne nuk zbritëm nga Karpatet. Mirëpo koha e mitomanisë ikën. Përballemi me realitet të egër, rrënues.

### Aty u promovua krimi

Në enklavat serbe, jeni dëshmitar me bashkësinë ndërkombëtare, se mbi katërdhjetë mijë bashkëqytetarë tanë serbë votuan për vrasësin, do të thotë u identifikuan me krimin. Rreth

presidentit të ri të ashtuquajtur “Jugosllavi” u tubuan forcat më të errëta të shoqërisë serbe, bile dhe vrasës që kërkohen nga Tribunali i Hagës! Nuk ju frikëson kjo se do të kemi luftë të re, çka më tutje, zotëri? Të besojmë ende në dinjitetin njerëzor? Mbi banesën time jeton një familje serbe pesanëtarëshe. Në hyrjen tonë askujt nuk i ka shkuar ndërmend ta shqetësojë. Shkolla jonë nuk e ka lektyrë lëndën e urrejtjes, por dashurinë ndaj njeriut. Është rrenë ajo që e trumbeton Beogradi se serbët ndiqen e vriten. Dhe të vjen keq kur këtë e gëlltit bashkësia ndërkombëtare.

Nëse dikush e shihka Kosovën si një dele, mashtrohet rëndë, zotëri. Kur Kosovës i vjen era vdekje dhe kur ende nuk janë zbuluar të gjitha varrezat masive, nxitimi të vihet kontakt mes Beogradit e Prishtinës dëmton dhe imazhin e OKB-së. Të hiqet më parë mjegulla mbi teatrin serb e pastaj të mendohet për bisedime në nivelin ndërkombëtar. Para së gjithash, Kosova është çështje shqiptare dhe ndërkombëtare, ku duhet korrigjuar padrejtësitë e së kaluarës. Në këto rrethana të diskutohet me Beogradin për njëfarë autonomie substanciale trimëron nacionalizmin serb rreth presidentit të ri dhe pavetëdjshëm inkadrohet krimi.

Për manastiret dhe eposin e tyre, serbët nuk e duan Kosovën, por shkak i resurseve të mëdha natyrore. E shikoni ç’bëjnë për “Trepçën” ? Mund ta lexoni Noel Malcolmin, “Kosova një histori e shkurtër”. Në mbarim të mileniumit të dytë Serbia ëndërron të ketë koloni. Do të ushtronte aty dhunën e të milte të mirat e një populli. Do pranon kush këtë turp kur i dihet fundi?

Nacionalizmi është e zeza e një populli. Për popullin e kulturën serbe respekt dhe nuk mbështes kuaziteori se fqinjët të hidhen në një planet tjetër. Mund të mësohet dhe nga ata, por të lirohen nga iluzioni se kanë të drejtë të vrasin e të bëjnë çdo gjë me të tjerët. Opcionet tona janë të hapura e të qarta. Mund të ndikojnë dhe në lirinë e serbëve nga mitomania. Fatkeqësisht, shenjat e para janë shqetësuese. Aty u promovua krimi. U ndërruan vetëm dy karrige. E, mu në këtë marramendth nacional serb të deklarohet për një autonomi substanciale për Kosovën (besoj se kështu nuk mendon e tërë anëtarësia e Aleancës Euro-Atlantike) lë përshtypje se u merret e

drejta shqiptarëve për deklarimin e tyre të lirë, të ngjiten prapë maleve dhe të kemi prapë ndonjë fletë të re nga Bibla moderne.

Nëse viktimën e xhelatin bëjmë përpjekje t'i bashkojmë,  
nuk ka moral aty

Zoti Kushner, vendi është i atyre që e banojnë dhe e shfrytëzojnë. Edhe pse na vranë e na rrënuan kujtesën vazhdimisht, ne mbetëm edhe kur paranoja serbe bëri çmos të na hedhë tej Bjeshkëve të Nemuna. Pra, çdo ndërmarrje e pakontrolluar ndaj nesh do të ishte skandaloze edhe për bashkësinë ndërkombëtare. Mes shqiptarëve dhe serbëve ka ndodhur divorci. Mund të bisedohet tani për mirëkuptim të ndërsjellë e assesi për një çati të përbashkët. Tekefundit, ç'i afron shqiptarët me sllavët dhe mos ishim ne ata që u shkaktuam varreza masive e shkatërrimin e kujtesës së tyre nacionale? Nëse viktimën e xhelatin bëjmë përpjekje t'i bashkojmë, nuk ka moral aty. Fyejmë dhe të rënit, lëndojmë njerëzoren.

Ik viti i dytë qysh se gjendeni në mesin tonë. Është e vërtetë kur dëgjohet se Kosova nuk është atdheu Juaj. Por të ndashë të mirën e të keqen me qytetarët e saj, nuk ju bëhet se pakëz jeni dhe kosovar? Ngjallja e jetës e sukseset kundër dhunës ndaj minoriteteve dhe brendashqiptare, është kontributi Juaj e i bashkësisë ndërkombëtare në një mjedis të traumatizuar. Një pjesë të jetës ia falët çështjes së Kosovës. E, si t'u konsiderojmë të huaj?

Në një kohë kur shemben kufijtë është poshtërsi të jeshë i burgosur në liri. Radhët e bashkëqytetarëve Tu nuk u turpërojnë kur para sportelit serb kërkojnë dokumentin e udhëtimit? Apo herët në mëngjes kur të uriturit e shkundin edhe fundin e kontejnerëve? Apo kur dëgjon se filan intelektual bëri vetëvrasje shkak i gjendjes sociale dhe masmediat lajmërojnë se krimi në Kosovë rritet? Apo e kenë vënë re, edhe valutat më të forta të kohës në vend të varfër devalvojnë? Megjithë përpjekjet e bashkësisë ndërkombëtare, te ne ende nuk gëzohet e drejta elementare për qarkullim. Mbyllja e shqiptarëve në kibuce dhe moskomunikimi i tyre me të tjerët, i konvenon regjimit

serb dhe autoparlantëve të tyre. Nuk bën të dëgjohen shqiptarët në metropole se sjellin shqetësim. Në të vërtetë, metropolet bombardohen nga të pavërtetat e kuazishkencës serbe, duke sharë edhe NATO-n e bashkësinë ndërkombëtare, që për mua nuk ishin vetëm përkrahës të shqiptarëve. Përkundër të gjitha këtyre mashtrimeve e zhurmës, ne kemi diçka që serbët nuk e kanë, të vërtetën dhe guximin njerëzor. Me vonimin e dokumenteve personale le të dyshohet se u merret e drejta shqiptarëve të ndjejnë vetën qytetarë të barabartë të Evropës. Ka diçka kjo me vlerat njerëzore?

Ata janë të teatrit serb

Në rrënimin e diktaturës më të egër të këtij fundshekulli, që ishte e turpshme dhe për racën njerëzore, nuk harrohet ndihma e NATO-s, e cila mbrojti dhe vetë serbët nga më e keqja. Por a u mund e keqja, zotëri?

Zoti Kushner, letra ime nuk u drejtohet vetëm Juve. Më çudisin pakëz dhe të pispillosurit tanë. Ç'nënshkruajnë dhe ç'thonë? A kanë mundësi të dëgjohen më shumë? Ekzistojnë dhe arsye ndoshta, që më vonë mund t'i lexojmë në memoare, por kush t'u besojë fjalëve kur nuk u dëgjuan në kohën e duhur?

Dy ministra të jashtëm, i Rusisë dhe i Greqisë, e vizituan presidentin e të ashtuquajturës "Jugosllavi". Nuk vonoi as z. Vedrin për t'ia sjellë sihariqin dhe mesazhin e të mëdhenjve. E, diku në Kosovë është një qytet, që ma kujton Berlinin e dikurshëm dhe më bën të dyshoj se lufta nuk qenka kryer. Zatën këtë e kam paralajmëruar moti. Por nuk di ç'iu desh shtetit Tuaj të na lë zjarrin te dera? Ndarja e Mitrovicës ndodhi për shkak të "Trepçës". Nuk mund të pajtohem se politika e vendit Tuaj ka shkëlqimin e letërsisë së madhe frënge, që frymon dhe në bibliotekën time. Mes Moskës-Beogradit-Athinës vrapimet marramendëse paralajmërojnë tërmete. Ma kujtojnë boshitin e dikurshëm që rrëronte identitetin tonë kombëtar. Sa i përket opozitës dhe takimet me të, di vetëm se ata janë

të teatrit serb. Miqasitë e vjetra dëmtojnë imazhin e të ardhmes. Të bëjmë çmos që e kaluara të jetë sa më pak në mesin tonë.

E mbyll këtë letër me një parafrazë të një poeti, prapë amerikan, Uiston Oden: *ca ngritën e ca përgatitën për një jetë ibret...* Edhe tani u shoh si humanist. Kaq keni mundësi të bëni. Diskursi im nuk është në rolin e viktimës. Me respekt.

*(Ulpianë, 2000)*

*Ali Podrimja*

## FRIKË PËR TË ARDHMEN

### GJENOCIDI I PUSHTETIT SERB

Kur na flisnin të moçmit për kohën e krimet e kralit, pakkush besonte, se rrëfimet e tyre u ngjanin tregimeve fantastike. Mendonim se me fjalët e kujtesën kishin problem dhe ato që na thoshin i kishin dëgjuar diku dhe dëshironin të na kallëzonin edhe neve. U desh kohë të bindemi se kallëzimet fantastike të baballarëve ishin më se të vërteta dhe i kishin përjetuar me lëkurën e vet.

Shpërbërja e hapësirës, tkurrja e atdheut tonë nisi ngamoti dhe vështirë të përcaktohet ndonjë datë, se ndërrimet e gjerave në dëm të çështjes sonë kombëtare filluan me ndërrimin e toponimeve, me rrënimin e fshatrave, të qyteteve, të objekteve tona që dëshmonin për identitetin kombëtar, qofshin ato sakrale të të tri besimeve apo monumenteve kulturoro-historike, me plaçkitje të mëdha të pasurisë tokësore e nëntokësore, me rrënimin e shëndetit e të institucioneve, me përgjakjen e kodit tonë etik e fyerjen e familjes sonë, me rrezikimin e ekzistencës sonë biologjike e etnodemografike e deri te krijimi i një mjedisi traumatik-psikik me tragjedi të rënda; se gjenocidi i pushtetit serb kishte zbritur deri në palcë të dheut, të frutit, të kokrrës së bukës, të pikës së ujit, të ndërrimit të peizazhit. Pra, nuk kishin lënë segment të jetës sonë pa prekur dhe gjithë ky krim kishte ndodhur në mënyrë



sistematike nga dita në ditë, nga viti në vit dhe është çudi si arritëm të mbesim gjallë mes fiseve paranoike kur botën shumëherë nuk e kishim pranë, bile ca vende patën dorë dhe në tragjedinë shqiptare.

Në Sesionin shkencor mbi gjenocidin e pushtetit serb ndaj shqiptarëve, të organizuar për herë të dytë nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, tek dëgjoja shkencëtarët tanë, isha rrëqethur dhe më kujtoheshin rrëfimet fantastike të baballarëve; sillnin një dëshmi të madhe të një krimi gjenocidal kundër njerëzimit dhe nuk mund të mos pyetësh: ku është drejtësia ndërkombëtare dhe pse kaq gjatë heshti Evropa? Pastaj dhe të habisin qëndrimet e ca kancelarive për çështjen shqiptare dhe të Kosovës. Nuk mund të pajtohesh se viktima duhet t'i kërkojë falje xhelatit pse u vrau, apo pas gjithë këtyre krimeve me përmasa katastrofike të kërkohet se shqiptarët duhet të pajtohen me viktimizimin për qejf të dikujt.

Në një poezi Tagora thotë: Vdekja s'është e vërteta e fundit. Por, si duket, gjenocidi i pushtetit serb ndaj shqiptarëve dhe çështjes së Kosovës ishte çmenduria e tyre e fundit. Ky morbiditet njerëzor duhet të jetë dhe leksion në vetëdijësimin tonë para të keqes e të ardhmes; besoj, po ashtu, se dëshmitë tona nuk do të tregohen më vetëm mes nesh, sepse është lënduar rëndë personaliteti i njeriut...

## RE TË ZEZA NË HORIZONT

Disi të gëzon që dredhinë e ashtuquajtur revolucion demokratik serb filluan ta lexojnë edhe të tjerët pasi u doli gjumi. Gradualisht ngritet edhe mjegulla mbi z. Koshtunica, të cilin përmes fjalëve e nxitimeve e shihja se kemi të bëjmë me një fasadë të jashtme të regjimit kriminal serb pasi që të gjithë penjtë e shtetit i kontrollon ende vozhdit. Pakëz e papritur kjo për ca vende të bashkësisë ndërkombëtare. Kurdisja se më në fund Serbia triumfoi mbi krimin e vet, në një tekst e shpall si rrenë më fantastike të këtij fundshekulli, po i deziluzionon edhe përkrahësit. E dhembshme është kjo edhe për vetë popullin serb, i cili kalon dorë më dorë si një stafetë duke mos ditur se blic “revolucionit” i opozitës ishte më tepër lojë e vozhdit. Zatën, vozhdin e vrastarët e tjerë i shpëtoi mu kjo nga më e keqja që, pas një pushimi të “merituar”, u kthyen triumfalisht në zgjedhjet e paradokohshme të PS. U zgjodhën e u duartrokitën si në kohët më euforike të nacionalizmit serb kur ushtronin gjenocid ndaj të tjerëve.

Tentimi i bashkësisë ndërkombëtare për të restauruar ish-Jugosllavinë, ku do të përfshiheshin Serbia, Mali i Zi dhe Kosova, vë në dyshim edhe përkrahjen e saj. Pse tentohet “vëllazërim-bashkim” i popujve, që u përgjakën e u vranë? Dhe ç’ka me humanizmin e vlerat njerëzore ky insistim, që vetëm tensionon situatën në këto anë?

Ndoshta politika është diç tjetër, por mozaiku i ngjarjeve, rikrijimi i tërësisë fatkeqësisht është pikëllues. Unë si krijues i lexoj pak më ndryshe dhe nuk mund të mbështes morbiditetin që fyen jo vetëm njeriun tim. Dhe ka një kohë që qëndroj para një dritareje të thyer e assesi t’i ngjes spirrat e xhamit të derdhur se mungon shumëçka. Të kota më bëhet se janë dhe veprimet e bashkësisë ndërkombëtare, që kanë marrë turr t’i fusin nën një kulm ujë e qengj. Le përshtypjen se këtë duan ta kryejnë sa më parë derisa SHBA merren ende me vetveten. Pra, rreth çështjes së Kosovës ca duan të krijojnë çarje në

mes aleatëve perëndimorë. Shtrohet pyetja: pse veprohet kështu vetëm me shqiptarët, që ende nuk janë shëruar nga traumat e barbarisë serbe? Nëse vazhdon të insistohet, pa dashje kemi shfaqjen e një forme të butë të racizmit: bën të kenë shtet të gjithë pos shqiptarëve!

Koshtunica nëpër forume ndërkombëtare përcjell atë që i thuhet atje poshtë. Në Kosovë nuk mund të ketë paqe kur nuk ka as në Shqipëri. Klithmat: vota, koka të kthejnë në mesjetë të thellë. Bëhen shqetësuese për një vend normal. Ngjarjet më të reja shtynë të mendosh se mos forcat e errëta serbe u vunë në veprim edhe aty ku ka pak sovranitet dhe kësaj nuk do t'i shpëtojnë as trojet tjera shqiptare? Hallakatjet tërheqin vëmendjen se diçka morbide përgatitet dhe kurrë më shumë nuk është dashur uniteti gjithëkombëtar.

Është e vërtetë se zotëria nga Beogradi ka përgatitje të lartë, por nuk di sa mund të bisedohet me të kur nuk ka në dorë asgjë. Çdo gjë që ndërmerr Koshtunica nuk mund të shkëputet nga nacionalizmi primitiv i popullit të vet, në trurin e të cilit është ngulitur se Kosova është çështje e brendshme serbe. Pra, kemi punë me një mentalitet që refuzon të tjerët, tepër të mjegulluar. Me shmangiet e vazhdueshme nga cilido faktor amerikan, zotëria bën çmos të fitojë në distancime e hutit të bashkësisë ndërkombëtare. Është zgjedhur udha se me të gjithë nuk bën të bisedohet për Kosovën.

Në mileniumin e tretë nuk di sa mund të mbështetet Miti i Kosovës, që është pjellë e hegjemonizmit serb ndaj të tjerëve. Mund të mbyllet ky iluzion me fatkeqësinë e vetë serbëve. Por në horizont kanë filluar të duken re të zeza të një lufte të pashpallur, që kanë zënë t'i fryjnë zjarrit edhe ca vende për arsytet e të okupuarve të tyre dhe të bëjnë çmos t'i lënë edhe kosovarët në mjerimin serb.

## SHPEJTËSIA

Shpejtësia është e rrezikshme dhe shpesh ndëshkohet. Neve nuk na konvenon vrapimi, se nuk e shohim ende horizontin. Serbia bën çmos në këto mjegullira ndërkombëtare të kthejë të humburën, prandaj dhe hendeqet i kalojnë duke iu falënderuar miqve të tyre të vjetër. Në emër të Kosovës, po ashtu, nuk mund të flasë asnjë parti e më së pakti individi. Kosova është çështje e madhe e kombit, e cila nuk bën të na rrëshqasë prapë nga dora shkaku i pakujdesive.

Me ndërrimet e ashtuquajtura “demokratike” në Serbi, shihen qartë interesat e hershme të boshtit të vjetër ortodoks, të përkrahur fort nga Franca, Italia e Kina. Veprimet e tyre lexohen si hipokrizi njerëzore dhe pak kanë gjë me të drejtën ndërkombëtare. E, nëse këtyre u ngutet, ne nuk bën t’u mundësojmë asgjë. Situata në të mirë që ecën në mjedisin tonë, i tmerron dhe ngjall aleancat e dikurshme serbe. Kjo është punë e ndërgjegjës, e moralit të tyre. Ne duhet të mbështesim vlerën njerëzore, realitetin e ri, pavarësinë.

Pakëz qesharake duket kur bashkësia ndërkombëtare vrapon pas Serbisë dhe bën çmos t’ia hapë dyert kudo. Bëhet përpjekje të mbahet gjallë një shtet fantom, që nuk dihet ku fillon e mbaron, e i cili nuk ka kryer asnjë obligim ndaj bashkësisë ndërkombëtare qoftë për dorëzimin e kriminelëve të luftës, qoftë për obligime që i merr ndaj fqinjëve dhe të dëmtuarve. Një gjë dihet se Koshtunica nuk është Havel as Mesiç. Si duket, Serbia mbetet e llastuara e Evropës. Ndoshta i duhet dikujt një shtet terrorist në Ballkan.

Vihet në dyshim edhe drejtësia planetore, e cila thuhet e propagandohet kur nuk mund të hapet Kutia e Pandorës. Shteti fantom zë vend aty, ku është dënuar për krimet në Kroaci, Bosnjë e Kosovë dhe - *rrova më rrove, brisku i berberit!* Sipas logjikës së kancelarive mund të bëhet gjithçka me kroatët, boshnjakët e shqiptarët. Në momentin e pikërishtëm më tmerron shpejtësia e miqve. Pse insistohet

ne të bëjmë hapin e parë, kur askujt nuk i shkaktuam një të keqe? Na vranë, na burgosën e na bënë pikë e pesë, e nuk dimë ende edhe sa varreza masive duhet hapur, edhe sa të burgosur gjenden nëpër kazamatet e Serbistanit. Bajraktarët tanë kalojnë hudutin me ishpasaportën e Yu e nuk turpërohen. Ndërkaq, lëkura e Kosovës i ngjan gjithnjë e më shumë lëkurës së leopardit. Ne nuk kemi hapësirë për të gjallëruar.

Ditë më parë ishim të zënë me zgjedhje, por a kemi nevojë për fërkime të reja? Bashkësia ndërkombëtare na gëzon me ndonjë fjalë, e Serbisë i bën vend ku nuk e ka. Mendohet se më në fund arritën ta hapin kutinë e zezë serbe dhe do të ndodhin mrekullira në bisht të Evropës. Kjo sjellje të frikëson mbasi Serbia shpesh i ka lënë me gisht në gojë jo vetëm fqinjët e vet. Prapë do të pasojë koha e zhgënjimeve e bashkësia ndërkombëtare të kërkojë të pamundurën. Shikoni vetëm sjelljet e Koshtunicës, e paramilitarit që e kishte qitur udha edhe në Drenicë. Dallon fjalori i tij nga ai i forcave ekstreme të nacionalizmit mesjetar serb? Duhet të jemi të dëgjueshëm? Gjatë votimeve demonstruam kulturën tonë. Në të vërtetë, dinjitetin tonë e lexoja si një buzëqeshje të hidhur dërguar mu kancelarive të hamendura rreth çështjes shqiptare e që prapë flertojnë me pikën e tyre të dobët, Serbinë. Fatkeqësisht, shpejtësia shpesh përfundon në hendek. Nëse bashkësia ndërkombëtare ndryshe e sheh këtë problem, atëherë ne bën të biem në karrem?

“Renesansa e ndritshme” serbe nuk kaloi pa e entuziasmuar edhe zotin Hollbruk.

## MIMIKËRIA SERBE

Revolucioni i ashtuquajtur demokratik serb, me dy-tri zjarre e dy viktima, sa ndodhin brenda një nate në Kosovën e lirë e të pavarur, mundëson interpretime nga më të skajshmet. Vërtet pati hallakatje në Serbi apo gjithçka ishte kurdisur rreth ndërrimit të karrigeve dhe përmirësimit të imazhit serb para bashkësisë ndërkombëtare? Ata që i kuptojnë shenjat, vështirë të pajtohen me konstatime qesharake se në Serbi ndodhi më në fund ajo që pritej.

Kishte hallakatje, por çfarë ishin? Nga dy godinat e zymta, që nuk i kanë as dyqind metra në mes, flakën ia vunë Kuvendit të Jugosllavisë, e atë të Serbisë e lanë anash. Kjo nuk ndodhi se Kuvendi i Jugosllavisë identifikohet me postin e vozhdit, por pse bashkësia ndërkombëtare mendonin se ishte aq e marrë sa të mos i kuptojë truqet serbe, se kjo që ndodhi në Beograd nuk ishte kurrfarë shkëputjeje nga e kaluara e tyre. Dhe një popull që edukon breza e breza me urrejtje e kultivon mitomaninë mesjetare, vështirë të demokratizohet e të harrojë ëndrrën për Serbinë e Madhe në dëm të fqinjëve.

Kjo nuk do të thotë se në Serbi nuk ka individë që duan shtetin e vet ta quajnë me emrin nacional dhe të kënaqen me atë që nuk u është derdhur e të mos kamuflohen nën ombrellën e ish-shtetit fantom. Këtë e venerova në Takimet e sivjetme poetike të Strugës. Kisha kundërshtuar të lexoja, mbasi maqedonasit Kosovën e kishin vënë në korniza të ish-bashkësisë që nuk ekziston. Poetët nga Podgorica e Beogradi vepruan ngjashëm si unë. I pari nuk mund e shihte Malin e Zi aty ku thoshin maqedonasit, ndërkaq ai nga Beogradi dëshironte të përfaqësonte thjesht Serbinë. Në pyetjen e masmediave pse nuk kisha lexuar në Kalishtë, pata deklaruar se tani ekzistojnë shtetet Sllovenia, Kroacia, Bosnja, Maqedonia, Kosova.

Nesër mund të ekzistojë dhe Mali i Zi. Do të dëshiroja të pavarësohet Serbia nga ish shteti fantom.

Në momentin e pikërisht asgjë të re nuk ka, vetëm thellohen problemet mes shqiptarëve dhe serbëve. Deri ku kreu i ri e sheh Serbinë, nga Sharri në Horgosht apo nga Rashka në Zemun, do shihet më vonë. I ashtuquajturit revolucion demokratik serb brenda natës mori njollën e parë. Forcat më radikale e më nacionaliste iu vunë krah. Ca nga ta ndiqen edhe nga Tribunali i Hagës, nderin e të cilit u përpoq ta shpëtojë pak më parë në Kosovë zonja Karla del Ponte. Njolla e dytë është deklarimi i hapët i vozhdit, se tani e tutje do të merret me çështjen e partisë.

Këso marifetesh serbe sa vijnë e shtohen dhe nuk mund të mos pajtohesh se në Serbi nuk ka ndodhur kurrfarë revolucioni as nuk ka pasur përleshje mes palëve kundërshtarë se nuk ka opzione as ide për zgjidhjen në rajon. Kjo që ndodhi ishte një dekor nga përditshmëria serbe. Përflitej se brenda serbëve e mentorëve të tyre kërkohej një modus për daljen nga ferri. Si duket atë ua mundësoi Koshtunica me dirigjentët e padukshëm. Por deklaratat e tij nuk dallojnë fare nga ato të nxënësit të tij, vozhdit. Në vend se t'u kërkojë falje kroatëve, boshnjakëve e shqiptarëve për krimet serbe, u bëri thirrje dypërqindëshit malazias t'i zënë vendet në Parlamentin e ri pranë Sheshelit e kriminelëve të tjerë që, siç thonë, edhe i kërkon Tribunali i Hagës. Në këtë farsë serbe ndodhi vetëm ndërrimi i dy karrigeve në të njëjtin dekor mesjetar. Se është e vërtetë kjo, dëshmon bindshëm intervista cinike e vozhdit në radio, dhënë të shtunën në mëngjes, se shkon zotëria për të pushuar derisa çunat ta pastrojnë terrenin nga bashkësia ndërkombëtare. Do të thotë ndjente lodhje nga marshimet mortore në Kroaci, Bosnjë e Kosovë.

Dhe shenjat e tjera shpiejnë te mimikëria serbe. Pas Luftës së Dytë Botërore ngjashëm kishte ndodhur. Pjesa më e madhe e çetnikëve shpallëshin fitimtarë të së ashtuquajturës LNSH. Pra, ndodhemi në një kasino të çuditshme. Ne shqiptarët pakëz kemi pasur fat. Zarin shpesh e hodhën të tjerët. Paqja e mirëkuptimi në Ballkan nuk besoj se varen më vetëm nga bashkësia ndërkombëtare e cila,

kam frikë, se ra këtë herë në karremin serb. Brenda një nate nuk mund të urtësohet kopeja, ndoshta.

Mirëpo farsa serbe mbyllet me shkuarjen kinse të vozhdit e me ardhjen e nacionalistit të përbetuar. Ndërrimi u bë dhe me një ngritje gote për shëndetin e bashkësisë ndërkombëtare dhe të viktimave të reja. Revolucioni demokratik serb, që zgjati vetëm sa një blic, mbetet mësim i mirë dhe, për fat, tepër transparent e neveritës për racën njerëzore...

Eh, Evropë, gabon ndonjëherë ti? Pata pyetur në një metropol.



## “VIRTYT” SERB

Bisedonim për përditshmërinë, kur miku më tha se tërë natën nuk kishte fjetur. Ma tregoi arsyen. Iu gjegja pakëz në gaz: kush të ka faj që nuk je gexhë, mbarë e mbrapsht do ta rrotulloje. Bile Evropa do ta pranonte rrenën për të vërtetë. Nuk është vështirë të kalosh nga kali i zi në të bardhin, kur di ta luash. Miku nuk kishte pritur këtë. E përbiu me dhembje. I tregova se edhe mua shpesh më ndodh. Më duket se vetëm një herë në jetë kam rrejtur thellë. Në supa e shëtisja të ndjerin e nëpër tërë Evropën ia kisha kallëzuar një rrenë këlluqe, e cila nuk mbaronte fare. Por, nuk bën të brengosemi, ne shqiptarët vërtet nuk dimë të rrejme, ose kur rrejme, nuk e bëjmë kur duhet, por kur kalon pajtoni.

Mendimtarët e vjetër helenë e arsyetonin rrenën në raste të veçanta. Kur atdheu është në rrezik bën të zbulohen fshehtësitë? Hordhive gjakatare bën t’u hapet udha? Edhe në kohë moderne këtë kategori filozofike, e turpshme për naivët që besojnë në pastërtinë e sinqeritetin njerëzor, shikohet nga këndi i interesit nacional dhe përsoset në nuanca. Edhe grackat diplomatike kanë diç nga kjo.

Te serbët rrena është traditë, shkollë. Kanë shkruar edhe studime. Këtë nuk e fshehin. Çfarë serbi je po qe se brenda dite nuk e shpik një rrenë. Këtë aftësi nacionale e pranojnë edhe krerët e tyre, krenohen bile për këtë “virtut” nacional. Ja kujtova D. Qosiqin dhe atë thënien: *Çdo gjë serbe është ngritur mbi rrenën.* Letrën e fundit serbi e hap kur e sheh se do ta sjellë të mundshmen. Aftësi diplomatike e shohin ca, e të tjerët deformim nacional. Ne shqiptarëve na turpëron pjesa e fundit e fjalisë.

Rrena është e dënueshme gjithkund në botë. Për serbët vështirë të ketë ligj, edhe pse bënë gjenocid, sidomos ndaj boshnjakëve dhe shqiptarëve. Dikujt ndoshta i pëlqen kjo mjeshtëri arti.

Pakkush te serbët beson se me sinqeritet mbrohet edhe çështja kombëtare. Këtë mund ta mbështet vetëm naiviteti ynë. Si t'i hapet kundërshtarit edhe letra e fundit? Miku nuk mund u përmbajt: edhe te ne rrehet. Po, i thashë, ne nuk rrejmë kur duhet, prandaj fare pak jemi enigmatikë. Të kujtohet deri ku shtriheshim? Kot nuk i kam shkruar "Mollën e Kuqe" e poezitë për Artën. Na prenë e gati na herrën e rrenën serbe e mbështesin se propaganda pansllave ia shiti për të vërtetë jo vetëm Evropës.

Pastaj e zumë në gojë z. Koshtunica. Se është kukull në dorën e padukshme të ikonës Vozhdi, u pajtua. Por assesi nuk besonte se atë me suitën e vet ushtarako-policore e dërguan në pushim të merituar dhe pret komandën nga një qendër se kur të veprohet prapë. Me revolucionin demokratik serb, i cili mahniti Evropën (!), regjimi kriminal me miqtë e tyre të vjetër, për të dalë nga qorrrokaku dhjetëvjeçar kurdisi rrenën më fantastike që bashkësia ndërkombëtare turpshëm e pranoi. Kjo është hapja e letrës së fundit serbe. Regjia zvarriti edhe inkuadrimin e Koshtunicës për arsye: u ndanë palët brenda serbe, pastaj kërkuan t'u hiqnin të gjitha sanksionet e t'u bënin të mundshëm bredhjet nëpër botë edhe atyre që Tribunali i Hagës i kërkon dhe, së dyti, çështja e Kosovës të shihet si çështje serbe dhe shqiptarët nuk bënë të marrin pjesë në forume ndërkombëtare, ku bëhet fjalë edhe për fatin e tyre. Evropa nuk është hera e parë që bie në karremin serb. Më ishte kujtuar Fishta.

Ky është lexim i historisë së ballkanasve. Dikur i thashë mikut të merret edhe me leximin e nënteksteve. Ky farë revolucionit demokratik serb ndodhi mu kur në krye të bashkësisë ndërkombëtare erdhi Franca! Regjia ashtu e kishte kërkuar: çudia serbe ndodhi kur u ndërrua timonieri evropian. Nuk ju bëhet se mjegullat e mesjetës dhe interesave të të mëdhenjve nuk janë shpërbërë ende dhe duan të zhbijnë një qytetërim të lashtë? Nëse ndokush e sheh ndryshe fenomenin e rrenës, më gëzon. Nga pabesia e fqinjëve gëlltitës nuk do të ruheshja, bile as me miq të prisheshja. Se u demokratizua, më në fund, Serbistani, mund të

besojë vetëm ortodoksizmi në krye me zotin Vedrin. Ndoshta fat është se ky zotëri u zbulua shpejt.

Pjesa më e madhe e intelektualëve dhe krijuesve francezë, besoj se nuk mendojnë si ukrainasi i tyre.

Do të përjetonim edhe një depërtim biblik. Kësaj here në ndonjë planet të panjohur, ku do ta kishim mall edhe “virtytin” serb e naivitetin njerëzor.

## ILUZIONI SERB

Intelektualët serbë dhe e ashtuquajtura “opozitë” vazhdojnë të luajnë në letrën e nacionalizmit serb, duke modifikuar e stilizuar elaboratet e memorandumet e mëhershme. Pra, nuk përpiqen të shkëputen nga iluzioni se Serbia është qendra e dynjasë dhe duhet të sillen të tjerët rreth saj; po ashtu ngulin këmbë se asnjë çështje nuk mund të zgjidhet në Ballkan pa pjesëmarrjen e tyre. Kuptohet se asnjë zgjidhje nuk mund të shtrohet pa pjesëmarrjen e të gjithëve, bile dhe të hashkalinjve dhe romëve.

Mirëpo kërkesat që i shtrojnë dhe i mbështesin janë thuaja identike me ato që i shtronin dikur kokat e tyre të nxehta, nën pushtetin e thikës dhe të rakisë. Kërkohen mënyra dhe bëhet çmos të legjitimohen dhe të lëndojnë të tjerët, e sidomos çështjen shqiptare ta sjellin para aktit të kryer dhe të marrë fund çdo gjë me ta. Nuk çojnë dorë nga hegjemonia dhe jetojnë në një iluzion të thellë se ende ekziston Jugosllavia, pra Serbia e Madhe. Zatën, serbët dhe fqinjët e tjerë i ka munduar vazhdimisht problemi shqiptar dhe tëra kusuritjet u bënë në kurrizin shqiptar. Hetohet kjo edhe nga një tekst: Zgjedhja e propozuar për Kosovën nga *Forumi për Marrëdhëniet Etnike-OJQ e Beogradit*, të botuar më 3 qershor, në faqen 6 të *Kobës Ditore* e që na qenka mjaft autoritativ edhe në mjedise të tjera.

Por në cilat?

Besohej se pas ndëshkimit të fashizmit serb nga nën-tëmbëdhjetë vendet demokratike, në krye me SHBA, ky fis do e kuptojë më në fund se kanë të drejtë edhe të tjerët të jetojnë e të rindërtojnë shtetin e tyre ashtu si duan pa lënduar kë. Por serbët e gëlltësit e tjerë mendojnë se shqiptarët nuk kanë zot as përkrahës dhe duhet vazhduar xhuxhëzimi i tyre. Nënteksti i shkrimit të këtij forumi është copëzimi i mëtutjeshëm dhe i vetë Shqipërisë, kinse për shkak të paqes në rajon. Pra, Shqipëria të ndahet në dy pjesë: jugu e veriu, në të

ashtuquajturën republika (?!) me shpresë se Republika e Toskëve, siç e trilloi mendja e errët serbe, t'i bashkëngjitet dikur Greqisë, kurse me Republikën e Gegëve bëhet më lehtë, aty do jetojnë katolikë e myslimanë dhe asimilimi i tyre është i paevitueshëm. Këto janë dhe receta greke, që bëhen synime të hapta për gëlltëjen e jugut. Pra, tentohet në federalizimin e Shqipërisë ku “marrëdhëniet federale ndërmjet Republikës së Gegëve dhe Republikës së Toskëve” do të ishte një zgjidhje fatlume edhe për trojet e tjera shqiptare. Diçka më të zezë nuk kanë propozuar as kokat më të errëta serbe në të kaluarën. Çështja shqiptare shikohet pra ashtu siç ëndërrojnë, ëndrra serbe nuk dallon aspak nga ëndrra greke: eliminimi i shqiptarëve nga skena ndërkombëtare. Cinizmi i tyre shkallëzohet kur fillon shpëlarja e “ndërgjegjja serbe”, shkak i opinionit të jashtëm më tepër, se më në fund edhe serbët ofrojnë zgjidhje. Kërkojnë nga regjimi kriminal i Serbisë dhe SFJ “të suspendojnë të gjitha ligjet dhe dekretet që kufizojnë të drejtat dhe liritë e pjesëtarëve të komunitetit (sic!) shqiptar”. Shtrohet pyetja: ku bie Kosova? Dhe vrasjet e mijëra shqiptarëve, varrezat masive, të zhdukurit e rrënimet deri në themel i pasurisë shqiptare lejuakan mbetjen e Kosovës nën tutelën serbe?. Dhe po qe se ndodh ky farë tërmeti “Serbia dhe Mali i Zi do të mund të gjejnë kornizat e shteteve të tyre”, kuptohet në dëm të trojeve shqiptare. Iluzioni serb vazhdon me ngulm, duke u mbështetur nga krahu rusokinez. Edhe shkrime të tilla, si i Forumit “autoritativ” do të ketë në të ardhmen, bile do të shtohen variante edhe më morbide, por një qëllim do ta kenë: nxjerrjen e NATO-s dhe SHBA-së nga Ballkani, konkretisht nga Kosova dhe fillimi i tragjedi të reja. Është koha që bashkësia ndërkombëtare, siç ua bëri me dije dhe zoti Bill Clinton, t’ua përkujtojë mesjetarëve se nuk ekziston Jugosllavia dhe në Ballkanin fatkob nuk ekziston vetëm çështja serbe. Paqja të kthehet në rajon, duhet të lirohen nga iluzioni i marrë.

## PROPAGANDA SERBE E METROPOLEVE

Propaganda serbe kohëve të fundit bëhet më e zhurmshme dhe s'do ta ndalë marshin metropoleve të Evropës. Në mënyrë habitore, qoftë përmes botimeve serbe qoftë nga autorë të huaj, shkel e fyen rëndë. Posaçërisht merr flakë kur bashkësia ndërkombëtare bën përpjekje për kthimin e besimit mes njerëzve dhe në ruajtjen e paqes, atëherë kur ndërmerret të bëjë diç rreth zgjidhjes së statusit të Kosovës.

Të pavërtetat e servuara kancelarive të Evropës mbi shqiptarët mbështesin hegjemoninë dhe duan të shkaktojnë kaos në Kosovë, kinse t'u tregohet ja kë keni mbrojtur, një fis mafioz e të pa kulturë. Bëhet një propagandë e përlyer, që të çojnë dorë ata që na mbrojtën në vitin biblik.

Ndërkaq, ne na ka rrokur një vetëkënaqësi, e një gjysmë ëndrre nuk e kemi parë ende. Vrapojmë pas ndonjë gjysmë shkami, ose të zëmë ndonjë çati apo dyqan "të vjedhur"; krijojmë një kapital të vdekur, që shumë pak ndikon në rindërtimin e qenies sonë. Dhe harrojmë qenësoren: shtetin, pikësynimin tonë historik. Nëse besojmë se çdo gjë duhet të na e zgjidhë bashkësia ndërkombëtare dhe se vetëm kjo duhet të ngrehë zërin për çështjen tonë, ne krijojmë një vetëkënaqësi, që propagandës së regjimit serb i konvenon për ta shpalosur metropoleve në dritën e zezë serbe.

Rast eklatant dhe më rrënues për ne dhe për luftën tonë është dhe botimi taze në frëngjishte "*Mafia shqiptare - një kërvënim për Evropën*" botuar në "Favre" të Lozanës dhe në Paris, me autorë Ksavier Raufer dhe Stephane Quere. Zatën, botime të tilla kundër çështjes shqiptare shtohen dhe në to bëhen përpjekje që Evropa të korrigjojë të vërtetën "mbi luftën e popullit të Kosovës dhe të hedhin baltë mbi rezistencën kosovare dhe, para së gjithash, mbi UÇK-në". Sipas ambasadorit shqiptar Luan Rama, etiketohet e fyhet një luftë e një forcë.

Pas hyrjes së NATO-s dhe nxerrjes së regjimit kriminal serb nga Kosova, serbët filluan një luftë tjetër, atë të propagandës: kundër çështjes shqiptare. Dhe, e gjithë kjo zhvillohet përmes publikimeve, qofshin të autorëve serbë apo të huaj, siç ndodh edhe me autorësinë e librit të përmendur. Pra, shkrimtari austriak Handke nuk është i vetëm. Dhe, se në këtë pamflet ka dorë propaganda serbe, lë të dyshosh vendi i botimit, Lozana, ku ekziston njëri ndër institutet më të forta serbe në Evropë, i krijuar mu për këso qëllimesh propagandistike, pra për gjithfarë “fabrikimesh”.

Mbasi dihet se ç’i servohet Evropës, nuk bën të na çudisin edhe sjelljet e ca vendeve që na dolën zot e të cilat tani na shikojnë ndryshe. Shkaku i sjelljeve dhe i papërgatitjeve tona, imazhi ynë për ne po zbehet. Vetëm brenda dhjetë vjetëve të fundit regjimi kriminal serb në gjuhë të huaja lancoi një numër të madh publikimesh të shkruara enkas për çështjen e Kosovës. E ne, ku jemi e ç’bëjmë? Pakëz na dëgjohet edhe diaspora. Tamam nuk mund ia ofruam Evropës një libër për të vërtetën tonë. Menduam se për çështjen tonë të flasin të tjerët edhe në të ardhmen. Asgjë nuk bëmë dhe në krijimin e miqve, por merremi me do gjëra të imëta e intriga të kuzhinës sllave, kënaqemi me një gjysmë karrige, me një çati dhe me ndonjë shkarravinë “patriotike” të kalemhanës dhe mendojmë se kush nuk guxon nga aty të na heqë. Por, rreth e brenda nesh luhet një lojë e zezë. Nuk do mend se kjo dhe pengon realizimin e projekteve ndërkombëtare në Kosovë.

Vetë titulli i librit “*Mafia shqiptare - një kërvënim për Evropën*” njollos dhe gjërat më të shenjta shqiptare me të vetmin qëllim: bashkësia ndërkombëtare dhe SHBA të çojnë dorë nga Kosova dhe çdo gjë t’i lihet fatit; se ajo që ndodhi në Kosovë ishte një film i Holivudit.

Në këtë marshim mortor të propagandës serbe padyshim kontribuojnë dhe zënkat tona farefisnore e bajraktareske, aspak kombëtare në një kohë kur nuk dihen as kornizat e Kosovës: mbetet ajo e kohës së komunizmit apo bëhet më xhuxhe. Nuk është brengosëse vetëm Mitrovica.

Prandaj dhe propaganda serbe rrit zhurmën edhe përmes publikimeve me autorë të huaj, siç është edhe ky libër poshtërues. Por nëse duam shtet, ne duhet ta fitojmë edhe këtë luftë me mençuri dhe me të vërtetën. Në të kundërtën, vëmë në zare çdo gjë. Nuk është politikë të merresh vetëm me vetveten...



## NOSTALGJIA MAQEDONASE PËR YU

Nëse u besohet, vitin e kaluar (1999) na paskan ftuar në Takimet Poetike të Strugës. Për mosshkuarjen time e të një kolegu, paskan alarmuar opinionin se shqiptarët nuk duan të marrin pjesë as në manifestime të tilla ndërkombëtare, ku do të njoftonin se ç'kishte ndodhur në Kosovë. Pakkush mund t'u besojë këtyre marifeteve maqedonase. Së pari, gati një gjysmë milioni shqiptarë ishin strehuar kryesisht nëpër shtëpitë e shqiptarëve të Maqedonisë Perëndimore dhe në kampet e bashkësisë ndërkombëtare; së dyti, masmediat perëndimore e botërore detajisht kishin informuar për çdo gjë që ndodhte në hapësirën shqiptare. Bllaca ishte një kallëzim bibliik. Së treti, dhe masmediat maqedonase lajmëronin herë pas here për tragjedinë shqiptare, që ndodhte edhe në mesin e tyre. Ajo farë thirrjeje ishte si duket në stilin maqedonas.

Mbasi këtë vit na arriti ftesa mua dhe një mikut tim, pranova të marrë pjesë në Takimet Poetike të Strugës (2000) dhe shkaku i shqiptarëve.

Nga dita e parë venerova kurthet për ringjalljen e njëfarë shteti që për mua është një shtet fantom. Basri Çapriqin e kishin prezantuar si poet nga Mali i Zi, mua nga njësia secesioniste e ish-Jugosllavisë. Përpiqeshin shqiptarët të dukeshin oaza në atë tubim ndërkombëtar të fjalës poetike. Po që se vazhdohet kështu, ne nuk do të lexojmë, ua bëme me dije organizatorit. Na prematuan se gabime të tilla nuk do të ndodhin, por kush u beson fjalëve të tyre...

Në matinenë ndërkombëtare letrare në Kalishte (26 gusht) Kosovën e kishin vënë në korniza të ish-Jugosllavisë. Organizatorin e masmediave e bëra me dije se në një tubim të tillë kategorisht refuzoj të lexoj. Protestës sime iu bashkuan dhe poetesha nga Shqipëria Ledija Dushi dhe Basri Çapriqi, që e konsideronin ende si poet nga Mali i Zi. Nuk ekziston më Jugosllavia, u thashë organizatorëve. Ekzistojnë

shtetet: Sllovenia, Kroacia, Bosnja, Maqedonia, Kosova. Nesër do të ekzistojë edhe Mali i Zi. Më gëzon edhe pavarësia e Serbisë nëse e fiton. Por frikësohem për ju, që tentoni aq shumë në ish-Jugosllavinë.

Ishin arsyetuar se këtë listë e kishte përpiluar dikush tjetër. Kërkonin falje se Kosovën nuk do ta vënë më në korniza të ish-Jugosllavisë. Nga dita e parë hetova se fjala Kosovë është tmerruese për ta dhe u kujtonte diçka. Dhe, sa herë e dëgjonin, kisha përshtypje se rrëqetheshin. Nuk mund ta fshihnin këtë as para të huajve. Pra, bezdisja e tyre në shtypin maqedonas se i kishin thirrur vitin e kaluar shkrimtarët e Kosovës, ishte një mashtrim para opinionit të vet dhe të jashtëm.

Në manifestimin qendror URAT (27 gusht) ku hipja pas dhjetë vjetësh, dola si poet nga Prishtina. E, çdo kush e dinte se ku gjendet ky qytet. Veptoi po kështu dhe një poet malazias. Poeti serb nga ish-Jugosllavia tentoi ta prezantojnë nga Serbia. Por organizatori mendonte se më në fund arriti të luajë me përkatësinë e dinjitetin tim e të malaziasit. Para mikrofonit deklarova: jam filan filani. Vaj nga Prishtina, i cili është kryeqytet i Kosovës. Ju përsëhendes dhe ju falënderoj për gjithë atë që bëtë vitin e kaluar për Atdheun e popullin tim! Dhe kisha lexuar poezinë *Livadhi*. Të njëjtën udhë ndoq dhe poeti malazias: Podgorica nuk është shtet, por është kryeqyteti i Malit të Zi. As këto dy reagime nuk pat mundësi organizatori t'i censurojë. Transmetimi i TV-së ishte direkt.

Në manifestime të tilla ndërkombëtare të vjen keq kur përpiqen të fyejnë përkatësinë e dinjitetin kombëtar të tjetrit. E, këtë mund ta bëjnë vetëm ata që frikësohen nga liria e të tjerëve. Sidoqoftë, marritë e organizatorit lexohen si nostalgji maqedonase për ish-Jugosllavinë dhe si frikë nga pavarësia e të tjerëve që, unë e kuptoj, si paqe të tyre dhe të Ballkanit...

E, takimet u mbyllën më 28 gusht në Shkup, pa ne shqiptarët, pikërisht në ditëlindjen time.

## VRITEMI APO NA VRASIN?

Krimi përsoset dhe vazhdon të marrë jetë në mesin tonë, me gjithë forcimin e policisë ndërkombëtare. Pa marrë parasysh i cilës anë na qenkan të pësurit, para botës na rrënojnë imazhin tonë dhe kjo më shumë i intereson Serbisë. Në gabimet tona kërkojnë rehabilitimin e ngadhënjimin e tyre. Në pikë të ditës, mu në qendër të qytetit shkrep arma. Cila dorë e bëri këtë, as pas gjashtëqind vrasjeve nuk dihet. “Demokrati” i Evropës dhe i “Revolucionit” të tetorit serb, Gjingjiriq, i lëshoi zë bashkësisë ndërkombëtare për kinse lëshimet e saj dhe iu kujton se shqiptarët mund t’i qetësojë vetëm policia serbe; pra ajo që hapi me qindra varreza masive anekënd Kosovës. Ngjashëm veproi edhe z. Koshtunica me letrën e dërguar NATO-s, pas pëlcitjes që ndodhi në godinën e përfaqësuesit serb në Prishtinë. Edhe reagimet e tjera shpiejnë te një gjakderdhje e re. E paralajmëroi këtë në Samitin e Zagrebit prapë Koshtunica, i cili tha po qe se pavarësohet Kosova, do të ketë luftë. Po ne ç’bëjmë? Vritemi ose grindemi për kurrgjësend! Shesim mend kafeneve e bodrumeve të partive se me ne nuk ka.

Gjendemi në një teatër të absurdit: dënohet krimi, nuk kapet vrasësi! Luhet me ne si do zoti. Çfarë mallkimi! Vrasjet ndodhin kur nuk besohet. Vetëdijësimi e organizimi ynë kombëtar merr tatëpjetën. Nëse dikujt i intereson çështja kombëtare dhe e ndien veten shqiptar, duhet të veprojë në të mirë të kombit. Pazari i Kosovës bie. Kanë filluar të përzihen në fatkeqësinë tonë edhe të tjerët, e sidomos ata që na rrinë me gërrshërë mbi trojet tona.

Pse ndodh kjo në një kohë mjegullirash, kur shpirtërisht e kombëtarisht është dashur të jemi një? Nuk është vështirë të elaborohet. Ne duhet të jemi të vetëdijshëm se pakkush e dëshiron forcimin e faktorit shqiptar në Ballkan, prandaj na nxjerrin margjinave, në mesin tonë të krijohet kaos; të flitet nëpër forume ndërkombëtare sa më pak për Kosovën e trojet tona. Vetëm të verbërit nuk i vërejnë

lidhjet e lëvizjet mes Beogradit - Moskës - Athinës. Me rumunë, bullgarë, grekë, serbë e turq marrin pjesë dhe komunistët shqiptarë (!) në një konferencë të fshehtë në Selanik, pas të cilës qëndrojnë forcat retrograde ruse, që komunizmin e konsiderojnë për ideologji të pansllavizmit dhe dihet pse. Kërkohej aty të nxirret nga Ballkani NATO-ja, e vetmja forcë që mund të frenojë dhunën në këto anë. Po këtë e mbështesin edhe “demokratët” e sapodalë nga gëzhoja e Fyrrit serb. Pse t’ia puthim dorën vrasësit? A pak na vranë? Nëse u besohet shkrimeve nga Tirana, drejtori i Bankës Botërore për Evropën Juglindore, Portman, pas aderimit të “RFJ” në OSBE, paska thënë edhe këtë: tash e tutje të gjitha planet e projektet për zhvillimin e Kosovës do të kalojnë nëpër Beograd. Po qe se mbështetet edhe nga faktorë të tjerë kjo, bashkësia ndërkombëtare nuk është e interesuar për paqen në Ballkan e më së pakti në Kosovë. Bëhet çmos Kosova të mbetet aty ku ishte para luftës. Frikësohem se na zhveshin nga identiteti e kombëtarja dhe në këto momente të disfavorshme edhe për qenien kombëtare duhet të bëjmë më shumë për fatin tonë dhe para të tjerëve të mos tregohemi ashtu çfarë na paraqesin fqinjët tanë. Të përcaktohem: të jetojmë si njerëz apo si minj.

Edhe kjo që ndodh në Shqipëri rreth votës, reflektohet te ne. Vërtet proceset demokratike kuptohen si fisnore apo të një shoqërie civile? Përkrah ata që ofrojnë alternativa, që lëvizin gjërat në të mirë të çështjes kombëtare, me ide e përmbajtje të reja mbi demokracinë e kombëtares. Nuk rrënohet vendi për kaprice vetjake apo klanore. Ata që veprojnë kështu duhet t’u tregohet vendi. Bëhet fjalë për ardhmërinë e një populli. Fatkeqësisht në asgjësimin e vetvetes marrim pjesë të gjithë - kush më pak e kush më shumë. Ky është turp nacional që nuk ka ndodhur as në Zululandin e Faik Konicës. Të hyjmë në një aventurë të re, të mos lëmë përshtypjen para të tjerëve se ne nuk duam atdhe as liri? Ndoshta më së miri është që në maratonin tonë, ata që janë lodhur, për merita t’u jepet pensioni nacional. Besoj se me këtë pajtohen edhe zotërinjtë në Tiranë: Nano dhe Berisha. Shkuarja e tyre do të ndihmonte edhe në pavarësimin e uljen e tensioneve në Kosovë. Zotërinjve ndoshta nuk u pëlqen kjo, por mua si krijues më gëzon më shumë triumfi i kombit dhe nuk besoj se

shqiptaria ka mbetur në këta dy burra. Vritemi apo na vrasin? Kjo është sfidë e madhe për ne e për bashkësinë ndërkombëtare. Zinxhiri i krimeve mos e dhashtë Zoti të mbyllet me fundin e Kosovës. Zoti e shpëtoftë Kosovën, tha miku e rokeri, M. Limani. Le të jetë ky refren i përditshmërisë sonë derisa ta mundim të keqen...

## PAKËZ MË NJERËZOR, JU LUTEM!

Vrasja është akt i ulët pa marrë parasysh nga cila anë bie viktima e sidomos kur shtihet në fëmijë e pleq. Nga kodi ynë etik kemi mësuar se nuk shtihet në fëmijë, as nuk është trimëri të shtiesh në njërëz që janë duarthatë e nuk janë në konflikt. Po qe se dorë ka ndonjë yni, nuk di sa mund të jetë yni ai. Tekefundit, ne nuk jemi serbë dhe krimin nuk e kemi zanat. Në udhëtimin tonë aktet e vrasjes e të shkatërrimeve i kemi dënuar. Të pranojmë logjikën e barbarit, të pyesim veten më parë: për kë vras dhe kë ndihmoj në momentin e pikërishtëm kur bashkësia ndërkombëtare dhe miqtë tanë kërkojnë nga ne të përmbahemi.

Eksceset e fundit që ndodhën jo vetëm në rrethinë të Gjilanit, janë brengosëse për sjelljet e dyanshme. Paralajmërohet e keqja. Duhet të biem në grackë, nëse këto na i ngrisin të tjerët për qëllime të errëta? Nuk luhet me fatin e popullit e të Kosovës. Këto dy nocione qëndrojnë mbi çdo gjë. Të kujtojmë familjen e Jasharëve. Deri në fëmijë u bënë dhë Kosove. Me hallakatjet tona bën ta gëzojmë regjimin kriminal të Millosheviqit? Ky qysh moti nisi t'u pëshpëritë kancelarive se shqiptarët nuk e meritojnë kujdesin e bashkësisë ndërkombëtare, me ta duhet të merren forcat serbe. Në artikullin që e kisha lexuar diku në Gjermani, kasapi i Ballkanit shpresonte dhe mbështet këtë se shqiptarët do bien në konflikt me forcat e KFOR-it dhe humbjen nga NATO-ja ta kthejë në fitore. Bën t'ua mundësojmë këtë për shkak të moskontrollit tonë? Kush nuk e mohon se nuk na kanë vrarë e na vrasin, por Kosova është mbi të gjitha.

Frikën e zotit Kushner për ngjarjen fatkobe në rrethinë të Gjilanit e kuptoj edhe si shqetësim të normalitetit tonë kombëtar. Gjëra morbide të mos përsëriten, as të mos u lejojmë të na nëpërkëmbin. Paqja të vijë nga të dy anët se fëmijë e pleq të sakatosur

ka pasur edhe në anën tonë, por rajoni ynë duhet të lirohet nga gjaku i zi.

Historia serbe ka shënuar shumë shembuj ku serbët janë vrarë ndër vete e sherrin ua kanë lënë të tjerëve. Ndaj serbëve fatkob të Cërnicës mund të përsëritet ky mësim nga e kaluara e tyre, fajin t'ua lënë shqiptarëve dhe forcave të KFOR-it. Por kjo vështirë të na lirojë nga përgjegjësia, mund të jetë përzier edhe ndonjë yni e të na hedhë një hije të keqe. Mbrojtja e së drejtës për të jetuar nuk do të thotë se mbrohen edhe kriminelët. Ne ngremë zërin kundër së keqes që ndodh në vendin tonë nga kushdoqoftë. Po të tregohemi më njerëzorë, më dinjitozë, ne ndihmojmë edhe të burgosurit tanë dhe kërkimin e të zhdukurve. Liria është e të gjithëve, por shpesh lojë bixhozi. Momentalisht neve na intereson e ardhmja jonë, rreshtimi ynë dhe ç'duam nga qytetërimi evropian...

Shtrohet pyetja: pse vrasjet ndodhën në zonën e forcave amerikane? Kjo nuk do koment se regjimi kriminal serb lehtë mund të lexohet. E kanë lexuar edhe SHBA, por serbët mbasi me elaborate e memorandumë fashistoide nuk mund u ndërruan mendjen, kërkojnë mënyrë të tjera për ta fyer qenien shqiptare - se shqiptarët nuk meritojnë liri, as atdhe... Ju lutem, të jemi më dinjitozë në veprimet tona dhe të mos i kënaqim armiqtë tanë; t'u tregojmë se jemi evropianë e të zezat nuk i shkaktojmë ne...

## KTHEHEN KOMANÇEROSËT?

Demokratizimi i Serbisë mund të jetë kthesë e madhe në Ballkan po që se serbët më në fund lirohen nga iluzioni i Serbisë së Madhe dhe kuptojnë se edhe të tjerët kanë të drejtë të krijojnë shtetin e tyre. Por, fotografia e Koshtunicës tregon diç tjetër, se serbët vështirë mund të shkëputen nga e kaluara. Evropa e ka më lehtë, se moti i ka harruar varrezat masive dhe nuk ka pasur deportime biblike. Unë pakëz besoj në ndërrimet në Serbi, se nuk është gjetur njeriu adekuat, që ia do më së pari të mirën popullit të vet. Fotografia me kallashnikov e me një buzëqeshje vrasësi, në mes të paramilitarëve diku në Kosovë në vitin 1998, nuk mund t'i sjellë popullit serb e as të tjerëve paqe. Ndërrimi i Millosheviqit duhet të ndodhë, por jo me njeriun me kallashnikov në fotografi.

Serbët nuk mund të lirohen aq shpejt nga e kaluara dhe nuk mund të heqin dorë nga xhandarllëku mbi të tjerët. Mëkatet e tyre janë të shumta dhe vështirë këto të pranohen. Kështu serbët do të vazhdojnë të merren më shumë me të tjerët, sepse nacionalizmi serb do të shfaqet në një petk tjetër, që do të mashtrojë edhe bashkësinë ndërkombëtare, e cila mund të bëhet e verbër para fotografisë me kallashnikov. Pra, kthehen komançerosët më të sofistikuar e më perfidë, kthehen ata që kanë përgatitur masakrat dhe rrënimet në Bosnjë, Kroaci e në Kosovë, kthehen zjarrndezësit, që krimet do t'i japin një dimension tjetër.

Kjo që ndodh në Serbi nuk bëhet nga shkak i ndërrimit të politikës serbe ndaj të tjerëve, por nga frika se mos Serbia kthehet në pashallëkun e dikurshëm. Duke shikuar fotografinë dhe kallashnikovin në duart e njeriut që do të marrë frerët e shtetit të ardhshëm, më habit një gjë: si vazhdon të bjerë bashkësia ndërkombëtare në grackën serbe dhe me një ndërrim, ta quajmë demokratik, më në fund mori fund diktatura në bisht të saj. E me



varrezat masive, e me rrënimet, e me të burgosurit, e me të zhdukurit, e me kriminelët e luftës kush të japë llogari? A t'i falet krimi kastës politike serbe?

Pas Luftës së Dytë Botërore dihet se në aradhat e ashtuquajtura të LNSH-së, pjesa më e madhe e çetnikëve ishte rreshtuar e kishte vazhduar krimet në Kosovë, në Sanxhak e gjetiu. Ca prej tyre kishin arritur edhe në kreun shtetëror të ish-Jugosllavisë. Dhe jo vetëm ky shembull të bën të frikësohesh se historia e krimit mund të përsëritet në mesin tonë dhe prapë Ballkani t'i ngjajë mesjetës. Fatkeqësia e një vendi nuk qëndron vetëm te ndërimi i kreut të një shteti, por edhe te logjika primitive e fisit. Rast më eklatant është votimi i serbëve në enklavat e tyre në Kosovë. Pa fije turpi votuan për vrasësin, do të thotë u identifikuan edhe para botës se kush janë e me çka janë marrë e merren. E, kush mund të thotë se këta nuk do të gjenden nesër nëpër repartet e reja të komançerosëve? Dita kur populli serb të lirohet nga Millosheviqi gëzon çdokë që di çmimin e lirisë, por ata që do të gjenden në krye do të jenë të vetëdijshëm se gjaku i zi nuk shfaqet më në Ballkan? Kam përshtypjen se Evropa është mërzhitur nga ballkanasit. Ky karamboll është i mirëseardhur për të. Do të fillojnë prapë miqasitë e vjetra dhe tregtitë me popuj. Mund të ndodhë ndonjë Kongres i Berlinit apo i Shën Stefanit. Çfarë nuk pritet nga të mençurit...?!

Zotërinj, nuk e bëmë luftën për bashkimin a për konfederatën me Serbinë.

## FRIKË PËR TË ARDHMEN

Të parit të Serbisë iu hapën edhe dyert e Parlamentit Evropian. Me fanfare u prit paramilitari i dikurshëm, i cili në vitet e përgjakshme mund të ketë vrarë edhe ndonjë shqiptar ose boshnjak e të shohë sa larg e qet plumbin kallashnikovi. U dëgjuan me atë rast dhe fjalët: “Admirimin e Evropës për heroizmin e trimërinë e popullit serb” (Krye. Nicole Fontaine). E çfarë “trimërie” paska treguar ky fis sllav, e dinë më mirë kroatët, boshnjakët e shqiptarët. Paska të tillë që edhe krimin e shpallkan trimëri! Me këso sjellje nuk mund të zbutet një fis, që art e ka krimin. Po ashtu, nuk mendoj se serbët nuk bën të afrohen në familjen evropiane, por e kaluara e tyre nuk bën të harrohet aq shpejt. Euforia e ca vendeve të bashkësisë ndërkombëtare, në krye me Rusinë e Greqinë, nxjerrin margjinave popujt e dëmtuar nga paranoja serbe. Nëse thuhet gjëra të tilla në një parlament, kur disa herë është ndëshkuar, atëherë kemi punë me një hipokrizi. Nuk më çudit nëse një ditë lexojmë apo dëgjojmë se në Kosovë kurrë nuk ka pasur luftë, as nuk është e vërtetë se ka pasur varreza masive ndonjëherë, kjo është pjellë e fanstastëve. Mahnitja e Evropës pas “triumfit” të ashtuquajtur demokratik serb ndodh t’i lirojë nga ndjekjet edhe kriminelët e formatit të Slobodan Milosheviqit. Pse veprohet kështu, është mjaft e qartë. Mendojnë ca se këtë e bëjnë për të ulur tensionin në Ballkan, mirëpo harrojnë se mund të luhatet me drejtpeshimin evropian. I admiruari i evropianëve asnjë kërkesë nuk e mori parasysh. Është ky njëfarë sinjali se serbët edhe në të ardhmen do t’i shohim në rolin e komançerosëve në Ballkan.

Nëse tërheqim paralele mes nesh dhe hyrjes së Koshtunicës në Parlamentin Evropian, është katastrofike. Ca vende për çështjen shqiptare mbështeten ende në propagandën serbo-greke. Mund të ilustruhet kjo edhe me nxjerrjen tonë nga forumet e ndryshme ndërkombëtare, ku bisedohet për fatin e Kosovës. Ndodh e njëjta gjë

si në shekullin XIX kur shqiptarët nuk mund i mbronin trojet e tyre. Por, shtrohet pyetja: nëse shqiptarët nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ato forume dhe të dëgjoen, atëherë kush duhet t'i marrë në mbrojtje? Apo mendohet se ne gjendemi ende në mesjetë dhe me fatin tonë mund të luajnë si të duan të tjerët. Nëse vazhdohet të na shikojnë në këtë mënyrë, nuk bën të bëjmë sehir e të mashtrohemi se me politikën tonë nuk ka. Të bërit politikë me vetveten është turpërues në kohën kur duhet të dëgjoemi më shumë aty ku na prehet fati. Ç'na duhen bajorat e çatitë? Të padukshmit filluan të qesin Kosovën në bixhoz. Habit pasiviteti kombëtar në të dy anët e Murit, thuajse Kosova është çështje afrikane. Derdhim energjinë brenda vetes dhe harrojmë gjërat vitale, që na cilësojnë si kulturë e komb.

Me sintagmën Shqipëri e Madhe prapë luhet. Na nxjerrin si kartuç të kuq. E bëjnë këtë të fshehin apetitet e të tjerëve dhe të arsyetohet Serbia e Madhe, se kjo është diç tjetër. Nuk duan ta pranojë pavarësinë tonë. Por, ç'kemi ne të përbashkët me sllavët? Nga sirtarët e kancelarive nxirren elaborate të llojllojshme.

Alarmohet opinionioni ndërkombëtar se pavarësia e Kosovës destabilizon Ballkanin; se u formuaka Shqipëria e Madhe(!). Por, këto janë përralla për fëmijë. Etnia e një populli krijon paqen në rajon. Rreth ndriçimit të kësaj çështjeje diplomacia shqiptare u tregua e paaftë; nuk mund të krijojë aleatë seriozë për çështjen shqiptare, as nuk u dëgjua; mbeti inferiore, të mos themi servile, e dëgjueshme. Në momentin vendimtar mungon. Mendojmë se të falim edhe xhelatin bëjmë politikë të madhe. Po me sjellje të tilla dëmtojmë para së gjithash vetë Shqipërinë. Nuk çohet dorë nga e drejta për të ekzistuar si kulturë e komb.

Bijtë e luftës e të dekës treguan guxim njerëzor e kombëtar, dhanë ç'mundën. Të urtit e njerëzit e penës nuk di si do ta mbrojnë jehonën e veprës së tyre. Mu për këtë frikësohem se të ardhmes nuk i shihen konturat ende.

Loja me ne mund të përfundojë aty ku ishim: pikë e pesë.

## BETEJA PËR KOSOVËN

Të përzemërt nuk e kam politikën, por e kam një të keqe se vendin tim nuk mund e shoh sa çatia e një koteci. Për fatin e tij, ngritja e zërit arsyetohet. Punë analisti as mund të quhet konstruktimi i ngjarjeve për e rreth Kosovës. I kap këto përmes shenjave që, si krijues, i shoh ndoshta edhe me emocione.

Fatkeqësisht, në rajonin tonë nuk pranë e liga. Ka shenja brengosëse. Është thënë se në Serbi nuk ndodhën ndërrime çfarë mendohej, u bënë ca retushime. Një karrige u skajua në hije, e tjera doli në dritë. Penjtë kush i tërheq, nuk dihet ende. Shtërëngimi i duarve mes Koshtunicës dhe Millosheviqit ditë më parë bashkësinë ndërkombëtare e vuri në një situatë jo të kënaqshme. Zatën kjo bëri më shumë seç pritej për një dele të zezë. Retorika e regjimit të mëparshëm dëgjohet edhe tani, bile nganjëherë është më kërcënues. Kështu ballafaqimi i dy karrigeve lexohet siç duhet të lexohet: e humbe Kosovën, por ne do ta kthejmë me përkrahjen e aleatëve të vjetër.

Nxitimi i bashkësisë ndërkombëtare të pranojë Serbinë (Jugosllavia nuk ekziston as mund të ekzistojë shkak i hegjemonisë serbe) në të gjitha forumet e mundshme, çuditë edhe vetë serbët. Në një farë mënyre, ky vrapim ngjalli edhe nacionalizmin serb: ne mund të bëmë ç'duam! Prapë një armatë intelektualësh e krijuesish u vunë në veprim jo vetëm brenda Serbisë, po me atë retorikë serbomadhe e propagandë të tyre të njohur mesjetare. Fjalët e Koshtunicës se nuk do të dorëzohet në Hagë Millosheviqi, as të tjerët që kërkohen nga Tribunali si kriminelë lufte, e përsëritën edhe funksionarë të tjerë në stilin e njohur komunisto-nacional: Hagën nuk e pranojmë as nuk e dorëzojmë veten(!)

Bashkësia ndërkombëtare ç'do të bëjë tani me arrogancën serbe, e cila nuk përfill asgjë të saj? Siç vërehet, ne gjendemi në një

çirk, ku Evropa u mundëson edhe vrasësve ordinerë të argëtohen, pra vrasësit të kenë dhe rolin e klaunit. Një tragjedikomedi ku duan të kenë rolet edhe viktimat. Neglizhenca e proceseve frikëson. Vrapimi pas Serbisë po i qet bashkësisë ndërkombëtare një hije të keqe. Lidhjet e vjetra kanë filluar të ngjallen dhe ca anëtarë të Aleancës së Veriatlantikut, që ishin mjaft pasivë në intervenimet në Bosnjë e Kosovë, filluan të shfaqin mospajttime. Dikujt iu kujtua të shpikë “sindromin e Ballkanit”. Së pari, për të fyer NATO-n dhe, së dyti, Evropa të deamerikanizohet e sidomos Bosnja e Kosova. Vendet që fare pak u angazhuan gjatë intervenimeve në Kosovë fajësojnë NATO-n dhe SHBA-të. Më së shumti dëgjohet Greqia.

Mes shtetit represivo-hegjemonist serb dhe Kosovës dikur e pat tërhequr vijën e kuqe Bushi i vjetër. Kësaj i doli në krye Bill Klintoni. Nuk do e shkelë fjalën e babait e angazhimet e presidentit të mëparshëm as Bushi i Ri. Bëhet fjalë për një pikë të rëndësishme gjeostrategjike, çfarë është Kosova, edhe për paqen globale. Në hapësirën tonë ndodhi gjenocid i shkallës së lartë, ndjekje me përmasa biblike.

Po ç’kontribujmë ne tani? Merremi me do gjëra që rrënojnë imazhin tonë. Nuk ekziston ende diçka që na bashkon dhe na këndell(!). Kapemi për do kode fisnore dhe zhvillojmë një politikë qorre mesvete dhe tërë energjia vete disi në distruksion.

Është rastësi apo kurdisje, nuk e di: Lajmet nga Athina i konfirmoi edhe agjencia serbe BETA: javën e kaluar në një hotel të kryeqendrës greke e në të njëjtin kat, ndoshta dhe në të njëjtën dhomë, nën dritën e qiririt grek, paskan kaluar natën dy zotërinj, njëri nga Beogradi e tjetri nga Tirana. Nuk dihet të kenë biseduar e çfarë mesazhe u dërgojnë qendrave të tyre. Por zoti Nano nuk është hera e parë që u zgjat dorën. Në Kretë qe takuar me nxënësin e Koshtunicës, Millosheviqin, dhe sipas zotërisë, ishte ndarë triumfues. Mbetet të shohim si është ndarë me mësuesin e Kasapit të Ballkanit. E, për këtë duhet pritur filterin grek. Nuk kam asgjë me marshutën e “rastësishme” të zotërisë nga Tirana, por te ata që na vranë e na tkurrën vazhdimisht, nuk kërkohet mbështetje. Ndoshta për mua

politika është matematikë e lartë. Edhe këtë shëti t'ia lëmë ndërgjegjes...

Beteja për Kosovën nuk dihet kur e si do të kryhet. Boshti ortodoks bën përpjekje t'i nxjerrë SHBA-të e NATO-n nga Bosnja e Kosova, të krijojë kaos në Ballkan, që do t'i konvenonte më së shumti Ruisë për riinkadrimin e saj si superfuqi ose të coptojë Kosovën në dy etnitete. Të besojmë në arsyen njerëzore për pavarësi të Kosovës, që vështirë mund t'i mohohet.

## FUNDI I NJË PARANOIKU

Ç'është ajo atje? Një tepsi, zotëri. Ka kohë që bredh këndeje. Ç'kërkon? Ku ta di. Do të ketë diçka? Dakiku i fundit bie, thonë. Pastaj? I mbetet të zgjedhë ai farë vozhdi. Këndeje apo andej. Dhe? Do të përcaktohet për më të rëndën, si duket. Ku e qet plumbin pushka jote? E shkeli Malin e Zi, turpërohet; hyri në Kosovë, arsyetohet se humbi nga më i forti. Do të thotë? Do ta shohim aktin e fundit. Po ajo tepsi e zbrazët? Tani për tani e larë. Duket e tmerrshme. Ndjell zi? Çka nuk ndodh në Ballkan: shpesh i zë gjaku njerëzit. Këtë farë vozhdi moti e ka zënë, por nuk ka kush t'ia presë veshin. Ashtu! Ka qejf të ecën rrugës së njëfarë Car Lazarit. Po kush është ai? I vrarë në tokë të huaj e i shpallur për... Do të thotë, ky farë vozhdi imiton atë? Para pasqyrës të tillë e sheh veten. Po të tjerët? Ja mundësojnë të bëhet azgon. Është trimëruar? Sa nuk bën. Orë e çast e shikon orën në Sahat Kullë. I bëhet nganjëherë se ecën ngadalë, nganjëherë i shtyer me dorë. Një Zot e di pse kaq shumë e shikon orën. Po ç'orë? Atë të xhepit. Tërë fisin e vet e mban aty. Nuk qenka aq i vogël? Mban mend ç'i kishte thënë gjeneralit amerikan në takimin e fundit? Ma kujto, të lutem! I kemi vrarë e do t'i vrasim shqiptarët. A e sheh Stambollin ndonjëherë ky farë...? I shtihet në ëndërr Gazimestani. Po ku bie Serbia? Në Serbistan. Ky Serbistani gjendet? Në Pashallëk, zotëri. Po sa është i madh ky farë vendi? Sa një fund livadhi. Ashtu. Vë bast se ky farë vozhdi luan me lëkurë të vet kësaj herë. Kështu thonë edhe të Presidencës. Vë bast, tepsia atje nuk është kot. Shihni ëndrra, zotëri? Unë nuk kallëzoj gjeputa, Bajraktar. Ajo tepsi nuk bën të vërvitet e zbrazët më. Përnjëmend e keni, zotëri? Unë nuk kallëzoj as përralla, bajraktar. I mbetet të zgjedhë ky farë... Nuk biejnë më lulëkuqe të ne. Po pastaj, zotëri? Në krye të të vdekurve nëse prin tepsia kthehet plot në Pashallëk. E pamundur, zotëri! Mos baj gajle, Bajraktar. Edhe për këtë mendon Padroni i tij. Kush? Lëre më vonë punën e regjisorit. Por

kur do të shfaqet filmi? Është aktrimi i fundit i vozhdit. Syri ynë është i gjithëpushtetshëm. Kap edhe atë që e sheh në ëndërr ky farë vozhdi. Ne asgjë nuk na shpëton. Ashtu thonë dhe në Presidencë kur dëshirojnë të fotografohen. Tepsia atje paralajmëron fundin. Pastaj? Pastaj do t'i thotë Padroni na bezdisët me atë farë cari. Është koha të shkosh pakëz në pushim. Biletën e keni në filan vend dhe aeroplani iu pret aty. Vozhdi kalon pranë tepsisë. Për herë të fundit shihet te Sahat Kulla. Hap shuplakën dhe mbyll Pashallëkun. Populli thyen parmakët. Formon rrethin e rrethi vazhdon të shndërrohet në një vrimë të thellë. Pas pak fluturon diçka në hava. Populli derdhet pa e dëgjuar ndjesën e vozhdit. Dikush ndez Radiofushën. Spikerja përsërit lajmin taze: në hapësirën e pidentifikuar ndodhi një aksident i rëndë. Aeroplani i carit të Serbistanit u zhduk. Hetimet vazhdojnë nga të gjitha anët. Dhe në shtresat qiellore e nëntokësore.

Tepsia nuk shihet. Një fëmijë del nga gërmadhat dhe vrapon me një lule. Kërkon fituesin mes varrezave.



## EVROPA HARRON SHPEJTI

Nuk e kisha parë moti një mik. Në bisedën tonë ra fjala edhe për një tekst të Mirko Kovaçit, të cilit ia kishim botuar dy romane shumë vjet më parë. Gjatë bombardimeve të NATO-s e kishte besdisur një kalemxhi serb nga Parisi: shiko ç'na bën bota për një racë të ulët. Kovaçi kishte mbyllur telefonin dhe kishte shkruar më vonë tekstin, të cilin miku im e kishte lexuar në Paris. Seç kishte ndodhur pas atij rebelimi të Kovaçit, nuk na intereson. Por as në fund të shekullit njëzet pjesa dërrmuese serbe nuk mund të na shikojnë ndryshe nga Garashanini, Cvijiq, Çubriloviq, Andriq e ca helaq të kohës sonë.

Zatën, kalemxhia që na shihte si baballarët e vet, e që ishte bërë shkas i tekstit të Kovaçit, nuk është i vetëm. Dhe derisa bombat e NATO-s binin aty ku lypsej, nëpër metropolet e ndryshme strehoheshin shumë të tillë. Shpalleshin për kundërshtarë të regjimit kriminal serb dhe krijonin hapësirë për të lëvizur, pra vazhdonin veprimtarinë e tyre, që më së pakti kishte lidhje me thirrjen e tyre që deklaroheshin. I tillë kishte qenë edhe serbi bezdisës, që i kishte telefonuar Mirko Kovaçit. Shumica nga ta thonin se ishin nga Kroacia, Bosnja e Sanxhaku. Të tillë kisha takuar edhe në Gjermani, ku numri i tyre nuk dihej.

Është për t'u çuditur se nacionalizmi serb gjen hapësirë të mjaftueshme dhe përkrahës nga intelektualët e shkrimtarët e tipit të Petër Handkes. Se shqiptarët janë racë e ulët dhe rrënues të paqes jo vetëm në rajon ku ekzistojnë; se ishin tubuar rreth të ashtuquajturës UÇK-ës dhe torturonin popullsinë serbe gjithandej Kosovës, dëgjohej gati në çdo tubim, ku debatohej për atë që ndodhte në Ballkan. Dhe vështrë gjeje ndonjë që gjërat i shikonte në tjetër dritë. Shpesh mendoja ku gjithë ky vrerë ndaj nesh.

Në një librari të Frankfurtit ishte zënë në flagrancë një “bursist” tek fotokopjonte fotografi të shumta nga krimet serbe në Drenicë e përgatitej t’i dërgonte në adresa të caktuara, si dëshmi masakrash nga terroristët shqiptarë ndaj popullsisë së “pambrojtur” serbe në Kosovë. “Bursistit” iu kishin rrëmbyer të gjitha materialet dhe nuk di ç’kishte ndodhur me të. Por Gjermania, megjithatë, ndryshe pagëz është nga Italia apo Greqia.

Ditë më parë Sergjan Popoviq mori në mbrojtje Koshtunicën dhe nacionalizmin e tij. Sipas tij deklarimet e presidentit të ri ishin pozitive, edhe pse me bashkëmendimtarët e konsideron Kosovën pjesë të Serbisë dhe forcat serbe duhet të kthehen në vendin e krimit! Disi ngjashëm veproi dhe z. Vesna Peshiq në një emision TV italian. Deklaroi se Kosova me Serbinë nuk mund të kenë kufij, kufijtë duhet të ekzistojnë në anën tjetër. Pra, nuk ishte ajo Vesna që kudo në Evropë deklarohet për paqe në rajon dhe lozte rolin e një pacifisteje.

Fatkeqësisht, Evropa vazhdimisht i ka strehuar intelektualët e tillë dhe i ka marrë në mbrojtje. Simpatitë e saj shpesh u bënë dhe krahu të dhunës. Shumë lehtë ranë në gracka pacifistët dhe të gjelbërit. Kishin ngritur zërin edhe kundër bombardimeve të NATO-s. Dhe nuk ishte hera e parë që simpatia e ca vendeve evropiane vete në drejtim të kundërt. Më kishte pyetur një herë njëri sa kilometra ka Kosova. I kisha treguar dhe pa fije turpi më ishte përgjigjur ai: nuk mund e humbasim gjithë atë hapësirë ruse për juve. Kishte ndodhur shkretërimi i Çeçenisë dhe vërtet nuk kishin ngritur zërin fare. Pra, nuk do të thotë se Evropa nuk gabon. Shikon çështjen e vet, që shpesh i vjen era dhe biznes njerëzor. Nuk bën të na çudisë pse kaq shumë vrapohet pas Koshtunicës dhe harrohet se ç’kishte ndodhur në Kroaci, Bosnjë e Kosovë. Harresa e Evropës mund të sjellë dhe të papritura. Ndryshe janë amerikanët. Kanë kod të fortë etik, thoshte Borhes.

Bën, pra, dhe ne të harrojmë ç’përjetuam?

## LIRIA SI BURGIM

Në momentin e pikërishtëm në Evropë më të zhurmshëm janë ata që nuk kanë përjetuar dhunën ose e kanë harruar atë. Pritet që të tillët të bëhen edhe më të zhurmshëm, kur shqiptarëve po u kundërvihen të gjitha kancelaritë, e posaçërisht disa shtete që nuk mund t'i shohin me sy SHBA-ja në Ballkan as në Evropë. Përmes ndonjë ekscesi të shqiptarëve bëjnë çmos të fyejnë NATO-n dhe SHBA-në e të lirohen nga kompleksi. Pra, disa vende evropiane, në kurrizin shqiptar, synojnë fitoren mbi SHBA-në, që mund të lexohet edhe si intrigë ruse.

Ky nuk është moral!

Mirëpo realiteti është diçka tjetër. Gjithë këto kërcënime ndaj shqiptarëve ndodhin edhe për shkak se shqiptarët për herë të parë ditën të orientohen dhe të dalin nga ombrellat e gëlltitësve, që i tkurren e i copëtuhan sa herë deshën, qoftë në Kongresin e Berlinit (1878), qoftë në konferencat e Parisit e Londrës. Arsyeja tjetër është se disa në Evropë nuk dinë vërtet se çfarë të quajnë moral. Nëse mendohet se duke ia puthur dorën një regjimi kriminal, që vrau fëmijë, gra e pleq dhe hapi me qindra varreza masive, që krijoi krematoriume të fsheh krimin, ka të drejtë prapë të vrasë e të vendosë për fatin e kufijtë e shqiptarëve, po ky nuk është moral e më së paku mund të quhet e drejtë njerëzore! E krijuesit, intelektualët e pushtetarët e tillë asnjëri normal nuk mund t'u japë krah, përkundrazi krijon distancë dhe neveri. Mua si njeri e krijues më tmerron liria e kriminelëve të luftës dhe përkëdheljet ndaj tyre nga ana e Evropës nuk i shoh si shenjë të mirë. Unë nuk mbështes dhunën, as nuk ia cënoj

lirinë askujt, por e drejta për të jetuar nuk pranoj se në lirinë e përbashkët duhet të ketë edhe viktimat?!

Është e turpshme kur nga të gjitha anët vijnë akuza e kërcënime ndaj shqiptarëve, nëse ndonjë kriminel na qenka vrarë në kufi të Kosovës dhe nuk e shohin të arsyeshme të reagojnë ndaj masmediave vendore, që fyejnë me qindra varreza masive shqiptare dhe disa i shpallin edhe të trilluara, siç ndodhi me Reçakun nga injoranca televizive gjermane. Apo angjeneral shqiptarët shpallen destabilizues e vrasës, ashtu siç kërkon çarshia serbe. Por kjo lexohet si lojë qorre e Evropës, e cila kërkon interesin e vet në fatkeqësinë njerëzore. Bëjnë çmos të vënë në pyetje edhe arsyetojnë vrasjet masive të shqiptarëve nga regjimi kriminal serb, që Evropa filloi t'u marrë dorë. Do kleptomanië mendojnë se me pakësimin e shqiptarëve kthehet stabilizimi i Ballkanit. Ky është mashtrim i mësuar keq nga propaganda e mjerë shoviniste serbe. Dhe, po që se vazhdon të mendohet kështu gjithandej Evropës, paqja do të jetë larg, e cila është më se e nevojshme për të gjithë ballkanasit.

Mësimi i evropianëve nga propaganda serbe është një fatkeqësi e vetë evropianëve, të cilët duket se nuk e njohin historinë e ballkanasve, bile as të veten. Pra, kemi punë me njerëz që nuk u intereson e vërteta, dhe mu për këtë vështirë t'u besohet fjalëve të tyre. Nga një regjim kriminal nuk mund të mësohet asgjë. Njoh shumë serbë intelektualë e krijues që dinë ç'do të thotë liri dhe nuk pranuan të kthehen në Serbi, sepse "blic revolucionin demokratik serb" e kuptojnë si farsë dhe mashtrim ndaj Evropës, e cila ka zënë të humbasë drejtpeshimin.

## Evropa po gëlltit gënjeshtren serbe

U bënë dy vjet e një kriminel të luftës bashkësia ndërkombëtare nuk e vuri para drejtësisë. Lë përshtypjen se me amnistinë e shqiptarëve, të amnistohen edhe kriminelët e luftës. Po ky do të ishte fundi i një Evrope demokratike çfarë proklamohet. E këtë mund ta mbështesë vetëm e ashtuquajtura kope intelektualësh evropianë, të

cilët mjerimin e tragjedinë njerëzore e kuptojnë si levërdi të tyre personale.

Beqë Cufa ka të drejtë që alarmon për shthurjen e kësaj kopeje. Tani është atraktive të nëpërkëmbet një popull, që nuk di edhe sa varreza masive duhet hapur e ku fshihen të zhdukurit. Është e vërtetë se kam qenë shpesh në metropole, ku i kanë botuar librat e mi, por nga zotërinjtë kam dëshiruar të di vetëm një gjë: dinë ndonjë rast që shqiptarët kanë hapur varreza masive serbe, dinë ndonjë rast që shqiptarët u kanë nxjerrë fëmijët nga barku nënave serbe? Askush nuk ka pasur guxim të tregojë diçka makabre nga ana e shqiptarëve, ndërsa tani propaganda serbe rrënimet e varrezat masive anekënd Kosovës ia deponon Evropës si rrëtime e varreza masive serbe. Por Evropa e gëlltit edhe këtë, se rrenën serbe e pranoi si të vërtetë. I mbylli sytë edhe para vrapimit “panortodoks” që t’u dalin ndihmë vëllezërve maqedonas, të cilët qenkan zënë me një grusht shqiptarë të “çmendur”, pse duan ta ndjejnë veten të lirë e si njerëz. Kjo dëshmon se, kur është çështja shqiptare, Evropa e kërkon interesin e vet. Dhe, ç’ka kjo lidhje me moralin? Mua më vjen turp nga etika krijuese e njerëzore, kur tërë një Evropë dele të zezë sheh vetëm në taborrin e shqiptarëve. Ndoshta për këtë janë fajtorë dhe liderët tanë. Kanë dëshirë më shumë të shihen në masmedia sesa ta mbrojnë ndonjë çështje kapitale para ortekut evropian(!).

## Respekt dhe liri për të gjithë

Nuk mbështes se serbët e maqedonasit nuk bën ta gëzojnë përkrahjen e bashkësisë ndërkombëtare, por nuk mund të pranohet se serbët e maqedonasit duhet liruar nga krimi e përgjegjësia ndaj të tjerëve. Nëse vazhdon ky ledhatim me kriminelët, pagja vështirë arrihet në Ballkan. Nëse Evropa ka probleme me SHBA-në rreth konceptit të lirisë dhe demokracisë, kjo nuk mund të zgjidhet, duke i etiketuar shqiptarët me gjithfarë epitetesh.

Unë vazhdimisht marr thirrje nga metropolet, por fatkeqësisht unë jam një i burgosur në liri. Bashkësia ndërkombëtare nuk ma

mundëson të lëviz, se nuk kam dokument dhe nuk jam i barabartë me të tjerët. Si unë ndihen shumica e kosovarëve. E ky nuk është turp shqiptar, por i evropianëve, që fatkeqësisht nuk e dinë mirë historinë e ballkanasve, por çdo ditë gozhdohen si Krishti në rrenën serbe. Kërkoj respekt e liri për të gjithë dhe, në mileniumin e ri, nuk mund e shoh vendin e popullin tim më të copëtuar. Kjo nuk është e drejta ime.

As Beqa nuk bën të shqetësohet. Hera e parë nuk është që Evropa luan majtap me ne...

## SHQIPËRIA NË MILENIUMIN E RI

Makina e bardhë kishte humbur në terrinën e Arbërisë. Nuk dija e sata gropë ishte. Nga përplasjet prekja plafonin e planetit tim. Dikur ishte fikur edhe motori e një dorë leshatuke parahistorike kishte hapur derën.

- Mirë se vini në antikël!

E kisha shikuar njeriun e veshur në rroba ndezëse dhe me një buzëqeshje kisha pyetur:

- Me sa gropa është kjo udhë?

Zotëri, të mos ishte e tillë, nuk do e shijoni antikën shqiptare.

- Po pronarët e këtyre villave të bukura, nuk mund e hedhin ndonjë kamion me rërë?

- Këtu qëndron problemi. Nuk mund të bashkohen të giorët. Ishte përgjegjur rojtari me theks verior.

- Do të thotë?

- Do të thotë vetëm në këtë mënyrë e përjetoni antikën shqiptare,

- Në këto anë banojnë ndoshta zotërinjtë Berisha dhe Nano?

- Fatkeqësisht edhe këtu vepron mendja e tyre. Ja pse ne nuk mund të shkëputemi nga antika...

Prapë dora parahistorike kishte mbyllur derën e makinës, e cila kishte vazhduar udhën edhe më tutje. Kisha harruar çfarë ngjyre kishte. Arbëria ishte një yll i largët e gati i padukshëm në Planetin Ka Ka...

*(Tiranë, dhjetor 2000)*

## BAJRAKTARËT DHE QENTË

Kallëzojnë në qytetin tim se pasi ishin vrarë e prerë ndërveti bajraktarët, i kishin çuar fjalë njëri-tjetrit se mund të takoheshin në ndonjë nahi neutrale. Asnjëri nuk kishte kundërshtuar. I kishin mbledhur të vrarët e i kishin varur armët thuajse asgjë nuk kishte ndodhur mes tarafeve. U kishin hipur kuajve më të mirë e kishin rënë në atë farë nahi neutrale. Kallëzojnë pastaj se ata kishin bërë pallën e sefasë: kishin pirë e hëngër desh të pjekur rreth hellit të zjarrit, që shihej kushedi se ku. Ngapak dhe kishin kurvnuar e lidhur miqësi.

Mirëpo, kur u ishin sosur të gjitha me shishe e tepsi, ia kishin filluar do bisedimeve fort të prera mes tarafeve. Kishte pyetur dikur i pari: po sa qen t'u vranë? Më pak se ke shkrepur plumba. Iu kishte gjegjur tjetri rreth zjarrit. Po ty? - kishte pyetur të parin i dyti. Aq sa ty. Iu kishte gjegjur i pari me kokë të ulur. Me ferk ishin ngritur e përqaftuar dhe secili kishte rënë në bajrak të vet. Prapë ishte dëgjuar pushka dhe gjëma derisa kishte ndodhur një sebeb tjetër qejfi. E kështu me radhë ishin pakësuar tarafet e “qentë”.

Para një kallëzimi të tillë morbid, i cili mund të kallëzohet në varianta e me ditë, njeriu normal shtanget dhe nuk mund të rrijë pa sharë. Në këtë hasmëri të tarafeve, kallëzojnë më vonë, dorë kishte pasur hasmi që me mjeshtëri ua kishte përzier punët. Bajraktarët Atdheun e shihnin aty nën çati dhe e konsideronin të madh sa, bie fjala, livadhi i Hasanit, ose nuk e shikonin kurrëgjë më të lartë se Suka e Cërmjanit. Shtrinin shuplakën pastaj e mendonin se e tij është deri aty ku bie kokrra e plumbit. Se kush ishin ata “qentë” për bajraktarët, nuk mund ta them se fyhem si njeri e krijesë. E vërteta qëndron se në të dy anët ishin vrarë shqiptarët e gjorë, që kishin përcjellë bajraktarët edhe atje ku ata bënin qejf në oda të fshehta. As vetë nuk di pse hapa këtë plagë, që aty-këtu ende mund të kullojë. Sall kam të drejtë të frikësohem në momentin e pikërishtëm, mos po e pranojmë lojën e



bajraktarëve. E kjo më tmerron kur në bazë të nahive e krahinave duam t'i ngremë edhe partitë. Ndonjë recidiv i të kaluarës së largët, për të cilën më kallëzonin shpesh të urtit e mëhallës, po të qesë kokë do të ishte turp edhe për elitën intelektuale. Një gjysmë karrige nuk mund t'ia zërë vendin çështjes kombëtare. E asaj pakkush ia ka parë hajrin. Unë frikësohem se mos krahinizohemi, lagjizohemi, çatizohemi e po harrojmë diçka më të shenjtë...

## FERKU

Pas tërmetit Burri i Dheut e kishte shikuar orën. Mbi Bjeshkë të Namuna syri ia kishte kapur harkun e mprehtë të dritës nën magjinë e së cilës veneronte vrimat në Kullë. Një i marrë e kishte shpër popullin deri atje, ku kishte filluar dhe ëndrra, fundin e së cilës pakkush di ta kallëzojë. Dheut, Ujit të Madh e Zjarrit i kishte vënë veshin. Ende bubullonte rreth një Cungu njerëzor.

*(Gjakovë, mars, 2001)*

# PËRMBAJTJA

<b>DIELLI I ZI</b> .....	7
Shqetësimet e imazhit të ri .....	9
<b>MBI FATIN DHE MJESHTËRIT E ÇELËSAVE</b> .....	11
Pasqyra e një fatumi.....	11
Kosova formë e vrazhdë e lirisë.....	18
Intelektualët e bodrumeve dhe viçat .....	23
Të fyerit vendosin për të ardhmen.....	28
Miti që vazhdon.....	32
Mbi fatin dhe mjeshtërit e çelësave.....	36
Përballë realitetit .....	40
<b>FOTOGRAFITË E ZEZA</b> .....	45
Në një kohë robërie.....	45
Ëndrra polare .....	49
Fotografitë e zeza .....	53
Lufta tek ka filluar .....	57
Kur vjen e nesërmja.....	62
Fund i carëve.....	67
Kantonizimi - fund i Kosovës .....	69
A është çliruar Kosova.....	73
Në kërkim të dinjitetit .....	76

Logjika e mediokrit.....	80
Maskat lojë e rrezikshme.....	82
Bariu serb dhe biçiklisti shqiptar.....	86
Baladë për paqësorët.....	89
Fatet.....	91
<b>DIELLI I ZI.....</b>	<b>94</b>
Ky nuk ishte ferku.....	94
Dielli i zi.....	95
Kopshti do frymëmarrje.....	98
Ç'do të bëjmë pa Kalderonin?.....	99
Nën hijen e Shën Albanit.....	100
Mbi identitetin.....	102
Përmendoret.....	104
<b>MARATONI.....</b>	<b>106</b>
Etnia pikëmbështetje.....	106
Nuk bën të përzihemi në zanatin e primitivëve.....	111
Besoj në të nesërmen.....	114
Përbindësh mesjetar nuk mund ta shoh shqiptarin.....	118
Bukuria trishtuese.....	122
Nga shënimet e një frikacaku.....	123
Credo.....	124
Fundi i ëndrrës.....	125
Hapja e librit.....	126
Shënim.....	127
<b>ËNDRRA KALLËZOHET NË MËNGJES.....</b>	<b>129</b>
Muzgu.....	131
Maskenballi kombëtar.....	132

LEXIMI I XHAMIT TË ERRËT.....	135
Shkrimtari i fëmijërisë sime.....	135
Leximi në xhamin e errët.....	138
Zë i ndërgjegjësimit.....	141
Antikiteti në modernitet .....	145
Triptikon .....	148
Kadare: Pakëz letërsi Kosove (!).....	152
E shtunë pas një të premtje .....	157
Mungesa e nderit.....	163
Grafomanët.....	165
Mediokri vrasës i mundshëm .....	168
Dinjiteti dhe shkrimtari.....	172
Defekti njerëzor.....	176
Ndërrimet, triumf i ri.....	179
Dersi i Akademisë Suedeze.....	182
NJERIU I DY MILENIUMEVE .....	184
Vrima e Mishos .....	184
Liria në kohën e kaosit.....	187
Magjia e një dege .....	190
Bukuria e tmerrit .....	193
Molla .....	196
Karagjozët.....	199
Vendi ku nuk vdiset.....	203
Mbamendja.....	206
Pse ky tekst ka zjarmi?.....	209
Njeriu i dy mileniumeve .....	212
TI DHE VRASËSI.....	215
Ëndrra kallëzohet në mëngjes, në kohë të bukur.....	215
Vrasja e ëndrrave.....	220
Baladë për njëqind e katërdhjetë e tre .....	222
Lot e dasma .....	224
Romani për hallën Dudi.....	226
Lufta e dytë e femrës sonë.....	228

Ndërrimi i imazhit fyen .....	230
Identiteti i kërcënuar.....	232
Ku është shteti ynë?.....	235
Ti dhe vrasësi .....	237
Shndërrohet Kosova në rezervat?.....	239
Testimi i dinjitetit.....	241
Troket anarkia .....	244
Për një katedrale në Prishtinë.....	246
Tragjedia si mesazh.....	248
Letër e hapur z. Kushner .....	250
<b>FRIKË PËR TË ARDHMEN.....</b>	<b>256</b>
Gjenocidi i pushtetit serb .....	256
Re të zeza në horizont .....	258
Shpejtësia.....	260
Mimikëria serbe .....	262
“Virtyti” serb .....	265
Iluzioni serb .....	268
Propaganda serbe e metropoleve .....	270
Nostalgjia maqedonase për YU .....	273
Vritemi apo na vrasin .....	275
Pakëz më njerëzorë, ju lutem! .....	278
Kthehen komançerosët .....	280
Frikë për të ardhmen.....	282
Beteja për Kosovën .....	284
Fundi i një paranoiku .....	287
Evropa harron shpejt.....	289
Liria si burgim .....	291
Shqipëria në mileniumin e ri.....	295
Bajraktarët dhe qentë.....	296
Ferku .....	298

ALI PODRIMJA

# VEPRA

Vëllimi i nëntë

Prishtinë, 2013

Botues:

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Design: ZENI BALLAZHI

Radhitja & faqësja: BURIM REXHEPI

Lektor & korrektor: SHEFQET RIZA

Madhësia: 18.93 tabakë shtypi

Tirazhi: 500 kopje

Formati A5 (14.8 x 21 cm)

Shtypi: FOCUS-PRINT, Prishtinë-Shkup

Katalogimi në botim – **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

821.18-4

821.18-92

Podrimja, Ali

Vepra =Works / Ali Podrimja. - Prishtina : Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës : Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 2013. - 9 libra ; 21 cm.

Vëllimi 9 : Dielli i zi : (ese dhe shënime nga esnaf i krijues) ;  
Ëndrra kallëzohet në mëngjes. – 303 f.,  
portreti i autorit

**ISBN 978-9951-615-14-3**

**ISBN 978-9951-615-23-5**